40 faqe

Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 11/12 (163) / 2019. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË.

Redaksia e gazetës ju uron Gëzuar Festat! Ardhtë një vit i mbarë në familjet tuaja!

STUDIM

Epoka e Gjergj Kastriotit, bazament i vetëdijes kombëtare shqiptare

Nga Dr. **ENVER HALILI**



36

PROFIL

Misionet angleze dhe përshtypja e tyre për krerët dibranë

Nga **RODERICK BAILEY**



33

PROFIL - 1 VJETORI

Ruzhdi Lata - meteor i pashuar i tokës dibrane

Nga **MALVINA KALOSHI TAFCIU, NEKI KALOSHI, MUSA RIÇKU**


16



Pamje e tunelit në Rrugën e Arbri, mbyllur pas shembjes. Foto: B.Karoshi

Shembja e tunelit rrit koston e Rrugës së Arbrit

Ahmetaj: Rruga e Arbrit do të jetë pa pagesën. Balluku: Rruga e Arbrit pritet të jetë në funksion në mars të vitit 2021. Burime nga kompania: Deri më tani janë kryer rreth 50% e punimeve në volum. "Gjoka '87" mori në fillim të dhjetorit një pagesë nga qeveria shqiptare prej 630 milionë lekësh (rreth 5.16 milionë euro) për punimen e kryera. FAQE 3

KONFERENCA SHKENCORE / STUDIMI

Ndjekja nga LID dhe Gazeta "Rruga e Arbërit" e punës së kryer për ndërtimin e Rrugës së Arbërit gjatë viteve 2007-2018 dhe ecuria e punimeve të ndërtimit të kësaj rruge në periudhën 2018-prill 2019

Autorë: **BASHKIM LLESHI, MUSA RIÇKU, BUJAR KAROSHI, HYSEN UKA**

Pas shumë përpjekjesh, në vitet nëntëdhjetë e fillimin e viteve 2000, të shoqatave "Nisma Dibrane" në Peshkopi, "Bashkësia Dibrane" në Tiranë e "Votra Dibrane" në Dibër të Madhe, si dhe shumë studjuesve e intelektalëve dibranë u arrit që më 2003 të futet në planin e shtetit "Studimi i fizibilitetit të Rrugës së Arbërit" i cili u përfundua nga Studioja "Infratransprojekt Ltd" në fund të vitit 2003, ku u miratua dhe në Këshillin teknik të Drejtorisë së Përgjithëshme të Rrugëve. Më qershor të vitit 2004 u miratua dhe në Këshillin Kombëtar të Rrugëve. Kështu i gjithë komuniteti dibran mendoi se u hap drita jeshile që edhe Dibra të bëhej me rrugën që i takonte për t'u lidhur me Tiranën. Në qershor të vitit 2005 në prag të zgjedhjeve parlamentare, ish kryeministri Nano vendosi një tabelë të madhe, afër Gurëve të Skënderbeut në dalje të Bulqizës, ku shënohej se filluan punimet për ndërtimin e Rrugës së Arbërit dhe filluan gërmimet me një buldozier të madh, pa u hartuar dhe miratuar projekti teknik për segmentin Dalje e Bulqizës-Ura e Çerenecit, ku sipas studimit të Fizibilitetit rruga duhet të hapej në krahun tjetër të luginës nga Draguni në Fushë Bulqizë. Menjëherë pas zgjedhjeve punimet u ndërprenë dhe me gjithë premtimet edhe të krahut që fitoi zgjedhjet se do të fillohej menjëherë nga projekti i zbatimit e ndërtimi i rrugës, u deshën edhe dy vite të tjera të planifikohej e miratohej projekti teknik i segmentit Bulqizë-Ura e Cerenecit më 2007. *(Faqe 4-6)*

SPECIALE / IKJA E AGRONIT



"Ne jemi me Agronin"

Opinione dhe komente nga:
ADEM BUNGURI, ADIL OLLURI, AG APOLLONI, AHMET PRENÇI, ALBAN TUFA, ANTON NIKË BERISHA, ARBER AHMETAJ, ARTAN GJYZEL HASANI, BALIL GJINI, BARDHYL LONDO, BESNIK MUSTAFAJ, BUJAR KAROSHI, EMIN AZEMI, FLURURA AÇKA, GAZMEND KAPLLANI, ILIR SECI, RAMIZ GJINI, VISAR ZHITI

FAQE 17-27

NË BRENDËSI:

■ Minatorët e Bulqizës në protestë ■ Ndërtimi i HEC-eve me ndikim në mjedis dhe në konflikt me banorët ■ Për një lapsus... ■ Menaxhimi i fermave blegtorale, qëndrueshmëria dhe sipërmarrja nga të rinjtë ■ 400 mijë dollarë ndihma për Spitalin e Bulqizës ■ Ferma e familjes Ndregjoni ■ Ramadan Çaushi (Halili) i Grezhdanit në Rrethimin e Shkodrës (1912-1913) ■ Masakra serbe në Sopot të Zerqanit ■ A do të shkojnë lurasit të vendosin një kurorë në Symizë të Mallakastrës? ■ Jufkat e Dibrës... ■ Urdhëri "Naim Frashëri" për ansamblin "Kuvendi" ■ Shtegu i kodoshëve ■ Pus i thellë ky "Bunari" i Fatmir Terziut! ■ Dritëhijet e pinjollëve të parë të fisit Murrja - Halili dhe Osmani ■ Luftëtari e burri mentar Zenel Hoxha ■ Sherif Dervishi, biri i Dardhës ■ Eh, more Nexh Tomçini ç'na bëre...

Rruga e Arbërit rrugaearberit Bej "**Like**" dhe "**Share**". Pajtohu dhe qëndro me gazetën #rrugaearberit më pranë #Dibrës!

Për më shumë informacion: Tel: 00455 68 65 08 441. Email: rrugaearberit@gmail.com | www.rrugaearberit.com +355 **68 65 08 441** +355 **69 20 68 603**

cyan magenta yelloë black 1

Gazeta "Rruga e Arbërit" është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 11/12 (163). Nëntor - Dhjetor 2019
Gjendet në treg gjatë gjithë muajit Nëntor 2019.

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Editor i faqes online: Agim Deva

Kontribuan për këtë numër:
Binak ULAJ
Osman XHILI
Xhafer MARTINI
Arif MURRJA
Bernard ZOTAJ
Mevlud BUCI
Hamdi HYSUKA
Zabit LLESHI
Ramazan BUCI
Dukagjin HATA
Gezim VODA
Sakip CAMI
Halil TEODORI
Marsel LELA

KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.
Të interesuarit të shkruajnë email
në adresën <rrugaearberit@gmail.com>
ose të telefonojnë në numrin
069 20 68 603.

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t'i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë
Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

fejton / kohë bidatesh...

Dibra e "ka" adet, nga një bidat nxjerr përvjet...

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

Po, po, thoni po të doni jo.
E ka filluar me Ali Pashën në betejën e Torviollit më 29 qershor 1444...
E ka vazhduar për një çerek shekulli në 18 nga 25 beteja fitimtare të Gjergj Kastriotit zhvilluar në trevën e saj...
E ka vazhduar me Hajredin Pashën më 1844 ku në fushë të Gjoricës la ***"Jo më pak por dymbëdhjetë mijë..."***
E zhveshi në brenavekë, e hipi në kalë lidhur pas samarit dhe e përcolli drejt Prizrenit Hisni Pashën në "loxhën" e madhe që i bëri, duke ia marrë të gjitha, pa i lënë kohë të shkrepte një fishek të vetëm...

Udhë e mbarë, or Hisni pasha,
Se Nand Malet i ke përmbrapa!

Trime Dibra...
Heronj dibranët...
Të shkuara, larg e larg, të harruara...
Ka lënë pas edhe bidate...
Moisiu i Dibrës...
Hamza Kastrioti...
Të shkuara, larg e larg, të harruara...

DIBRA E KA ADET NGA NJË BIDAT NXJERR PËR VJET...

Erdhën kohë të reja...
Pa shpata...
Pa pushkë...
Me fjalë gazetave e portaleve...
Me figura televizioneve, kombëtarë e lokalë, tokësorë e satelitorë...
"Brekë grisur..."
Bidati...
"Or brekëgrisur sa na ke bezdisur..."
I dhembi fort, ia uli kokën...
Një "çame" deputete në Dibër!
Bidat...
Si është e mundur që në një trevë ku nuk ka një çam për be të mblidhen aq vota "çamësh" sa në Kuvend të ngjitet një deputete?
Bidat mbi bidatet...
Dosja 184...
Dibra paska vjedhë vota...
Me presion...
Me para në dorë...
Me thasë me grurë...
Me torba me miell...
Kaq shumë ka vjedhës sa eklipsoi 26 majin 1996 kur votat u vodhën njëqind për qind!
Bidati vazhdon...

Dosja shkon e vjen,
Nga pakica në prokurori
Nga Tirana në Peshkopi

Bidatet nuk mbarojnë...
Në Dibër ka çamë...
Ka edhe deputet "çamë"...
Në Dibër ka Afro Amerikanë,
Me pasaportë të pastër, qytetarë shqiptarë...
Bidat mbi bidatet e bidateve!
Emrat e tyre janë: Jason Forrestal dhe Marquez Bragg...
Këtu e 19 vjet të shkuara, Dibër 2000, të dy këta, basketbollistë, pa qenë asnjëherë në Shqipëri (në Dibër jo e jo), pa ditë asnjë fjalë shqip, u bënë dibranë, safi dibranë me gjysh e gjyshe.
Komisariati policor i Dibrës u dha atyre pasaportë shqiptare...
Sesi ka ndodhë kjo është bajagi larg ta kërkojmë e ta gjejmë.
Punë sporti, basketbolli, ku pazaret janë në modë...
Kur plasi tullumbacja të dy lojtarët u larguan nga ekipi francez i basketbollit.
Tirana zyrtare do të deklaronte se Jason Forrestal dhe Marquez Bragg nuk ishin shqiptarë.
Afërmendsh edhe gjyshërit e tyre...
Nuk u dha asnjëherë sqarim se kush i pajisi ata me pasaporta të rregullta shqiptare.
Kanë kaluar shumë vite... nëntëmbëdhjetë...
U harruar si histori...
Edhe dy "dibranët" e kanë harruar "kombin" e tyre, edhe pse në internet figurojnë ende si shqiptarë...
Dibra e kishte adet: " Nga një pashë e pret përvjet"...
Dibra e "ka" adet: Nga një bidat nxjerr përvjet...
Kohë bidatesh...

Shënim: Shkruar mbi motivet e lajmit: "Skandali që nuk u hetua, si u bënë dibranë basketbollistët amerikanë"

Athinë, 19 nëntor 2019

Thekri mbillet e korret në shtator

Rrëfenjë sipas lojës popullor "e ka kush e ka" – fajin, pse jemi në gropë... e nuk na begenisin në Evropë...

Konaku i burrave për një çast ra në heshtje. Soba në mes të odës, skuqur nga të dy anët, bubullonte nga drutë e thata të dushkut që i zoti i shtëpisë i ngucte nëpër derën e vogël prej llamarine.
Burrat, nga kryet e vendit deri tek dera e odës ishin rrahur njeri me tjetrin si është zakoni.
Njeri i binte e tjetri ia mbante.
Njeri i binte Salës e tjetri ia mbante.
Njeri i binte Edit e tjetri ia mbante.
Bjer e mbaj... fjala mbeti tek dera.
Mbeti në këmbë dhe askush as e tërhiqte brenda e as e shtynte jashtë
Dikush duhet ti vente kunjin mullarit si e do zakoni. Në të dy anët e oxhakut,



Foto ilustruese

në të majtë e në të djathtë, dy më pleqtë vetëm tym nxirrnin nga çibukët e mbushur me duhan të sertë vendi .

- Thekri mbillet në shtator e korret në shtator- tha i zoti i shtëpisë duke futur në sobë me zor një dru, si të fuste në mill shpatën.
- I re pikës, tha burri në të majtë të oxhakut. Thekri do dymbëdhjetë muaj, donë një vjeshtë, një dimër, një pranverë e një verë që kokrra të bëhet drithë për mulli.
- Disa njerëz korrin mbi kalli. - e pasoi një tjetër muhabeti nisi nga e para...
Ishte natë Shëndreu e për Shëndre nata është e gjatë e dita e shkurtër.
Edhe njerëzit kështu janë, natë gjatë e ditëshkurtër...

Abdurahim Ashiku
Athinë, Shëndre 2019

Bëj një abonim
online ose në print...

Kushton vetëm 600 lekë në vit...

email: rrugaearberit@gmail.com

Bëj pajtimin tënd me
PayPal
përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>

Një pajtim vjetor kushton:
Në Shqipëri: 600 lekë.
Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.

Pajtimi në Europë dhe SHBA
është vetëm në versionin PDF.

Ne nuk jemi gazetë e pavarur, ne jemi gazetë e lirë dhe pavarësia jonë garantohet vetëm nga mbështetja e lexuesve...

aktualitet

Qeveria paguan rreth 5.16 milionë euro si këst të dytë për Rrugën e Arbërit.

Shembja e tunelit rrit koston e Rrugës së Arbrit

Ahmetaj: Rruga e Arbrit do të jetë pa pagesën. Balluku: Rruga e Arbrit pritet të jetë në funksion në mars të vitit 2021. Burime nga kompania: Deri më tani janë kryer rreth 50% e punimeve në volum.

Që nga mesi i Shtatorit, kur mes kompanisë Gjoka Konstruksion dhe drejtoreshës së Autoritetit Rrugor Shqiptar nisi një konflik në lidhje më një tender për një rrugë në jug të vendit, informacionet në lidhje me Rrugën e Arbrit janë ndërprere.

Kryeministri i Shqipërisë e kishte zakon cdo muaj të përecillte një foto apo video-lajme mbi ecurinë e rrugës, por që nga 31 gushti, kur ishte postimi i tij i fundit, në murin në Facebook të tij nuk ka më lajme.

Lajme nuk ka as nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe as nga vetë kompania. Ndërsa një grup nga Prokuroria ka qenë në terren për të vërtetuar situacionet e punimeve të deklaruara, të cilat ishin përdorur edhe si fakte në tenderin për rrugën

"Rruga e Arbrit - investimi më i madh i qeverisë në infrastrukturë, është ëndrra që po realizohet, por është edhe sfida e madhe e dibranëve për të qenë të përgatitur përpara kësaj mundësie të jashtëzakonshme", tha deputetja e Dibrës në parlament Almira Xhembulla më 28 tetor 2019, sikur donte të tregonte se interesi për rrugën nga ana e qeverisë nuk është shuar.

Televizioi Top Channel njoftoi në tetor se një grup nga prokuroria kanë qenë në terren duke verifikuar situacionet e punimeve, të cilat ishin përdorur si fakte në ternderin për tunelin e Kardhiqit.

Rezultatet e hetimit nuk janë bërë të ditura, ka gjasa që pretendimet e ARRSH të mos jenë të vërteta, pasi "GJoka '87", kompania e re e cila po ndërton rrugan e Arbërit, mori një pagesë nga qeveria shqiptare prej 630 milionë lekësh (rreth 5.16 milionë euro) si pagesë të dytë punimen e kryera.

Një burim i tha kompanisë se deri më tani janë kryer në Rrugën e Arbrit rreth 50% e punimeve në volum.

"Monitor", një revistë e specializuar ekonomike e cila botohet në Tiranë, njoftoi në fillim të nëntorit se Qeveria e ka rritur financimin për Rrugën e Arbërit me 45 %, duke e çuar investimin final në 560 milinë euro.

"Burimet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës pohuan se kjo shumë do të shkojë si kompensim për një shembje të madhe që ka ndodhur në rrugë vitin e kaluar, në tentativë për hapjen e një tuneli", shkruante revista më 6 nëntor 2019.

Rruga e Arbrit ishte debat edhe në Komisionit e Ekonomisë dhe Financave, kur po diskutohej projektbuxheti i vitit 2020. "Rruga e Arbrit do të jetë pa pagesë", tha Arben Ahmetaj, kryetar i komisionit.

Belinda Balluku, Ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë, tha në Komisionin e Veprimtarive Prodhuese se "Rruga e Arbrit pritet të jetë në funksion në mars të vitit 2021", ndërsa theksoi se "është një projekt që na bën krenarë të gjithëve".

Ky vit u mbyll edhe me një vendim tjetër të Qeverisë Shqiptare, e cila vendosi të ndajë rreth 1.8 milionë lekë për pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen, pasi pasuritë e tyre, "truall" dhe "tokë buke" preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Rruga e Arbrit". Pronarët që kompensohen pasi të kenë paraqitur certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë, si dhe hartën treguese të regjistrimit në Autoritetin Rrugor Shqiptar. Afati i mbylljes së kësaj procedure është tre muaj nga data e publikimit të vendimit në Fletoren Zyrtare.

BUJAR KAROSHI




Pamje e tunelit në Rrugën e Arbri, mbyllur pas shembjes. Foto: B.Karoshi

Qeveria rrit me 45% financimin për PPP-në e Rrugës së Arbrit, e çon në 460 mln euro

Revista Monitori/ 6 nëntor 2019: Qeveria, në harkun kohor të një viti e gjysmë, nga momenti kur firmosi kontratën për ndërtimin e Rrugës së Arbrit ka rritur me 45% financimin, duke e çuar koston totale në 58 miliardë lekë (460 mln euro) nga 40 mld lekë (33,6 mld vlera e kontratës plus 6.5 miliardë lekë TVSH) të parashikuara në kontratën ligjore.

Vitin e kaluar, qeveria e kontraktoi ndërtimin e Rrugës së Arbrit nëpërmjet formës koncesionare me Partneritet Publik-Privat me kompaninë "Gjoka Konstruksion". Sipas kontratës, që u miratua në mbledhjen e datës 28 mars 2018 të Këshillit të Ministrave, vlera e financimit të rrugës është 33.6 miliardë lekë, me të cilat do të financoheshin gjithsej 41 kilometra rrugë të kategorisë C , nga të cilat 26 do të bëheshin nga e para dhe 15 të tjera pjesërisht.



Në fillim të vitit 2018, në kuadër të projeksioneve në buxhetin afatmesëm, qeveria raportoi një tabelë shoqëruese të financimit të koncesioneve ndër vite, ku raportoi se financimet totale për Rrugën e Arbrit do të ishin 40 miliardë lekë. Burimet nga Ministria e Financave pohuan në atë kohë se kjo vlerë shtesë nga kontrata përfaqësonte TVSH, e cila nuk ishte raportuar në kontratën fillestare.

Këtë vit, gjithçka ka ndryshuar kryekëput, pasi Ministria e Financave ka riprogramuar financimin e Rrugës së Arbrit me 58 miliardë lekë. Burimet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës pohuan se kjo shumë do të shkojë si kompensim për një shembje të madhe që ka ndodhur në rrugë vitin e kaluar, në tentativë për hapjen e një tuneli.

Shembja ka ndodhur në afërsi të tunelit të Murrizit. Inxhinierë të fushës që janë njohur me shembjen, i pohuan "Monitor" se ajo ka ndodhur si pasojë e një gabimi inxhinierik, ku një pjesë e tunelit është tentuar të shmanget, duke hapur trasenë e duke çarë malin në formë kove. Mirëpo vendimi i ka kushtuar kompanisë, pasi thellësia e madhe skarpateve ka krijuar shembjen, e cila gjithashtu kalon nëpërmjet një zgjidhje të vështirë inxhinierike dhe financiare.

Ministrja e Infrastrukturës, Belinda Balluku, në një inspektim në terren pohoi se "pas investigimeve me mjete, me specialistë, rezulton që rrëshqitja është mbi 60 metër". Dhe kjo pastaj na detyroi që ta ndalonim në hyrje, për të mos lënë ritmet këtej nga dalja. "Jemi në përfundim të investigimeve dhe besoj shumë shpejt, punë ditësh do t'i dalim Ministrisë me propozimin e një apo dy varianteve, të cilat do të vlerësohen sesi mund të zgjidhen", bëri të ditur përfaqësuesi i kompanisë "Gjoka Konstruksion"

Rruga e Arbrit, me gjatësi mbi 70 kilometër, e cila lidh Tiranën me Maqedoninë, nëpërmjet Dibrës, nisi si ide në vitin 2008. Projekti i propozuar ishte një rrugë e tipit C, me gjerësi 7 metra, kostoja totale e të cilit fillimisht u llogarit 150 milionë euro, për shkak të punimeve të vështira në një terren malor me shumë tunele. Për shkak se të gjitha studimet e nxorën rrugën jo fizibël, qeveria nisi ndërtimin e saj me fondet e veta, mirëpo kriza e vitit 2008 dhe shpenzimet e larta për Rrugën e Kombit kufizuan mundësitë për të ndërtuar Rrugën e Arbrit, edhe pse disa segmente të saj rreth 20 kilometra, kanë përfunduar, ndërsa pjesa më e vështirë me tunelet brenda mbeti e papërfunduar.

I konsideruar si një projekt populist, Rruga e Arbrit u përfshi në paketën 1 miliard euro, me financim 250 milionë euro për rreth 50 kilometër. Vetëm një vit pasi është firmosur kontrata kostoja e rrugës është dyfishuar duke arritur në 460 mln euro.

Rruga e Arbërit nr. 163

speciale

Me përmirësimin dhe ndërtimin e rrugëve të reja lidhëse me aksin kryesor të Rrugës së Arbërit do t'i jepet një hop zhvillimit të mëtejshëm jo vetëm ekonomisë, por dhe zhvillimit tëturizmit historik e malor të kësaj treve.

Ndjekja nga LID dhe Gazeta "Rruga e Arbërit" e punës së kryer për ndërtimin e Rrugës së Arbërit gjatë viteve 2007-2018 dhe ecuria e punimeve të ndërtimit të kësaj rruge në periudhën 2018–prill 2019

AUTORË: BASHKIM LLESHI, MUSA RIÇKU, BUJAR KAROSHI, HYSEN UKA



Në foto: Bashkim Lleshi, duke mbajtur referimin.

Pas shumë përpjekjesh, në vitet nëntëdhjetë e fillimin e viteve 2000, të shoqatave "Nisma Dibrane" në Peshkopi, "Bashkësia Dibrane" në Tiranë e "Votra Dibrane" në Dibër të Madhe, si dhe shumë studjuesve e intelektalëve dibranë u arrit që më 2003 të futet në planin e shtetit "Studimi i fizibilitetit të Rrugës së Arbërit" i cili u përfundua nga Studioja "Infratransprojekt Ltd" në fund të vitit 2003, ku u miratua dhe në Këshillin teknik të Drejtorisë së Përgjithëshme të Rrugëve. Më qershor të vitit 2004 u miratua dhe në Këshillin Kombëtar të Rrugëve. Kështu i gjithë komuniteti dibran mendoi se u hap drita jeshile që edhe Dibra të bëhej me rrugën që i takonte për t'u lidhur me Tiranën.

Në qershor të vitit 2005 në prag të zgjedhjeve parlamentare, ish kryeministri Nano vendosi një tabelë të madhe, afër Gurëve të Skënderbeut në dalje të Bulqizës, ku shënohej se filluan punimet për ndërtimin e Rrugës së Arbërit dhe filluan gërmimet me një buldozier të madh, pa u hartuar dhe miratuar projekti teknik për segmentin Dalje e Bulqizës-Ura e Çerenecit, ku sipas studimit të Fizibilitetit rruga duhet të hapej në krahun tjetër të luginës nga Draguni në Fushë Bulqizë. Menjëherë pas zgjedhjeve punimet u ndërprenë dhe me gjithë premtimet edhe të krahut që fitoi zgjedhjet se do të fillohej menjëherë nga projekti i zbatimit e ndërtimi i rrugës, u deshën edhe dy vite të tjera të planifikohej e miratohej projekti teknik i segmentit Bulqizë-Ura e Cerenecit më 2007.

Një shtytje të mëtejshme për njohjen dhe leverdinë e hapjes së kësaj rruge ka dhënë krijimi i Shoqatës "Lidhja e Intelektualëve Dibranë" dhe organi botues i saj me emrin "Rruga e Arbërit" në maj të vitit 2006. Që në numrin e parë të kësaj gazete u ri botua artikulli i prefektit të Dibrës Xhafer Seiti, *"Rruga e Arbërit integron jo vetëm Dibrën"*, marrë nga gazeta "Shqip" ku shtrohet si domosdoshmëri ndërtimi i kësaj rruge që me të drejtë zoti Seiti thekson se : *"Integron jo vetëm Dibrën". (Xhafer Seiti maj 2006)*

Në këtë numër të Gazetës "Rruga e Arbërit", Shaqir Skarra, boton artikullin "Rruga e Arbërit, përmasa kombëtare e munguar" *(Shaqir Skarra maj 2006)* ndërsa Bujar Karoshi boton artikullin " Një e vërtetë mes shumë të vërtetash" ku thekson se *" Rruga e Arbërit nuk është vetëm një titull gazete... kjo rrugë është kthyer në personifikim të së ardhmes". (Bujar Karoshi maj 2006)*

Për të prishur heshtjen e qeveritarëve që kishin premtuar se me të fituar zgjedhjet do të fillonte rruga, në numrin e dytë të kësaj gazete u botua artikulli*: "Pushtetarë dhe opozitarë, edhe sa kohë do të vazhdoni të mos e mbani premtimin e dhënë për ndërtimin e Rrugës së re të Dibrës, Rrugës së Arbërit" ?.(Bashkim Lleshi qershor 2006)* Në numrin 3 të kësaj gazete përsëri shkruan prefekti Seiti : *"Rruga e Arbërit do ndërtohet por kam dëshirë t'a ndërtojë qeveria që përfaqësoj" . (Xhafer Seiti korrik 2006)* Ndërsa në numrat 4 e 6 të saj shkruhen artikujt : *"Rruga e Arbërit, rrugë kryesore e vendit krahas rrugës Egnatia që në lashtësi", (Bashkim Lleshi gusht 2006)* dhe *"Rruga e Arbrit i shërben edhe zhvillimit të turizmit malor dhe njohjes së mëtejshme të historisë". (Bashkim Lleshi tetor 2006)*

Në shkurt 2007 në gazetën "Rruga e Arbërit" u botua artikulli i diplomatit Abdi Baleta *"Sali Hapi dy arteret koronare të Shqipërisë"* marrë nga gazeta "Rimëkëmbja" ku përshkruan rëndësinë shumë të madhe që kanë për Shqipërinë ndërtimi i këtyre dy akseve rrugore. *(Abdi Baleta shkurt 2007),* gjeologu i pasionuar dibran Vesel Hoxha boton artikullin *" Rruga e Arbërit, rruga e zhvillimit të Shqipërisë lindore"* ku përshkruan me hollësi për lexuesit e gazetës Rruga e Arbërit, pasuritë e njohura nëntokësore e mbitokësore të kësaj treve që do të vihen në lëvizje me ndërtimin e kësaj rruge. *(Vesel Hoxha shkurt 2007),* ndërsa gjeologu i vjetër matjan Agim Shenjatari në mars 2007 informon lexuesit për *" Pasuritë minerale të rrethit të Matit dhe zhvillimin që do të marrin ato me ndërtimin e Rrugës së Arbërit." (Agim Shenjatari mars 2007)*

Të shqetësuar nga vonesa për fillimin e punës për ndërtimin e rrugës, Shoqata "LID" e mbështetur edhe nga shoqatat e tjera dibrane, më 7 maj 2007 organizoi Kuvendin Tekniko Shkencor për Rrugën e Arbërit. Në këtë kuvend referuan me nivel të lartë shkencor studjues dibranë e jo dibranë si : *"Rruga e Arbërit, rruga kryesore e vendit, krahas Rrugës Egnatia që në lashtësi" (Valter Shtylla), "Studim për mundësinë e ndërtimit të Rrugës së Arbërit"* (Përmbledhje e studimit të fizibilitetit) nga studjoja "Infratransprojekt Ltd *" (Faruk Kaba, etj.) "Rruga e Arbërit në teritorin e Maqedonisë Dibër-Gostivar-Tetovë-Shkup" (Shefki Aliti), "Pasuritë minerale të rajonit të Dibrës që mund të vihen në qarkullim me ndërtimin e Rrugës së Arbërit" (Vesel Hoxha, etj.) "Pasuritë minerale të rrethit të Matit që do të vihen në lëvizje për ekonominë e tregut me ndërtimin e Rrugës së Arbërit" (Agim Shenjatari)* dhe *"Rruga e Arbërit-Premisë për zhvillimin e turizmit" (Bashhkim Lleshi, Avni Dibra),* të cilat u botuan në gazetën "Rruga e Arbërit".

Konkluzionet e kësaj konference me propozimin që të fillonte sa më shpejt ndërtimi i kësaj rruge, kryesia e LID nëpërmjet kryetarit të saj Prof. Nuri Abdiu, ia dërgoi Qeverisë, Ministrisë së Ndërtimit dhe Drejtorisë së Përgjithëshme të Rrugëve.

Për shoqatën "Lidhja e Intelektualëve dibranë dhe gazetën e saj "Rruga e Arbërit" vitet 2006 e 2007 u kthyen në vite sensibilizimi për rrugën e Arbërit jo më për komunitetin dibran por më shumë për qeveritarët e pushtetarët e këtij vendi, për ato që premtonin se do të fillojmë menjëherë punën për ndërtimin e kësaj rruge, para zgjedhjeve, por që menjëherë pas zgjedhjeve harronin se çfarë kishin premtuar. Pas gjithë këtyre përpjekjeve u arrit që në vitin 2007 të fillojnë projektet e zbatimit të kësaj rruge dhe në tetor 2007 u zhvillua tenderi për ndërtimin e segmentit Bulqizë-Ura e Çerenecit.

Gazeta "Rruga e Arbërit" në numrin e saj të parë të vitit 2008 jep sihariqin për fillimin e punës për ndërtimin e Rrugës së Arbërit nëpërmjet redaktorit të saj Bujar Karoshi, këtij djali të ri të papërtueshëm e të talentuar dibran, një nga nismëtarët e parë të kësaj rruge. Por çudia e madhe është se punimet për rrugën filluan aty ku Fatos Nano preu shiritin në vitin 2005, në dalje të Bulqizës, në rrugën ekzistuese, në një kohë që aksi i rrugës sipas Studimit të Fizibilitetit duhet të kalonte në krahun tjetër të luginës, në një kohë që projektin e zbatimit e ka hartuar po ajo studio që ka kryer Studimin e Fizibilitetit dhe në vend që ti përmbahet aksit të miratuar ose të bëjë përmirësime të mëtejshme në projektin e zbatimit, harton një projekt teknik që është rikonstruksion i rrugës ekzistuese, me shumë pak përmirësime, me gërmimë të mëdha, etj. që nuk i përgjigjet standarteve të kohës për rrugët. Të shqetësuar nga këto veprime në maj të vitit 2008 u botua **në gazetën "Rruga e Arbë**rit" artikulli: *"Pse lejohet të bëhen ndryshime të aksit të rrugës së miratuar në studimin e fizibilitetit në dëm të cilësisë së saj". (Bashkim Lleshi maj 2008)* Artikullin e mësipërm e botuan edhe dy organe të tjera shtypi, "Zëri i Popullit" dhe "Ekonomia" dhe m**ë** korrik 2008 **në gazetën "Ekonomia"** u paraqit**ë**n edhe propozimet **për të mos bërë ndryshime për pjesën e rrugës në luginën e Vajkalit, hyrjen e Tunelit të Qaf Buallit nga Bulqiza dhe Urën e Vashës, duke j'u përmbajtur asaj që** ishte shkruar e miratuar në Studimin e Fizibilitetit. *(Bashkim Lleshi 29 korrik 2008).*

Për t'u dalë përpara këtyre shqetësimeve më nëntor 2008 u botua libri "Gjeologjia e Rrugës së Arbërit" ku paraqitet në mënyrë të përmbledhur, historikisht, kontributi i gjithë intelektualëve e studjuesve dibranë e jo dibranë për Rrugën e Arbërit dhe jepet Studimi i plotë i pjesës gjeologo-teknike të paraqitur në Studimin e Fizibilitetit të kësaj rruge. *(Bashkim Lleshi nëntor 2008)* Ky libër ju d**ë**rgua të gjithë personave përgjegjës në organet drejtuese shtetërore për të patur parasysh se ç'farë është miratuar sidomos për aksin ku kalon kjo rrugë, për tunelet dhe Urën e Vashës dhe për të mos lejuar ndryshime sidomos të aksit të rrugës dhe veprave inxhinierike të rëndësishme (tunele e ura) në dëm të cilësisë së saj.

Nga viti 2008 e në vazhdim janë të njohura përpjekjet e Shoqatës "Lidhja e Intelektualëve Dibranë" ku nëpërmjet gazetës "Rruga e Arbërit" ka ngritur vazhdimisht shqetësimet se rruga po vazhdon të ndërtohet jashtë standarteve të kohës.

Në korrik të vitit 2009 filloi puna për ndërtimin e segmentit Bulqizë-Ura e Vashës. Në intervistën që ka marrë gazetari Bujar Karoshi në shkurt të vitit 2009 në studion "Infratransprojekt Ltd" thuhet : *"... Me një tunel në Qafën e Buallit 847m. ajo del në luginën e Planit të Bardhë duke vazhduar deri tek Ura e Vashës..." (Bujar Karoshi shkurt 2009)* Në vazhdim jo vetëm se nuk u zbatua asnjë afat për ndërtimin e këtij segmenti por për tunelin e Qaf Buallit filluan diskutimet në se duhet hapur apo jo dhe më në fund ai nga 850m në studimin e fizibilitetit e 847m në projektin teknik të zbatimit u reduktua në 460m. Edhe vazhdimi i rrugës nga Bulqiza në tunelin e Qafë Buallit pësoi ndryshime duke e diskutuar se mund të bëhet me ose pa tunel, se tuneli është në formacione të shkatërruara, etj. duke mos ju përmbajtur aksit të vendosur në Studimin e Fizibilitetit dhe duke bërë jo vetëm ndryshim të aksit duke e ngritur atë mbi varrezat e Bulqizës e duke bërë një usek të pa nevojshëm., si dhe u zgjat traseja e rrugës poshtë Urës së vjetër të Vashës, me justifikimin për të lidhur edhe Klosin sikur kjo rrugë po bëhët për të lidhur Dibrën me Klosin e jo me Tiranën e Durrësin.



Pamje e Qafë Buallit.Në VL të Dampës pozicioni ku duhet të fillonte hapja e tunelit. Foto Bashkim Lleshi nëntor 2006

Edhe në zgjedhjet e vitit 2013 kryefjala e premtimeve para elektoratit dibran, të dy krahëve të politikës, ishte premtimi se do të përfundojnë Rrugën e Arbërit. Krahu i majtë që fitoi zgjedhjet premtoi se në vjeshtë do të fillojnë punimet, por iku edhe vjeshta e fundi i vitit 2013 ikën edhe vitet 2015 e 2016 dhe në rrugën e premtuar nuk u hodh asnjë kazëm. Bile Qeveria e sotme për t'i dhënë gjoja rëndësi të veçantë kësaj rruge shpiku edhe një miratim Ligji të veçantë në paralament, kur nuk ishte nevojë ligjore, i cili nuk u zbatua.

Më 9 nëntor 2012 një grup i TV Dibra i përbërë nga drejtori Afrim Lela, bashkëpunëtori i tij Naim Lleshi dhe gazetarë e operatorë kryen një eskursion në aksin e Rrugës së Arbërit nga Dibra, Bulqiza, Ura e Vashës, Qaf Murriza deri në Zall Dajt e Tiranë. Në zonën ë Zall Dajtit u takuan edhe me përfaqësuesit e LID dhe ND, Bashkim Lleshi e Bujar Karoshi. Ata përgatitën një emision televiziv qe e dhanë disa herë në TV Dibra.



A. Lela,B.Lleshi, B. Karoshi e N. Lleshi në luginën e Dajtit më 9 nëntor 2012



H.Uka,D.Osmani,B.Lleshi e M.Riçku më 31.8.2013 në Qafën e Murrizës më 31 gusht 2013

Më 31 gusht të vitit 2013 një grup pune i shoqatave "Lidhja e Intelektualëve Dibranë" dhe "Nisma Dibrane" i përbërë nga Bashkim Lleshi, Musa Riçku, Demir Osmani, Bujar Karoshi, Hysen Uka, Afrim Karoshi e Kujtim Buci, kryen vrojtime nga Ura e Vashës deri në Tiranë dhe konstatuan se: *"Gjatë gjithë aksit që përshkon Rruga e Arbërit, pothuajse vetëm traseja e hapur nga Tuneli i shkurtër në afërsi të Zall Dajtit deri tek ish Uzina e Artilerisë në afërsi të Urës së vjetër të Brarit dhe një pjesë e trasesë në luginën e Planit të Bardhë e mbi Urën e Vashës, mund të quhen trase të Rrugës së Arbërit, ndërsa në pjesët e tjera kemi ose rikonstruksion të rrugës ekzistuese ose shmangje nga aksi i Rrugës së Arbërit." (Bujar*

konferenca

Përveç këtyre bukurive, qarku i Dibrës nga Qafa e Murrizës deri në Kala të Dodës në kufi me Kukësin është pëllëmbë e histori, në çdo vend do të ndeshësh një ngjarje të hershme ose të vonshme historike. Rruga e Arbërit do të bëjë që të njihet historia e herëshme dhe e re e këtyre trojeve duke u bërë të vizitueshme jo vetëm për dibranët por edhe për vizitorët tjerë të vendit dhe të huaj.



Foto 2 Pamje e trasesë së rrugës mbi Urën e Vashës. Foto Bashkim Lleshi gusht 2013



Lugina e përroit të Mashnorit poshtë fshatit Xibër Murrizë. Foto Bashkim Lleshi 31 gusht 2013

Karoshi, Gazeta "Rruga e Arbërit" gusht 2013) Shmangja më e madhe është ajo ku po hapet Tuneli i Qaf Buallit e cila është trajtuar që në vitin 2008 e në vazhdim. *(Bashkim Lleshi 2008, 2013)*

Gjeologu i vjetër dibran, prof. as. dr.Vesel Hoxha, pasi lexon artikullin e gazetarit Bujar Karoshi të muajit gusht 2013 "Shpëtoni rrugën e Arbërit", në Gazetën"Rruga e Arbërit" shkruan, *"...Standarti i Rrugës së Arbërit është në rrezik..." Ky është sinjal alarmi..."(Vesel Hoxha shtator 2013)*

Në intervistën që i ka dhënë inxhinieri shqiptar Shefki Aliti, korespondentit të gazetës "Rruga e Arbërit" Bujar Karoshi, në shtator të vitit 2013, tërheq vemendjen se, Rruga e Arbërit po ndërtohet larg standarteve europiane. Ai thekson se *: "... Kjo nuk është një autostradë që lidh dy shtete e më tej por një rrugë lokale" (Shefki Aliti, shtator 2013)*

Meqënëse hapja e tunelit të Qaf Buallit dhe fillimi i punimeve në objektet e tjera u ndërprenë për një kohë të gjatë, drejtuesit e dy shoqatave të "Lidhjes së Intelektualëve Dibranë" dhe "Nismës Dibrane", në mars të vitit 2014, i dërgojnë një relacion Ministrit të Transportit e Infrastrukturës dhe 6 deputetëve të Dibrës, ku propozojnë : *" ...që për objektet e rëndësishme* **të kësaj rruge si, tunelet e Qaf Buallit e Qaf Murrizës dhe Urën e Vashës, të rishikohen e përmirësohen projektet e zbatimit, duke bërë edhe krahasimet me projektet e hartuara..."** *(Nuri Abdiu, Bujar Karoshi, 2014)*

Për çudi, në fillim të tetorit të vitit 2014, menjëherë pas vizitës së Kryeministrit Rama në Kinë më 11 shtator, kur u dha sihariqi se Rruga e Arbërit do jepej me koncension dhe për objektet që nuk ishin filluar u sugjerua se duhet të kryhen përmirësime që në fazën e projektimit, filloi me shpejtësi hapja e tunelit të Qaf Buallit në vendin ku nuk duhet të vazhdonte hapja e tij duke shënuar edhe një njollë tjetër të zezë që ka prishur cilësinë e kësaj rruge.

Në dhjetor të vitit 2014 në gazetën "Rruga e Arbërit" u botua artikulli : *"Urojmë që fatin e Tunelit të Qafë Buallit të mos e pësojë Tuneli i Qafë Murrizës"(Bashkim Lleshi dhjetor 2014)*

Ku shkruhet se : *" ...Nuk ka arësye gjeoteknike e hidrogjeologjike për të ngritur lartësinë e tunelit të Murrizës nga 800-850m. në 950m. mbi nivelin e detit, rrjedhimisht shkurtimin e gjatësisë së tij nga 3000 deri 3500ml. të parashikuar, në 2400ml. duke prishur cilësinë e rrugës."*

Më 16 dhjetor 2014 në Tiranë u nënshkrua në parim Memorandumi i Bashkëpunimit midis Qeverisë Shqiptare dhe asaj Kineze, ku Banka Kineze "Eksim Bank" do të financojë disa projekte në vendin tonë, e në rradhë të parë projektin për përfundimin e Rrugës së Arbërit. Më së fundi filloi të ngjallet shpresa, që edhe rruga e shumë përfolur e Dibrës, Rruga e Arbërit të vihet në rrugën e zgjidhjes. Por nuk vonoi shumë dhe kjo shpresë u venit në vitin 2015. Për të ringjallur shpresat e dibranëve, gjoja për t'i kushtuar një rëndësi të veçantë ndërtimit të kësaj rruge u hoq dorë nga rruga e njohur ligjore e tenderimit, duke miratuar një Ligj të veçantë në Parlament më 16 prill 2015, për dhënjen e kësaj rruge me koncension. Në shtator 2015 në artikullin e Bujar Karoshit *"Vihet në dyshim financimi kinez për Rrugën e Arbrit"* thuhet : *"Të deleguar të firmave kineze në Shqipëri deklarojnë tërheqjen e "Exim Bank" por "China State Construction" vazhdon negocimin. Deputetët Përparim Spahiu dhe Ulsi Manja : Gjithçka po ecën sipas parashikimeve. Punimet nisin në janar" (Bujar Karoshi shtator 2015)*

Më **dhjetor 2015 kryeministri Rama takon në Pekin Kryeministrin kinez Li Keqiang dhe përsëri deklarohet se do ta ndër**tojmë Rrugën e Arbërit, ndërsa m**ë janar 2016 Rama theksoi se :** *"Po e vonojmë firmën për Rrugën e Arbërit në interes të publikut",... "por mandati i qeverisjes po të mbaron zoti Rama, po rrugën kujt po ia len, publikut?!" (Bujar Karoshi dhjetor 2015, janar2016)*

Në gazetën Ruga e Arbërit të dhjetorit 2015, gazetari Bujar Karoshi citon deklaratat e kryeministrit Rama, kryeparlamentarit Meta, të mininistrave Haxhinasto, Cani e Ahmetaj dhe deputetëve Spahiu e Manaj nga janari e deri në dhjetor 2015 duke deklaruar nga muaji në muaj se : *"... jemi në negociata, se do të fillojmë në qershor, në shtator apo në fund të vitit e janar, erdhi dhe fundi i vitit dhe deputetët dibranë përgjigjen se nuk kemi informacion, kur të informohemi do t'ju njoftojmë, por edhe viti të dashur deputetë mbaroi, filloi dhe 2016-ta dhe fillimi i punimeve për rrugën nuk po duket." (Bujar Karoshi dhjetor 2015)*

Në gazetën Rruga e Arbërit m**ë** janar 2016 shkruhet se Peticioni i nisur online që në mars të vitit 2013 po përhapet edhe në mediat e tjera sociale. Gëzim Alpion pedagog në Universitetin e Birmingamit, nismëtari i peticionit thekson për gazetën : *"Përveç 2000 nënshkrimeve me formularë, nisma jonë tani ka edhe mbi 8000 përkrahës online"*. Grupi lobues i këtij peticioni në tryezën e rrumbullakët të organizuar në Tiranë në maj 2014 arriti të bashkojë një gjysëm dyzine parlamentarësh të cilët nuk janë bërë asnjëherë bashkë për të ngritur zërin në Kuvend për Rrugën e Arbërit. *(Bujar Karoshi janar 2016)*

Mbështetur në Relacionin e vitit 2014, përsëri pas tre vitesh më 20.04.2017 në emër të kryesisë së LID e ND me nënshkrimin e kryetarëve Edlira Haxhiymeri e Bujar Karoshi u dërgohet përsëri Relacion Ministrisë dhe Autoritetit të Rrugëve duke theksuar se ne vazhdojmë t'i qëndrojmë propozimit për rishikimin e projekteve të zbatimit të rrugës nga Ura e Vashës deri në Zall Dajt, dhe propozojnë që :

1. Të ribëhet projekti i Urës së Vashës që të kalojë në luginën më të ngushtë të lumit të Matit, mbi Urën e vjetër të Vashës.

2. Të mos ngrihet niveli i Tunelit të Murrizës mbi 850 m nga ana e Tiranës, rrrjedhimisht gjatësia të jetë mbi 3000 m. dhe të ndërtohet me dy gryka tunelesh për të përmirësuar standartin e rrugës. Në vartësi të këtyre dy veprave kryesore të bëhen projektet e zbatimit të trasesë nga Ura e Vashës në Zall Dajt.

3. Të rishikohet traseja e rrugës nga Bulqiza deri tek Ura e Cerenecit në drejtim të përmirësimit të standarteve të saj, aty ku ka shmangje nga aksi i miratuar në Studimin e Fizibilitetit. *(Edlira Haxhiymeri e Bujar Karoshi, prill 2014)*

Në gazetën Rruga e Arbërit janar 2017 gazetari Bujar Karoshi boton artikullin *"Para zgjedhjeve nisin punimet " (Bujar Karoshi, janar 2017),* por u desh q**ë** ky lajm t**ë** b**ë**het realitet vet**ë**m nga fillimi i vitit 2018.

Në gazetën Rruga e Arbërit gusht 2017 njoftimi se Qeveria shpall tenderin për dhënjen me koncension të Rrugës së Arbërit. *(Bujar Karoshi, gusht 2017)*

Më 10 nëntor 2017 prezantohet nga Qeveria projekti i pjesës së mbetur të Rrugës së Arbërit dhe u botua në gazetën Rruga e Arbërit, fjala e kryeministrit Rama, "Rruga e Arbërit nga premtim në realitet" dhe artikulli i gazetarit Bujar Karoshi, *"Me Rrugën e Arbërit Dibra kthehet në kopshtin e Tiranës" (Edi Rama, Bujar Karoshi, nëntor 2017)*

Në gazetën e muajit mars 2018 u dha njoftimi se "Qeveria firmos kontratën, "Gjoka Konstruksion" gati të nisë punimet", si dhe nga dibrani Mehmet Dume u botua artikulli "Rruga e Arbërit i bashkon shqiptarët". *(Mehmet Dume, mars 2018)*

Në gazetën Rruga e Arbërit nëntor 2018 botohet artikulli i deputetes Almira Xhembulla *"Ja ku po punohet në Rrugën e Arbërit"* ku jepen detaje të vazhdimit të punimeve në tunelet afër Urës së Vashes dhe tunelin e Murrizit dhe të punës që po kryhen në urat e Vashës, të Shupenzës e Gjoricës, për të cilat raportoi edhe në Kuvendin Popullor. *(Almira Xhembulla nëntor 2018)*

Po në këtë gazetë gjeologu dibran Vesel Hoxha boton artikullin *"Ndërtimi i Rrugës Aras-Lurë domsdoshmëri për zhvillimin e turizmit dhe kërkimin e mineraleve"* ku shtrohet si domsdoshmëri për zhvillimin e zonës, ndërtimin e rrugës. *(Vesel Hoxha, nëntor 2018)*

Në gazetën Rruga e Arbërit shkurt 2019 njoftohet se në Rrugën e Arbërit janë kryer deri tani 30 % e volumit të punimeve, ku punohet në dy shpatet e lumit Mat poshtë Urës së Vashës për hapjen e tuneleve 4 e 6, betonimin e tunelit 5 dhe ndërtimi i këmbëve të Urës së Vashës. Në Zonën e Shupenzës dhe Gjoricës janë në përfundim Urat e Shupenzës dhe Gjoricës dhe vazhdon traseja në mes të dy urave mbi pritën e Zallit të Gjoricës.

Kontributin më të madh për për informimin e qytetarëve se ç'po bëhet me Rrugën e Arbërit e ka dhënë gazeta "Rruga e Arbërit". Në maj të këtij viti mbushen 13 vite të botimit të saj. Që në numrin e parë të saj në maj 2006 e deri më sot, kjo gazetë ka paraqitur me objektivitet punën e kryer për Rrugën e Arbërit, nëpërmjet bashkëpunëtorëve të saj dhe botuesit të palodhur të kësaj gazete Bujar Karoshi. Gazeta "Rruga e Arbërit" në 13 vitet e botimit, nëpërmjet shkrimeve të bashkëpunëtorëve të saj ka propoganduar vlerat e mëdha turistike që ka rajoni i Dibrës nga Bulqiza e Zerqani, në Dibër të Madhe, Maqellarë e Peshkopi, Grykë të Vogël e Katër Grykët me liqejt e Bukur të Kacnisë dhe Allamanit, në Luzni e Muhurr, Kastriot, Çidhën, Sllovë, Radomirë e Korab, Reç e Dardhë dhe deri në Lurën e bukur malore me liqejt e saj mahnitës.

Bashkëpunëtorë të tjerë të gazetës "Rruga e Arbërit si : Gazmend Kërkuti, Shuip Markja e Tafë Ameti, Abdurahim Ashiku, Shaqir Skara, Hysen Likdisha, Hysen Uka, Agron Totraku, Selman Mziu, Vesel Hoxha, Rruzhdi Bitri, Metush Skeja, Grehans Uka, etj, etj. në shkrimet e inervistat e tyre kanë folur edhe për bukuritë e natyrës së Dibrës, për liqejtë e bukur e mahnitës malorë të Lurës, Balgjajt, Allamanit, Bulqizës e Gramës, për burimet e freskëta të Bulqizës, Okshtunit, Zerqanit, Tuçepit, Kovashicës, Delgjurrës, Selishtës, Luznisë e Muhurrit, Ilnicës, Rabdishtit, Cerjanit, Gramës e Radomirës, për gjurrat e Mazhicës, Lishanit e Muhurrit, për burimet e Reçit e Dardhës, Sllovës, Gramës e Radomirës, për Veleshicën, Setën e Mollën e Lurës, etj.

Në korrik të vitit 2016 gazeta Rruga e Arbërit pjesën më të madhe të shkrimeve të saj ia kushton propogandimit të bukurive natyrore të trevës së Dibrës për zhvillimin e mëtejshëm të turizmit malor në këtë krahinë me bukuri të rralla natyrore por të harruar nga pushteti.

Agim Totraku përshkruan bukuritë e rralla të liqejve akullnajore të Balgjajt, të 5 liqeneve të Shtrugës, liqenet e Bataçeve të Kacnisë etj. si dhe florën dhe faunën shumë të pasur të kësaj zone, etj.

Shuip Marku (Markja) përshkruan, bukuritë e masivit malor të Deshatit, 5 liqejt akullnajorë të Deshatit, luginën e bukur të lumit Radika, shpellat e Sharkut e kristaltë të Selenitit në Mavrovë e Kosovrast, fshatrat turistikë të Gajres, Galiçnikut e Kiçinicës, objektet historike të qytetit të Dibrës e rrethinave, Kishat e Shën Mërisë e Shën Jovan Preteça, Manastiret Bigorski e Shën Gjergji fitimtari, Ura e Kaprollit, etj.

Grehans Uka në intervistën dhënë gazetarit Bujar Karoshi tregon disa nga destinacionet e turizmit malor në zonën e Peshkopisë që mund të vizitohen nga turistë vendas e të huaj, duke përshkruar edhe disa nga guidat malore në drejtim të Gramës e Radomirës, organizimin e raftingjeve në lumin e Drinit të zi, etj.

Rruzhdi Bitri në reportazhin "Prapë na çeli Grama" përshkruan bukuritë e bjeshkës së Gramës e të Zonjave ku kanë jetuar zonjat ilire, romake e kastriotët, dhe gjeomonumentet e kësaj zone të studjuara nga gjeologu i apasionuar dibran profesor Vesel Hoxha.

Tafë Ameti, në intervistën dhënë gazetarit Bujar Karoshi tregon për bukuritë e Rekës së Epërme dhe për prezantimin e veshjeve tradicionale, të traditave, zakoneve, lojrave popullore, folklorit e ushqimeve tradicionale të Rekës.

Metush Skeja në reportazhin "Pesë kuriozitete rreth Kalasë së Dodës" shkruan se Korabi është për turizëm duke filluar nga pylli me mështekna në Ploshtan e Rafshi i Sorokolit deri tek shpella e Ago Ymerit e Kepi i Stogit. *(Agim Totraku, Shuip Marku (Markja),Grehans Uka, Rruzhdi Bitri,Tafë Ahmeti, Metush Skeja, gazeta Rruga e Arbërit nr.7 (123) korrik 2016)*

Destinacione të tilla të turizmit malor që mund të vizitohen nga turistë vendas e të huaj mund të organizohen edhe në zona të tjera të Dibrës si : Në zonën e Bulqizës, Zerqanit e Martaneshit deri në Bakgjaj e Kaptinë, liqejve të Balgjajt dhe Komavecit, në zonën e Grykës së Vogël, Katër Grykëve, Luznisë e Muhurrit, në zonën e Arrasit, Dardhës e Reçit për t'u ngjitur në drejtim të Gur Lurës e liqejve të Lurës nga lugina e bukur e madhështore e Setës, apo nga Lan Lura, ose Zall Reçi nëpërmjet luginës së bukur të lumit Molla e Lurës deri tek liqejt, etj. Në këto guida vizitorët do të njihen me bukuritë e natyrës së Dibrës, njohjes me gjeomonumentet, hidromonumentet e biomonumentet *(Perikli Qirjazi, Skendër Sala 2006)*

Përveç këtyre bukurive, qarku i Dibrës nga Qafa e Murrizës deri në Kala të Dodës në kufi me Kukësin është pëllëmbë e histori, në çdo vend do të ndeshësh një ngjarje të hershme ose të vonshme historike. Rruga e Arbërit do të bëjë që të njihet historia e herëshme dhe e re e këtyre trojeve duke u bërë të vizitueshme jo vetëm për dibranët por edhe për vizitorët tjerë të vendit dhe të huaj.

Me këtë histori lexuesit janë njohur nëpërmjet shkrimeve në gazetën "Rruga e Arbërit" dhe librave të shumë studjuesve e historianëve dibranë, etj. si : Adem Bunguri, Ali Hoxha, Iljaz Kaca, Munir Shehu, Moisi Murra, Qeram Lleshi, Hysen Repa, Selman Mziu, Aziz Keta, Destan Rama, Kristo Zharkalli, etj. *(Adem Bunguri 2010, Ali Hoxha 2014, Iljaz Kaca 2003, Munir Shehu 2010, Moisi Murra 2003, Qeram Lleshi 2003, Hysen Repa 2014, Selman Mziu 2011, Aziz Keta 2018, Destan Rama 2014, Kristo Zharkalli 2011)*

(vijon në faqen 6)

Me përmirësimin dhe ndërtimin e rrugëve të reja lidhëse me aksin kryesor të Rrugës së Arbërit do t'i jepet një hop zhvillimit të mëtejshëm jo vetëm ekonomisë, por dhe zhvillimit tëturizmit historik e malor të kësaj treve.

Eskursion në Rrugën e Arbërit

(vijon nga faqja 5)

Më 20 prill në mëngjes u nisëm nga Tirana me një autobuz 20 vendësh për eskursionin Klos-Ura e Vashës-Plani i Bardhë-Tuneli i Bulqizës dhe Ura e Shupenzës-Gjoricë-Ura e Drinit për t'u njohur me punimet që po kryhen në Rrugën e Arbërit nga kompania "Gjoka". Grumbullimi dhe nisja u bë më ora 7^{00} të mëngjesit nga qendra e Tiranës. Në këtë eskursion përveç anëtarëve të kryesisë së LID, Latif Miha, Enver Hysa, Bashkim Lleshi, Miranda Goleci, Demir Osmani e Shaqir Skarra, muarën pjesë edhe aktivistët, Ana Lleshi, Agim Kasa, Bujar Karoshi, Besa Uka, Bukurije Cami, Dëfrim Methasani, Hajredin Toca, Hysen Uka, Irfan Zebi, Islam Uka, Kamber Farruku, Mehdi Dema, Osman Miha, Osman Vladi, Qamil Sula, Rahman Dapi, Selami Nazifi, Shehat Cami, Vesel Hoxha, Zabit Lleshi, Zaim Elezi, Ymer Saraçi etj. Më ora 9^{30} arritëm në Klos ku biznesmeni Irfan Zebi kishte porositur mëngjesin për të gjithë eskursionistët. Pas një mëngjesi shumë të këndëshëm në Klos u nisëm për tek aksi i rrugës së Arbërit mbi fshatin Fshat ku vizituam tunelet dhe Urën që po ndërtohej poshtë Urës së vjetër të Vashës.

Inxhinieri i Kantierit të Ndërtimit na foli për ecurinë e punimeve të tuneleve dhe Urës së Vashës mbi lumin Mat. Kishte përfunduar hapja e tuneleve 4, 5 e 6 , vazhdonte betonimi i tunelit 4 dhe puna për ngritjen e këmbëve të betonit në Urën e Vashës.





Pastaj i gjithë grupi u nis në drejtim të Planit të Bardhë ku pamë trasenë e kësaj rruge në këtë luginë dhe tunelin e përfunduar më parë të Qafës së Buallit. Ndalimin e dytë e bëmë në Urën e Shupenzës mbi zallin e Bulqizës. Aty u takuam dhe me Musa Selamin, drejtuesin e punimeve të kompanisë "Selami" që ka ndërtuar dy urat mbi zall e Drin dhe segmentin Ura e Çerenecit-Gjoricë-Majtarë.

Pasi vizituam dy urat e betonit të përfunduara dhe trasenë që lidh këto dy ura gjatë argjinatutës së Zallit nga Gjorica e Epërme në të Poshtëmen, bëmë foto e dhamë intervista për Tv Bulqizën, të gjithë së bashku u nisëm për të kaluar drekën në një Restorant shumë të bukur pranë pishave matanë Fush Bulqizës të cilën e kishte porositur zv/kryetari i LID, biznesmeni Latif Miha. Eskursionistët e shtruar në këtë drekë i përshëndeti në emër të kryesisë së LID Bashkim Lleshi. Në këtë drekë përshëndetën pothuajse të gjithë eskursionistët. Pas kësaj



Ura mbi zallin në afërsi të Shupenzës.



Ura mbi lumin Drini i Zi në afërsi të Gjoricës.



Foto e Eskursionistëve të Rrugës së Arbërit mbi fshatin Fshat të Klosit

dreke shumë gazmore u nisëm për në Tiranë. Të gjithë eskursionistët që ishin në autobuz u ndaluan në një lokal tek Ura e Skurajve, për një kafe të ofruar nga Bashkim Lleshi me vajzën e tij Ana që mori pjesë në këtë eskursion shumë të bukur.

Më 27 prill u zhvillua eskursioni i dytë për t'u njohur me punimet e Rrugës së Arbërit në segmentin Tiranë-Ura Brarit-Brar-Zall Dajt-Shpal-Hyrja e Tunelit të Murrizës. Në këtë eskursion përveç anëtarëve e kryesisë së LID, Musa Riçku, Bashkim Lleshi, Enver Hysa, Nazmi Koçi, Shpëtim Cami, Demir Osmani e Shaqir Skarra, megjithëse koha ishte me shi muarën pjesë edhe shumë aktivistë të vjetër e të rinj dibranë e matjanë si: Ali Selita, Aziz Keta, Artur Buci, Bukurije Cami, Esat Skarra, Mentor Deda, Flutura Osmani, Halil Robi, Ilmi Cani, Ilmi Dervishi, Ismail Hysa, Jahe Selmani, Kamber Farruku, Lavdërim Shehu, Mentor Deda, Mirela Cami, Naim Karaj, Nehat Daci, Osman Vladi, Rakip Dançe, Ramazan Ceni, Rustem Deva, Sali Bushi, Shahin Lazri, Shehat Cami, Shuip Methasani, Vesel Hoxha, Xhafer Martini, Xhelil Gjoni e Ymer Saraçi.

Më ora 8^{00} u nisëm nga qendra e Tiranës dhe përshkuam rrugën e Dibrës deri tek Ura e Brarit, pastaj vazhduam rrugën gjatë grykës së lumit të Tiranës deri tek tuneli i shkurtër tek Shkalla e Tujanit ku u ndalëm për foto dhe për vrojtimin e punimeve të rrugës.

Të gjithë pjesëtarëve të eskursionit i'u shpërndanë nga dy fletë ku shënoheshin programi i eskursionit, të dhënat e rrugës sipas projektit teknik (largësitë, tunelet, urat) dhe monumentet historike që mund të vizitohen për gjatë rrugës nga Tirana në Bulqizë, Peshkopi, Çidhën e deri në Kala të Dodës e Lurë, të përgatitura nga Bashkim Lleshi.

Pastaj vazhduam rrugën nga Zall Dajti sipas trasesë së re të rrugës për gjatë lumit të Tiranës, kaluam në përroin e Selitës së Malit afër lagjes Marec dhe u ngjitëm në rrugën dytësore deri tek sheshi i Tunelit të Murrizës. Aty u takuam me inxhinierin e punimeve të Kompanisë "Gjoka" Mark Pepkolën i cili na foli për ecurinë e punimeve të tunelit. Tuneli kishte avancuar rreth 520 m nga krahu i Tiranës dhe këto ditë kishte filluar puna nga krahu i Xibër Murrizës.

Në kthim të gjithë pjesëmarrësit e eskursionit bënë një pushim në një lokal në grykën e Brarit afër ish Repartit Ushtarak ku së bashku pimë nga një kafe të ofruar nga biznesmeni Musa Riçku, i cili mbuloi edhe shpenzimet e transportit të gjithë eskursionistëve. Në emër të kryesisë së LID eskursionistët pjesëmarrës i përshëndeti Bashkim Lleshi. Në përmjet këtij eskursioni shumë të bukur u njohëm me ritmet e punimeve të kësaj rrugedhe na u krijua bindja se Rruga e Arbërit do të përfundojë sipas parashkimit dhe premtimit të Kompanisë "Gjoka", brenda 6 mujorit të parë të vitit 2021.

Kështu edhe dy vite na ndajnë nga realizimi i ëndrrës gati 30 vjeçare të dibranëve për përfundimin e Rrugës së Arbërit. Por në Qarkun e Dibrës janë në gjendje shumë të keqe, ose në disa vende mungojnë, rrugët lidhëse me aksin kryesor të kësaj rruge. Në rrugët e brendëshme të Dibrës e Matit ka vite që nuk është vënë dorë. Ato kanë nevojë për përmirësime e mirëmbajtje dhe në disa zona, si në Martanesh e Macukull, Grykë të Vogël, Gollobordë e Katër Grykët, në Lurë, Reç, Dardhë e Kala të Dodës duhet edhe ndonjë shtesë rruge e re, ç'ka do t'i jepte një shtytje të mëtejshme zhvillimit ekonomik të këtij qarku me pasuri të shumta nëntokësore e mbitokësore, me pasuri ujore, pyjore, me bjeshkë e kullota alpine malore, me monumente historike, gjeomonumente, hidromonumente e biomonumente, me lumej, kanjone, ujvara e liqej akullnajorë malorë shumë të bukur të cilat natyra ia ka falë kësaj treve të pasur e me bukuri të rralla të natyrës, për zhvillimin ekonomik dhe turizmin historik e malor të kësaj treve të begatë.

Shoqata LID dhe gazeta "Rruga e Arbërit" ashtu si deri tani do të vazhdojnë të jenë në opozitë me çdo qeveri, jo vetëm për përfundimin në kohë e me cilësi të Rrugës së Arbërit por edhe për përmirësimin, mirëmbajtjen dhe hapjen e ndonjë segmenti të ri për t'u lidhur me aksin kryesor të Rrugës së Arbërit, ç'ka do ti jepte një hop të mëtejshëm jo vetëm zhvillimit ekonomik të kësaj zone, nëpërmjet zhvillimit të bujqësisë, blegtorisë, frutkulturës, kërkimit e shfrytëzimit të pasurive nëntokësore e mbitokësore, por edhe zhvillimit të mëtejshëm të turizmit historik e malor. Pasuritë dhe bukuritë e Qarkut të Dibrës nuk janë pronë, vetëm e dibranëve dhe matjanëve, por janë pronë e gjithë kombit shqiptar, pasuritë nëntokësore e mbitokësore të kësaj treve janë pronë e gjithë shqiptarëve, prandaj organet e larta të shtetit duhet t'i kthejnë sytë edhe nga Dibra që asaj t'i akordohen investimet e nevojshme për zhvillimin e mëtejshëm të saj.



Eskursionistët e Rrugës ssë Arbërit pranë Pamje nga Hyrja e Tunelit të Murrizës Tunelit në ZallDajt më 27 prill 2019

Zhvillimi i kësaj konference do të na njohë jo vetëm me pasuritë nëntokësore e mbitokësore dhe bukuritë natyrore e historinë e këtij qarku, por edhe me gjendjen e rrugëve lidhëse me aksin kryesor të Rrugës së Arbërit, duke shtruar detyrën para organeve qëndrore e vendore të pushtetit, për akordimin e fondeve të nevojshme për përmirësimin, mirëmbajtjen e hapjen e ndonjë segmenti të ri rruge, ç'ka do t'i shërbejë zhvillimit të mëtejshëm ekonomik e kulturor të kësaj treve.

Referimet

Abdi Baleta "Sali Hapi dy arteret koronare të Shqipërisë" Gazeta "Rruga e Arbërit" shkurt 2007
Abdurahim Ashiku "Natyra dibrane, "guaska" që mban perlën e bukurisë shqiptare" Gazeta "Rruga e Arbërit" nr.3(131) mars 2017
Adem Bunguri "Prehistoria e Dibrës" Tiranë 2010
Adi Darsi "Për në Petralbë, një rrugë drejt historisë" Gazeta "Rruga e Arbërit" nr.3(131) mars 2017
Agim Shenjatari "Pasuritë minerale të rrethit të Matit që vihen në lëvizje për ekonominë e tregut me ndërtimin e Rrugës së Arbërit"
Kuvendi tekniko-shkencor për Rrugën e Arbërit" maj 2007
Agim Totraku "Liqenet e Balgjajt , bukuria e heshtur", gazeta Rruga e Arbërit nr.7 (123) korrik 2016).
Ali Hoxha "Kjo përmendore na kujton se të parët tanë këtë truall e kanë mbrojtur me gjakun dhe jetën e tyre." Gazeta Rruga e Arbërit nr. 11 (103) Tiranë nëntor 2014
Azis Keta "Rruga e Arbërit, Dëshmitë historike nga Tirana në Bulqizë" G."Rruga e Arbërit" nr.11 (151) 2018
Iljaz Kaca "Rrugët e vjetra të Dibrës" Tiranë 2003
Bashkim Lleshi "Rruga e Arbërit i shërben edhe zhvillimit më të shpejtë të turizmit malor dhe njohjes së mëtejshme të historisë" Gazeta "Rruga e Arbërit" nr.6 tetor 2006
Bashkim Lleshi "Rruga e Arbërit i shërben edhe zhvillimit më të shpejtë të turizmit malor dhe njohjes së mëtejshme të historisë" Gazeta Rruga e Arbërit nr.6 tetor 2006
Bashkim Lleshi, Avni Dibra "Rruga e Arbërit premisë për zhvillimin e turizmit"
Kuvendi tekniko-shkencor për Rrugën e Arbërit" maj 2007
Bashkim Lleshi "Gjeologjia e Rrugës së Arbërit" libër Tiranë 2008
Bashkim Lleshi "Pse lejohet të bëhen ndryshime të aksit të rrugës së miratuar në studimin e fizibilitetit në dëm të cilësisë së saj". Gazeta Rruga e Arbërit maj 2008, Gazeta Ekonomia korrik 2008
Bashkim Lleshi "Pushtetarë dhe opozitarë, edhe sa kohë do të vazhdoni të mos e mbani premtimin e dhënë për ndërtimin e Rrugës së re të Dibrës, Rrugës së Arbërit"? Gazeta "Rruga e Arbërit" qershor 2006
Bashkim Lleshi "Macukulli fshati i historisë së vjetër dhe investimeve të reja" G."Rruga e Arbërit" prill 2011
Bashkim Lleshi "Urojmë që fatin e Tunelit të Qafë Buallit të mos e pësojë Tuneli i Qafë Murrizës"dhjetor 2014
Bashkim Lleshi "Rruga e Arbërit do ti shërbejë njohjes së mëtejshme të historisë" G."Rruga e Arbërit" mars 2017
Bashkim Lleshi "Ruga e Arbërit i shërben edhe zhvillimit të mëtejshëm të turizmit malor"G.Rr.Arbërit"prill 2017
Bujar Karoshi "Një e vërtetë mes shumë të vërtetash" Gazeta "Rruga e Arbërit" maj 2006
Bujar Karoshi "Shpëtoni Rrugën e Arbërit" Gazeta Rruga e Arbërit gusht 2014
Bujar Karoshi "Vihet në dyshim financimi kinez për Rrugën e Arbrit, Gazeta Rruga e Arbërit shtator 2015
Bujar Karoshi " 2015: Deklaratat për Rrugën e Arbrit", Gazeta Rruga e Arbërit dhjetor 2015
Bujar Karoshi "Kryeministri: Po vonojmë firmën për Rrugën e Arbrit në interes të publikut ",Gazeta Rruga e Arbërit janar 2016
Bujar Karoshi "Qeveria shpall tenderin për dhënjen me koncension të Rrugës Arbërit" Gazeta Rruga e Arbërit gusht 2017
Bujar Karoshi "Me Rrugën e Arbërit Dibra kthehet në kopshtin e Tiranës" Gazeta Rruga e Arbërit nëntor 2017
Destan Rama"Peladhia, një emër që vjen nga legjenda" Gazeta "Rruga e Arbërit" nr.7 (99) korrik 2014
Edi Rama "Rruga e Arbërit nga premtim në realitet" Gazeta "Rruga e Arbërit" nëntor 2017
Edlira Haxhiymeri, Bujar Karoshi "Relacion për Rr. e Arbërit" Ministrisë Ndërtimit e DPRrugëve prill 2017
Almira Xhembulla "Ja ku po punohet në Rrugën e Arbërit" Gazeta "Rruga e Arbërit" nr.11 (151) nëntor 2018
Faruk Kaba, etj. "Studim për mundësinë e ndërtimit të Rrugës së Arbërit (Përmbledhje e studimit të fizibilitetit)
Kuvendi tekniko-shkencor për Rrugën e Arbërit" maj 2007
Grehans Uka, Bujar Karoshi: "Guida malore, ja vendet që mund t'i vizitoni" gazeta Rruga e Arbërit nr.7 (123) korrik 2016
Hysen Repa -" 470 vjetori i Betejës së Torviollit"Gazeta Rruga e Arbërit nr.6 (98) qershor 2014
Kristo Zharkalli - "Takim me Isa Elez Ndreun", Gazeta "Rruga e Arbërit" Mars 2011
Metush Skeja -"Pesë kurizitete rret Kalasë së Dodës" gazeta Rruga e Arbërit nr.7 (123) korrik 2016)
Moisi Murra-" Mersim Dema, Mbreti i Maleve", Tiranë 2003
Munir Shehu - "Dibra I në vitet 1840-1860", Tiranë 2010
Nuri Abdiu,Bujar Karoshi "Relacion për Rrugën e Arbërit" Ministrisë së Ndërtimit DPRrugëve mars 2014
Perikli Qirjazi, Skënder Sala –"Monumentet e natyrës së Shqipërisë" Tiranë 2006
Qeram Lleshi- "Përshkrime dhe konstatime mbi Sfetigradin nga burime historike dhe gjurmime në terren"
Sesion shkencor "Skënderbeu dhe Dibra " faqe 195-214, Dibër mars 2003
Rruzhdi Bitri "Prapë na çeli Grama" gazeta Rruga e Arbërit nr.7 (123) korrik 2016)
Selman Mëziu "Të gjallët grishin gërmadhat", Gazeta "Rruga e Arbërit" Mars 2011
Shaqir Skarra - "Rruga e Arbërit, përmasa kombëtare e munguar" Gazeta "Rruga e Arbërit" maj 2006
Shefki Aliti "Rruga e Arbërit në teritorin e Maqedonisë.Kuvendi Tekniko-Shkencor për Rrugën e Arbërit, f. 43-49, Tiranë maj 2007
Shefki Aliti "Inervistë për Gazetën Rruga e Arbërit", shtator 2013
Shuip Marku "Uji dhe mali aty ku shërohet trupi dhe shpirti" Gazeta Rruga e Arbërit nr.7 (123) korrik 2016.
Tafë Ameti,Bujar Karoshi- "Ringjallja e Rekës së Epërme" Rruga e Arbërit nr.7 (123) korrik 2016
Valter Shtylla "Rrugët dhe urat e vjetra në Shqipëri" faqe 19, Tiranë 1998
Valter Shtylla- "Rruga e Arbërit rruga kryesore e vendit krahas rrugës Egnatia që në lashtësi"
Kuvendi Tekniko-Shkencor për Rrugën e Arbërit, faqe 5-19, Tiranë maj 2007
Vesel Hoxha " Rruga e Arbërit, rruga e zhvillimit të Shqipërisë lindore" Gazeta "Rruga e Arbërit" shkurt 2007
Vesel Hoxha:"Pasuritë minerale të rajonit të Dibrës që mund të vihen në qarkullim ekonomik me ndërtimin e Rrugës së Arbërit" Kuvendi tekniko-shkencor për Rrugën e Arbërit" maj 2007
Vesel Hoxha "Ndërtimi i Rrugës Arras-Lurë domsdoshmëri për zhvillimin e turizmit dhe kërkimin e mineraleve" (Vesel Hoxha, Gazeta "Rruga e Arbërit" nr.11 (151) nëntor 2018
Xhafer Seiti "Rruga e Arbërit integron jo vetëm Dibrën", Gazeta "Rruga e Arbërit" maj 2006
Xhafer Seiti "Rruga e Arbërit do ndërtohet por kam dëshirë t'a ndërtojë qeveria që përfaqësoj" . Gazeta "Rruga e Arbërit" korrik 2006

aktualitet

Ekipi kosovar i kërkim shpëtimit ishte ndër të parët, që në orën 4.30 të mëngjesit pas tërmetit të 26 nëntorit në ndihmë të viktimave në Thumanë.

TËRMETI QË KA RËNË NË DURRËS, KA BËRË QË TË TRONDITET SHQIPËRIA E MADJE MBARË SHQIPTARIA. SHQIPTARËT KANË QENË MË SOLIDARË SE ASNJËHERË NË KËTO DITË TMERRI E PANIKU.

Humbja më e madhe ishte në familjen Lala në Durrës, me origjinë nga Dibra. "Tetë anëtarë të familjes Lala u shuan nën rrënojat e vilës së tyre katër katëshe në zonën e ish-kënetës në Durrës. Ata u përcollën në banesën e fundit më 29 nëntor.

"Lalajt ishin një nga familjet që pësuan goditjen më të fortë të tërmetit me jetë të humbura. Sahadete Lala 79 vjeç ndërroi jetë me djalin e saj të paralizuar Ilir Lala 52 vjeç, me nusen e djalit tjetër Marjeta Lala, 4 fëmijët e saj, dhe mbesën nga djali tjetër.Vila ku jetonin bashkë familjet e tre vëllezërve u kthye në mort, pasi u shemb nga tërmeti i 26 nëntorit. Bashkëshorti i Marjeta Lalës që humbi të katërt fëmijët ishte në Itali, ashtu edhe vëllai tjetër i cili në këtë tragjedi humbi vajzën, Griselda Lalën, 22-vjeç. I vetmi që doli gjallë nga rrënojat ishte Ramë Lala 17 vjeç", raportonte shqiptarja.com më 29 nëntor.

Por kjo tragjedi pati edhe anën tjetër, atë të solidaritetit. Lajmet raportuan nga terreni për vullnetarë që iu bashkuan ekipeve të shpëtimit si dhe makina me ndihma ushqimore dhe rroba. Grupe vullnetarësh nga Dibra e Madhe mblodhën ndihma dhe u angazhuan në Durrës duke ndihmuar. Bashkia e Dibrës së Madhe ndau 300 mijë denarë për të prekurit, duke vërtetuar se pavarësisht se kufijve, shpirtërisht gjendet afër Shqipërisë.





ARBEN FIDA: Më thirri gjaku i të parëve të mi

Zjarrfiksi nga Dibra e Madhe. që vuri jetën e vet në rrezik për të shpëtuar të mbijetuarit e tërmetit të datës 26 nëntor 2019

Tërmeti i 26 nëntorit 2019 ishte një tmerr i vërtetë. 51 të vdekur dhe 900 të plagosur. Lajmi hapet si vetëtimë. Si vetëtimë vrapojnë shpëtimtarët, atdhetarët, shqiptarët anë e mbanë botës.

Një nga këtë shpëtimtarë ishte Arben Munir Fida nga Dibra e Madhe, i trajnuar si zjarrfikës dhe shpëtim jetësh në rast fatkeqësie natyrore. Arbeni nuk priti as urdhër, as porosi, as leje, por vrapoi drejt shtetit Amë, drejt Shqipërisë, drejt Durrësit.

U bashkua me skuadrën e zjarrfikësve të Rumanisë dhe me të u bashkua edhe një mik i tij zjarrfikës nga Kavaja. Shpëtuan jetë njerëzish, nxorën kufoma nga gërmadhat, vunë jetën e tyre në rrezik.

Televizioni Report TV e interviston në vendin e ngjarjes.

"Kush jeni ju?"

"Jam Arben Fida nga Dibra e Madhe."

Paradoksi qëndron se ka akoma shqiptarë, akoma nxënës shkolle që nuk e dinë se ku bie Dibra e Madhe, se Dibra e Madhe që nga viti 1913 është shkëputur nga trupi amë nga vendimet famëkeqe të fuqive të Europës.

Kush është Arben Fida ? Është pak të thuash hero. Është i biri i Munir Fidës, profesorit të historisë në Gjimnazin e Dibrës së Madhe, historianit që derisa vdiq shkroi për Dibrën dhe Shqipërinë. Muniri është nip në trojet brenda Shqipërisë, tek fisi Cami në Viçisht të Dibrës dhe vetëm pas viteve 90 arriti që të bashkohet me dajat e tij dhe të afërmit.

Arbeni është vëllai i Argëtim Fidës, mjekut që për dy legjislatura drejtoi komunën e Dibrës së Madhe. Dhe s'ka si të ndodhte ndryshe. Ky atdhetarizëm i mbrujtur në shekuj tek të afërmit e tij si të nënës dhe të babait, u ngrit në piedestal në një rast të tillë epokal siç ishte tërmeti i 26 nëntorit.

Në internet nga Durrësi Arbeni nxori një lajmërim: "Kush ka nevojë për strehim dhe ushqim nga Shqipëria le të shkojë në Dibër të Madhe tek Hotel Restoranti i tij modest. Ushqimi dhe fjetja ofrohet falas. E ç'mund të bëjë më njeriu i mirë përveç se kaq?

- Ku e gjeni forcën për t'u futur në rrënoja? - e pyet gazetarja e Report TV.

- Është obligim shpirtëror kombëtar, profesional, - përgjigjet Beni. - Ne zjarrfikësit jemi njerëz të betuar. Aq më tepër për këtë rast. Oj Shqipëri të qofshim falë, na ke bij, të kemi nanë, - e mbyll bisedën Arben Fida, heroi zjarrfikës nga Dibra e Madhe.

Sakip Cami

Mirënjohje ekipit kosovar të kërkim-shpëtimit

Nga **Halil RAMA**



Të premten në darkë, më 29 Nëntor (ditën e jubileut të lavdishëm të 75-vjetorit të çlirimit të atdheut), pas katër ditë kërkimi intensiv, gjeneral brigade Manushaqe Shehu, në funksionin si zëvendës shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave tona të Armatosura nderoi me Çertifikata Mirënjohje ekipin kosovar të kërkim shpëtimit, të kryesuar nga Kapiten Kreshnik Nimani. "Mirënjohja, si shprehja më e bukur e karakterit të Njeriut është më kuprimplote në këto ditë të veshtira për të gjithë ne. Ajo ju takon Ju që si ekip kosovar erdhët të parët dhe dhatë një kontribut të veçantë në shpëtimin e disa jetëve dhe në nxjerrjen e disa të pajetëve nga gërmadhat. Në këto ditë të vështira Ju u bëtë shembull frymëzimi edhe për forcat tona të armatosura", u shpreh ndër të tjera numri dy i Forvave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Vetë gjeneral Brigade Manushaqe Shehu, e vetmja grua shqiptare me këtë gradë madhore dhe në një funksion kaq të rëndësishëm ishte vetë bashkë me ekipipin kosovar në ndihmë të personave që u ndodhen nën rrënoja, si pasojë e tërmetit që shkatërroi një qytezë të tërë në Thumanë ku mori jetën e 24 personave (24 viktima te tjera në Durrës dhe 2 në Kurbin) dhe shkatërroi dhjetra pallate e shtëpi banimi. Në përfundim të këtij misioni ajo i falenderon përzemërsisht dhe shpreh mirënjohje për heronjtë ekëtyre ditëve të paharrueshme dhimbjeje kombëtare.

Vlerësimi maksimal i gjenerales shqiptare është për këtë trupë të shkëlqyer djemsh e vajzash, të bukur, të fortë, të aftë, të disiplinuar dhe të palodhur deri në përmbushjen me sukses të misionit, si produkti më spektakolar që ka nxjerrë lufta e Kosovës, në funksion të paqes së dinjitetshme...

"Ekipi kosovar i kërkim shpëtimit ishte ndër të parët, që në orën 4.30 të mëngjezit pas tërmetit të 26 nëntorit në ndihmë të viktimave në Thumanë. Me një angazhim maksimal mbresëlënës vetëm më 26 Nëntor, në bashkëpunim me forcat shqiptare dhe ato greke shpëtuan në Thumënë 17 jetë njërëzish", pohon gjeneral Brigade Manushaqe Shehu.



Efektivët e skuadrave të kërkim-shpëtimit të ardhura nga Kosova, ekipet e specializuara të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe të Policisë së Kosovës ishin të parat që mbërritën, duke u përqëndruar në Durrës dhe Thumanë, në punën për nxjerrjen e të mbijetuarve dhe personave që humbën jetën nën rrënoja. Gjeneral Brigade Manushaqe Shehu i ka falenderuar njësitet e specializuara nga Kosova, duke nënvizuar mirënjohjen për solidaritetin e treguar si dhe duke evidentuar profesionalizmin dhe gatishmërinë e lartë, si dhe kurajon e pashembullt që ata dëshmuan, duke na bërë krenarë të gjithëve.

"Ekipi kosovar i kërkim shpëtimit ishte ndër të parët, që në orën 4.30 të mëngjezit pas tërmetit të 26 nëntorit në ndihmë të viktimave në Thumanë. Me një angazhim maksimal mbresëlënës vetëm më 26 Nëntor, në bashkëpunim me forcat shqiptare dhe ato greke shpëtuan në Thumënë 17 jetë njërëzish", pohon gjeneral Brigade Manushaqe Shehu. Ajo është e vetmja grua shqiptare që mban këtë gradë. Numri dy i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Shqipërisë (Nga data 16 janar 2018 e në vijim kryen detyrën e Zëvendësshefit të SHP të FA) vjen në këtë funksion mjaftë të rëndësishëm pas një karriere të shkëlqyer në të gjitha nivelet e Ushtrisë Shqiptare.

Veçanërisht, dibranët krenohet me profilin e vajzës së tyre, doktore e shkencave, gjenerale dhe juriste. Mbi të gjitha tek ajo spikasin vlerat njerëzore që i demonstroi përkrah vëllezërve tanë kosovarë edhe në këto çaste tragjike për kombin tonë. Personaliteti dhe karakteri i saj në asnjë rast nuk devijoi, por u shpalos me dinjitet për më shumë se tri dekada në funksion të zhvillimit dhe modernizimit të Forcave tona të Armatosura. Ishte nga të parët që i fali shpirtin dhe zemrën ëndrrës së dëshiruar në vite. Në këtë përditshmëri ajo mbetet një nga figurat më interesante si përfaqësuese e elitës intelektuale shqiptare.

Rruga e Arbërit nr. 163

Ndërkohë kompania reagoi publikisht në faqen e saj në Facebook, duke e cilësuar protestën një përplasje mes sindikatave, ndërsa tha se ishte vetëm nga një grup i vogël punëtorësh

Minatorët e Bulqizës në protestë

Albchrome shkarkon nga puna disa prej anëtarëve të sindikatës

Nga **SAMI CURRI**



Vetëm pak ditë pas themelimit të Sindikatës së Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës, kompania Albchrome ka shkarkuar kryetarin e zgjedhur të kësaj sindikate Elton Debreshi, ndërsa disa prej themeluesve janë thirrur nga kompania në Tiranë me arsyetimin "për të shmangur raste të thyerjes së etikës dhe disiplinës në vendin e punës".

Shkarkimi i Debreshit ka sjellë që punëtorët e tjerë të Albchrome të bojkotojnë punën për 10 ditë dhe të protestojnë para hyrjes së kompanisë. Kompania gjatë periudhës ku punëtorët ishin në protestë ka shkarkuar nga puna një tjetër anëtar të këshillit sindikal të Sindikatës Minatorët e Bashkuar të Bulqizës. Beqir Duriçi që mban njëkohësisht edhe detyrën e përgjegjësit të finacave në sindikatë. Duriçi e lidh shkarkimin e tij nga puna me aktivitetin sindikal dhe protestën që u zhvillua para kompanisë Albchrome. Kompania paralajmëroi për shkarkim nga puna edhe Behar Gjimi që është pjesë e Këshillit Sindikal.

Sindikata e Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës në një komunikatë shpërndarë në faqen e saj në Facebook shkruan se vendimi për shkarkimin nga puna të kryetarit të sindikatës së Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës, Elton Debreshi dhe të anëtarit të këshillit sindikal Beqir Duriçi nga kompania Albchrome është i padrejtë, në shkelje të plotë të Kushtetutës që garanton lirinë në organizime sindikale, Kodit të Punës dhe të Konventave Ndërkombëtare.

"Kompania e Samir Manes e ka humbur toruan nga greva dhe kërkesat e drejta të minatorëve. Kush mendon se do të na thyejë me presion dhe paligjshmëri, e ka gabim. Vetëm sa forcohemi në rezistencën tonë për punë dhe jetë të dinjitetshme", shkruhet në faqen e sindikatës.

Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore dega Dibër bëri me dije se kishte nisur hetimet edhe për shkarkimin e dytë. ISHPSHSH, njoftoi hetime edhe pas shkarkimit të Debreshit, por burime nga inspektoriati thanë se ende nuk ka dalë me një raport përfundimtarë.

Ndërkohë Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë dhe një prej sindikatave të saj e cila ka edhe kontratën kolektive me Albchrome, ka sulmuar protestuesit duke u kërkuar të braktisin protestën për të mirë të punës "që i ushqen". Nga ana e saj policia e Bulqizës, e akuzuar nga minatorët për presion, njoftoi fillimin e procedimit penal ndaj shtatë protestuesëve duke i akuzuar se kishin zhvilluar protestë "pa lejen e organeve kompetente". Policia nuk iu përgjigj pyetjes së BIRN në lidhje me pretendimin e minatorëve se u ishte bërë presion që të mos vijonin protestën.

Albchrome nuk iu përgjigj një kërkese të BIRN për koment në lidhje me shkarkimet dhe paralajmërimet. Ndërkohë kompania reagoi publikisht në faqen e saj në Facebook, duke e cilësuar protestën një përplasje mes sindikatave, ndërsa tha se ishte vetëm nga një grup i vogël punëtorësh. "Një pakicë punonjësish, që nuk përfaqësojnë masën e minatorëve, teknikëve dhe inxhinierëve, kanë themeluar një sindikatë tjetër dhe ne si Albchrome nuk jemi pjesë e saj, kjo për arsye se aktualisht, kemi nënshkruar një kontratë kolektive me një sindikatë tjetër", thuhet në njoftim e shpërndarë në faqen zyrtare të kompanisë.

REAGIMET E SINDIKATAVE TË TJERA

Reagimi i kompanisë nuk sqaron se përse Albchrome ka marrë anën e njërës prej sindikatave dhe po shkarkon punonjësit që janë përfshirë në sindikatën e re. Ndërkohë Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë që drejtohet nga Kol Nikolla, sulmoi protestuesit dhe Sindikatën e Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës, duke i akuzuar ata si anarkistë dhe pseudomarksistë. "Me kërkesa haxhi-qaministe, të artikuluara në letra paçavure, të afishuara nëpër mure tualetesh dhe dhoma çveshjesh të minatorëve janë fytyra e vërtetë e pseudostudentëve pseudomarksist", shkruhej në faqen e KSSH-së në Facebook.

Një reagim të ngjashëm bëri edhe Federata Sindikale e Punonjësve të Industrisë së Shqipërisë, FSPISH, e cila ka nënshkruar kontratën kolektive me Albchrome dhe aderon në KSSH. KSSH pretendon se ka fituar disa të drejta për minatorët në vite dhe ka përmirësuar kushtet e punës. Sindikatat megjithatë nuk reaguan pas shkarkimit të Debreshit, të cilin e akuzojnë se po punon për karrige.

Ato nga ana tjetër përdorën në komunikimet e tyre gjuhë që tingëllon kërcënuese ndaj minatorëve, për t'i ndaluar t'i bashkohen protestës. "Edhe një herë, për të mirën tuaj, por dhe të punës që ju ushqen", shkroi në një reagim po në Facebook FSPISH. Ajo u kërkoi minatorëve "t'i kthehen normalitetit të tyre".

Të dy sindikatat ndërkohë pretenduan pa ndonjë të dhënë se protesta njëfarësoj kishte lidhje me rënien e çmimit të kromit në tregjet ndërkombëtare dhe e përdorën këtë si presion për të ndaluar protestën. "Këto çorganizime të organizuara paralajmërojnë situatë të përkeqësuar, pasi kemi një rënie drastike të çmimit në bursën e kromit dhe ferrokromit, e për pasojë mbylljen e ativitetit minerar për kohë të pa përcaktuar", thuhet në reagim të KSSH.

Ndërkohë në përgjigje të këtyre reagimeve Sindikata e Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës akuzoi FSPISH dhe Konfederatën e Sindikatave të Shqipërisë se kishin marrë anën e kompanisë dhe po u bënin presion minatorëve.

"Për ne është e papranueshme: ata që deri më sot e kanë konsideruar veten sindikalistë, kërcënojnë punëtorët që po protestojnë që të rikthehen në vendin e punës. Për ta, e mira ju ka zënë sytë, por minatorët e Bulqizës nuk arrijnë t'i shohin. Në ç'vend normal të botës, sindikata nuk do të mbronte interesat e punëtorëve, por interesat e kompanisë në kurriz të punëtorëve? Kjo ndodh në Shqipëri", shkruhet në reagimin e SMBB.

Kompania nga ana e saj e distancoi veten nga protesta dhe ajo që e quajti përplasje mes sindikatave. "Kompania Albchrome distancohet tërësisht nga ky proces dhe siguron opinionin publik që puna në minierë vijon rregullisht dhe nuk është ndërprerë për asnjë moment", thuhet në njoftim, ku po ashtu pretendohet se Aolbchrome kishte investuar 22 milion dollarë në muajin e fundit në minierë.

Instituti Botëror i Punës (Global Labor Institute) i është drejtuar me një letër kryeministrit Rama duke kërkuar ndërhyrjen e tij për shkeljen e rëndë të të drejtave të anëtarëve të Sindikatës së Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës (SMBB) në Shqipëri. Nëpërmjet kësaj letre Instituti i kujton qeverisë se ka ratifikuar Konventën Ndërkombëtare të Punës dhe veprime të tilla janë në kundërshtim të saj.

"Më 17 nëntor të këtij viti një grup i punëtorëve të minierave të kromit në Bulqizë njoftuan formimin e një sindikate të re. Ata nuk ishin të kënaqur me punën e sindikatës ekzistuese, nga e cila ata ishin anëtarë, dhe po kërkojnë të krijojnë një strukturë të re mbi të cilën ata mund të ushtrojnë kontroll të plotë demokratik. Siç jam i sigurt se jeni në dijeni, kjo është e drejta e tyre sipas Konventave 87 dhe 98 të Organizatës së Punës, të cilat Shqipëria ka ratifikuar dhe të cilat janë baza e legjislacionit aktual shqiptar të punës", thuhet në letër.

Në këtë letër është përmendur fakti që Elton Debreshi, kryetari i zgjedhur i sindikatës për ta ushtruar këtë post me një mandat prej tre vjetësh, është shkarkuar disa ditë pasi është shpallur formimi i SMBB-së. Instituti Botëror i Punës ka reaguar edhe ndaj heqjes nga puna të Beqir Duriçit, anëtar i këshillit të SMBB-së dhe kanë dënuar thirrjen në polici dhe kërcënimet për pushim nga puna të anëtarëve të tjerë, të cilët u oganizuar në grevë për të kërkuar kushte më të mira pune.

"AlbChrome ka reaguar me armiqësi totale: kryetari i sindikatës së re, Elton Debreshi, u pushua nga puna më 22 nëntor, si dhe anëtari i Komitetit Ekzekutiv, Beqir Durici, në 3 dhjetor. Anëtarët e tjerë të Komitetit Ekzekutiv janë kërcënuar me pushim nga puna dhe janë ndaluar nga policia. Ne besojmë se kjo është sjellje e egër nga ana e një kompanie, të cilës i mungon respekti për punonjësit e saj dhe për shoqërinë në të cilën operon".

Duke përmendur kërkesat kryesore të sindikatës, të cilat përkojnë me kthimin e Debreshit dhe Duriçit në punë, ndalimin e intimidimit dhe kërcënimit nga ana e kompanisë AlbChrome, Instituti Botëror i Punës është plotësisht në përkrahje të minatorëve dhe mbështet kërkesat e tyre deri në krijimin e një marrëveshjeje kolektive. Letra drejtuar Kryeministrit mbyllet duke i kërkuar edhe një herë ndërmarrjen e veprimeve bazuar në standardet ndërkombëtare.

Vendimi ynë për ndërprerjen e përkohshme të grevës është një hap i nevojshëm që do të na japë vrull më të madh javët në vazhdim, për ta detyruar kompaninë të vërë të drejtën në vend.

REAGIM NGA SINDIKATA MINATORËT E BASHKUAR TË BULQIZËS

Greva që ngjalli shpresën e minatorëve dhe të gjithë Bulqizës

Shumica dërrmuese e minatorëve të Bulqizës që punojnë në kompaninë Albchrome, janë hedhur në grevë që më 25 nëntor. Shtysa për grevë erdhi nga pushimi i paligjshëm nga puna i kryetarit të Sindikatës së Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës, Elton Debreshit. Një akt i tillë u bë nga kompania vetëm 5 ditë pasi sindikata ishte shpallur në qendër të Bulqizës. Kërkesat tona përfshinë edhe plotësimin e kushteve bazike për punë të sigurt dhe të dinjitetshme.

Pavarësisht presioneve të kompanisë, paligjshmëria e të cilës solli edhe pushimin nga puna të sindikalistit Beqir Duriçi, presioneve policore, ku vetëm në harkun kohor të dy ditëve në Komisariatin e Policisë Bulqizë u shoqëruan 7 protestues, dhe nga ana tjetër heshtjes mediatike: prapësepraprë ne e kemi vazhduar grevën me vendosmëri.

Sot, pas një takimi të gjatë me përfaqësuesit e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe zotimit të tyre se do t'i hetojnë me imtësi pushimet nga puna të shokëve tanë, vendosëm ta ndërpresim përkohësisht grevën.

Ne, njëkohësisht do të nisim edhe betejën në gjykatë.

Arsyet që na shtynë në grevë mbeten në fuqi. Vullneti ynë për të kthyer në punë shokët tanë dhe për të fituar të drejtat që na takojnë, gjithashtu.

Nëse zyrtarët e Albchrome-it do të guxojnë



ta shtrijnë hakmarrjen e tyre te të tjerë minatorë, ne zotohemi se do ta përshkallëzojmë grevën në format më të rënda të mundshme për fitimet e kompanisë.

Ne me krenari mund ta themi se për një kohë shumë të shkurtër që nga themelimi, kemi ngjallur shpresën dhe kemi fituar besimin e minatorëve të Bulqizës se jemi zëri i vetëm i përfaqësimit të tyre. Sot Sindikata e Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës është përfaqësuesja ligjore e shumicës së minatorëve. Sipas Kodit të Punës, sindikatës tonë i takon e drejta të negociojë kontratën e ardhshme kolektive, e cila duhet të përfshijë se s'bën kthimin e shokëve në punë, siguri të plotë në punë, rritje të pagave dhe ulje të normave skllavëruese.

Vendimi ynë për ndërprerjen e përkohshme të grevës është një hap i nevojshëm që do të na japë vrull më të madh javët në vazhdim, për ta detyruar kompaninë të vërë të drejtën në vend.

Ne synojmë të përfshijmë në sindikatë të gjithë punëtorët e minierës, në mënyrë që greva e ardhshme të jetë paralizuese e krejt prodhimit.

Bashkë ia dolëm që në kaq pak kohë të tregojmë se solidariteti mes njëri-tjetrit sjell ndryshim.

Bashkë ia dolëm që sindikata e vjetër të humbasë legjitimitetin për të përfaqësuar ligjërisht dhe moralisht minatorët e Bulqizës.

Bashkë ia dolëm që kompania Albchrome të kuptojë që dinjiteti i minatorit nuk mund të përdhoset më.

Bashkë ia dolëm që të mundim frikën, terrorin dhe të ngjallim shpresën te minatorët dhe tek i gjithë qyteti.

Bashkë ia dolëm të tregojmë se fuqia e njerëzve të thjeshtë të Bulqizës, larg partive politike, është shumë e madhe.

Minatorët e bashkuar kanë për të fituar!

Mbështetje nga sindikatat ndërkombëtare për Sindikatën e Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës:

MBËSHTETJE NGA GJERMANIA, NGA SINDIKATA E INDUSTRISË SË MINIERAVE, KIMISË DHE ENERGJISË (PËRFAQËSUESE E 630.000 PUNËTORËVE)

"Të dashur kolegë,

Mësova me shqetësim të madh për betejën tuaj me kompaninë AlbChrome pas themelimit të sindikatës suaj të pavarur.

Në emër të sindikatës sonë, IG BCE (Sindikata e Industrisë së Minierave, Kimisë dhe Energjisë), përfaqësuese e 630.000 punëtorëve në Gjermani, deklaroj solidaritetin tonë të plotë në luftën tuaj për kushte pune dinjitoze dhe për rikthimin në punë të drejtuesve tuaj, të shkarkuar në mënyrë të jashtëligjshme.

Si President i rreth 7 milionë anëtarëve të Federatës Europiane - Sindikata Europiane e IndustriAll, unë do të inkurajoj sindikatat e tjera t'i bashkohen luftës tuaj për paga më të mira dhe për kushte më të sigurta pune.

Sipas kërkesës tuaj, ne i kemi dërguar një letër proteste Kryeministrit të Shqipërisë dhe Drejtorit Ekzekutiv të kompanisë AlbChrome.

IG BCE qëndron në solidaritet me ju dhe sindikatën tuaj në Bulqizë. Ne do i ndjekim në vazhdim zhvillimet e sindikatës dhe të çështjes së të drejtave të njeriut në shtetin tuaj dhe ju kërkojmë që të na mbani të informuar.

Sinqerisht,
Michael Vassiliadis, President i IG BCE"

DEKLARATË SOLIDARITETI NË MBËSHTETJE TË MINATORËVE SHQIPTARË NGA SINDIKATA E PUNËTORËVE TË LIBRARIVE DHE SHTËPIVE BOTUESE TË SELANIKUT, GREQI

Sindikata e Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës u shpall më 17 Nëntor 2019, pas aprovimit të gjykatës më datë 15 Tetor. Miniera e Kromit të Bulqizës është më e madhja dhe më e vjetra në Shqipëri, me më shumë se 600 minatorë që punojnë në kushte të vështira dhe paga të ulëta.

Dy ditë pas shpalljes së sindikatës, drejtues të kompanisë Albchrome shkarkuan kryetarin e saj - Elton Debreshi - pa ndonjë arsye reale. Është një veprim i paligjshëm dhe qartësisht hakmarrës, për të frikësuar minatorët dhe për të shtypur vetë-organizimin e tyre.

Pavarësisht kërcënimeve të punëdhënësit, minatorët janë mbledhur jashtë minierës për të kërkuar rikthimin në punë të kryetarit të sindikatës së re.


Michael Vassiliadis
Vorsitzender

IG BCE
Geschäftsführung

Abteilung

Hauptverwaltung

Union of United Minerworkers of Bulgiza
by Email: sindikatiminatorevs@gmail.com

Dear Colleagues,

With great concern, I have heard from your severe struggle with AlbChrome after the foundation of your independent trade union.

On behalf of my union IG BCE (Mining, Chemical and Energy Industrial Union), representing 630 000 workers in Germany, I declare our full solidarity for your fight for decent working conditions and the reinstatement of your illegally fired leaders.

As the President of our roughly 7 million members strong European Federation industriAll European Trade Union I will encourage other unions to join your fight for better wages and safer working conditions.

As you wished we sent postral letters to the Prime Minister of Albania and the CEO of AlbChrome.

The IG BCE stands in solidarity with you and your union in Bulgiza. We will follow further developments of the trade union and human rights situation in the country and ask you to keep us informed.

Your sincerely,

IG BCE President


S.P.M.T.K
KOSOVË

Sindikata e Pavarur e Minatorëve të Trepçës Kosovë

E-mail:sprt.trepca@hotmail.com
Phone:038/551 451
044/104-372

Sindikata e Pavarur e Minatorëve të Trepçës e konsideron si të paligjshëm shkarkimin nga puna të kryetarit të Sindikatës së Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës, Elton Debreshi, nga kompania AlbChrome.

Ne shprehim keqardhjet tona për kryetarin Elton Debreshi dhe për të gjithë minatorët e tjerë që janë shkarkuar nga puna vetëm pse kanë kërkuar kushte më të mira të punës.

Puna jonë si minatorë është mjaft e vështirë, andaj sa herë që kërkojmë kushtet më të mira dikush pëson, mirëpo ne minatorët si të bashkuar gjithmonë do të kërkojmë më të mirën për ne.

Do ta keni përkrahjen tonë gjithmonë për çdo kërkesë të drejtë e cila është në të mirën e minatorëve, ne jemi gjithmonë këtu për ju.

Shprehim solidaritetin ndaj Sindikatës së Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës e sidomos për kryetarin Elton Debreshi, i cili ka dalë në mbrojtje të të drejtave të punëtorëve dhe në fund ka përfunduar me shkarkim nga puna.

Kërkojmë edhe nga Qeveria e Shqipërisë që të marrë masa ndaj kësaj kompanie që shkarkon punëtorë pa asnjë arsye.

Ne nuk do të qëndrojmë duarkryq, por do ju mbështesim gjithmonë, ashtu siç na mbështetni edhe ju ne, andaj me shpresën më të madhe kërkojmë rikthimin e kryetarit Elton Debreshi në vendin e punës dhe të të gjithë minatorëve të tjerë që janë të larguar nga puna.

Respekt për Minatorët e Bulqizës!

Nga: Sindikata e Pavarur e Minatorëve të Trepçës

Në solidaritet me Sindikatën e Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës, kërkojmë rikthimin e kryetarit të saj - Elton Debreshi - menjëherë në punë!

Minatorët dhe punëtorët ballkanas do ia dalin!

- SINDIKATA E PUNËTORËVE TË LIBRARIVE DHE SHTËPIVE BOTUESE TË SELANIKUT, GREQI
Kryetari: Glarnetatzis Yannis
Sekretari i Përgjithshëm: Xoplidis Panayiotis

MINATORËT E TREPÇËS NË KOSOVË, NË MBËSHTETJE TË MINATORËVE TË BULQIZËS

Sindikata e Pavarur e Minatorëve të Trepçës në Kosovë ka dalë në mbështetje të minatorëve të Bulqizës, pas shkarkimit nga puna të kreut të Sindikatës së Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës, Elton Debreshi. Me anë të një komunikate dërguar minatorëve të Bulqizës, Sindikata e Pavarur e Minatorëve të Trepçës, shpreh keqardhje për shkarkimin nga puna të minatorëve që kanë themeluar sindikatën dhe kanë kërkuar kushte më të mira pune në minierën e Bulqizës. Një mbështetje e tillë vjen në vazhdën e një sërë sindikatave ndërkombëtare që janë solidarizuar me Sindikatën e Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës.

Deklaratë solidariteti nga Sindikata e Pavarur e Minatorëve të Trepçës

Sindikata e Pavarur e Minatorëve të Trepçës e konsideron si të paligjshëm shkarkimin nga puna të kryetarit të Sindikatës së Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës, Elton Debreshi, nga kompania AlbChrome.

Ne shprehim keqardhjet tona për kryetarin Elton Debreshi dhe për të gjithë minatorët e tjerë që janë shkarkuar nga puna vetëm pse kanë kërkuar kushte më të mira të punës.

Puna jonë si minatorë është mjaft e vështirë, andaj sa herë që kërkojmë kushtet më të mira dikush pëson, mirëpo ne minatorët si të bashkuar gjithmonë do të kërkojmë më të mirën për ne.

Do ta keni përkrahjen tonë gjithmonë për çdo kërkesë të drejtë e cila është në të mirën e minatorëve, ne jemi gjithmonë këtu për ju.

Shprehim solidaritetin ndaj Sindikatës së Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës e sidomos për kryetarin Elton Debreshi, i cili ka dalë në mbrojtje të të drejtave të punëtorëve dhe në fund ka përfunduar me shkarkim nga puna.

Kërkojmë edhe nga Qeveria e Shqipërisë që të marrë masa ndaj kësaj kompanie që shkarkon punëtorë pa asnjë arsye.

Ne nuk do të qëndrojmë duarkryq, por do ju mbështesim gjithmonë, ashtu siç na mbështetni edhe ju ne, andaj me shpresën më të madhe kërkojmë rikthimin e kryetarit Elton Debreshi në vendin e punës dhe të të gjithë minatorëve të tjerë që janë të larguar nga puna.

Respekt për Minatorët e Bulqizës!
Nga Sindikata e Pavarur Minatorëve të Trepçës

DEKLARATË SOLIDARITETI ME MINATORËT SHQIPTARË NGA SINDIKATA E INXHINIERËVE TË PUNËSUAR NË GREQI (mekanikë, gjeologë, të teknologjisë, teknicienë, projektues)

Më 15 tetor 2019, sindikata e pavarur "Sindikata e Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës" u themelua në veri të Shqipërisë, në minierën më të madhe dhe më të vjetër në Shqipëri, me mbi 600 punëtorë që punojnë në kushte shumë të vështira. Siç shprehen në deklaratën e sidnikatës, "ne minatorët e Bulqizës kemi aftësinë të përballemi me vdekjen përditë, me pagat e ulëta, me frikën dhe me shkeljen e dinjitetit tonë. Sindikata është fuqia jonë."

Pak ditë pas themelimit zyrtar të sindikatës së pavarur, kompania që shfrytëzon minierën, ALBCHROME, u përgjigj duke pushuar nga puna Elton Debreshin, një prej themeluesve dhe drejtuesin e sindikatës. Ky veprim është në kundërshtim me Kodin e Punës në Shqipëri dhe qëllimi i tij i vetëm është të frikësojë punëtorët në mënyrë që të ulin kokët dhe të mos kërkojnë të drejtat e tyre demokratike.

Ne solidarizohemi me Sindikatën e Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës dhe kërkojmë rikthimin e menjëhershëm të Elton Debreshit në punë. Sulmi mbi të drejtat në punë nuk do të mbysë kërkesat e lëvizjes punëtore për paga dhe kushte pune të dinjitetshme në Greqi, Shqipëri dhe në të gjithë botën.

SINDIKATA E INXHINIERËVE TË PUNËSUAR (mekanikë, gjeologë, të teknologjisë, teknicienë, projektues)Athinë, Greqi.



Shumë projektet për ndërtim HEC-esh në zonën e Bulqizës kanë sjellë përplasje mes banorëve dhe kompanive koncesionare. Shkak për një përplasje të tillë kanë qenë mos konsultimi me banorët dhe ndikimet në mjedis që kanë këto projekte. Nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bëhet me dije se në Bulqizë janë 9 projekte për ndërtim HEC-esh që pritet të vihen në zbatim dhe 28 projekte të tjera që janë në ndërtim e sipër. Sipas Balkan Rivers në Shqipëri numërohen 692 hidrocentrale, duke përfshirë 179 ekzistuese, 453 të planifikuara për t'u ndërtuar dhe 60 hidrocentrale të cilat janë në ndërtim e sipër.

Ndërtimi i HEC-eve *në Bulqizë, me ndikim në mjedis dhe në* **konflikt me banorët**

Teksti dhe fotot nga **SAMI CURRI**

Njësia administrative Fushë-Bulqizë është vetëm 7 minuta larg nga qyteti i Bulqizës. Në këtë zonë ka burime të shumta ujore që rrjedhin nga lartësitë e maleve. Këto burime njëkohësisht janë projektuar për një sërë HEC-esh. Tre projekte për ndërtim HEC-esh ju prezantuan Këshillit Bashkiak të Bulqizës në muajin Mars të vitit 2019-të. Kundërshtimi i banorëve të Fushë-Bulqizës për të lejuar nxjerrjen e një pjese të pyllit të kësaj zone nga fondi pyjor i Bashkisë Bulqizë për t'i hapur rrugë projekteve për HEC-e, çoi në dështimin për të disatën herë të mbledhjes së Këshillit Bashkiak ku do shqyrtohej kjo çështje. Ende sot e kësaj dite që flasim, Këshilli nuk ka trajtuar projektin për transferimin e pronësisë tek Ministria e Mjedisit që do ti hapte rrugë ndërtimit të këtyre HEC-eve. Naim Visha, banor i fshatit Kodra e Danit tregon se këto projekte për ndërtim HEC-esh nuk kanë marrë dakordësinë e banorëve të zonës dhe se ndikojnë në jetën e tyre, duke ju marrë ujin e pijshëm dhe vaditës, por edhe në mjedis. "Këta e kanë ndritur mjedisin, pyjet e të gjitha. Vijnë me një projekt që duan të marrin ujin, të shkaktojnë dëme në mjedis, një mrekulli e natyrës që është ajo zonë, ato ujra që rrjedhin në ato male e ti fusin në tuba, dakordësinë e komunitetit nuk do ta kenë kurrë." shprehet Visha.

Bashkia Bulqizë në përgjigjen me shkrim për këtë rast, shkruan se kërkesa për transferimin e pronësisë të pyllit të kësaj zone vjen si kërkesë zyrtare e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për t'i hapur rrugë projekteve për HEC-e.

Në datë 17. 09. 2018, lidhur me projektet për ndërtimin e HEC-eve "Dragoi" dhe "Dushk" njësia administrative Fushë – Bulqizë, në Drejtorinë Rajonale të Mjedisit është raportuar me dokumente se janë zhvilluar takime për efekt të konsultimeve me publikun për të dyja HEC-et, përkatësisht në orën 11.00 për HEC "Dushk" që ndodhet në fshatin Dushaj dhe në orën 13.00 për HEC



"Dragoi" në fshatin Dragua. Banorët e pyetur për një fakt të tillë, tregojnë se nuk kanë dijeni dhe nuk janë thirrur për dëgjesë duke treguar se distanca e kohës, vetëm dy orë larg njëra-tjetrës, dëshmon për një mungesë të theksuar serioziteti, për një zhvillim fiktiv të konsultimeve me publikun. Gjithashtu në faqen e Drejtorisë Rajonale të Mjedisit Dibër nuk ka të publikuar informacion lidhur me ecurinë e këtyre konsultimeve. Në raportin e ndikimit në mjedis të kompanisë "Renewable Energy" shpk, për këto projekte HEC-esh thuhet se nuk do të ketë ndërveprime me mjedisin dhe as ndikime të mundshme, thelbësore në elementet përbërës të tij. Në VNM thuhet edhe se në zonën ku do të zbatohen projektet janë pak të banuara.

Vendimi për transferimin e pronësisë nga Këshilli Bashkiak Bulqizë, bie në kundërshtim me ligjit Nr.10440, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", "Pyllëzimi fillestar dhe shpyllëzimi për qëllimet e ndryshimit në një lloj tjetër të përdorimit të tokës, pasi duhet t'i nënshtrohet procedurës paraprake të vlerësimit të ndikimit në mjedis". Në rastin konkret ekziston vetëm një procedurë paraprake e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, dhe është ajo për projektin e ndërtimit të HEC-ve, e miratuar nga VNM-ja paraprake e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. E njëjta procedurë ligji detyron që të kryhej edhe për procesin e shpyllëzimit. Bajram Disha u shpreh gjatë fjalës në mbledhjen e Këshillit Bashkiak se kjo është "prerje në besë" për së dyti herë që i bëhet kësaj zone. "Kemi vujtur shumë me pyjet, tani po doni me ja nis me ujin. Ndaluni sa jeni në kohë. Pyjet dhe uji janë jeta jonë. Nuk do ju lejojmë që ta merrni. Mjedisi i kësaj zone duhet të shërbejë për të zhvilluar turizmin dhe ndihmuar zonën e çdo banorë që jeton aty dhe jo një grup njerëzish", u shpreh Disha.

GJORICA, NJË TJETËR ZONË PËRPLASJESH PËR NDËRTIMIN E HEC-EVE

Gjorica është një nga zonat më të popullura në Bashkinë Bulqizë. Përpjekjet e kompanisë koncesionare që kërkon të ndërtojë një HEC në zallin e Bulqizës, rrjedha e të cilit shkon mes për mes njësisë administrative Gjoricë, ka dështuar. "Rajfi" Shpk ka aplikuar që në korrik të vitit 2018-të për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM) të thelluar. Por përpjekjet e kompanisë koncesionare për të mbajtur një dëgjesë publike me banorët e zonës kanë dështuar, pasi janë kthyer në protesta. Nga Drejtoria Rajonale e Mjedisit në Dibër, u shprehën për autorin e këtij shkrimi se konsultimet me publikun për këtë rast kishin dështuar disa herë me radhë, pasi banorët e zonës që preken nga ky projekt që shfrytëzon ujin e Zallit të Bulqizës nuk pranonin të merrnin pjesë dhe as të firmosin raportet pas takimeve të mbajtura. Bashkia Bulqizë në një përgjigje me shkrim për rastin në fjalë, por edhe për raste të tjera që kanë të bëjnë me ndërtim HEC-esh shprehet se ky institucion nuk jep leje, pasi kjo kompetencë është tek institucionet qendrore. "Ti fusësh Gjoricës ujin në tuba, sidomos gjatë stinës së verës është fatkeqësi. Me futjen në tub të ujit, të gjitha gjallesat ngordhin. Gjorica është një fshat që ka 1400 hektarë tokë, që zhvillohet mbi bazën e ekzistencës së këtij lumi", deklaron Shpëtim Kaja, banor në Gjoricë, por që ka mbajtur edhe pozicionin e ish-inspektorit të mjedisit. Gjorica ka problem me ujrat e zeza dhe menaxhimin e mbetjeve, të cilat depozitohen në zallin e Bulqizës. Për banorët, nëse nuk ka ujë të bollshëm që do të tërheq këto mbetje, do të prekeshin nga infeksione dhe sëmundje të ndryshme.

KONFLIKTET PËR HEC-ET

Në Bulqizë konfliktet kanë qenë të shumta, gjeneruar nga projekte për ndërtim HEC-esh. Liman Kenga, banor i fshatit Lenë në Mar-

vëzhgim



tanesh, ka që prej vitit 2013-të që ndodhet në proces gjyqësor për një HEC-i që po ndërtohet në fshatin e tij. Ai pretendon se kjo po ndodh në tokën e tij dhe pa i marrë dakordësinë. Sipas Kengës, lejet për ndërtim HEC-esh në zonë vazhdojnë. "Punimet për ndërtimin e HEC-it vazhdojnë. Kanë bërë një masakër mjedisore të tmerrshme. Kam kaluar një kalvar seancash gjyqësore dhe në Gjykatën e Apelit në Tiranë kam fituar duke e rikthyer çështjen sërish për trajtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër", shprehet Kenga. Për këtë rast Kenga ju drejtua edhe Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, me një ankesë ndaj gjyqëtarit Halil Vani, i cili e kishte rrëzuar padinë e tij në Gjykatën e Dibrës për rastin e ndërtimit të HEC-it në tokën që pretendon se është e tija.

Ndërtimi i Hec-it në fshatin Valikardhë të njësisë administrative Zerqan dhe punimet për devijimin e ujërave të Liqenit të Sopeve, kanë sjellë prej vitit 2014 përplasje të ashpra me banorët e fshatrave që preken. Banorët e zonës së Valikardhës dhe Martaneshit kundërshtojnë punimet me argumentin se devijimi i ujit të liqeneve u shkatërron atyre ekosistemin, u cënon mundësitë për vaditje dhe madje edhe furnizimin me ujë të pijshëm. Në protestën e 10 qershorit 2014, policia procedoi penalisht 7 persona të cilët më pas u dënuan nga Gjykata e Apelit në Tiranë me gjobë 100 mijë lekë për akuzën e shaktërrimit të pronës. Studimi i Bankwatch, publikuar në vitin 2017-të nxjerr se në HEC-in e Tërnovës, janë duke u shkatërruar ekosistemet natyrore që lidhen me Liqenin e Zi, në Majën e Gjatë, i shpallur si Monument Natyre. "Ndërtimi i këtij HEC-i përveç të tjerash konsiston në ndërtimin e 23 km kanale devijimi dhe rreth 30 km rrugë aksesi. Projekti po shkakton një erozion masiv përgjatë linjës së tubacionit të devijimit që çon ujin nga Liqeni i Zi drejt turbinave. Nga ana tjetër gjatë vizitës që Bankwatch zhvilloi në Qershor 2017, erozioni ka qenë i lartë edhe përgjatë kanaleve të devijimit që furnizojnë me ujë vetë Liqenin e Zi duke transportuar së bashku me ujin edhe një sasi të konsiderueshme të sedimenteve drejt këtij liqeni." thuhet në raport. Protestat e banorëve ja kanë dalë që deri më sot të bllokojnë vënien në zbatim të projekteve për ndërtim HEC-esh.

Një studim vlerësues mbi konfliktet për ujin të lidhura me HEC-et në Shqipëri, i titulluar 'Rastet e konflikteve ujore të lidhura me zhvillimin e hidroenergjisë në Shqipëri' dhe i realizuar nga tre organizata mjedisore, nxori në pah 18 raste konfliktesh të lidhura me hidrocentralet që janë raportuar në Shqipëri gjatë periudhës 2012-2016, ku ka pasur 34 persona të arrestuar ose të shoqëruar nga policia. Po në këtë studim, hidrocentralet e vegjël janë burimi kryesor i konflikteve, duke listuar si shkaqe nxitëse mungesën e konsultimeve dhe atë të informimit të komuniteve të prekura nga ndërtimi i HEC-eve, të drejtat e ujit dhe shkatërrimin mjedisor.

Geri Emiri, bashkëpunëtor për Rrjetin Ballkanik të Gazetarisë Investigative në Shqipëri, BIRN Albania, në një investigim të realizuar për konfliktet e gjeneruara nga ndërtimi i HEC-eve, me të dhëna nga të gjitha prokuroritë e vendit, shprehet se në Dibër ka pasur një sërë konfliktesh të banorëve të fshatrave të ndryshëm, që kanë kundërshtuar ndërtimin e HEC-eve, për arsye që nisin nga marrja e ujit vaditës dhe atij të pijshëm. "Nëpërmjet kërkesave për të drejtë informimi, nga 13 prokurori, 12 gjykata rrethesh dhe 7 drejtori policie mbi banorët që janë përballur me sanksione ligjore për shkak të konflikteve të lindura si pasojë e ndërtimit të hidrocentraleve, prokuroritë e ndryshme bënë me dije se në vitet 2008-2017, rezulton të jenë dënuar 10 persona, 27 janë hetuar dhe 7 prej tyre janë arrestuar. Gjykatat dhanë shifra të tjera, por edhe ato të larta, ku rezulton se janë dënuar 15 persona, 7 janë hetuar dhe sipas tyre nuk ka pasur asnjë person të arrestuar", shprehet Emiri.

RAPORTET NDËRKOMBËTARE, KRITIK PËR DËMET E HEC-EVE NË MJEDIS

Në një analizë të posaçme për programin e reformave ekonomike në Shqipëri 2019, Komisioni Europian vlerësoi se qeveria e Shqipërisë po i ndërton këto HEC-e duke shpërfillur rreziqet që ata krijojnë në mjedis. "Qeveria planifikon të rrisë gjenerimin e energjisë nëpërmjet ndërtimit të hidrocentraleve të reja. Këto objekte po shkaktojnë shqetësime serioze në ndikimin në mjedis dhe kanë efekte negative të mëdha mbi komunitetet lokale dhe për turizmin", thuhet në dokumentin që Komisioni Europian lëshoi së fundi për reformat ekonomike në Ballkanin Perëndimor. Prandaj, sipas Komisionit është e nevojshme që Shqipëria të zgjerojë qasjen e saj strategjike duke e diversifikuar prodhimin e energjisë elektrike, duke rritur investimet në prodhimin e energjisë diellore dhe të erës, si dhe të zhvillojë një strategji gjithëpërfshirëse të menaxhimit të ujit.

Një studim në terren në vitin 2018-të të 20 ekspertëve të atashuar nga PNUD (Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara) ka vërejtur një situatë alarmante në të gjithë procesin që shoqëron ndërtimin e HEC-eve që nga momenti i dhënies së lejeve, planifikimit dhe ndërtimit.

Dëmet më të mëdha, në raport thuhet se janë bërë në zonat e mbrojtura, pasi aty dendësia e lumenjve dhe ujërave është e madhe. Gjithashtu ekspertët treguan në raport se Ministria e Energjitikës, gjatë dhënies së lejeve nuk ka marrë në konsideratë ligjet e tjera në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe zonave të mbrojtura. Gjithashtu ata verifikuan se Shqipëria ka shkelur edhe konventat ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit që i ka nënshkruar më parë.

Projekti "Vëzhguesi Rural", i mbështetur nga BE, ka konstatuar se problemet mjedisore të shkaktuara nga Industria hidroenergjetike në Bulqizë janë të shumta. Duke filluar që nga problemet me pronësinë, ku shumë investime janë bërë në prona private, pa marrë më parë dakordësinë e zotëruesëve, në biodiversitet, bujqësi, turizëm, përdorimi i ujrave, shkarkimi i sedimenteve. "Shumica e projekteve të HEC-ve mund të ndikojnë në procesin e ujitjes dhe përdorimin e ujit të pijshëm. Ky aspekt është lënë pas dore gjatë hartimit të VNM-së. Sidomos në ndërtimin e HEC-eve që kanë një shtrirje të gjatë të tubacionit. Ndryshimi i rrjedhës natyrale të ujit ka ndikim negativ kumulativ në biotën e lumenjve. Nuk ka të dhëna dhe analiza për impaktin që kanë këto HEC-e edhe në burimet nëntokësore", shkruhet në faqen zyrtare të Vëzhguesit Rural.

Por nga ana tjetër përhapja me shpejtësi e HEC-eve të vogla në të gjithë vendin, përveçse ka përkeqësuar gjendjen mjedisore aty ku janë ndërtuar, ka ndikuar në rritjen e prodhimit të energjisë në vend. Shifrat tregojnë se, për herë të parë në tremujorin e dytë të vitit 2019, HEC-et private dhe ato me koncesion kanë prodhuar 62% të energjisë në vend, sipas të dhënave zyrtare nga INSTAT.

Një studim në terren i ekspertëve mjedisor të atashuar nga PNUD, tregon se ndërtimi i rrugëve për shtrirjen e tubacionit kanë sjellë degradimin e karakteristikave të peizazhit në nivele të shumëfishta. Kjo ka ndikim të drejtpërdrejtë tek vegjetacioni natyror. "Gërmimi në shpatet e pjerrëta, proceset e erozionit ndodhin kryesisht si pasojë e punimeve për ndërtimin e HEC-eve dhe mos marrja e masave rehabilituese të mjedisit. Rrugat e hapura për ndërtimin e HEC-eve, siç mund të ndihmojnë komunitete për ti përdorur, gjithashtu edhe mund të çojnë në prerjen e paligjshme të pyjeve." thuhet në raportin e PNUD.

Kanë qenë të shumtë raportet ndërkombëtare të organizatave mjedisore që kanë kritikuar lejet e larata për ndërtim HEC-esh në Shqipëri. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës (MIE) shpalli në fillim të vitit 2019-të për "pezullimin e të gjitha kontratatave jo-operative". Për këtë qëllim, u lajmërua fillimi i një procesi "skanimi fizik" e dokumentimi të çdo hidrocentrali, pasi "duhet një ekuilibër perfekt mes zhvillimit ekonomik dhe mbrojtjes se pasurive natyrore".

SHËNIM

Për një lapsus...

Nga **BUJAR KAROSHI**

Në fillim të dhjetorit një grup nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, e kryesuar nga drejtoresha znj. Adriana Peti , ishin për një inspektim në Kanionin e Setës, aty ku janë ndërtuar disa hidrocentrale, njëri prej të cilëve, Seta 4, kundërshtohet fuqishëm prej banorëve dhe organizatave mjedisore. Në këtë takim ishin ftuar edhe përfaqësues nga bashkia e Dibrës, por me gjithë premtimet se do të ishin aty dhe do të mbronin interesat e banorëve, ata nuk erdhën.

Banorët e zonës dhe ekspertët e mjedisit mendojnë se për të marrë lejen për ndërtimin e këtij HEC janë falsifikuar dokumente, duke spostuar në hartë burimin e Sopanikës dhe grykën e thellë dhe të ngushtë të Setës, të cilat janë shpallur monumente natyre.

Mustafa Tola, i cili udhëheq një përfaqësi banorësh që kundërshtojnë fuqishëm ndërtimin e këtij HEC-i, thotë se "është zhvendosur qëllimisht burimi i Sopanikës nga Çidhna në Fushë Çidhën, si dhe është manipuluar harta e lumit, e cila nga rrjedhën nga lindja në perëndim ndërsa në dokumente është veri - jug."

Sazan Guri, eksperti mjedisor që po e ndjek çështjen edhe në gjykatë, thotë se "harta satelitore është manipuluar dhe se është nxjerrë qëllimisht nga kufiri i zonës së mbrojtur shpella dhe burimin i Saponikës". Ai thotë se do ta dërgojnë këtë çështje edhe gjykatat ndërkombëtare. Banorët janë të bindur se manipulimet e hartave janë të qëllimshme, me synim që ti hapin rrugën ndërtimit të HEC-it.

Drejtoresha e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, e ndodhur në terren dhe duke u ballafaquar me vetë shkresat që kjo agjenci ka përpiluar, madje ka dërguar edhe në gjykatë, pranoi se mund të ketë një lapsus...

Po të pranojmë si të vërtetë deklarimin e znj. Peti, për këtë "lapsus" gjatë këtyre dy viteve kanë ndodhur shumë ngjarje...

Për një "lapsus" kompania ka hedhur miliona euro në një vend ku nuk duhej të kishte HEC...

Për një "lapsus" burrat e një fshati janë akoma në hetim policor, atyre u janë bllokuar pasaportat dhe nuk dalin dot as në Dibër të Madhe.

Për një "lapsus" gjykata administrative e Tiranës zhvilloi një gjyq për këtë çështje, vendimi i së cilës duket dukshëm "i marrë nën presion" nga "lapsuset" e shkresave zyrtare...

Për një "lapsus" një konfilikt i hapur është mes banorëve dhe kompanisë, dhe nuk dihet kur do të shpërthejë...

Për një "lapsus" Seta po thahet dhe e ardhmja e turizmit në këtë zonë po venitet..

Për një "lapsus" që askush nuk mban përgjegjësi, jo vetëm janë lënë në mëshirë të fatit interesat e komunitetit, por janë futur në rrugë pa krye institucionet qeveritare, përfaqësuesit e të cilëve, ndërkohë që në terren u japin të drejtë banorëve, në zyrat e shtetit, aty ku ballafaqohen me këto "lapsuse" marrin vendime të gabuara...

Pra, ky është një "lapsus" që me sa duket nuk do ti gjendet zgjidhja, veç në qoftë se me të merret, së paku, SPAK-u.

Jufkat e Dibrës...



Nga **VALDRIN VLESHA**

Jufkat e Dibrës tashmë janë një ushqim që janë të njohura kombëtarisht dhe nërkombëtarisht.

Më poshtë do ju përcjell një historik të shkurtër rreth krijimit të jufkave të mbledhur nga vetë unë duke takuar njerëz të ndryshëm në zonën e Dibrës së Madhe dikur ka qenë një Dibër.

Jufka daton të jetë një produkt ushqimor shekullor. Ky produkt është prodhim autokton i zonës së Dibrës së Madhe. Ka përbërje 100% organike me bazë miellin e grurit i bluar në mulli me ujë, vezën e pulës të rritur e të ushqyer në natyrë dhe qumësht lope të kullotur në bjeshkët e Dibrës. Pas procesit të pergatitjes jufkat priten me thikë sipas dëshirës por e mira është me një trashësi diku ke 1.5cm dhe lihen të gjata diku me një gjatësi që varion nga 10-15 cm.

Historia e jufkës është paksa interesante dhe pak sa si legjendë. Mendohet që prodhimi i tyre ka filluar që në mesin e shekullit të XIV nga familjet ortodokse ne zonën e Rekës.

Dibra, si një zonë malore dhe me një klimë relativishtë të ftohtë dimri zgjat diku afërsisht 5-6 muaj, dhe për rrjedhojë përgatitjet për dimër fillojnë që ne vjeshtën e hershme. Nga takimi me Efimin (ortodokse) një zonjë nga Reka e Epërme tregon që jufka (petka) ka një legjendë interesante ku tregon që mielli i grurit simbolizon bardhesin(zemërgjërsinë dhe mikpritjen e dibranëve), veza simbolizon berthamën (familjen) , qumshti (begatinë) është tretësi dhe bën lidhjen në këtë rast, që të 3 këto përbërës shkrihen në një dhe krijojnë jufken që del si kërc i fortë ,ku ky kërc simbolizon familjen e bashkuar dhe të shendetëshme, Efimi është diku rreth 85vjec dhe këtë histori ja ka treguar gjyshja e saj ku gjyshja e saj e kishte trashiguar nga parardhësit e saj.

Po të njëjtën histori e tregon dhe Dimitra banore po aty. Pra, nga historia e Efimit dhe

Dibra, si një zonë malore dhe me një klimë relativishtë të ftohtë dimri zgjat diku afërsisht 5-6 muaj, dhe për rrjedhojë përgatitjet për dimër fillojnë që ne vjeshtën e hershme.

Jufka daton të jetë një produkt ushqimor shekullor. Ky produkt është prodhim autokton i zonës së Dibrës së Madhe. Ka përbërje 100% organike me bazë miellin e grurit i bluar në mulli me ujë, vezën e pulës të rritur e të ushqyer në natyrë dhe qumësht lope të kullotur në bjeshkët e Dibrës.

e Dimitrës janë një dëshmi e rëndësishme që tregojnë se jufka është ushqim i zonës së Dibrës.

Ndërsa në Dibër të Madhe ka nje histori tjetër që tregohet për jufkat. Sipas Asimes një zonjë e vjetër që banon në Banisht, një fshat pranë qytetit, tregon që jufkat janë berë si rezultat pasi kanë proteina e vitamina. Në dimër ky ushqim shërben për të na mbrojtur edhe nga i ftohti.

Asimja nje grua me moshe diku tek të 60-tat tregon që jufka është një ndër zahiret më kryesore për stinën e dimrit ku përgatitet në kushte shtëpiake. Ajo shton, që mbaj mend kur ikja ke gjyshja e nënës sime në kohën kur isha fëmijë gjyshja mbyllte më çelës odën ku përgatiteshin jufkat.

Referuar ketyre dy tregimeve që ndava me ju unë arrij ne konkluzion që ky produkt tashmë është i zonës së Dibrës dhe zonat për rreth e njohin vëtem si produkt Dibran.

Gjithësesi duhet një studim më i gjërë rreth këtij produkti për ta përforcuar dhe ta ditur më të detajuar historinë e jufkave.

Këto dy histori janë një gur themeli për mbledhjen e të dhënave rreth jufkave të Dibrës.

Urdhëri "Naim Frashëri" për ansamblin "Kuvendi"

Presidenti i Republikës dekoron grupin e Zall Dardhës



Nga **ILMI DERVISHI**

Me rastin e 70 vjetorit të krijimit të Ansamblit Artistik Kuvendi i Zall Dardhës me inisiativën e Presidentit të Ansamblit Z. Neshat Ndreu u mblodhën këngëtar e muzikant, valltar të të gjitha moshave nga Dardha për të dhënë një koncert me rastin e 70 vjetorit të krijimit, që daton vitin 1949.

Ansambli i Dardhës ka breza të tërë artistësh, me fillimet e para si Riza Poleshi e Xhevahire Gjoka, muzikani e themeluesi i tangos shqiptare Muharrem Xhediku, me Mjeshtrin e Madh, artistin shumëdimesional Haziz Ndreu, Mjeshtër i Madh Lirie Rasha, Mjeshtrin e Madh Qerim Sula, Sajhe Poleshi, organizatori, krijuesi dhe interpretuesi Xhelal Çerpja, këngëtarin vurtuoz Sherif Dervishi etj. Zall Dardha ka dhe këngëtar të tjerë, më të rinj por me një njohje për këngët e tyre si Bledar Kaca, Rrushdi Dervishi, Metush Luca, Gentjan Dervishi, Mentor Topuzi...

Në përbërjen e ansamblit në vite ka patur valltarë të njohur qe në vitin 1957 grupi i valleve të Zall Dardhës përfaqësoj Shqipërinë ne Festivalin Botëror të rinisë në Moskë, ku dhe u vlerësuan. Të tillë ishin Qazim Selimi, Dostan Topuzi, Shaqir Shira, me brezin e art si Avdi Ndreu, Hysen Ndreu, Lazam Sula, koreografi dhe valltari Avni Ndreu, Muharrem Sula, Muharrem Gjoka e Medi Hysa, Dostan Rama, Arif Hysa, duke vazhduar me më të rinjët, Rasim Shira, Avdi Rama, Baftjar e Neshat Ndreu, Faik Sula etj. Ansambli kishte dhe valltare që i dhanë ritëm e gjallëri valles si Lumie Shira e Hazbie Rasha, Zana

Ansambli i Dardhës ka breza të tërë artistësh, me fillimet e para si Riza Poleshi e Xhevahire Gjoka, muzikani e themeluesi i tangos shqiptare Muharrem Xhediku, me Mjeshtrin e Madh, artistin shumëdimesional Haziz Ndreu, Mjeshtër i Madh Lirie Rasha, Mjeshtrin e Madh Qerim Sula, Sajhe Poleshi, organizatori, krijuesi dhe interpretuesi Xhelal Çerpja, këngëtarin vurtuoz Sherif Dervishi etj.

Ndreu e Fitore Sula, Manushaqe e Revie Dervishi, Lirie Cani e Defe Ndreu etj.

Muzikant dhe orkestranti si Neki Ndreu e Zaim Kaca, Qemal Toluli, Muharrem Poleshi, Naim Cala e tjerë.

Drejtuesit e këtij Ansambli me presidenti Neshat Ndreu, Lirie Rasha Drejtuese, Avni Ndreu Keorograf, drejtues muzike Xhelil Imeri, përgjegjës orkestre i ndjeri Sherif Dervishi e Zaim Kaca me 15 nëntor, në pallatin e Kulturës në Kamzë dhanë një koncert madhështor, jo vetëm për dernjanët e dibranët por me një publik më të gjerë. U kënduan këngë, u hodhën valle, e mes shumë vlerësimesh për artistë të këtij Ansambli në vite, vjen dhe vlerësimi i Presidentit të Republikës, z. Ilir Meta, i cili i akordoi Urdhërin "Naim Frashëri" i Klasit Parë për Ansamblin Artistik "Kuvendi" i Zall Dardhës.



cyan magenta yelloë black

menaxhim

Prioritetet e Dibrës janë blektoria, frutikultura e turizmi malor. Pikërisht për këtë arsye, afrimi dhe angazhimi i sa më shumë të rinjve në projekte blektorale do të bëjë të mundur rritjen e numrit të krerëve dheshtimin e kujdesit ndaj mjedisit.

Menaxhimi i fermave blegtorale,

qëndrueshmëria dhe sipërmarrja nga të rinjtë

Nga **OSMAN XHILI**



Në kushtet e sotme të zhvillimit te vendit,veprimtaria prodhuese e fermave blegtorale për të imta eshte nje aktivitet fitimprures duke shfrytezuar resurset natyrore te territorit të bashkisë Diber me hapasira kullosore,livadhore mbi 5400 ha dhe tokë inproduktive dhe djerrëmbi 4500 ha.Kjo situate krijon kushte per nje zhvillim mëtë shpejtë te blegtorise kjo e mbeshtetur edhe nga politikat e zhvillimit te shtetit nepermjet skemave mbeshtetse kombëtare te subvecionit dhe poashtu aplikimeve te IPARD II dhe AZHBR.Organizata e shoqerise civile " AGRO EKO DIBRA" në Bashkinë Dibër aplikoi dhe po zbaton projektin "Menaxhimi i qëndruesheëm i fermave blegtorale ,qëndrueshmëria dhe sipermarrja nga të rinjtë " me synim plotësimin e nevojave të tanishme dhe në të ardhmen për produktet blegtorale,afrimin e të rinjve në krijimin e tufëve të reja ,mbrojtjen e mjedisit , ndaljen e ç'popullimit dhe emigrimit në funksion të zhvillimit ekonomik rural .

Projekti zbatohet në kuadër të Programit Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD) dhe financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga UNDP.

Projekti synon të afrojë sa më shumë të rinj në mbarështimin e blegtorisë në përgjithësi dhe të imtat në veçanti. Projekti po zbatohet në një territor mjaft të gjërë të Bashkisë Dibër dhe përfshin katër njësi administrative, Maqëllarë, Melan , Tomin dhe Muhurr dhe do zgjasë për një periudhë6 –mujore (tetor 2019-mars 2020).

Nxitja dhe hapja e fermave te reja me blegtori te imët ,të leshta dhe të dhirta duke afruar bashkëpunim dhe rritje te kapacitetev të fermerëve sipërmarrës për leverdisshmërinë ekonomike dhe mundësinë gjithnjë në rritje të kërkesave të tregut me produkte blegtorale të zonave të pastra të Dibrësështë objektiv i një bashkëpunimi aktiv midis fermerëve ,shoqatës Agro Eko Dibra dhe pushtetit vendor, duke bashkëvepruar edhe me partner të institucioneve të shtetit si AREB-Dibër,AZHBR,AgroPika dhe ASHVMB-Dibër.

Rrethi i Dibrës ka pasur tradita të shkëlqyera në mbarështimin e menaxhimin e fermave blektorale. Malet që e rrethojnë nga të gjitha anët, pllajat e luginat e bukura, kullotat e pafund dhe me një bimësi të dendur e të shumëllojshme, e bëjnë plotësisht të mundur mbajtjen e një numri të konsiderueshëm të imtash. Të gjitha këto territore përshkohen nga ujra e burime të pastra, që i shërbejnë si blegtorisë, ashtu dhe fermerëve që kujdesen për to. Tregimet gojore na thonë se nuk kanë qenë të pakta familjet që kanë pasur njëmijë të imta çdonjera, kurse një prej tyre në Kala të Dodës, thuhet se ka disponuar 12 mijë krerë. Kjo traditë e bukur është përcjellë ndër breza, për të ardhur si e tillë deri në ditët tona.

Por, kohët e fundit, duket sikur problemi nuk shkon në linjën e duhur. Të gjithë jemi dëshmitarë të një largimi masiv të njerëzve për një jetë më të mirë. Për pasojë, kjo dukuri është shoqëruar me një pakësim drastik të numrit të krerëve, qoftë në të trasha dhe në të imta. Normalisht, arsyet janë të shumta. Humbja e interesit nga të rinjtë për tu marrë me këtë profesion të vështirë, tregjet e pasigurta për mishin e qumështin, mungesa e subvencioneve shtetërore në masën e duhur ka bërë që në finale, numri i krerëve të bagëtive të ulet ndjeshëm. Sektori i veterinarisë në Drejtorinë e Bujqësisë po zhvillon një census, apo një inventarizim të blektorisë, dhe nga rezultatet paraprake duket që ajo është përgjysmuar.

Pikërisht, për të ndalur sadopak këtë hemorragji të numrit të krerëve në blektori, projekti në fjalë merr përsipër të bëjë një përpjekje modeste duke dhënë kontributin e tij. Ai synon të kontaktojë rreth 60 ferma, për të bërë vlerësimin e gjëndjes, nevojat dhe problemet që ata kanë. Të paktën 45 persona, kryesisht të rinj, do trajnohen, lidhur me kapacitetet menaxhuese të fermave blektorale, në bashkëpunim me ekspertë të Agro Pika Dibër dhe AREB – Dibër.

Takimet e deritanishme, që specialistët e projektit kanë zhvilluar me fermerët e rinj në Maqëllarë e Tomin kanë pasur shumë interes. Këtë e ka dëshmuar pjesëmarrja e kënaqshme e blektorëve të rinj, por dhe problemet që ata kanë ngritur. Takime të tilla kanë shërbyer për njohjen e fermerëve me njëri tjetrin, shkëmbim eksperiencash, rritje të ndërveprimit të tyre dhe të fituarit e njohurive shkencore nga referimet e specialistëve të projektit.

Projekti "Menaxhimi i fermave blektorale dhe sipërmarrja nga të rinjtë" është ambicioz dhe synon rezultate konkrete.

- Po punon për të përgatitur një hartë të fermave blektorale dhe sipërfaqeve kullosore, sipas kapaciteteve, në katër njësi administrative nga një ekspert.
- Do të hartojë një katalog profesional për shërbimet per 150 fermat blektorale me tregues profesional, financiar e mjedisor.
- Do të përgatisë e të shpërndajë 300 fletë palosje.
- Do të operohet me 10 ferma të reja për format e zhvillimit dhe mbështetjes nga IPARD dhe skemat kombëtare.
- Do të organizohen katër Ditë të Hapura për promovimin e blektorisë së imët, si mundësi zhvillimi për zonat rurale në Bashkinë Dibër, duke kontaktuar me blegtorë, komunitetin, shkollat dhe administratat lokale.
- Do të realizohet një studim për gjëndjen aktuale të blegtorisë ne 4 njesitë administrative duke vlerësuar me nje analizë te hollesishme si numrin e krerëve në të imta ashtu edhe ecurinë e fermave blegtorale në situatën aktuale.
- Do të realizohet një plan studimi mbi metodat e ndërhyrjes dhe një plani veprimi për qëndrueshmërinë e fermave dhe afrimin e të rinjve në krijimin e fermave te reja në të imta.
- Do të realizohet një spot televiziv për ecurinë e projektit dhe promovimin e treguesëve të fermave blegtorale.

Tashmë dihet se prioritetet e Dibrës janë blektoria, frutikultura e turizmi malor. Pikërisht për këtë arsye, afrimi dhe angazhimi i sa më shumë të rinjve në projekte blektorale do të bëjë të mundur rritjen e numrit të krerëve dheshtimin e kujdesit ndaj mjedisit. Fshatrat e malet po zbrazen pak nga pak dhe do të jetë shumë e vështirë për ti ripopulluar, ndaj duhet të nxitojmë në nisma e projekte të tilla që ngjallin shpresë.

* Ky botim është realizuar per shkrimet ne gazeten lokale në kuadër të projektit "Programi Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD)", i cili financohet nga Bashkimi Evropian (BE) dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Përmbajtja e këtij publikimi, si dhe gjetjet e paraqitura në të, janë përgjegjësi e Agro Eko Dibra dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian (BE) ose Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).



400 mijë dollarë ndihma për Spitalin e Bulqizës



Projekti C.U.R.E., një organizatë bamirëse në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dorëzoi në spitalin e Bulqizës një konteiner me mbi 400 mijë dollarë ndihma në pajisje spitalore.

Transporti i ndihmave tejet i shtrenjtë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës në Bulqizë u pagua falë një fushate për të mbledhur fonde nga Vëllezërit Keta me fondacionin Keta4kids. Kësaj fushate ju bashkuan shumë donator, nga Bulqiza dhe jo vetëm të cilët dhuruan për të mbuluar koston e transportit dhe të shpenzimeve të tjera doganore. Një ndihmë të madhe për mbërritjen e ndihmave në Bulqizë dhanë Ina Farka dhe mjeku gjerman Dr. Carsten Buse, që së bashku me vëllezërit Keta morën pjesë në një maratonë vrapimi në Gjermani për të mbledhur sa më shumë donator për transportin e ndihmave nga Amerika në Shqipëri.

Projekti C.U.R.E. shpërndan pajisje mjekësore kudo pasi mbledh dhurime të vogla nga qytetarët deri 1 dollar e më shumë. Spitali i Bulqizës mbulon me shërbim më shumë se 30 mijë banorë dhe në këtë spital ka shumë raste të aksidenteve në minierë. Falë ndihmave të mbërritura në spital do të ketë një set të ri të pajisjeve kirurgjikale për trajtimin e rasteve urgjente. Edhe reparti i pediatrisë dhe gjinekologjisë do të ketë pajisje mjekësore bashkëkohore, e shumë të tjera. Një kujdes të veçantë për mbërritjen e këtyre ndihmave treguan edhe autoritetet lokale shtetërore.

Faleminderit gjithësecilit për ndihmën e dhënë që këto ndihma të vinin në spitalin e Bulqizës! Faleminderit dhe mirënjohje Vëllezërve Keta për punën e palodhur në të mirë të këtij komuniteti! Faleminderit ndaj çdo donatori, që dhuroi nga pasuria e tij për mbulimin e kostos së transportit të ndihmave! Faleminderit personave që lobuan që këto ndihma të vinin në spitalin e Bulqizës!

***Sami Curri** / bulqizaime*

Ferma e familjes Ndregjoni lartëson akoma më shumë emrin e saj.

Ferma e familjes Ndregjoni



Nga **OSMAN XHILI**

Ashtu si për të gjithë shqiptarët e tjerë, vitet nëntëdhjetë e gjetën familjen e Haziz Ndregjonit në Brezhdan të Dibrës në një huti e konfuzion të plotë. Hazizi kishte shërbyer për vite e vite si punonjës në ndërmarrjen bujqësore të asaj kohe. Fëmijët akoma të vegjël, pa ndonjë zanat, fare pak tokë. Shpresë dhe frikë për të ardhmen. Vuri pak blegtori si fillim, një lopë, një kalë dhe 20 kokë dhen. Kishte dëgjuar nga të vjetrit që bujqësia nuk të bën të pasur, por dhe pa opinga nuk të len. Mori toka me qira, mësoi zanatin e shoferit, gjeti dhe një fugon të përdorur, duke filluar në linjën që lidh fshatin e tij me Peshkopinë.

EKSPERIENCA NE SHTETIN FQINJ

Vitet po ecnin dhe fëmijët po rriteshin. Ndonëse në moshë të njomë, ata provuan emigracionin. Asllani është më i vogli nga dy djemtë. Ai ishte vetëm 14 vjeç kur mori rrugët e Greqisë. Rastësia e çoi te një pronar grek, që kishte jo pak, por tre mijë kokë dhen dhe 17 punëtorë. Gati 10 vjet punoi atje, për tu lidhur përfundimisht me ato kafshë të urta, të mbara e të bekuara. Ishte normale që të mjelja deri 300 litra qumësht në ditë, tregon Asllani. Mësoi dhe shumë sekrete, që do ti duheshin në të ardhmen. Në një rast, pa që dikush solli një dele që sillej rrotull vetes me një sëmundje të trurit. Populli e quan " e ndërkryer", kurse në gjuhën veterinare emërtohet si cenurozë. Pronari i tij mori një thikë të mprehtë, i hapi një vrimë në mes të kockave të kokës, në anën nga rrotullohej delja. Futi te vrima e hapur një kunj me pak lesh të mbështjellë dhe fshikëza, apo qeska me lëng që kishte pushtuar njërën anë të trurit, u mbështoll për kunji dhe bashkë me të dolën jashtë. Pak dezinfektantë e pak pluhur mbi plagë dhe delja ishte shëruar plotësisht. Kur Asllani e pa tre herë këtë gjë, të katërtën e kreu vetë operimin, gati po aq mirë sa dhe mjeshtri plak.

Dhjetë vjet më vonë, Asllani u kthye në Shqipëri. Ishte viti 2005. Mendja i thoshte se dhe ai mund të vinte një tufë dele e t'i mbarështonte me kujdes e dashuri. Ndoshta jo aq shumë sa mjeshtri plak në Greqi, por le ta niste njëherë . Eksperiencë tashmë kishte fituar, por dhe ca para kishin vënë mënjanë si familje. Sakaq, tufa e tyre prej 20 krerësh u dhjetëfishua e u bë 200 kokë. Vështirësitë e fillimit si kudo, por familja e bashkuar u bëri ballë sfidave dhe e rriti akoma më shumë numrin e tyre, gati 400 kokë, sot që flasim. Duke bërë eksperimente të vogla në vite, tashmë ata kanë përcaktuar një skemë të mbarështimit të tufës.

KUJDESI PER TUFEN

Deshtë i lëshojnë me 25 korrik dhe mjelja vazhdon deri me 5 shtator. Gati gjysma e tufës kanë pjellë, akoma pa shkuar data 10 dhjetor dhe familja Ndregjoni është angazhuar në kujdesin për të posalindurit, meqë janë dhe ditë të ftohta. Në fillim të dhjetorit fillon trajtimi me tagji në masën 0,5 kg për barsat dhe gati një kilogram për pllejat. Ndoshta me norma më të reduktuara ky trajtim vazhdon deri në prill. Rraca është vendi e kryqëzuar me Rudën. Në vjeshtë skartohen delet e vjetra mbi 5 – 6 vjeçare, më të dobtat, si dhe ata që janë me një gji . Ndërkohë tufës i shtohen çdo vit dhe 40 krerë qengja femra, që janë përzgjedhur si më të mirat, në pamje dhe në madhësi. Në prill shiten dhe qengjat, meqë pjelljet kanë qenë të hershme. Çmimi ka qenë i mirë këtë vit, thotë Asllani, deri në katër mijë lekë për kilogram peshë të gjallë. Po kështu dhe çmimi i qumështit ka qenë me leverdi. Kur e dërgojnë verës në baxhon e Radomirës paguhen me njëmijë lekë për një kilogram. Në një sezon pjellje ata kanë rreth 50 dhen që pjellin nga dy qengja. Ka një sekret të vogël këtu që lidhet me trajtimin, Nëse delet trajtohen me tagji dy javë para e pas ndërzimit, ky numër shkon dhe më tepër. Asllani ka marrë pjesë në takimet që ka bërë organizata AGRO EKO DIBRA me fermerët e rinj blegtorë, duke përfituar mjaft nga të tjerët, por dhe duke dhënë eksperiencat e tij pozitive.

KATËR MUAJ NË BJESHKË, QË MUND TË BËHEN DHE PESË

Qëndrimi i tyre për katër muaj në bjeshkë është sa i bukur, aq dhe i vështirë. Karvani i dhenve, i njerëzve, i qenve dhe i kuajve ngjiten në bjeshkë me 15 qershor dhe zbresin zakonisht me 15 tetor. Asllani thotë se sikur ca gjëra të ishin ndryshe në legjislacionin shqiptar dhe ne mund të vepronim ndryshe. Pronësia e kullotës, vazhdon arsyetimin djaloshi i pasionuar pas dhenve, duhet detyrimisht ti kalojë shtetit dhe unë të marr një leje shfrytëzimi dhjetë deri njëzetë vjeçare. Atëherë mund të ndërtoja një shtëpi të vogël pranë stanit, ku të merrja dhe familjen. Po kështu mund të ndërtoja një stallë verore tek stani. Kjo do ta shtonte të paktën dhe një muaj qëndrimin në bjeshkë, dy javë përpara e dy javë pas datës që ne ikim zakonisht. Stalla na shërben dhe në netë të veçanta, kur moti është me shira, erë e rrebeshe. Pajisja me ndonjë panel diellor na mundëson një ndriçim minimal, pak ujë të ngrohtë, karrikim telefoni e plot gjëra të tjera, që në kushtet e stanit do të ishin luks për ne.

Rruga për të shkuar e për të ardhur është një hall më vete. Nuk është se ata shkojnë vetëm njëherë. Qumështi transportohet çdo ditë me kuaj për në baxho. Ushqimet për njerëz e qen, krypa e furnizimet e tjera bëhen shpesh. Po të ishte rruga më e mirë dhe turizmi do të ishte në limite të pa imagjinueshme. Kush nuk do të donte të shihte liqenin e Gramës, bjeshkën e Zonjave, ku qëndrojnë ato, apo vise të tjera po aq të bukura? Kush nuk do mahnitej e mrekullohej duke shijuar kosin, djathin e mishin e njomë, të mbrujtur me lulet shumëngjyrëshe të bjeshkës? Turisti do të kthehej sërish vitin tjetër, duke marrë plot miq e shokë të tjerë. Që këtë vit Asllani kishte marrë në bjeshkë dhjetë pula deti të gjalla dhe rreth 30 pula shtëpie, për ti pasur atje vezët e freskëta. Disa blegtorë të tjerë, si ajo e Dertit nga Blliçja, kanë ngjitur sipër koshere blete, duke prodhuar një mjaltë, që nuk gjen të dytë si ai. Këto imazhe të bukura e shumë të tjera si këto nuk do ishin aspak një trill imagjinate, por një përvojë e jetuar, mjaft që të plotësohej ai kriteri që përmendëm, dhënien e bjeshkës me një qira shumëvjeçare.

TË TJERA AKTIVITETE

Familja Ndregjoni është vazhdimisht në punë e në lëvizje, si një zgjua mbushur me bletë punëtore. Babai, Hazizi, nuk i ndahet me fugonin e tij linjës së Brezhdanit me qytetin e Peshkopisë. Sa herë që ka ndonjë pushim u përvishet punëve të shumta të fermës me mbi dyzet dynymë tokë të mbjellë me jonxhë, misër, grurë e ndonjë kulturë tjetër. Dy djemtë e tij, Kastrioti dhe Asllani, gjysmën e kohës janë në shërbim të fermës dhe gjysmën tjetër punojnë në Gjermani në një kompani ndërtimi. Nuk ka zanat e mjeshtëri, që ta shohë njëherë Asllani dhe të mos e bëjë. Po aq mirë sa blegtorinë di të shtrojë pllaka, të punojë gurin dekorativ, të punojë tokën me zetorë, të kosisë e të mbledhë jonxhën me mjete mekanike, apo të punojë me fadromën e firmës në Gjermani. Po kaq fort punojnë dhe gratë e kësaj familje, duke i bërë më të lehta punët për burrat e tyre. Përveç gati 400 kokë deleve, ata mbarështojnë dhe katër lopë të mëdha, me vlera të larta racore, dhjetë kokë dhi dhe shtatë kuaj, duke e bërë më të larmishme dhe më efiçente fermën e tyre. Këtë vit që vjen ata duan të ndërtojnë një stallë moderne, që ti përgjigjet shtesës progresive të numrit të krerëve dhe për të lehtësuar shërbimet në të. Pak ndihmë nga shteti, fare pak. Në Greqi, te pronari me tremijë kokë që përmendëm në fillim, qumështin e mishin e merrnin te dera e stallës. Por kjo nuk i pengon këta njerëz për të ecur përpara. Ja, kështu ecën çdo ditë e më e sigurt, çdo ditë e më e rritur ferma e familjes Ndregjoni, duke na dhënë surpriza të këndshme, duke lartësuar akoma më shumë emrin e saj.

Kërkohen korrespondentë në Peshkopi dhe Dibër të Madhe

KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE.

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë.

Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing.


Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.

Të interesuarit të komunikojnë me redaksinë.

traditë

FJALË E FRAZEOLOGJIZMA TË RRALLA

Marrë nga libri "Toponimia e Çidhnës" i autorëve
Haki Përnezha dhe Rruzhdi Bitri,
Botimet M&B, Tiranë, 2016.



FJALË TË RRALLA

H

► ***hipi***: Folja hip me kuptimin merr sundimin dikush: Hipi Nemcja, hipi Zogju. Hipi përdoret dhe për të treguar një veprim që fillon a pritet të fillojë shpejt: hyni brenda se hipi shiu. Fjala është e njëvlershme me fjalën rra-rrani, me sa duket një rrënjë e hershme pa parashtesë, si tek mbërrini, mbërrajni.

► ***halvet / shpirti / hálvet shpirti:*** Stërmundim i madh. Nga turq. *havlet, vetëm*. *Havlet shpirti, vetëm shpirti*.

► ***has / has / hás:*** Lloj pëlhure e bardhë që përdorej për të brendshmet. *Këmishë e brekë hasi*.

► ***hen'soj:*** Përgatis barrën për ta ngarkuar. *Hensova barrën time dhe atë të kalit.*

► ***hëëësh / hëëësh:*** Përngjitje e *eja e shiko, hajde e shih, hajsh, hësh*. Përdoret me kuptimin *shih atje, ja atje: hëëësh ku janë delet!* Për të njëjtin funksion Çabej sjell formën *eshata*.

► ***haekeç:*** Ai që zgjedh shumë në të ngrënë, që nuk han çfarë t'i shërbesh. *Ai është haekeç*. Antonim: *hās*.

► ***hatërçor / hátërçor:*** Ai që bën hatër, që i ndihmon shumëkujt. E ka dheÇabej. *Ai është hatërçor i madh.*

► ***hept e m'hept / hépt e m'hépt:*** Tejpërtej; qosh e më qosh. *I kishin ftuar njerzit hept e m'hept.*

► ***hiç e mo dis / híç e mo dís:*** Gjendja e njeriut *hiq frymën për të vdekur e mos vdis, midis jetës dhe vdekjes*. Thuhet për dikë që vuan gjatë, që *heq e nuk vdes*. *Ka mbet hiç e mo dis.*

► ***hashër / háshër-háshra:*** Dërrasat e vogla e të holla mbi të cilat vihen tjegullat e çatisë. Kështu quhen edhe dërrasat që shërbejnë për të bërë ndarje në shtëpi që quhen *bilme*. Për të njëjtin kuptim Çabej, sjell formën *patavër*.

I-J

► ***jerm' / jérm'-a:*** *Jermë* quhet misri i bluar bashkë me brrollen (koçanin) dhe që shërben si ushqim (gjellë) për bagëtitë. E përmend Çabej, në formën *ermik*[277], me sqarimin: *maja e miellit, që vjen më ashpër se mielli i mirëfilltë*. Por jerm përdoret edhe në kuptimin *përçart*: *flet jerm*.

► ***jagra-jugra:*** *Flet jagra-jugra, flet pa kuptim*: *ai fliste jagra-jugra*.

► ***jezullaj' / jézullaj':*** Shpat mali a kodre ku nuk bie dielli. *Drurët e prerë në jezullajë digjen nër vete* (*bëjnë më shumë tym se flakë*).

K

► ***këlir i:*** Pjesa që rrethon gropën ku ndizej zjarri në oxhak. Me këtë emër quhet edhe pjesa zbukuruese që i vihet xhupit të grave nga prapa: *xhup me kolir*.

► ***kalaveshas / kalavéshas:*** Nga *kalavesh, veshul rrushi, bistak*. *Kalaveshas* përdoret për të treguar një zënkë me të rrahura. *U kalaveshën keqas. Fëmijët e kishin kalavesh qershinë.*

► ***kacipup / kacípup:*** *Galiç, as ndenjur as ulur*.

► ***krahanez' :*** Shtresa e ngricës në formë dëbore që mbetet në degët e pemëve në mëngjeset e ftohta dimërore jo prej dëborës, por prej ngrirjes së lagështisë së mjegullës gjatë natës. Kjo shtresë bëhet e trashë si dëborë.

► ***kin / kin / kín-i / kin-at:*** *Kind, veshje, rrobë*. *A i veshe kinat? Krushqit kishin veshë kina të reja*. Edhe në këngët popullore: *Or akshaj or kinakuq / po t'shkojnë morrat si kakruq*.

► ***kuni / kuni / kúni:*** *Dikund-i, askund-i*: *mos shko kuni!*

► ***kacarrup / kácarrup, iu:*** Iu ngjit, iu kap për trupi.

► ***kokorosh / kókorosh:*** *I ngrehur, fodull*.

► ***kashtrajs / káshtrajs- i kashtrajsun:*** *I krisur, i hutuar, i luajtur mendsh*.

► ***k'nell' / k'néll':*** *Këndell, ndez*. Këndell zjarrin. Edhe fig.: *ishte k'nell' në fytyrë*, ishte skuqur si zjarri.


► ***kuvajse / kuvájse:*** Probleme. Është grua pa halle e *kuvajse*.

► ***kërc'nez':*** *I zemëruar, i kërcënezur*.

► ***krajf / krájf-i:*** Aq sa mban një krah: *e premë misrin dhe e bëmë krajfa-krajfa; mora nji krajf kashtë.*

TREGIM ALEGORIK

Hakmarrjen ma lini mua



Buka e magjes së popullit
Tregime alegorike
Xhafer Martini
Botimet M&B, 2019
ISBN 978-9928-256-59-1
Faqe 160
Çmimi: 700 lekë

Jetonte dikur një burrë që nuk linte punë të ligë pa bërë. Ishte hajdut me çizme, si thonë. Por ishte frikacak i madh. Vidhte aty ku sigurohej se nuk do ta gjente gjë e keqe. Atë natë, kur zë fill tregimi ynë, iu afrua shtëpisë së një plake, që nuk kishte asgjë mbi shpirt, veçse një kotec me pula. Hapi derën e kotecit, vuri thesin dhe i futi pulat një nga një në të. Shkoi në shtëpi, ku jetonte vetëm, dhe, si ndezi një zjarr të madh, poqi njërën prej pulave dhe e hëngri me oreks të madh e me shumë shije. Por nuk kaloi as gjysmë ore dhe trupi filloi t`i mbushej me pupla. I hipi një kromë kaq e madhe, sa donte ta lëshonte lëkurën në tokë. Kruhej sa mundtte, por kjo nuk e lehtësonte fare.

Nuk la doktor pa vajtur, por asnjëri prej tyre nuk i erdhi në ndihmë. Ishte një sëmundje e pashërueshme për ta. Mësoi që në një krahinë jetonte një plak i ditur. Takoi plakun dhe ia tha hallin që kishte. Plaku i tha: "Do të shpëtosh nga kjo sëmundje vetëm nëse bën plakën që të shfaqë dëshirën për hakmarrje ndaj teje".

Hajduti i shkoi plakës në shtëpi dhe e pyeti:

A t`i vodhën pulat, moj plakë?

Po, m`i vodhën.

Po sikur të ta gjej unë njeriun që të vodhi pulat, çfarë i bën ti?

Asgjë nuk i bëj. I kam lënë Zotin.

Plaka tha si thoshte Perëndia: "Hakmarrjen ma lini mua!" Atij filluan t`i shtoheshin puplat në trup dhe kroma iu bë e padurueshme.

Po ja, moj plakë, - nisi prapë ai, - ta pruna këtu, ta mbaj që t`i biesh me një dru, nuk do ta bësh këtë me hajdutin?

Të thashë: i kam lënë Zotin.

Hajdutit iu duk se e hodhën në zjarr, në prushin e dushkut. Bëri një përpjekje të fundit që ta kandiste plakën për hakmarrje.

Po sikur atë hajdutin ta sollën ushtarët e mbretit të lidhur këmbë e duar dhe të thanë: "Jepja dënimin, se e zbatojmë ne", ti nuk do t`i bësh asgjë?

Plaka, për të shpëtuar nga ky njeri i bezdisshëm, i tha:

Do t`ia këputja kokën, sikur ua ka këputur ai pulave te mia!

Me të thënë plaka ashtu, hajdutit filluan t`i bien puplat dhe e ndjeu veten të lehtësuar. Pak më vonë edhe kroma iu hoq fare. U ngrit dhe iku i gëzuar që e kaloi edhe kësaj radhe, falë atyre fjalëve të fundit të plakës…

Librin mund ta gjeni te Botime M&B,
Rr. "Isa Boletini", Nd.2, H.12, Nj.Admin.nr9.
Tel. 069 20 68 603 (Viber). Tel. 068 65 08 441
(WhatsApp). E-mail: mbbotime@gmail.com
Ose përmes rrjetit të Librarive #Adrion,
#Bukinisti dhe agjencive të shpërndarjes së
librit në Tiranë.

Rruga e Arbërit nr. 163

portret

Kontributi i Ruzhdi Latës ka qenë shumëdimensional. Ai iu përkushtua jo vetëm të afërmve e rrethit të ngushtë miqësor që e rrethonin, porse, së pari mendoi e veproi për misionin më fisnik njerëzor: të qenit i dobishëm e një vesh i dëgjueshëm për çdokënd që trokiste në portën e tij.

Myftiu dhe kryetari Ruzhdi Lata - *meteor i pashuar i tokës dibrane dhe i trojeve të shqiptarisë*

Vdekja është një e vërtetë absolute që e pret çdo krijesë që ka lindur e ka ardhur në këtë botë të përkohshme. Çastet e jetës vështirësohen më tepër për njeriun e humbur e vajtimet bëhen më të ndjera e më të përjetshme, kur personin që ka ndërruar jetë e njeh nga afër në të gjitha dimensionet, apo siç thotë populli "me të gjitha të mirat dhe të këqijat e tij". Por kjo ndarje nga jeta edhe për besimtarët muslimanë, të cilët karakterizohen e në thelb pajtohen me idenë se ky është kader i Allahut (caktimi i Zotit), dhe se jeta jonë nuk mbyllet me ciklin e kësaj dynjaje, por se, përkundrazi, libri i jetës së tokës do të dëshmojë në jetën tjetër që na pret nën Arshin e Allahut, edhe për ata çasti i vdekjes është shumë i dhimbshëm, i prekshëm e zemra u vajton, loti i tradhëton në faqet e tyre.

Të flasësh për jetën e dikujt, jo vetëm në aspektin kronologjikë të veprave të tij, por se në të gjitha dimensionet e jetës aq më tepër për kontributin e tij në komunitete të caktuara e shoqëri, nuk është aq e thjeshtë sa mund të duket, sidomos kur ato fjalë përshkohen krahas subjektivizmit të pashmangshëm edhe prej objektivizmit të qartë e të matur.

E tillë është edhe ndarja nga jeta e myftiut të nderuar e tashmë të ndjerit z. Ruzhdi Lata.

Eh, sa monologje kam bërë ndaj ikjes së tij në çdo çast, ku mendimet mbi dynjanë më rrëmbenin, ku frika mbi botën tjetër më kaplonte, e ku mëshira e shpresa e Zotit më mbante gjallë. Ndaj sot vendosa që ato fjalë të pathëna, të mirëmenduara e të çastit, ato ndjesi të bukura mbi vlerat e tij, dhe mungesën e tij që nga dita e ndarjes nga jeta, këto e shumëçka tjetër, ta hedh në letër se ndoshta kështu e qetësoj pak shpirtin tim të trazuar edhe shumë zemra të tjera që përjetojnë të njëjtën ndjesi, ndoshta edhe më shumë se mua.

Profesor Ruzhdi Lata lindi në një familje qytetare dibrane të trojeve të shqiptarisë, përkatësisht në Ame të Dibrës së Madhe. U shkollua dhe u arsimua në vendlindjen e tij e shkollën e mesme "Medresenë" e kreu në Prishtinë. Studimet e larta dhe ato pasuniversitare i finalizoi po në Prishtinë. Pasi mbaroi studimet, ai kthehet në vatrën e familjes, duke pranuar fatin e tij, si një i ri që udhëhiqej nga logjika e shëndoshë dhe nga besimi i lartë e i palëkundur se ky ka qenë fati dhe caktimi prej Zotit: t'i shërbejë vendlindjes së tij. Me siguri që ky çast është i rëndësishëm në jetën e tij saqë edhe ai vetë më vonë e kuptoi këtë se ishte në vendin e duhur, pasi Zoti që atëherë kishte vendosur se kush do të ishte ai në këtë jetë, kishte përcaktuar profesionin e tij në shoqërinë që e rrethonte.

Kontributi i tij në Dibrën shumë të dashtun ka qenë shumëdimensional. Duke i qëndruar pranë familjes, ai iu përkushtua jo vetëm të afërmve e rrethit të ngushtë miqësor që e rrethonin, porse, së pari mendoi e veproi për misionin më fisnik njerëzor: të qenit i dobishëm e një vesh i dëgjueshëm për çdokënd që trokiste në portën e tij, pavarësisht pushtetit të tij, pikërisht duke vënë në zbatim kësisoj atë çka i diktonte shpirti e besimi i tij, siç përmendet edhe në hadith: "Më i miri prej jush është ai që është më i dobishëm për njerëzit". Ai dha një kontribut të vyer e të rëndësishëm duke u bërë model frymëzimi për rininë e mbarë shoqërinë shqiptare, në radhë të parë si qytetar, teolog, funksionar i administratës shtetërore e një profesor i shumë brezave apo edukator i të gjitha shtresave. Me mençurinë, drejtësinë, qetësinë që e karakterizonte ai ndoqi një politikë gjithëpërfshirëse për çdo aktor të qytetarisë dibrane, duke u kthyer kështu në një figurë tepër të përkushtuar e të dashur për bashkëqytetarët e tij. Nuk ishte më tepër lidershipi kauza e tij sesa ndriçimi i mendjes njerëzore për të qenë

1 VIT PA MYFTIUN "RUZHDI LATA"

Më 24 nëntor 2019, në Xhaminë e Myftiut "Ruzhdi Lata" në Dibër të Madhe u shënua përvjetori i parë i ndarjes nga jeta të ish-myftiut dhe ish-kryetarit të Komunës Dibër, Ruzhdi Lata. Të pranishëm në këtë përvjetor ishin shumë miq, shokë e dashamirë të Latës, mes të cilëve edhe z. Telat Xhaferi, Kryetar i Parlamentit të Maqedonisë së Veriut etj.

Në këtë përvjetor po sjellim një profil të Ruzhdi Latës, që përfshin kontributin e tij në jetën shoqërore e politike në hapsirën shqiptare dhe më gjerë.







së pari lider i vetes së tyre, prej nga vjen edhe suksesi e qytetaria e një shoqërie.

I ndjeri myfti, ti nuk ishe ai udhëheqësi shpirtëror që përtej interesave personale sytë e mendja nuk të shikonte asgjë, përkundrazi përballë mirëqenies së popullit tënd ti me vendosmëri të plotë i kapërceje interesat familjare. Ti nuk ishe ai politikani të cilit i nevojitej megafoni për të depërtuar zërin e tij tek qytetarët e vet e me hipokrizi të prekë zemrat e tyre. Ti e dije shumë mirë peshën e zërit tënd, se kur duhet me e nxjerr atë e kur duhet me hesht, ndaj më shumë heshte e në heshtje vepra fliste për bukurinë e shpirtit tënd, për lirinë e tij si dallëndyshja që nis shtegtimin pas shumë pranverave të munguara.

Ti nuk e pe politikën si biznes fitimprurës, por investove në të me të gjitha forcat dhe energjitë e tua për të pastruar papërgjegjshmërinë dhe turpësitë e politikanëve që e mbollën farën e atij morali dështak e shkatërrues. Ti nuk ishe ai modeli i liderit që shëtiste me foristradë a me eskortë badigardësh, por një njeri i thjeshtë që ecje në këmbë për në punën që të priste, për në takimet me qytetarët, ai lideri popullor që qante hallet shtruar me popullin e vet duke u zhveshur nga petku i politikanit e udhëheqësit.

Ti ishe ai politikani që vatanin dibran e dheun që të lindi e pe si vatrën e ngrohtë familjare, duke sakrifikuar pa fund për lumturinë dhe mirëqenien e qytetarëve të tu, për ata që të besuan por edhe për ata që të tradhtuan, që pas shpine thikën donin ta ngulnin e që fatkeqësisht nuk ja arritën, pasi krahas drejtësisë hyjnore ka edhe një drejtësi njerëzore, të cilët ishin bashkëkombësit e tu që e kuptuan thjeshtësinë, modestinë e nacionalitetin tënd. Ata panë te ti atë politikanin që punonte për një Dibër të fortë, e jo atë politikanin milioner, që siç shprehet analisti e shkrimtari Kim Mehmeti, i cili i mëson qytetarët e vet se si mbrohet partia e pushtetarët e si shembet atdheu.

Po ç'mund të themi për jetimët?! A nuk ishin ato të cilëve u përkëdhelje flokët, iu dhuroje buzëqeshje, ua ngrohje shpirtin jo vetëm duke i ndihmuar financiarisht, porse duke i përfshirë ato në programe integruese, edukuese, emancipuese, argëtuese për të ndryshuar katërcipërisht rrjedhën e jetës së tyre, në dobi të rritjes së vetëbesimit të tyre dhe gjithëpërfshirjes në jetën shoqërore me kauzën e vetme "Punë sot e lider të suksesshëm nesër".

Po a mund të numërohen dot tryezat e shtruara, iftaret e shumta që shtroheshin në nder të gëzimit që ndieje e që doje ta ndaje me të gjithë duke ngrohur zemrat me bamirësi, humanizëm, drejtësi, paqe, dashuri pasi këto ishin shtyllat që t'i diktonte morali i bukur që të karakterizonte, "pasi një bukë e dhënë sot, është mburojë mot".

Ti ishe ai shpirti i zogut të lirë që fluturon pa ndalur në hapësirën qiellore në kërkim të një jete më të mirë, ashtu siç pa pushuar nuk të zuri gjumi e as nuk të kaploi lodhja kur hallet e shqiptarisë trokisnin në veshin tënd duke rendur e duke u bërë copash për të ofruar zgjidhjen më të mirë, edhe nëse do të hiqej kafshata juaj tamam si ai prindi për fëmijën e vet. Dhe e di pse? Sepse kurrë nuk i pe mbështetësit e tu, përkrahësit, qytetarët si shërbëtorë, skllevër apo "mjete pune", si subjekte drejtë realizimit e kurorëzimit të objektivave të tua gjeopolitike, profesionale apo në çdo fushë tjetër. Ti nuk ishe ai modeli i rëndomtë i liderëve të sotëm që demokracia e shoqëria moderne e kapitalizmit fatkeqësisht na ka ofruar mbi katër dekada e po na ofron dita-ditës; ai udhëheqësi që sapo rrëmben zemrat e qytetarëve të vet në prag të zgjedhjeve u vë shkelmin atyre duke mbyllur çdo shqisë, porse përkundrazi ti hape "dyert e zemrës dhe të arsyes" për qytetarët e tu.

Për këto e shumë të tjera, do i mungosh çdo shtrese të shoqërisë, pasi ti punove fortë për secilën prej tyre për të mbrojtur të vobektit, për drejtësinë e të pafuqishmëve, për ndëshkimin e pushtetarëve, për të drejtat e fëmijëve, për shëndetin e shëndetligëve, për buzëqeshjen e jetimëve, për mbrojtjen e të braktisurve. Ndoshta nuk more shumë prej tyre, por ajo çfarë more në shkëmbim të këtyre veprave ishte shumë më e fuqishme se çdo pushtet tjetër: lutja e sinqertë për ty e cila u bë forcë, burim qetësie shpirtërore e fuqi për ty për më shumë vepra madhore.

Do u mungosh jo vetëm shqiptarisë, por edhe qytetarëve të tjerë të Maqedonisë së Veriut, ku punove dhe veprove, pasi për ty shqiptaria nuk njihte kufi gjeografikë. Ti ishe një prej atyre personazheve për të cilët flet pena e ndritur e Hafiz Ali Korçës, tek vepra "Shtat ëndrrat e Shqipërisë": Me vërtet ky është atë, / Që mundohet dit' e natë / Për të nçuar bijt e vetë / Të rrojnë bukur në jetë (Vepra 12, Logos A, 2006:192).

Ti ishe ai "kandili i pashuar i shpresës", "ato ditët e mira", për të cilat ka folur pareshtur shkrimtari Naim Frashëri e rilindasit e tjerë, e ti do të mbetesh njëri prej tyre, pasi gjithherë përpiqeshe për ndriçimin e mendjes njerëzore.

Ti nuk aktrove përballë askujt në këtë jetë, por punove fort me bindje e siguri, me sinqeritet e dashuri për të hedhur rrënjët e shoqërisë, shtyllat e forta të njerëzimit. Ti ishe ai strategu largpamës, jo për veten, për njerëzinë e sot, me dritën që lëshove, ndriçon e fuqizon mendjen e rinisë shqiptare. Ti nuk preferove të ndërtoje gradaçelat e kësaj dynjaje, pallate e shtëpi në katër cepat e botës, por kërkove e punove për të ndërtuar mbretërinë e veprave të bukura, fillimisht para njerëzisë, e mbi të gjitha para Krijuesit, sepse ti ishe aq i mençur e largpamës duke besuar se ajo çka mbetet është vepra e bukur e jo vilat shumëkatëshe. Ti ishe Skëndërbeu i shqiptarëve e sot je forca e frymëzimi i tyre.

Sot e çdo ditë të kësaj jete do i mungosh çdo shpirti dibran, çdo vatre ku fale fjalës së bukur dhe ndërmjetësimit tënd, sot po jeton jetën e qetë, larg ngujimit e gjakderdhjes që e priste çdo familje ku shkoje e pajtoje, zbusje gjakrat e nxehta dhe hasmëritë e hershme të trashëgueme brez pas brezi.

Do u mungosh atyre fëmijëve të uritur ku me bamirësinë tënde ua shuajte urinë, ia lehtësove brengën kryefamiljarit, ia ktheve buzëqeshjen familjes e lumturove zemrat e tyre. Do u mungosh atyre shqiptarëve që u dhe ushqim shpirtëror, që i frymëzove dhe u ofrove një model të pastër e të bukur të krijesës njerëzore, pa e kuptuar se ai shembull I denjë ishe ti për ta.

Do t'u mungosh ditëve të vetmuara e të trishtuara të moshës së tretë, ku përkëdheljet e tua, fjalët e tua magjike, të bukura në vlera e me mesazhe të larta ishin ushqim për ta, burim qëndrese së fortë edhe pse shumë prej tyre ishin braktisur prej fëmijëve të tyre, e më keq akoma për disa, në azilet e pleqve. Me pak fjalë, do i mungosh çdo njeriu të kësaj toke. Së pari do u mungosh djalit tënd të vetëm, Bajramit, vajzave të tua: Fisnikes e Lejlës, nipërve e mbesave të tu, e më shumë akoma do i mungosh shpirtit të fortë e të bukur, heroinës e shumë të shtrenjtës, bashkëshortes tënde, znj. Flora.

Duke e kaluar pragun familjar ku mosprezenca jote ndihet në çdo cep të vatrës e në çdo detaj të jetës së tyre ku vlerat e dashuria jote ndihet kudo e është dëshmi e gjallë e jetës së tyre, do i mungosh çdo shpirti ku nga fjala jote mori një mësim: dikush besimin e palëkundur, dikush liderin e fortë, dikush prindin shembullor, dikush udhëheqësin e drejtë, korrektë e besnik. Do u mungosh miqve e dashamirësve të tu të cilët të kujtojnë me përmallim e çdo fjalë tuajën e ruajnë si thesar të çmuar e një leksion të vyer për jetën e tyre.

E në këtë zbrazëti e mungesë të madhe, do i mungosh edhe penës së artë qa ka mbetur pa një dorë mendimtare.

Do i mungosh të gjithëve, shpirtrave të shqiptarisë, pasi ti ishe e do të mbetesh përjetë i gjallë në mesin e njerëzisë, si kandili naimjan për shqiptarinë!

Allahu xh.sh. të pastë pranuar pranë Tij, në një ndër kopshtet e Xhenetit! Amin!

Dr. Malvina Kaloshi Tafciu,
Neki Kaloshi, Musa Riçku

cyan magenta yelloë black

“Ne jemi me Agronin”

Në fillim të Dhjetorit, poeti, shkrimtari, studiuesi e profesor Agron Tufa, së bashku me familjen e tij kërkoi azil politik në Zvicër.

Agron Tufa mbante detyrën e Drejtorit të Instituti të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit. Ky institut është miratuar nga Parlamenti shqiptar që në shkurt të vitit 2010 dhe ka për detyrë detyrë të studiojë dhe të vlerësojë objektivisht krimet dhe dëmet e komunizmit në Shqipëri, t’i zbardhë dhe t’i dëshmojë ato në mënyrë të dokumentuar dhe të pakontestueshme.

Agroni udhëhoqi prej gati 9 vitesh këtë institut me një staf të vogël prej afro 15 vetësh, por që gjatë këtyre viteve ka bërë një punë të madhe në zbardhjen e të shkuarës tragjike të Shqipërisë.

Që nga 1 prilli i këtij viti, Agroni është gjendur nën sulme denigruese e shpifëse ndaj punës dhe personalitetit të tij. Njerëz të veshur me pushtet, deputetë dhe media pranë tyre kanë udhëhequr një fushatë dizinformuese ndaj punës së ISKK në përgjithësi dhe ndaj Agronit personalisht. Dhe kjo fushatë fyese e denigruese kaloi edhe në sulme personale, duke u ndjerë i rrezikuar jo vetëm ai personalisht, por edhe familja e fëmijët e tij.

Institucionet shtetërore, ata që kanë për detyrë të garantojnë sigurinë dhe jetën e qytetarëve shqiptarë, aq më tepër të drejtuesve të një institucioni që po zbardhte çdo ditë të kaluarën e errët të njerëzve me pushtet në Shqipëri, nuk e bënë detyrën e tyre. Edhe pas largimit, nuk ka pasur asnjë deklaratë zyrtare për këtë çështje, me përjashtim të një deklarate të vonuar të Presidentit të Republikës, z. Ilir Meta, gjatë një aktiviteti mbi liritë e shprehjes dhe të drejtave të njeriut. Madje, deputetë të Parlamentit të Shqipërisë, kanë deklaruar pas largimit, se “... do të bëjmë të pamundurën që edhe atje ku ka kërkuar azil politik të mos gjejë vrimë ku të futet”.

Por ndërsa ka pasur një heshtje institucionale, nga ana tjetër ka pasur një reagim publik nga personalitete të kulturës shqiptare, shkrimtarë, studiues, kritikë, miq e dashamirë të autorit. Disa prej këtyre shkrimeve kemi vendosur ti botojmë këtë numër.

Ata e kanë mbështetur Agronin, jo vetëm si koleg, poet e shkrimtar nga më të mirët e postdiktaturës, por edhe në misionin e tij të zbardhjes së krimeve të komunizmit.

Për këtë arsye, ne kemi vendosur të botojmë një botim special në këtë numër, për të dëshmuar jo vetëm përkrahjen ndaj Agronit dhe familjes së tij, por edhe mbështetjen për punën e tij në zbardhjen e krimeve.

Sepse një krim i pandëshkuar rrezikon të rikthehet me një krim të ri.

BUJAR KAROSHI

REAGIME

ANTON NIKË BERISHA: *Zëri dramatik i ndërgjegjes ose i përkulem flijimit tënd dhe dhembjes sate*

ARTAN GJYZEL HASANI : *Nuk ka ikur Agron Tufa, por ju të gjithë*

VISAR ZHITI: *“Bota është bërë e vogël, por të bëhet i madh njeriu”*

GAZMEND KAPLLANI : *Ikja e Agron Tufës duhet të tingëllojë si një këmbanë zgjimi*

AHMET PRENÇI : Agron Tufa, pasqyra ku diktatura nuk sheh dot veten

RAMIZ GJINI : Një letër shkrimtarit Agron Tufa, *për gëzimet dhe tmerret që la pas*

ADEM BUNGURI: *Unë kam qenë dhe jam me Agron Tufën!*

Fallsifikimi i historisë - shkas për spastrime etnike

Nga **AGRON TUFA**

FAQE 26-27

Rruga e Arbërit nr. 163

opinion

Agron Tufa në të gjithë qasjen e tij publike dhe me kontributin shkencorë për zbardhjen e së kaluarës diktatoriale, ishte një pasqyrë e kulluar, e pa krisur, tek e cila nuk donin të shihnin veten armata që i shërbeu atij regjimi.

Agron Tufa, pasqyra ku diktatura nuk sheh dot veten

Nga **AHMET PRENÇI**

Që Agron Tufa, bashkë me familjen, iku nga vendi i tij, unë e mora vesh nga lajmet.

E konfirmova menjëherë këtë lajm dhe u trishtova shumë.

Ishim takuar disa herë këtë vit dhe kishim biseduar për breshërinë e kërcënimeve dhe debateve që ai përballej me personazhe të pushtetshëm dhe eksponentë të shumtë, përkrahës të regjimit ish-komunist dhe të ish-Sigurimit të Shtetit. Nga bisedat me të nuk më kishte shprehur kurrë një ide të tillë, për t'u larguar nga Shqipëria, ndonëse e shikoja të dëshpëruar e gati të vetmuar në këtë luftë publike, parimore dhe institucionale.

Agroni ishte i vetmi si Drejtor i një institucioni që nuk e drejtonte mazhoranca. Të gjithë institucionet tashmë janë nën thundrën e partisë shtet, nën urdhrat e Kryeministrit të plotfuqishëm. Të gjithë. Pa përjashtim. Përfshirë dhe pushtetin gjyqësor. Iku tashmë drejtori i fundit i një institucioni të krijuar si rekomandim i Këshillit të Evropës. Pra, iku një kryetar i një institucioni dhe me këtë rast njëkohësisht kanë thyer rëndë dhe shpirtin e një poeti.

Ai u gjend përballë kërcënimesh e shantazhesh deri me jetë. Kërcënime për të dhe familjen, për të 5 fëmijët e tij. Jo rrallë më ishte drejtuar për t'u konsultuar për të përballuar këtë hall të madh. Unë, si miku i tij, që kisha një jetë në institucionet e sigurisë dhe mund e duhet të bëja diçka për të. Ai, jo pa qëllim, më drejtohej për të gjetur mënyrën ligjore për të siguruar veten, bashkëshorten dhe pesë fëmijët e tij. Ai iu drejtua institucioneve të zbatimit të ligjit; policisë dhe prokurorisë, pasi kërcënimet i vinin publikisht, në rrugë elektronike, por edhe në rrugët e Tiranës ku Agroni lëvizte çdo ditë në aktivitetin e tij. I vinin nga persona anonimë, që i adresonin kërcënime direkte për jetën e tij dhe të familjes, për shkak të funksionit që kryente.


Duke ditur se institucionet i kanë mekanizmat e plotë për ta zgjidhur shumë shpejt çështjen, përpiqesha ta qetësoja, por pa sukses. Kur kaloi kohë e gjatë dhe asgjë s'po zgjidhej isha i bindur se askush nuk kishte vullnet për ta zgjidhur këtë problem. Megjithatë, rezervohesha për të mos ia pohuar këtë Agronit.

Agron Tufën e kam njohur dhe takuar për së pari në vitin 1985, në Peshkopi. Unë nga Reçi, ai ishte nga Sohodolli. Ishim pothuaj moshatarë. Të dy e donim letërsinë. Të dy shkruanim poezi. Mua më botuan asokohe një cikël me poezi tek "Ushtima e Maleve" falë mësuesit tim të ndjerë, poetit Islam Çenga. Agronit nuk ja botonin poezitë asokohe, megjithëse ishte shumë i talentuar. Të dy ishim me biografi të keqe, por ai shumë më keq se e unë. Mua mu vonua e drejta e studimit një vit, ai vazhdoi studimet vetëm pas vitit '90.

Agroni studioi dhe iu përkushtua në kohë të plotë letërsisë. Studioi shumë, krijoi shumë, punoi shumë dhe me përkushtim, botoi shumë. Fitoi disa çmime, sepse ishte i talentuar e shumë kërkues në përkushtimin e tij. Unë krenohesha dhe lumturohesha me letërsinë e tij të spikatur. Krenohesha me suksesin e tij.

Kur mori detyrën e Drejtorit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit (ISKK) mua më erdhi mirë. Kam ndjekur në vijimësi punën, aktivitetet dhe botimet e këtij Instituti. Kam lexuar botime të këtij Instituti me histori dhe ndodhi trishtuese, dëshmi tronditëse e prova drithëruese, autorë e dëshmitarë të mbijetuar që dëshmojnë për këto krime monstruoze e të paimagjinueshme të regjimit komunist e të Sigurimit të Shtetit.

Misioni i tij dhe i kolegëve të tij, u mbështetën me fisnikëri nga Fondacioni Konrad Adenauer. Pa këtë fondacion, puna e tij dhe e institucionit do ishte thuajse një iluzion.



Mungesa e kësaj mbështetje nga institucione, organe dhe donacione të tjera tregojnë se kujdestarët që ruajnë qelsat e krimeve të stalinizmit shqiptarë janë më të fortë se ajo pjesë e shoqërisë që kërkon të hedh dritë mbi të kaluarën për të siguruar të ardhmen.

Mbase pikërisht tek mos nxjerrja në dritë e krimeve dhe mos-dënimi dhe mos-denoncimi i tyre, duhet parë dhe lehtësia me të cilën kaloi ylberin e saj politik Rilindja socialiste drejt një kornize autoritarizmi, që po bëhet kërcënim për demokracinë.

Agron Tufa në të gjithë qasjen e tij publike dhe me kontributin shkencorë për zbardhjen e së kaluarës diktatoriale, ishte një pasqyrë e kulluar, e pa krisur, tek e cila nuk donin të shihnin veten armata që i shërbeu atij regjimi. Kjo armatë burokratësh enveristë, në fillim e gjuajti me gurë këtë pasqyrë, për ta thyer. Sulmuan Institutin dhe punonjësit e tij. Ua prenë fondet. Deshën ta shkrijnë. Nuk e bënë dot. Tani që drejtuesi i këtij institucioni iku, ata e pështyjnë me të njëjtën këlbazë, që dikur përdornin kundër imperializmit amerikan, kundër vatikanit. Madje dhe kundër shkrimtarëve "reaksionarë" të veriut ku përfshihej Fishta, Koliçi, Camaj, Pipa, Harapi etj etj.

Kjo është një shfaqje tragji-komike që do të ishte periferike nëse do të kishte në fokus vetëm zotni Tufa. Ishte tërmeti i 26 Nëntorit, në fakt, që bëri edhe një rrënim tjetër: -ky tërmet hodhi poshtë gjithë ngrehinën panagjerike të qeverisë që kish përgatitur për gjoja festimet e 75- vjetorit të çlirimit. Rilindasit kanë kohë që luftojnë e punojnë për ta ndarë shoqërinë tonë të lodhur nga tranzicioni në "Ne" dhe "Ata". Ky proces seleksionues nuk bëhet si dikur në ballë të brigadave me punëtorët e fermës apo ndërmarrjeve, por përmes syrit vigjilent të kontrollit kibernetik të postimeve në internet.

Agron Tufa edhe sikur të kishte ikur nga kjo jetë (larg qoftë), ai përsëri do mbetej një poet, shkrimtarë e veprimtarë i shkëlqyer i këtyre tre dekadave. Por për fat të mirë ai është i fortë dhe më i kalitur për ta bërë penën e tij një shigjetë drite për vitet që vijnë. Ai do të jetë nobelisti i parë shqiptarë. Pa ekzilin e poetit, ndoshta nuk do ishte i plotë fati i një shkrimtari të shquar si Agron Tufa.

Mjaftuan këto pak ditë dhe reagimet që rrethuan largimin e Tufës, për të kuptuar se sa pak jemi larguar nga vitet '90! Mjerisht!

Agroni si poet, studiues dhe shkrimtar; i denjë për detyrën që i ishte ngarkuar, u përfshi shpirtërisht dhe u përball me këtë masakër njerëzore që kishte ndodhur nën komunizëm. Reagoi fort e vazhdimisht. Mos vallë s'duhet ta kishte bërë?! Mendoj gjithë ditën që ka bërë gjënë e duhur. Ai ka mbi një vit që u kërcënua indirekt e direkt, në gazetë dhe publikisht, në televizion e në rrugë, nga anonimë dhe njerëz me pushtet. Në misionin e tij u mbështet nga opozita dhe shoqëria, por i gjithë mekanizmi shtetëror ishte krejt kundër tij.

Mendoj që bëri mirë që iku. Iku në një vend të BE-së, duke dhënë dorëheqjen dhe kaq. Sigurimi i fëmijëve për një prind është detyrë themelore dhe e shenjtë. Ai këtë ka bërë. Tashmë është i lirë të bëjë atë që di të bëjë më mirë. Të shkruaj e krijojë në një vend të lirë. E di, krejt i trazuar dhe i trishtuar për Atdheun që ka lënë. Ikja dhe azili janë krejt personale, nuk përbëjnë vepër penale

Në normalitet, Kryeministri duhet që dikujt t'ia kërkojë llogarinë për këtë ikje. Nuk mund të thotë Kryeministri dhe askush tjetër se Agron Tufa është bandit, nuk mund të thotë se Agron Tufa është kriminel, nuk mund të thotë për të që do ta gjejmë ku të jetë strukur që ta sjellim këtu të japë llogari para drejtësisë së reformuar, siç tha për oficerët e policisë në ekzil (!). Agron Tufa shkruan bukur dhe fliste qartë. Kaq. Nëse qeverisë i vjen e keqja nga këto, atëherë kjo shoqëri duhet të reflektojë thellë se ku po jetojmë, në çfarë regjimi jemi!

Kam ndjekur këto orë reagimet për këtë arratisje! Respekt për Besnik Mustafajn, Elez Biberajn, Bardhyl London, Arben Çejkun, Agron Gjekmarkaj,Rexhep Shahun, Izet Durakun, Jonila Godolen, Entela Kasin, Virion Graçin, Agron Shehaj, Pëllumb Nakon, Nebil Çikën, Lindita Çelën, Kujtim Cakonin, Agron Gashin, Balil Gjinin, Faruk Murtajn, Zhaneta Barxhajn, Gentiana Sula –Mara, Erl Kodrën, Parid Turdiun, Yzedin Himën, Bajram Karabollin, Ervin Nezhën, Shkëlqim Abazin etj. Ndjesë për ndonjërin që s'e kam përmendur. Një falënderim për secilin!

Me trishtim kam ndjekur komentet e ndonjë personaliteti të letrave që lëshuan vrerin e tyre të zi kundër Agron Tufës. Nuk do ua përmend emrin, sepse i kam lexuar here pas here, por në këtë rast mu neveritën. Mu neveritën, pasi këta nuk kanë thënë asnjë fjalë kur në Parlamentin shqiptarë u përfaqësuam më banditë e kriminelë, me trafikantë droge e femrash, me përdhunues e me vrasës dhe s'ju kam lexuar asnjë rresht. Agronin le ta shajnë si antikomunist. S'ka asnjë problem, por jo si shkrimtar, si studiues, si përkthyes, si profesor, si qytetar i mirë dhe i angazhuar. Jo, këtë s'duhet ta bëjnë njerëz të të njëjtit profesion si Agroni. Dhe e gjith kjo për hir të parties, të nostalgjisë së tyre për regjimin e kaluar komunist. Pra, atë e shajnë dhe e fyejnë rëndom si antikomunist, pikërisht në këtë moment shumë të vështirë për të dhe për të vetmen arsye se po nxirrte në pah krimet e komunizmit, pra për shkak të detyrës, sepse më parë se të kryente këtë detyrë Agron Tufa as nuk është kërcënuar dhe as nuk është fyer dhe as nuk është shantazhuar nga askush. Kjo nuk është e denjë për njerëzit e letrave dhe mendjehapur. Kjo nuk është e denjë për njerëz që duhet ta duan, ta pasurojnë dhe ta shpien përpara letërsinë e kulturën shqiptare.

> Agron Tufa, në këtë sfidë pas 30 vitesh të rrëzimit të komunizmit, mendoj se ishte krejt i vetëm nga përkrahja shtetërore. U ndje i vetëm, i pambrojtur, i pa mbështetur, ndaj dhe u largua. Mbështetja më e mire ishte hetimi i shpejtë, i plotë dhe i gjithanshëm i rasteve të kërcënimeve të tij. Vendosja e autorëve para drejtësisë nuk do kishte sjellë këtë veprim të Z. Tufa. Zgjidhja ligjore e rastit në kohë, identifikimi dhe procedimi i autorëve nuk do krijonte këtë situatë të vështirë për një njeri që nuk i sjell asnjë të keqe shoqërisë, përveçse të mira.

Agron Tufa, në këtë sfidë pas 30 vitesh të rrëzimit të komunizmit, mendoj se ishte krejt i vetëm nga përkrahja shtetërore. U ndje i vetëm, i pambrojtur, i pa mbështetur, ndaj dhe u largua. Mbështetja më e mire ishte hetimi i shpejtë, i plotë dhe i gjithanshëm i rasteve të kërcënimeve të tij. Vendosja e autorëve para drejtësisë nuk do kishte sjellë këtë veprim të Z. Tufa.

Ai nuk është një gangster që i ka hyrë rrugës së krimit për të mbijetuar. Nuk ka emigruar për këtë qëllim Agroni. Ai është një shkrimtar, një poet, një njeri i ndjeshëm që iu ngarkua një detyrë që e bëri me pasion, me devotshmëri, me ndjenjë e përkushtim. Prandaj përfundoi kështu. E dhimbshme të ndodh kjo me shkrimtarët e një vendi. Në vendin ku ka shkuar do jetë një qytetar model, se i tillë është edukuar e formuar Agron Tufa.

Si një qytetar i angazhuar me 25 vjet përvojë në organet ligjzbatuese shqiptare dhe si drejtues i Policisë së Shtetit për disa vite nuk mund të rri pa u tërhequr vëmendjen ish-kolegëve që janë marrë me rastin e z. Tufa. Një rast i tillë është shumë lehtë për t'u hetuar e për t'u sqaruar. Zgjidhja ligjore e rastit në kohë, identifikimi dhe procedimi i autorëve nuk do krijonte këtë situatë të vështirë për një njeri që nuk i sjell asnjë të keqe shoqërisë, përveçse të mira. Të kenë parasysh ata oficerë dhe prokurorë se janë rreshtuar me aktorët kryesorë që imponuan këtë largim të Agron Tufës.

Agronit i uroj shëndet bashkë me bashkëshorten dhe fëmijët. E këshilloj mos të lexojë gazeta dhe lajme shqiptare, pasi këtu vazhdojnë edhe sot të hapen gazetat me kërcënime kriminale ndaj tij. Ata që kryen krime në kohën e komunizmit e kërcënuan Agronin që kishte detyrë të dokumentonte veprimtarinë kriminale të tyre, janë po ata që sot pas ikjes së tij hedhin baltë për të denigruar figurën e tij. Tipike këto metoda të ish- Sigurimit të Shtetit. Nëse Agron Tufa paska shkelur ligjin pse pikërisht tani hidhen këto shashka të shëmtuara, thjesht e vetëm për të përbaltur figurën e tij?! Sa për sulmet, denigrimet, provokimet, përçmimet dhe korin e sharistave, i kujtoj Agronit fjalën e urtë dibrane; lisin më të gjatë e rreh era më tepër.

Agron, shkruaj i lirë në një vend të lirë. Shkruaj jo vetëm për trishtimin tënd por dhe për dëshpërimin tonë.

opinion

Një letër shkrimtarit Agron Tufa, për gëzimet dhe tmerret që la pas



Në një poezi tënden të mrekullueshme, që titullohet "Shqipëria", ti e ke thënë vetë, që "Shqipëria është më e madhe së toka e saj", prandaj nuk ke përse ndjehesh i përzënë jashtë atdheut dhe i veçuar në Zvicër. Të rrishë aty, në atë vend të lirë dhe të ndjehesh si në shtëpinë tënde. Sepse shtëpia është vetëm aty ku është liria.

Nga **RAMIZ GJINI**

I dashtun Ag!

Edhe pse tashmë je në ekzil, pamë se të kërcënuan sërish; po unë e di që ti nuk trembesh, sepse e ke syrin pishë, prandaj nuk është nevoja të zgjatem në këtë pikë.

Duhet të dishë një gjë, i dashtun vëlla, që ikja jote i ka gëzuar pa masë ca ndyrësira të thara nga koha, që kanë hypur sot në pushtet. I ka gëzuar më tepër për faktin, se u ke kursyer paratë, me të cilat do t'u duhej të paguanin vrasësin. Por ta dishë, që nëse kthehesh, ata e bëjnë.

Dy shkrimet e botuara menjëherë pas ikjes tënde te paçavurja "DITA" shkruar nga Spartak Braho dhe Fatos Tarifa, - cuba pushteti, që bien erë gjak, janë dy pështyma, që i hodhën, më tepër si thirrje solidariteti, për të mbledhë rreth ketyre pështymave, mizat dhe buburrecët e qenefit komunist.

Dhe sa çudi! Ngase ata nuk kanë armiq të tjerë përveç ballistëve, të kanë quajtur "ballisti i fundit". Fali, sepse nuk kanë ku të gjëjnë armiq të tjerë për t'i luftuar. Vetëm ti u kishe mbetur! Serbët i kanë vëllezër, grekërit po ashtu. Pastaj, luftën më të madhe, gjithmonë e kan patur dhe vazhdojnë ta kënë me "armikun" e brendshëm. Me atë, që u rrëzikon pushtetin. Dhe ti e di, qe ata, brenda Shqipërisë i kan bërë edhe malet me kufoma.

Ti nuk ke pse ligështohesh, vëlla, sepse ata, janë aq të poshtër, aq të ndyrë, aq hipokritë, aq skuthë, sa edhe udhëhëqësit të tyre të "lavdishëm", ia kan nxjerrë kockat nga varri, ia kan futur në thes, dhe i kanë fshehur në ndonjë zgëq bodrumi të errët. E kan bërë, jo se nuk e duan, por sepse kështu u intereson te shfaqen para botës, që aspiron ngritjen dhe konsolidimin e një shteti demokratik në Shqipëri.

Ke pare ti?! As emrin nuk ia përmëndin në publik, po prap e duan në fshehtësi.

E duan si kodoshi kurvën.

Tani po mbahen pas ca "dëshmorësh" që i patën stisur me plan partie për të mashtruar brezat që do rriteshin me gënjeshtrën e një lufte të "lavdishme". E bëjnë për të justifikuar pushtetin që kanë zaptuar më votë të vjedhur.

Shqiptarët, kanë luftuar në shekuj heroikisht, kanë bërë shumë luftëra, por ata trumbetojnë vëtëm njërën: "luftën" e tyre vëllavrasëse, kriminale.

Ti e di se si ua zmadhuan portretet dhe i frynë si tollumbace, që të kenë mundësi t'i shohin ata që u ka lënë shëndetin mendja.

I dashtun Ag!

Tani mbahu fort, sepse po të jap një lajm të hidhur: të kanë shpallur tradhëtar të atdheut. E kanë bërë, sepse ende mendojnë si dikur; që kush kalon kufirin dhe futet për të kërkuar strehim dhe mbrojtje në ndonjë shtet të huaj, është tradhëtar.

Në fakt, në njëfarë mënyre, ti je tradhëtar. Po, po! Je tradhëtar i idealit të tyre shterpë, të atij ideali, që i bëri shqiptarët skllevër për 45 vjetë, e që po i bën skllëvër edhe sot.

Je tradhëtar i mendimeve të tyre kriminale, ashtu siç jam edhe unë, siç janë një milion e gjysëm shqiptarë, që ikën dhe e lanë Shqipërinë sepse donin lirinë, jo skllavërinë.

Tradhëtar, sepse ti ke mendje të ndriçuar dhe udhëhiqesh nga mendimi yt vetiak analitik.

Tradhëtar, sepse nuk ke udhëheqës shpirtëror një kriminel si Enver Hoxha.

Tani, i dashtun Ag, ata kanë vëtëm një frikë në lidhje më ty: frikën së mos kthehesh sërish. Kjo i tmerron kur e mendojnë, prandaj dhe vazhdojnë kërcënimin edhe pse je larguar. Duan të të mbajnë sa më larg, që të mos kesh mundësi t'u afrosh mu te hunda, qe t'i marrin erë mutit të tyre; mutit që i kanë bërë Shqipërisë..

Por ti, dhe ne të gjithë bashkë, edhe pse nuk jetojme në Shqipëri, do vazhdojmë të luftojmë me artin tonë të shkrimit e krijimit, derisa këneta të thahet në atdheun tonë, e qelbësira të jetë groposur.

Në një poezi tënden të mrekullueshme, që titullohet "Shqipëria", ti e ke thënë vetë, që "Shqipëria është më e madhe së toka e saj", prandaj nuk ke përse ndjehesh i përzënë jashtë atdheut dhe i veçuar në Zvicër. Të rrishë aty, në atë vend të lirë dhe të ndjehesh si në shtëpinë tënde. Sepse shtëpia është vetëm aty ku është liria.

Po kanë edhe tmerre të tjera ata monstra: tmerrin, që po jetojnë si krimbat, vetëm për të ngrënë. Kanë tmerrin, për faktin, që u duhet të mbijetojnë në pushtet me propogandë, gënjeshtra dhe akte kriminale.

Kanë tmerrin që i mbërthen kur mendojnë, që ti je një poet dhe shkrimtar i mrekullueshëm; dhe se do të vazhdosh të dëgjohesh e të tregosh veten në jete të jetëve me artin tënd.

Kanë tmerrin që veprës tënde, ata nuk kanë çfarë i bëjnë.

A nuk po vazhdojnë të dëgjohen ende zërat e Trifon Xhaxhikës, Avzi Nelës, Genc Lekës, Vilson Blloshmit e shumë të tjerëve, që soj i tyre i ndyrë, i burgosi, vari e i pushkatoi duke menduar se i zhbinë nga faqja e dheut? Dhe të mendosh që ti, i dashtun Ag, nuk e pate, dhe shpresojmë të mos e keshë kurrë fatin tragjik të tye.

Çfarë do të lënë pas Brahot, Tarifat e shumë të tjerë si ata? Ta them unë. Do të lënë vëtëm një tahmë qelbësire, që do të duhen nja dhjetë tsuname për ta marrë me vete e për ta larguar nga Shqipëria.

Ti mos u ligështo, i dashtun vëlla, sepse ikja jote, nuk është dështim, ajo është vetëm një tërheqje taktike në fushë të betejës. Ti e di mirë, që një gjë të tillë, e kan bërë shumë shkrimtar nëpër botë, sidomos shkrimtar të mëdhënj rusë, krijimet e disa prej të cilëve, edhe i ke shqipëruar në mënyrë të mrekullueshme. Janë burgosur, janë përzënë, janë shpallur armiq, dhë prap janë kthyer te atdheu i tyre me vepra të pavdekshme, të vlerësuar nga gjithë bota, madje edhe me çmim nobël. Sepse regjimet, vijnë e ikin, porse populli dhe veprat mbeten. Prandaj, lëri të hanë deri sa të fryhen si rriçnat; sepse rruga e tyre është fare e shkurtër. Ajo nis te tryeza e ngrënjes, dhe përfundon te gropa e nevojtores.

Do t'i vrasë babëzia dhe do varrosen tragjikisht shumë thellë.

Do i varrosë ajo, e pa mëshirëshmja dhe e pagabueshmja: KOHA.

I dashtun Ag!

Tani po e mbyll. Paç jetë të gjatë! Kujdesu për familjen dhe bëj atë që ti di shumë mirë ta bësh: SHKRUAJ.

Nuk ka ikur Agron Tufa, por ju të gjithë

Nga **ARTAN GJYZEL HASANI**

Nuk ka ikur një individ, por ka ikur shkrimtari që shihte çdo ditë batakun në të cilin klikat uzurpatore të artit e kulturës zhysin shpirtin e një kombi.

Ikja e Agronit ka 30 vjet që ka filluar. Nuk ndodhi sot. Ka ndodhur ditën kur na bënë bashkëvuajtës e bashkëfajtorë.

Ikja e Agron Tufës është me e rëndë se ikja e Kadaresë në kohën kur diktatura numëronte ditët e fundit të saj dhe e kishte marrë rrugën e varrit.

Nëse ikja e Kadaresë rrëzoi fasadën e fundit të demokracisë proletare shqiptare, ikja e Tufës rrëzoi fasadën e mbetur të demokracisë së pretenduar shqiptare.

Të Demonkracisë dhe Demokraturës shqiptare 30 vjet pas rrëzimit de jure të regjimit komunist në Shqipëri.

Ikja e Kadaresë ishte akuze ndaj atyre që ushtruan diktaturën, ndërsa ikja e Tufës në të njëjtën masë është akuzë edhe për të gjithë shoqërinë shqiptare, stanin që prodhon bulmetin e thartuar në tridhjete vjet rresht.

Nuk ka ikur Agron Tufa. Ka ikur shkrimtari, publicisti, pedagogu, dhe së fundmi edhe drejtuesi i institucionit më antidiktaturë në Shqipëri. Nuk ka ikur një individ, por ka ikur shkrimtari që shihte çdo ditë batakun në të cilin klikat uzurpatore të artit e kulturës zhysin shpirtin e një kombi.

Ka ikur publicisti i censuruar që përballej çdo herë më botuesit e shitblerë të mediave dhe me dyert e mbyllura të studiove të uzurpuara nga këlyshët dhe shërbëtorët e Klikës së Rilindjes.

Iku pedagogu që prekte çdo ditë jo vetëm mungesën e interesit për ushqimin kulturor dhe artistik të atyre që do të jenë e ardhmja e vendit, por edhe politikat mediokre dhe klienteliste arsimore në atë vend.

Ka ikur edhe drejtuesi i atij institucioni që duhet të ishte më i shenjti dhe i paprekshmi në një vend që ka dalë nga diktatura më e egër komuniste e Europës për gjysmë shekulli.

Agron Tufa u neverit dhe u ngrit e iku nga ajo hale e madhe kutërbimim e së cilës mësëpari e ndjejnë shqisat intelektuale dhe jo ato fizike. Iku dhe ka bërë shumë mirë. Nuk ia vlen sakrifica individuale për të ndryshuar të ardhmen e atij vendi të banuar në pjesën dërrmuese nga njerëz indiferentë, apatikë dhe rehatlinj, nësë do përdorja fjalet më të buta.

Nuk ka fatkeqësi më të madhe sesa në vitin 2020 të kërcënohet me jetë nga mbetje të neveritshme të diktaturës një intelektual prominent. Por në një vend ku kryetar parlamenti është ish ministri i Diktaturës, ku kupola qeverisëse përbëhet nga nipat dhe bijtë e Bllokmenëve, kur në krye të Akademisë së Shkencave është vënë një figurë politikisht e diskredituar, pritet të ndodhin gjithnjë të tilla gjëra.

Ikja e Agronit ka 30 vjet që ka filluar. Nuk ndodhi sot. Ka ndodhur ditën kur na bënë bashkëvuajtës e bashkëfajtorë.

Atë ditë ka ikur Agroni.

Ka 30 vjet në ikje Agroni shqiptar. Për turpin e të gjithë atyre që drejtuan atë vend në këto tridhjetë vjet. Majtas e djathtas, njësoj përgjegjës për çfarë ka ndodhur pas rrëzimit të monumenteve të diktatorit e deri më sot.

Vallë nëse nuk do të ishte tradhtuar që në djep ëndrra jonë e dhjetorit 90-të do kishim rreth nesh sot si vendimmarrës për fatet e vendit qënie pa integritet dhe moralisht të pështira si Brahot, Brokajt e Gjinushët? Pa përmendur qindra të tjerë si ata që shfaqen herë si politikanë, oligarkë e herë si manjatë mediash, të gjithë njësoj spekulatorë të neveritshëm në një vend të mbushur me spektatorë.

Ikja e Agron Tufës nuk është kambanë alarmi, por thyerja e kësaj kambane. Ishte thyerja e kambanës e fundit që ra për veshët tuaj të shurdhët për shumë kohë, por ju e injoruat, e anatemuat, bëtë sikur nuk ishit aty, ju dukej delirant, arrivist, i ekzagjeruar.

Tashmë është vonë.

Moralisht keni ikur të gjithë nga ai vend, edhe pse fizikisht vazhdoni të frymoni aty.

Pyeteni një herë veten: A kishte nevojë Agron Tufa të kacafytej aq keq me monstrat prostatike deri sa të detyrohej të merrte në atë moshë me gjithë familjen rrugën e mërgimit? Me kapacitetin intelektual dhe artistik të dëshmuar më së miri ndër shumë vite ai mund të siguronte një jetesë të qetë e të sigurtë për veten dhe familjen.

Përse vallë zgjodhi të jetë David vetmitar përballë hordhive të Goliadhëve të kuq dhe mavi që akoma mbajnë peng Shqipërinë?

"Think about it!", - thonë këtu ku jetoj unë në raste të tilla."Think about it!"

Rruga e Arbërit nr. 163

letër e hapur

Zëri dramatik i ndërgjegjes ose i përkulem flijimit tënd dhe dhembjes sate

Nga **ANTON NIKË BERISHA**



Agron Tufa gjatë një takim me lexues në Prishtinë, nëntor, 2019.

Agron i dashur,

Ka gjysmë qindvjetshi që merrem kryesisht me punën studimore dhe me hartimin e veprave letrare poetike dhe kam qenë "larg" politikës dhe zhurmës që e kushtëzon përditshmëria. Kjo ka ndodhur sidomos në 23 vjetët kur kam punuar si ligjërues në Universitetin e Kalabrisë në Itali (nga nëntori i vitit 1993). Shpesh ajo që ka ndodhur në jetën tonë kulturore dhe politike në Kosovë dhe në Shqipëri, veçmas në dy dekadat e fundit, kur kanë ndodhur ngjarje e dukuri me rëndësi të madhe (lufta, shpallja e pavarësisë së Kosovës, qeverisja e saj nga vetë shqiptarët, hapja e Shqipërisë përballë demokracisë dhe botës, futja e saj në disa organe përfaqësuese të Evropës etj.) më ka trazuar përtej masës. Ky trazim ndonjëherë ka marrë aso përmasash sa më është dukur se po m'i bluan eshtrat dhe po më zhbën palcën. Kjo më ka bërë të ndihem i zhgënjyer jo vetëm nga pushtetarët tanë, po dhe nga vetvetja! E keqja nuk përligjet vetëm nga veprimet e gabueshme, shpesh të shëmtuara dhe rrënuese të pushtetarëve tanë e të disa organeve që ata udhëheqin, po pse ato veprime nuk i prekin në ndërgjegje, nuk i vetëdijesojnë për përgjegjësinë që kanë, për detyrat që duhet t'i përmbushin ndaj qytetarëve si të zgjedhurit e tyre. Kjo është ajo që duhet të na shqetësojë të gjithëve, para së gjithash vetë politikanët. Dhe sikur të mos ishte puna që bëja, të mos ishte përcaktimi im këmbëngulës, i mbështetur në parimin: meqenëse nuk mund t'i ndryshosh të tjerët, t'i ndryshosh rrjedhat, atëherë merru me veprimtarinë studimore dhe krijuese, bëj detyrën e një individi për arsye se çdo gjë në shoqërinë njerëzore fillon nga individi dhe gjithçka që ndodh brenda saj është rrjedhojë e punës së tij (secili i vë themelet e ndërtesës së veprimit dhe te jetës së vet me punë). Këtu dhe duhet kërkuar mos ndërhyrjen, përkatësisht mos reagimin tim publik përballë asaj që shpesh ka ndodhur në botën tonë, sa dhe jam turpëruar dhe e kam ndier veten fajtor për atë që ka ndodhur. Ndonjëherë edhe kur nuk merr pjesë në ndonjë veprim të gabuar ose të shëmtuar të pjesëtarëve të shoqërisë e të botës që i përket, vetvetiu, si pjesëtarë i asaj shoqërie dhe i asaj bote, a nuk bëhesh edhe ti fajtor!?

Me pak fjalë, dhembjen dhe pësimet që i kam ndier si pjesëtar i shoqërisë shqiptare, kam synuar t'i mbëltoj ose të ngritëm mbi to me punë: s'ka formë tjetër më të denjë të dëshmosh se je pjesëtar i një kulture dhe i një bote sesa me punë, e cila mund të shihet dhe të preket (natyrisht dhe të vlerësohet): janë shkrimet, librat, ligjëratat.

Largimi yt nga Shqipëria mëmë, nga kërcënimet që të janë bërë ty dhe familjes sate edhe nga njerëz në organe përfaqësuese shtetërore, më bën ta thyej parimin tim jetësor dhe të shkruaj këtë letër të hapur për arsye se punën e largimit tënd me familje nga Shqipëria, nuk e vërej si dukuri të një individi dhe të një familje, po si dukuri që duhet ta na tundë e të na vetëdijesojë para se ajo të marrë ato përmasa që do të jenë me pasoja të jashtëzakonshme, edhe për vetë ata që sot janë në vendet me përgjegjësi të madhe shtetërore dhe politike, si zë dramatik i ndërgjegjes.

Po kujtoj këtu letrën e hapur që Nëna jonë Tereze u shkroi "me lot në sy e me dashuri të Zotit në zemër " dy kryetarëve, Gjorgj Bushit dhe Sadam Hyseinit (po jo ushtarëve) që ta parandalonin luftën, përndryshe merrnin mbi vete përgjegjësinë para njeriut dhe para Zotit për të gjitha viktimat, jetimët dhe të vejat që do t'i shkaktonte ajo luftë .

Në fillim mendova t'u shkruaj një letër të hapur kryetarit të Shqipërisë, Ilir Metës, kryeministrit, Edi Ramës, po u mëdysha: pse t'ua kujtoj atyre përgjegjësinë që duhet të kenë dhe detyrën që duhet ta përmbushin dhe ta përligjin në çdo çast dhe për çdo rast që vë një pikë të zezë në rrjedhën e gjallimit të jetës shoqërore dhe politike të Shqipërisë dhe të botës shqiptare në përgjithësi. Një kryetar shteti dhe një kryeministër i një vendi duhet të kujdesen dhe të luftojnë me përkushtimin më të madh për t'u siguruar një jetë normale qytetarëve për arsye se ata – qytetarët – janë subjekti ku dëshmohet më së miri puna e tyre me përgjegjësi; ata pa ta do t'ishin të pa qenë. Në periudhën e komunizmit në Shqipëri, që është dëshmuar vijimisht, sidomos me burgjet dhe vrasjet e shumta pa procese përkatëse) çdo gjë ka pasur vlerë më të madhe se njeriu!

Nuk u shkrova dy njerëzve që janë në krye të Mëmëdheut tonë, për arsye se ajo mund të shkonte në vesh të shurdhër, sikur kanë dëshmuar disa raste të tjera, kur të tjerët u janë drejtuar atyre me ndonjë kërkesë që ka qenë krejt e arsyeshme. Në të shumtën e rasteve arsyetimi ka qenë i përmbysur: është detyrë e organeve të tjera..., e kanë hequr nga vetja, pa të drejtë, përgjegjësinë. Ose dukuritë e tilla i kanë zvogëluar, pra në qenësi i kanë prapësuar dhe mohuar.

Nuk u shkrova letër të hapur dy personaliteteve më të larta të Shqipërisë edhe për një arsye tjetër: ata deri më tani nuk treguan as edhe një veprim, qoftë dhe të dorës së dytë (nga ajo që unë kam mundur të mësoj) për braktisjen tënde të vendit tënd, për flijimin dhe për dhembjen tënde.

Për të mos përjetuar të njëjtin fat dhe letra ime, po të shkruaj pandërmjetësisht ty.

Janë disa arsye që po veproj kështu, por po përmend vetëm dy:

E para: ti je një krijues që e ke dëshmuar veten me punën letrare, me veprat në poezi, në prozë dhe në fushën e studimeve, që tashmë janë bërë pasuri e artit tonë të fjalës dhe e mendimit tonë intelektual dhe shkencor kudo ku flitet shqip; me punën pedagogjike (me ligjëratat si profesor), pastaj me punën e përkthimeve letrare, me të cilat e ke pasuruar letërsinë tonë. Pos kësaj, veprimtaria jote si dejtues i Institutit për studimin e krimeve dhe të pasojave të komunizmit në Shqipëri, ku u botuan një varg librash me të dhëna e dokumente të krimeve të pushtetarëve të kuq për rreth 50 vjet – përligj përcaktimin tënd dhe punën tënde për shumëçka të qenësishme për botën tonë shqiptare, të sotme, po që do të shtrihet edhe në të nesërmen.

E dyta: të marr pjesë në flijimin tënd dhe në dhimbjen tënde e të familjes sate. Fatin tënd kam mundur ta përjetoj dhe unë, edhe një tjetër, secili që gjakon ta dëshmojë vetën me punë për të mirën e shoqërisë që i takon e zotohet për përparimin e saj, që me punën e vet synon t'i ndriçojë dukuritë, rrjedhat, qoftë të së tashmes, qoftë të së kaluarës. Është thënë shpesh (po e përsëris edhe unë): kush nuk e ndriçon dhe nuk e njeh të kaluarën s'ka as të tashme të mirëfilltë, s'do të ketë as të ardhme. Sikur e tashmja që ndërtohet mbi të kaluarën, edhe e nesërmja ndërtohet mbi bazën e së sotmes (së tashmes).

Në kulturat e tjera, i dashur Agron, krijuesit i çmojnë dhe i nderojnë për arsye se ata janë shtylla të rëndësishme dhe, në forma të ndryshme, përligjin rrafshin e përparimit, rrjedhën dhe frymëmarrjen e një shoqërie. Fishta ynë i madh thoshte: "Ideja e naltueshme, e veshne me fjalë të bukura e të pershtatshme, nuk merr mort. Prandej nder popuj të gjytetnuem poetve të vertetë, letrarve të njimendtë u ngrifen pomendore të madhnueshme, e i lavdojn e i nderojn si t'ishin do hyjní, të thuesh; edhè brezníve të reja u a paraqesin si trashigimin mâ të çmueshmin, per t'a ruejtë të pacenuem gjatë gjith verigës së pakputne të shekujvet ".

Përkundër të gjitha rrethanave dhe pësimeve që po përjetojmë, ne do të vijojmë të frymojmë e të krijojmë edhe pse pushtetarët tanë, nuk shqetësohen shumë për këtë gjë. Pra, ne duhet të vazhdojmë punën tonë, dialogun tonë me librat për arsye se ne jemi ne, vetëm kur dëshmojmë me punën tonë që bëjmë ose, siç thotë Guliem Blinishti, "Librat janë dialogu, që shkrimtarët e shkëmbejnë me shpirtin e tyre, nga jeta në jetë".

Prishtinë, dhjetor 2019

OPINION

Një tërmet intelektual në Shqipëri

Nga **AG APOLLONI**

Mbrëmë nga disa portale mora vesh që shkrimtari Agron Tufa me familje, pas një persekutimi të gjatë nga pushteti i keq dhe shoqëria e kuqe, ka kërkuar azil politik në Zvicër. Edhe pse isha i sigurt që kjo herët a vonë do të ndodhte, mbrëmë nuk doja t'u besoja lajmeve, por këtë e konfirmova shpejt nëpërmjet komunikimit direkt me familjen e persekutuar. Natyrisht, u dëshpërova shumë për dy arsye: e para, sepse Agronin e kam mik dhe, e dyta, sepse ai është shkrimtar dhe intelektual i dorës së parë. (Për veprën e tij kam shkruar disa herë dhe një nga shkrimet që jua sugjeroj ta lexoni është ai me titull "Dy tragjedi dhe një katarsis", që flet për "Gurit të varrit ia rrëfej", një roman i jashtëzakonshëm që thërret për një katarsis kombëtar).

Agron Tufa u persekutua, sepse duke i zbardhur krimet e komunizmit, tregonte se sa e nxirë është sot fytyra e Shqipërisë, që s'ka kaluar ende nëpër procesin e lustracionit.

Duke hulumtuar, gjeta një postim që kisha bërë më 29 prill të këtij viti për rastin e persekutimit të Agron Tufës. Shkurtimisht, ai përmban këtë shënim: "Në Shqipëri, këto ditë ka nisur një luftë mes shkrimtarit Agron Tufa dhe mbeturinave komuniste shqiptare. Pak më parë e pashë në një televizion shqiptar sesi fliste një militant komunist, njëfarë Arben Duka, që kishte kryer Akademinë Ushtarake, por që i pëlqente të njihej si poet (sepse kishte shkruar vargje të panumërta lavdëruese për Enver Hoxhën) dhe si gazetar i gazetës "Dita". Ai thoshte se Agron Tufa ka hyrë në gjak me historinë dhe këtë nuk do t'ia falë populli. Kërcënimi ishte i pastër. Është e tmerrshme se si në Shqipëri, në vend se të jenë në burgje, këta Duka e duduka flasin në emër të popullit dhe të historisë".

Herën e fundit kur u takuam me Agronin dhe Elvanën, këtu, në Prishtinë, para disa javësh, bëmë një bisedë heretikësh mesjetarë, domethënë folëm për kërcënimet dhe persekutimet në ditët e sotme. Shpresoja që tashmë heretikët duhet të fitojnë, jo Inkuizicioni. Por...

Tash nuk e di nëse Shqipëria po e përjeton muzgun e demokracisë, apo ndoshta demokracia atje ishte vetëm një iluzion.

letër e hapur

“Bota është bërë e vogël, por të bëhet i madh njeriu”

Nga **VISAR ZHITI**

I dashur Agron,

Së pari, Ju dëshirojmë të jeni mirë, kudo qofshi, bashkë me Elvanën dhe fëmijët, që meritojnë çdo sakrificë dhe gëzime pa fund.

Edhe pse jemi shumë larg, përtej oqeanit, në SHBA, Eda dhe unë jemi vendosur afër Chicago-s, në një vend të heshtur dhe të veçuar, pa shumë lajme, ku dimri tashmë ka ardhur, me temperaturat minus - dhe jo vetëm ato janë minus për ne, - bashkë me dimrin, pra, na erdhi dhe lajmi i ikjes Tuaj familjarisht nga atdheu.

Edhe pse mua më dukej se pritej një ndodhi kësisoj, pa na befasuar dhe aq, se kështu është realiteti ynë, dramatik dhe i pabesë, gjithsesi na ka shqetësuar, shqetësim i natyrshëm për Ju, fëmijët dhe vendin.

Ikja sigurisht që pati një shkak dhe lutemi që pasojat të jenë për mirë.

Puna Juaj e madhe si drejtor i Institutit të Studimeve të Krimeve të Komunizmit mbetet e rëndësishme, plot me nxjerrje dëshmish tronditëse nga jeta, nga antijeta jonë infernale në burgje, ku me ne ishte dhe ati juaj, në kampet shfarosëse aushviciane, etj., nga epoka e diktaturës më të egër në Europë dhe e gjitha kjo u shndërrua dhe në një akuzë të hapur, vazhdim i duhur i ofshamave dhe akuzave tona ndaj sundimtarëve, krimi shtetëror i të cilëve kishte nisur që gjatë Luftës së Dytë Botërore, ku fitimtarët, nga çlirimtarë të vendit, u shndërruan menjëherë në pushtues të tij, u çlirua Shqipëria dhe shqiptarët u robëruan më keq se kurrë. Më parë se universitetet ata hapën burgjet dhe institucionalizuan dhunën duke mos e ndërprerë persekutimin, duke iu ngazëllyer si sadistë atij, duke e shitur me gjakun tonë si fitore të përgjithshme.

Të rrëfyerit e kësaj, me një polifoni të dhimbshme sot, një kor më tragjik se ai i antikitetit kështu, kjo hata e madhe nuk mund të durohej dot as si libër në shekullin XXI në Shqipërinë tonë të vogël nga ata që e bënë apo i shërbyen asaj diktature dhe nga bijtë e tyre, deputetë, ministra, gazetë, televizion, pedagogë, antilibra, opinion klanor, presidentë, grupe të kamufluara terrori, etj., të pasuruar të gjithë, ndoca pas emigrimit të fshehtë duke u bërë dhe qytetarë të Europës e më tej, etj., etj., kur ne duhej ta duronim diktaturën e tyre si vuajtje reale në jetë dhe pas saj, si të braktisur dhe të harruar deri në nëpërkëmbje në postdiktaturë, kur Shqipëria jonë është, si të thuash, në sistemin demokratik që ëndërruan ish të përndjekurit, ish të burgosurit, por, për paradoks, pa i dashur ata vetë, gjithandej, me mosdashuri edhe mes nesh. Idetë dhe dëshirat dhe aleatët idealë të ish të persekutuarve, BE-ja dhe SHBA-ja po, i duan, por jo neve, ish të persekutuarit dhe mbi vuajtjen tonë vazhduan, pa asnjë ndjesë a dënim moral, ndryshimin e të dikurshmes në shpëtim dhe dobi të vetes:

e kam thënë, ne kemi një demokraci me kundershtarët mizorë të demokracisë, një kapitalizëm me armiqtë e kapitalizmit, të cilët nga idhtarë të rremë ose jo të pronës sociale, të përbashkët dhe të askujt, u bënë pronarë të ethshëm, të dyshimtë, oligarkë të Shqipërisë.

Puna Juaj e madhe si drejtor i Institutit të Studimeve të Krimeve të Komunizmit mbetet e rëndësishme, plot me nxjerrje dëshmish tronditëse nga jeta, nga antijeta jonë infernale në burgje, ku me ne ishte dhe ati juaj, në kampet shfarosëse aushviciane, etj., nga epoka e diktaturës më të egër në Europë dhe e gjitha kjo u shndërrua dhe në një akuzë të hapur, vazhdim i duhur i ofshamave dhe akuzave tona ndaj sundimtarëve, krimi shtetëror i të cilëve kishte nisur që gjatë Luftës së Dytë Botërore, ku fitimtarët, nga çlirimtarë të vendit, u shndërruan menjëherë në pushtues të tij, u çlirua Shqipëria dhe shqiptarët u robëruan më keq se kurrë.

Jeta jonë prapë mbeti e vështirë, në fund të fundit si e të shumtëve, por shpesh më e pa durueshme, pa drejtësi dhe pa përgjegjës, pa kujtesë dhe të vërtetat, me moral të rrëzuar. Të mbetur në vetmitë tona që shqetësojmë dhe vetëm me pranitë, mjafton që jemi dhe shndërrohemi në akuza të gjalla...

I dashur Agron,

S’e di pse u zgjata, nga nevoja për të përsëritur shqetësimet e paqetësuara, ngaqë e ndjej ikjen Tuaj duke kërkuar azil politik në Zvicër, i sulmuar banalshëm dhe i kërcënuar deri dhe me jetë, që s’je i vetëm, i bindur që e ndjeni shumë dhe fatin tonë, të ne që jemi, si të thuash, “lënda e parë” e Institutit që drejtonit me dinjitet dhe guxim, i pësimit dhe dëshmive të rënda tonat.

Kur detyrohen të ikin studiuesit e persekutimit nga Shqipëria, ç’duhet të bëjnë të persekutuarit e mbetur gjallë, që ende u dhembin kockat nga prangat?

Agron,

Kujto atin, kujto të ikur e mëdhenj të mëparshëm, kujto persekutimin e tejmë dhe merr forcë, na kujtoni ne, nëpërkëmbjen që na bëjnë dhe sulmet e herëpashershme, edhe mua kujtomë, Mik i dashur, kur më sulmuan me të padrejtë Presidenti i Republikës, ish-oficeri me armë i diktaturës apo ish-shefi i ikur i policisë së burgut, shtypësi me hekur dhe gjak i revoltës tonë në burg e të tjerë barbarë me klanin e tyre e censorët e dikurshëm të poezive tona e deri te vrasja më e fundit afër shtëpisë së bashkëvuajtësit tonë, që e kishte të shkruar mbi lëkurën e vet dëshminë dhe akuzën kundër krimit shtetëror, etj., etj. Ne u ndjemë sërish të hedhur në arenë si gladiatorët mes bishave.

Ne e kujtojmë që pas sulmit, Ju u ngritët në mbrojtjen tonë, akuzuat si ne duke rrezikuar.

Prandaj keni dhe mirënjohjen.

Shembujt janë të shumtë.

Kujto prapë revoltat e reja të ish të burgosurve në posdiktaturë, grevat e reja të urisë, vetëdjegiet martirizuese, heshtjen e tyre të madhërishme, ikjet e tyre të mëpastajme drejt lirive të tjera dhe merr forcë si Anteu.

Kujto dhe tërmetin e tanishëm, të vrarët dhe gërmadhat e tij që na dhembin, dimrin jashtë, fëmijët e trembur, njerëzit që bashkohen, mundin e rimëkëmbjes, botën që s’na lë vetëm në pikëllimin dhe mynxyrën tonë. Kujtohu që është e pamundur të jesh vetëm, qoftë për mirë, qoftë dhe për keq.

Bota është bërë e vogël, themi shpesh, por të bëhet i madh njeriu, shtoj unë.

Agron,

Ju sërish ngritët një alarm të ri tani duke ikur, të rëndësishëm dhe të duhur dhe, për fat, të shumtë janë mbështetësit dhe bashkëluftëtarët e kauzës së përbashkët.

I bindur që do të vazhdoni betejën, si shkrimtar dhe qytetar i lirë në një botë të lirë, veprimtar i palodhur i të vërtetës dhe i të drejtës, i përulur para dhimbjes njerëzore, krah për krah me të vuajturit dhe të persekutuarit siç ishe dhe vetë nga burgu i atit Tuaj, për ta treguar me kurajo e kulturën e duhur të keqen tonë që ajo të njihet nga të gjithë për të mos u përsëritur ndër të tjerë, te askush në askund.

SHBA tani ka shtuar dhe Ditën e Kujtesës Botërore, 7 Nëntorin, në nderim të 100 milionë viktimave të komunizmit, ku janë dhe martirët tanë, që kundërshtuan heroikisht.

Edhe kujtesa jonë duhet t’i shërbejë përvojës dhe përpjekjes për pajtimin e drejtë dhe paqen e drejtë me historinë dhe veten. Është ende e vështirë. Mjafton të kujtojmë ceremoninë e rivarrimit të një patrioti të madh dhe intekektuali të madh, bir i Frashërllinjve që ribënë Kombin, se si u hodhën egërshane mbetjet e diktaturës, që as vdekja nuk i qetëson. Por nuk duhet sprapsur. Përpara për të afruar një të ardhme më të mirë se tonën te fëmijët.

Është detyrë ruajtja e tyre, rritja dhe edukimi me dashuri; “Mësomë të dua” lutej Shenjtja jonë Nënë Terezë dhe Ju bëtë një detyrë ndaj fëmijëve Tuaj, me përkushtimin dhe sakrificën prindërore. Askush nuk ka të drejtë të qortojë kërkesën Tuaj për azil, ndërkaq meritoni mbështetjen tonë dhe të të gjithëve.

Ne Ju urojmë mbarësi dhe forcë, durim dhe gëzime bashkë me gëzimet e fëmijëve, punë dhe art dhe dhimbje që së bashku të bëjmë më të mirën tonë për vendin...

Siç Ju thashë unë jam larg, edhe nga jeta tani, edhe nga bota, siç e dini, jam vetëm dhimbje, që e ndjen dhimbjen nëpërkudo...

Përqafime vëllazërore,
Visar Zhiti

REAGIME

Bardhyl Londo:

Termeti i dyte ndodhi: Agron Tufen, nje nga shkrimtaret me te talentuar shqiptare e detyruan te braktise atdheun e tij te dashur per te cilin ka bere aq shume. Shqiperia thyen keshtu nje tjeter rekord famekeq: nje shkrimtar nga me te njohurit ne periudhen postdiktatoriale detyrohet te kerkoje strehim politik ne nje vend tjeter per te siguruar jeten e femijeve te tij. Tani le te dale kryeministri dordolec dhe shakaxhi dhe te deklaroje: e cfare ka ketu? Kjo ndodh dhe ne Kroaci dhe ne Bullgari... Per cudi pas ketij termeti te dyte heshtin shkrimtaret, heshtin organizatat e tyre, hesht. PEN KLUBI.Po kur do te ndjeheni dhe organizoheni o njerez?

Flurura Açka:

Liria dhe AntiLiria e Agronit

Gjatë ditëve të panairit të Librit, me Agronin na u desh të shkonim në promovimin e një autoreje të re shqiptare. Me qetësinë e tij, me një kujdes të admirueshëm profesional, Agron Tufa i bëri një analizë të hollësishme librit poetik që na kishe mbledhur, e tillë, që nuk mund të ishte e një njeriu që ishte në nxitim e sipër për të ikur. Ajo ishte edhe hera e radhës kur u rrokëm përqafe, por jo e fundit. Ne e përzumë Agronin me heshtjen tonë. Tani po flasin shumë, dhe mirë bëjnë, por kur Agroni kërcënohej, fyhej, poshtërohej nga po ata njerëz që nuk kursejnë askënd, nga po ato puseta me imunitet shtetëror shpesh, ku ishim ne? Agron i dashur, bëre shumë mirë, ne jemi mësuar ta përzëmë me shkelma “Mendjen” nga Shqipëria. Europa është atdheu i Lirisë, Shqipërinë më parë duhet ta pastrojmë nga AntiLiria, por kur?

Arber Ahmetaj:

Agron Tufa, mik i dashur, autor i talentuar: ti ishe në listën e pushkatimit. Po t’afrohej dita! I ke lënë duarthatë vrasësit! Por, ata do kalojnë tek emri tjetër në listë! Ata e realizojnë planin! Ty t’mbetet tu dalësh zot, siç bënë me ne ata që shpëtuan para nesh! Mos u ndal! Duke shpëtuar veten, mund të shpëtosh edhe të tjerë! Jeta jote këtu do mbrohet! Ti nga këtu, mund e duhet ta ngresh zërin për të shpëtuar të tjerët! Kam kaluar asaj rruge! E di sa vështirë do ta kesh! Por për ty, vështirë, s’do të thotë e pamundur! Të njoh e të kam lexuar! Ti përbën brezin e tretë, fëmijët tu, të katërtin, që dhunuesit e Shqipërisë sonë, deshën ta eleminonin! S’duhet ta harrojmë vullnetin e tyre për t’na vrarë! Do ua kthejmë ndryshe, do i turpërojmë per ligësitë e tyre për dhjetë breza! Me dritën tonë, me letërsinë tonë!

Rruga e Arbërit nr. 163

opinion

Besnik Mustafaj: Pse ata që e kërcënuan s'kanë frikë dhe fshihen pas Edi Ramës?

Nga BESNIK MUSTAFAJ

Shteti nuk e mori Agron Tufën në mbrojtje përballë kërcënimeve të tyre të hapura e të fshehta dhe të përsëritura me një intensitet në rritje, sidomos gjatë dy viteve të fundit. Nga ana e tij, Agron Tufa, me vetëdijen e lartë të një shërbëtori të shtetit, bëri gjithçka ishte në dorën e tij për t'i shkuar përpara misionit të vet, në emër të interesit madhor të Shqipërisë. Ai hodhi poshtë me përbuzje të gjitha ofertat për të bërë kompromise që do t'i kthenin qetësinë vetjake e familjare, por që do t'i mbyllnin gojën dhe kërkoi mbështetje atje ku i takonte me ligj ta gjente mbështetjen: te shteti.

Agron Tufa është tashmë de facto azilant politik. Tërmet i dytë, e quajti poeti i mirënjohur Bardhyl Londo largimin e tij. Agron Tufa është një nga autorët më të spikatur të letërsisë së sotme shqipe, me një vepër të gjerë në prozë, poezi, ese dhe përkthime.

Është edhe një profesor universiteti shumë i dashur dhe i çmuar për studentët dhe ish-studentët e tij. Përfytyrimi i largimit të tij si një kataklizëm nga ana e poetit Bardhyl Londo, nuk lidhet megjithatë as me dëmet që do të pësojë nga ky largim letërsia bashkëkohore shqipe dhe as mësimdhënia në universitet. Mungesa (e përkohshme) fizike e autorit në arealin e Republikës së Shqipërisë nuk do të ketë asnjë ndikim në përhapjen e veprës së tij letrare të shkruar e të botuar tashmë dhe as në atë që ai do të vazhdojë të shkruaj.

Sepse unë jam i bindur që ai do të vazhdojë ta plotësojë veprën e tij në prozë, poezi e ese. Asgjë nuk mund ta ndalojë për t'u ngjitur pareshtur në rrugën e letërsisë që është edhe destini i tij hyjnor. Bindja ime se ai nuk do ta ndalë punën e shkrimtarisë mbështetet edhe në përvojën e dy paraardhësve të tij të shquar, të cilët ishin në moshën e tij sot, kur u detyruan të merrnin, për të njëjtën arsye, rrugën e emigrimit politik drejt Europës Perëndimore: Ernest Koliqit dhe Ismail Kadaresë. Pra, mua si lexues i të gjithë veprës së tij, nuk më shqetëson fare mungesa fizike e autorit në Tiranë. Madje, sikur të mos e kisha mik Agron Tufën, ndoshta as që do të mendoja se ku jeton ai.

Përfytyrimi i ikjes së Agron Tufës si një tërmet nga ana e poetit Bardhyl Londo lidhet me një dimension tjetër të personalitetit të tij. Në mos gaboj, Agron Tufa ishte në mandatin e tij të tretë si drejtor i Institutit për Studimin e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit. Sipas ligjit, mandatin e tij e jep bordi i këtij Instituti, i zgjedhur ky nga Parlamenti, që do të thotë se puna e këtij Instituti vlerësohet si e rëndësisë së veçantë për shtetin dhe për shoqërinë. Agron Tufa është në drejtimin e tij qysh në themelim. Nuk është vendi këtu të bëjmë bilancin e punës së tij afro dhjetëvjeçare, por fakt është se rrallë ndonjë institucion shqiptar i ngritur nga hiçi është afirmuar kaq shpejt, duke zënë vend qendror në vëmendjen e elitave dhe të publikut shqiptar lidhur me problematikat që burojnë nga studimi i krimeve dhe pasojave të komunizmit në Shqipëri.

Përmbledhtazi do thënë se këto problematika do të duhet të mishërojnë së bashku qëndrimin kolektiv të shoqërisë tonë ndaj të vërtetës historike dhe politike të regjimit komunist, e vërtetë kjo që kalendarikisht i përket të kaluarës, pra, nuk mund të ndryshohet, por që rrezatimet e saj vazhdojnë të veprojnë mbi të sotmen, rrjedhimisht edhe të ardhmen e shoqërisë tonë. Nevojën që ka procesi i ndërtimit të një realiteti demokratik për nxjerrjen në dritë të kësaj të vërtete më duket se e ka shprehur afro 30 vjet më parë më thjeshtë dhe më mirë se kushdo ish-Presidenti i parë paskomunist i Bullgarisë, i ndjeri Zhelju Zhelev, një historian i shquar i periudhës së fashizmit, të cilit, kur iu kërkua ta kthente faqen e historisë se komunizmit në emër të hedhjes së vështrimit përpara, u përgjigj se po, do ta kthejmë patjetër faqen, por më parë duhet ta lexojmë.

Me hamendje e them se një nga arsyet kryesore pse Zhelev nuk mori një mandat të dytë si President i Bullgarisë, qëndron pikërisht te përpjekjet e tij për t'i dhënë mundësi shoqërisë bullgare ta lexojë me vëmendje dhe ndershmëri faqen e historisë së komunizmit para se ta kthejë atë par ta mbyllur përgjithmonë. Përvoja ka treguar se leximi i një historie kombëtare të dhunshme, të përgjakshme, nuk është një detyrë që mund ta kryejë shoqëria civile, përfshirë këtu edhe Akademinë e Shkencave, sado i madh të jetë përkushtimi i saj. Për vetë kompleksitetin e saj, një punë të tillë mund ta kryejë vetëm shteti, si akt dhe si shprehje e vullnetit të tij për t'u pastruar nga metastazat e të keqes. (Me ndihmën e amerikanëve) Këtë e kuptuan menjëherë pas Luftës edhe gjermanët. Më në fund,në vitin 2010, këtë e kuptoi edhe shteti shqiptar dhe ngriti, me ligj të posaçëm, Institutin për Studimin e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, në krye të të cilit u emërua Profesor Doktor Agron Tufa.

Siç do të provohej gjatë viteve në vazhdim, ishte gjetur njeriu i përshtatshëm. Agron Tufa kishte formimin intelektual, integritetin moral, si edhe frymëzimin personal për ta kryer me nder këtë detyrë. Po, edhe frymëzimi duhej, në mënyrë që puna e ekipit të vogël të këtij Instituti të shndërrohej në mision, ashtu siç u shndërrua me të vërtetë. Shumë veta në Shqipëri kishin parë gjatë kohës tek Edi Rama simptoma të një nostalgjie enveriste për metodat si i pëlqente ta ushtronte pushtetin.

Por të rrallë do të kenë qenë ata, ma merr mendja, të cilët e kishin kuptuar se bërthama e fortë elektorale, e cila do ta sillte Edi Ramën në krye të pushtetit në vitin 2013 dhe do ta mbante atje kaq gjatë, ishin enveristët, jo më ca "gërdalla pa dhëmbë", siç i quajti një nga opinionistët tanë në modë, por skuadrone të organizuara mirë, me ndjeshmërinë dhe disiplinën e një sekti. Shkak real që ata të dilnin nga nëntoka e kriminalizuar, prej ku tërhiqnin fijet e pushtetit rilindës, për t'u shfaqur para mbarë opinionit publik me zë dhe fytyrë, u bë pikërisht Agron Tufa me ekipin e Institutit, që drejtonte. Duke pasur pushtetin nëpërmjet Edi Ramës, ata dëshmuan se nuk kanë më frikë jo vetëm nga e kaluara e tyre, por as nga shteti i sotëm.

Vetëm kjo shpjegon pse shteti nuk e mori Agron Tufën në mbrojtje përballë kërcënimeve të tyre të hapura e të fshehta dhe të përsëritura me një intensitet në rritje, sidomos gjatë dy viteve të fundit. Nga ana e tij, Agron Tufa, me vetëdijen e lartë të një shërbëtori të shtetit, bëri gjithçka ishte në dorën e tij për t'i shkuar përpara misionit të vet, në emër të interesit madhor të Shqipërisë. Ai hodhi poshtë me përbuzje të gjitha ofertat për të bërë kompromise që do t'i kthenin qetësinë vetjake e familjare, por që do t'i mbyllnin gojën dhe kërkoi mbështetje atje ku i takonte me ligj ta gjente mbështetjen: te shteti. Nuk e gjeti këtë mbështetje te Policia. Por nuk e gjeti as te Prokuroria, as te gjykatat, të cilave iu drejtua me denoncime konkrete, ndoshta jo me ndonjë shpresë të madhe te drejtësia e tyre, por me besimin prej qytetari të lirë tek e drejta e vet mbështetur në kushtetutë. Shpërfillja e plotë, që të denoncuarit prej tij i bënë gjithë kohën sistemit të drejtësisë, ku nuk u paraqitën as edhe një herë, përbën një fakt tronditës.

Jo vetëm kaq. Ata vazhduan kërcënimet e tyre, të artikuluara deri edhe në foltoren e Parlamentit të Republikës sonë. Me këtë sjellje, ata treguan praktikisht se pushteti i tyre është mbi shtetin. Çfarë mund të bënte Agron Tufa në rrethana të tilla dramatike për të ruajtur integritetin fizik, domethënë jetën e vet dhe të familjes së tij? Kur në letrën e tij të dorëheqjes, ai thotë se u gjend vetëm, sigurisht që ka plotësisht të drejtë. Por unë besoj se ka parasysh braktisjen që i bënë përballë rrezikut ekzistencial ata që i detyron ligji për ta mbrojtur dhe që paguhen me taksat tona për ta kryer këtë detyrë. Nuk besoj që ai ka pritur që ne, kolegët e tij të letrave e që pajtoheshim me veprimtarinë e tij si drejtor i Institutit për Studimin e Krimeve të Komunizmit, ta mbronim me trupat tanë. Do të ishte shumë naive dhe jo realiste sikur të mendohej një gjë e tillë.

Ai nuk ka qenë kurrë i braktisur nga një pjesë e madhe e elitës intelektuale të vendit. Përkundrazi, ka qenë dhe mbetet i mbështetur dhe i vlerësuar. Pra, çfarë mund të bënte ai në rrethanat dramatike për jetën e vet dhe të familjes? Zgjodhi të vetmen rrugë që i kishte mbetur: kërkoi mbrojtje nga një shtet tjetër për jetën e vet dhe të familjes dhe ku do të mund ta zhvillojë pa pengesa vokacionin e tij si njeri i fjalës dhe imagjinatës së lirë. Po punën e tij këtu për studimin e krimeve të komunizmit kush do ta bëjë, për sa kohë spartakët e Rilindjes janë ende plot me pushtet? Pikërisht këtë aspekt kishte parasysh poeti Bardhyl Londo, kur largimin e Agron Tufës e quajti tërmet. Po kush u trondit nga ky tërmet?

**** Marrë nga gazeta "Panorama"***

REAGIME

Adil Olluri:

Agron Tufa është njëri nga shkrimtarët më të rëndësishëm shqiptarë. Ai i dha letërsisë sonë vepra letrare, si "Dueli", "Mërkuna e zezë", "Tenxherja", "Gurit të varrit ia rrëfej", që për nga ana stilistike, tematike e narrative janë vlera të tejzakonshme letrare. Ai do t'i japë letërsisë sonë edhe vepra të tjera të arrira. Si lexues i vëmendshëm i veprës së tij letrare, them që jemi me fat që e kemi një shkrimtar të tillë. Andaj, lajmi se ai është larguar nga Shqipëria për të kërkuar strehim politik në Zvicër më pikëlloj shumë.

Shpresoj që në një kohë më të mirë, ai do të kthehet sërish në Tiranë dhe ky kthim të jetë triumfal. Agron Tufa i duhet Shqipërisë edhe me praninë e tij fizike. I duhet për ta vazhduar krijimtarinë artistike dhe veprimtarinë intelektuale në vendin e tij. Ndaj plotësisht mendimin me mikun tonë të përbashkët, shkrimtarin po aq të rëndësishëm sa Tufa, të nderuarin Virion Graçi, se "do të donim ta kishim këtu mes nesh, jo vetëm me shkrime". Shqipëria është më e fuqishme kur i ka pranë vetes njerëzit me integritet moral e profesional, si Agron Tufa.

Në bisedën tonë të fundit i thash se do të të shkruaj në çastin e parë që do të jem në Tiranë, për të pirë kafe dhe për të bërë llafe miqësore e letrare, si shumë e shumë herë. Kështu që, kafenë me të u dashka ta shtyj për një ditë më të mirë. U dashka ta shtyj deri në kthimin triumfal të Agron Tufës.

T'ju rikujtoj se aktiviteti i fundit letrar shqiptar që mori pjesë Agron Tufa ishte festivali i prozës artistike "FICTION FEST", që organizohet nga Qendra për Kulturë dhe Edukim "Sheshi", të cilën e drejtoj unë. Është privilegj të bashkëpunosh me Agron Tufën

Njashtu, është nder dhe krenari të kesh miqësi letrare me Agron Tufën.

Paç shëndetin, begatinë, rahatinë e pasosur për vete e për familjen!

U pafshim sa më shpejtë që do të jetë e mundshme!

Balil Gjini:

Trishtim i madh për këtë vend. Agron Tufa, njeri dhe shkrimtar i rrallë, e ka braktisur këtë vend. E ka braktisur sepse, siç thoshte në një nga statuset e tij, ndihej i kërcënuar mes sehirit të madh shtetëror.

Gjithë skota e kuqe e komunistëve iu turrën atij që, me një grup shokësh, u përpoq të nxirrte në dritën e diellit të vërteta kutërbonin era tmerr. Ndërkohë, skota të tëra sharlatanësh, puthatorë e lavire të pushtetit, flasin për demokraci dhe të drejta të njeriut. Turp! Turp! Turp!

opinion

Ikja e Agron Tufës duhet të tingëllojë si një këmbanë zgjimi

Nga **GAZMEND KAPLLANI**



Post Bunk'Art. Kjo eshte nje liste me emra dhe fotografi te drejtoreve te kampeve te punes dhe burgjeve te tmerrshme ku denohej elita dhe pjesa me e mire e kombit shqiptar per 45 vjet me radhe. Mes tyre edhe fotoja e drejtorit te Qafe Barit E.C.

Sot E.C. eshte qytetar Gjerman – dhe qe atje ka sulmuar dhe hedhur balte dhe ofenduar viktimat e tij.

Nje gazete e tere, pa teklif fare, ka mirepritur ne faqen e pare shkrimet e tij te gjata, delirante dhe cmirzeza. Kjo nuk ndodh ne vitin 1989, madje as ne vitin 1999. Ndodhi ne vitin 2019.

Disa nga dokumentet e Bunk'Artit jane nxjerre fale punes se Institutit te Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit. Sot ish-drejtori i Institutit Agron Tufa gjendet i vet-syrgjynosur ne Zvicer sepse i trembet te tashmes dhe te ardhmes per familjen e tij.

Nuk e di si matet frika e nje njeriu ndaj shantazheve dhe kanosjeve qe i behen nga persona me emer dhe pa emer. Dime qe personat me emer gjejne azil shpirtmadh ne gazeta per te artikuluar sulme denigruese, shantazhe, per te krijuar nje klime "lincimi" te nje personi ngaqe nuk jane dakort me idete e tij. Persona me emra qe kane gazeta per te botuar cdo lloj marrezie dhe kercenimi qe nxjerrin nga goja, kane pozita ne parlament, kane lidhje me struktura prane dhe rrotull pushtetit. Nuk e di, pra, si matet frika e nje njeriu ne nje klime te tille. Ajo eshte ceshtje personale e gjithkujt dhe si e tille duhet respektuar. Ata qe nuk e respektojne duket se mendojne qe eshte qejf i madh te marresh familjen dhe ti nenshtrohesh procedurave te dhembshme, per mos te thene poshteruese per nje intelektual, te azilit politik. Te mendosh ne kete menyre ose duhet te jesh krejt teneqe nga trute ose te jesh ithtar i cinizmit moral.

Ikja - le te urojme jo pergjithmone - e Agron Tufes duhet te tingelloje si nje kembane zgjimi, te pakten per te nxitur nje debat se "ku e lame e ku na mbeti". Nje debat per gjendjen e mjerueshme te dialogut publik ne atdheun tone. Me thoni nje vend tjeter te Europes Lindore ku ish-drejtore gulagesh denigrojne viktimat e tyre ne faqet e para te gazetave? Me thoni nje vend tjeter te Europes Lindore ku ish gjykues te regjimit, qe deklarojne publikisht krenarine si bashkepunetore te regjimit totalitar ulen dhe zgjidhen pa teklif ne Parlament, leshojne fushata denigrimi dhe lincimi moral kunder kundershtareve te tyre ideologjike me te njejten gjuhe qe perdornin edhe gjate regjimit totalitar?

Eshte ky nje vend qe toleron dhe mirekupton xhelatin qe keqtrajton perseri viktimen e tij te dikurshme, ndersa quan qesharak kerkimin e azilit nga nje intelektual si Agron Tufa, i cili as ka torturuar kend, as ka qene drejtor kampesh, as ka firmosur urdhera pushkatimesh dhe burgimesh por qe mbron idete e tij ne rruge paqesore– pavaresisht ne se dikush eshte apo nuk eshte dakort me menyren se si dikush mbron dhe promovon idete e tij. Madje pavaresisht nese dikujt i pelqen apo nuk i pelqen karakteri i Agron Tufes. Ketu kemi te bejme me ceshtje parimesh themeltare per nje shoqeri qe deshiron te jete e civilizuar, jo me thashetheme kafenesh. Mua personalisht frika e Agron Tufes me shqeteson tej mase. Ikja e tij me trishton shume dhe me problematizon per te tashmen dhe te ardhmen e ketij vendi.

Katedra e Studimeve Albanologjike Hidai Bregu ne Universitetin DePaul ne Cikago te cilen drejtoj do mbeshtese, promovoje dhe mbroje lirine e fjales dhe te hulumtimit te gjithe atyre qe perpiqen te kontribojne me seriozitet per pasurimin e kultures se dialogut, te kujteses dhe te vertetave, sidomos atyre "heretike", ngado ardhshin ato. Eshte detyra jone akademike, intelektuale dhe morale te shprehim mbeshtetjen tone per z. Agron Tufa. Te njejten mbeshtetje akademike, intelektuale dhe morale do shprehim per gjithkend behet shenjester e fushatave te lincimit moral dhe kanosjeve per arsye te ideve te tij/saj, qofte i/e djathte, i/e majte apo apolitik, qofshin njerez me te cilet idete dhe karakteret na perputhen ose jo.

Eshte detyre e te gjithe atyre qe merren me historine dhe kulturen shqiptare sot te krijojme hapesira per te promovuar ne menyre paqesore kete debat te dhembshem per historine tone, per te cilin kemi kaq shume nevoje. Te pakten ta promovojme ne qe jetojme jashte, meqenese ne Shqiperi duket se nuk ekziston ende siguria per nje hapesire te tille.

Duhet te gjithe te kontribojme qe te dalim, nje here e pergjithmone, nga bunkeri i erret dhe cnjerezor ku na futi regjimi totalitar...

REAGIME

Vetmia e Agron Tufës!

Nga **EMIN AZEMI**

Shkrimtari Agron Tufa iku nga shtëpia e tij dhe gjeti strehë dikund në Zvicër. Ai nuk u ndie sigurt më në shtëpinë e tij. U frikësua më tepër për fëmijët dhe gruan, se një ditë mund të ishin cak i ndonjë çmendurie kriminale.

Por, ajo që shqetëson më tepër, kur jemi te ky rast, është heshtja, ose reagimi i vonuar i shoqërisë shqiptare.

Heshtën institucionet që jetojnë nga fryma dhe shpirti i artistëve.

Heshtën shumica e shoqatave e asociacioneve të krijuesve e artistëve...

Por çuditërisht reaguan me vonesë edhe vetë shkrimtarët... Këta të fundit madje nuk ishin me Agronin atëherë kur ai mbeti i vetëm në përballje me kopenë e cubave të dalë nga inkubatorët e (neo) komunizmit.

Çka është kjo ndërgjegje që aktivizohet vonë e shkrimtarëve artisitëve të Shqipërisë dhe pse ata bëhen gjallë vetëm sa për t'u dukur?! Vetëm sa për të hedhur firmën në reagimin e radhës?!

Po të ndodhte në Poloni, Çeki, Hungari, Suedi, kjo çka ndodhi me Agron Tufën në Shqipëri, që moti do të ishin shkarkuar (dorëhequr) disa përgjegjës zyrtarë, ishin bllokuar nga shkrimtarët dhe artistët dyert e Parlamenti, Qeverisë dhe institucioneve tjera. Reagimi atje madje do të ndodhte shumë më heret, atëherë kur shkrimtari ka nevojë më së shumti të ndjehet se nuk është vetëm.

Duhet ta themi, pra, pa frikën se po i hymë në hak dikujt, se Agron Tufa mbeti vetëm, atëherë kur kishte më së shumti nevojë për shumëfishim zërash që akuzojnë epokën e errët të komunizmit, për mbrapshtitë që ua ka bërë shqiptarëve.

Edhe në kohën e Stalinit internoheshin shkrimtarët, kurse zhdanovët mprehnin tehun e kritikës kundër 'reaksionarëve' në komunitetin e letrave, por tani pse frikësohemi kaq shumë nga Gullagët imagjinarë që i projektojmë për të justifikuar mosreagimin tonë kolektiv.

Agron Tufa ishte mirë me statusin e tij prej pedagogu dhe shkrimtari dhe ai gjithë këtë kauzë morale e intelektuale nuk e ndërtoi duke i shtu mirëqenies së tij ndonjë favor plus. Përkundrazi, ai me angazhimin e pandalur viteve të fundit, veç sa e prishi komoditetin e tij dhe të familjes, por a u desht që një shkrimtar i kalibrit të Tufës të bëjë gjithë këtë rrugë gati vetëm....

Vetmia e Agron Tufës një ditë do të bëhet leit-motiv i ndonjë subjekti letrar/filmik, por ajo që e shëron plagën e një shoqërie është nevoja për një katarsis moral, i cili si duket ende nuk i ka ndodhur shpirtit tonë konformist...

Për lirinë e Agronit dhe humbjen e lirisë tonë

Nga **BUJAR KAROSHI**

1.

Kjo foto është në një nga netët e fundit në Tiranë me Agronin dhe Elvanën. Ndenjëm deri vonë – si kurrë më parë - dhe nuk ndaheshim dot. Pas një darke me poeten Kira Mantsu, ku kujtuam e folëm për poetët më të mirë bashkëkohorë europianë, morëm rrugëve të Tiranës për të gjetur një kafe... Kafe në mesnatë? Asnjërit nuk i pihej kafe, por askush nuk thoshte që duhet të ikim në shtëpi. Me sa duket ishin orë bisede e malli mes "miqve më të mirë, për zemër, që na i ka falë Zoti", siç do të shkruante një natë më pas në dedikimin e librit të ri të sapobotuar...

Kontaktuam mesnatën e 26 nëntorit, pas tërmetit, për t'u pyetur sesi po e përballonin situatën...

"Jam në merak për ju, - tha, - sepse ne jemi jashtë shtetit".

Kur mora vesh lajmin se kishin kërkuar familjarisht azil politik, isha duke lexuar tregimin e radhës nga libri "Kur këndonin gjelat e tretë"...

2.

Prej asaj dite kam dashur të shkruaja diçka, në shenjë solidariteti me Agronin, Elvanën dhe fëmijët e tij, por fjalët nuk i gjeja dot. Prej gati një viti dhe veçanërisht nga 1 prilli, sulmet ndaj tij personalisht, për shkak të detyrës (e theksoj: vetëm për shkak të detyrës) ia kishin prishur qetësinë. Për t'i treguar një shenjë solidariteti sa herë kisha pak kohë, e pinim një kafe së bashku. Një kafe që ftohej, sepse na rrëmbente biseda, rreth punës, sulmeve ndaj tij, por edhe për sigurinë e familjes dhe fëmijëve. Sidomos ai ishte i shqetësuar për ta, pasi Agroni, ndryshe nga "ajka" e pushtetarëve tanë gjatë këtyre 20 viteve, i shkollon fëmijët e tij në shkolla publike, jo në ato privatet, ku paguhet siguria më shumë se mësimdhënia.

Çdo herë që e takoja, mësoja prej tij, se ai ishte gjithmonë e me më pak shokë në misionin e tij. Në detyrën e tij, më saktë.

"A se lë fare atë punë? – i thashë njëherë? - Pse ore, ti i vetëm do t'ia dalësh fitimtar kësaj lufte?"

"Nuk po bëj luftë, - më tha. - Po bëj detyrën që më ngarkon ligji. Po të mos e bëj, atëherë po këta "monstra" do më turren e do më sulmojnë se pse nuk po zbatoj ligjin".

"Sepse ata dinë të trashin vetëm shtresat e gënjeshtrës" (1)

3.

Këto ditë kam lexuar çdo gjë që shkruhet për të. Edhe ata që kanë shpikur a shpifur kundër tij, me një gjuhë armiqësore që edhe regjimi i Enver Hoxhës do t'i kishte zili. Me një gjuhë armiqësore që e has në vëllimin e fundit me rrëfime të Agronit "Kur këndonin gjelat e tretë..."

Një pjesë e komenteve janë rrekur të shpjegojnë se "ikja" apo "arratisja" e tij ka qenë për shkaqe familjare dhe se ai është ndjerë i rrezikur e i frikësuar. Në fakt, unë mendoj se ai ishte i rrezikuar më shumë prej "tradhtisë" që atij i bënë institucionet e këtij vendi, qeveria dhe institucionet e drejtësisë, opozita dhe "miqtë e tij të idealit", bashkëvuajtësit dhe të persekutuarit e regjimit komunist.

"S'kam asgjë personale me ty, Atë. Është thjesht çështje detyre... (2)

4.

Agroni gjeti mënyrën për të ekspozuar para opinionit vendas dhe europian rrezikun që na kanoset ne që jetojmë këtu nga një e ardhme pa liri, sepse institucionet e quajtura demokratike të këtij vendi, në fakt, janë kthyer në institucione të dhunës.

(a) Qeveria dhe parlamenti: Gjatë gjithë këtij viti individë të veshur me pushtet e kanë



Agroni gjeti mënyrën për të ekspozuar para opinionit vendas dhe europian rrezikun që na kanoset ne që jetojmë këtu nga një e ardhme pa liri, sepse institucionet e quajtura demokratike të këtij vendi, në fakt, janë kthyer në institucione të dhunës.

sulmuar Agronin me fyerje, sharje, shpifje, duke mos kursyer asgjë nga fjalori kriminal. Dhe kjo qeveri dhe kjo mazhorancë nuk mori guximin t'i thoshte ndal këtij revanshi kriminal të veshur me pushtet. Kjo mazhorance përjashtoi një deputet nga radhët e saj thjesht se ai guxoi të kritikonte një shef policie, por nuk e ka gjetur akoma guximin, edhe sot, të largojë nga radhët e saj një deputet që kërcënon një qytetar të këtij vendi "se do të bëjmë të pamundurën që edhe atje ku ka kërkuar azil politik të mos gjejë vrimë ku të futet..."

"Heq pushkën prej supit dhe më merr shenjë. "Shaka do të jetë", mendoj dhe e ndjek krejt i qetë, pa treguar asnjë grimë frike. Deri në grimën kur papritmas buçet krisma.(3)

(b)Opozita: Gjatë gjithë kësaj kohe sulmesh ndaj njërit prej institucioneve të pavarura që merret me studimet e krimeve të diktaturës, opozita nuk është treguar asnjëherë instituconale në reagimet e saj. Përveç disa zërave brenda saj të vetmuar, që kanë dhënë deklarata personale, institucionalisht ajo nuk mori asnjë nismë publike për t'i thënë ndal këtij revanshi. Ndërsa "opozita" e re në parlament, ndërkohë që në foltore diskutonte e mbronte Agronin dhe ISKK, kur erdhi puna te vota, e hodhi kundër. Dhe pastaj kërkonin rrugë miqësore për të pirë një kafe me Agronin dhe të shpjegonin se "nuk e kanë personale, por ashtu e donte puna"...

"... "kuajt" kanë mbaruar kush një e kush dy universitete në Europë. Por janë të rrallë "kalorësit" që kanë mbaruar klasën e katërt fillore". (4)

(c)Të persekutuarit politikë: Agroni dhe ISKK janë tradhtuar nga ai brez shqiptarësh dhe pasardhësit e tyre që vuajtën në burgjet e regjimit komunist. Ata nuk zhvilluan qoftë edhe një proteste të vetme ku të kërkonin të ndalonte ky sulm ndaj Agronit dhe familjes së tij. Por, ndoshta nuk kishin mundësi, pasi kanë zënë radhët në zyrat e gjendjes civile për të marrë certifikatat familjare që vërtetojnë trashëgiminë nga të vdekurit e të vrarët në burgje komuniste dhe pastaj nxitojnë te zyra tjetër për të marrë këstin e radhës.

"Para meje qëndron Irena. Vështrimet tona ndeshen. Nëse më flet, kjo do të jetë hera e parë... në këto rrethana... Befas ajo ngrihet në majë të gishtave, barazohet me nivelin e syve të mi dhe... më pështyn fort në fytyrë. Madje është e vetmja, që shoqëron pështymën e saj me një fjalë të artikuluar kumbueshëm në rrethin e përsosur të dhëmbëve të saj të dëbortë:

- Re-ak-sio-nar!

Pështymat e tjera s'më bëjnë më përshtypje. (5)

5.

Po e mbyll me kaq për sonte. Duke i uruar Agronit, Elvanës dhe fëmijëve gjithë të mirat.

Dhe duke ju lutur, të luten për ne. Të luten për Atdheun tonë.

"Ju nuk do të vdisni, Atë Josif?

- Jo, biri im... Ju do të dilni! Jeni të rinj! Do të jetoni të lirë.. Veç mos e shani, mos e përbuzni e mos e urreni Atdheun tonë të shkretë. Ai sot gjendet në ditë të zeza. (6)

Shënim: Citimet e këtij shkrimi janë marrë nga tregimet e përfshira në librin e ri të Agron Tufës "Kur këndonin gjelat e tretë", botimet Onufri, 2019.

(1) Nega Totum!
(2) Kur këndonin gjelat e trete.
(3) Varri i dyqindtë
(4) Argëtimi
(5) Pështymat
(6) Vdekja e Atë Josif Papamihalit

LIBRI I RI



Prozat e këtij libri nuk kanë të bëjnë me përkufizimet teoriko-akademike apo shkollareske mbi zhanret (kufitare apo jokufitare). Ato janë autorrëfime, përshkrime, skena e situata, monologje në çastet kritike të minutës fatale para fytyrës së vdekjes. Qëllimi im ka qenë t'u jap zë këtyre hijeve tragjike, të cilat mbushën skenat mortore përgjatë ritualit satanik të flisë në "meshat e zeza" që bënte diktatura komuniste me adeptët dhe xhelatët e saj të përzgjedhur.

Kështu, lëndë e këtij libri janë zërat e pengjeve të atyre fëmijëve, adolleshentëve, pleqve e burrave në kampet mortore të internimit me tela me gjemba, në qelitë e paraburgimit apo të hetuesive, sikundërse në burgjet e kamp-burgjet e Shqipërisë komuniste. Kjo "zhaurimë e përtejvarrit" përbën polifoninë e vajtimit prej vdekjesh të dhunshme të kainiadës sonë me dramën e vëllavrasjes e gjenocidit brendashqiptar, edhe pse në kohë paqeje.

Historitë e rrëfyera këtu janë një kompromis mes trillit (fiction) dhe faktografisë së vërtetë, të marra nga ngjarje reale përmes videoregjistrimeve me të mbijetuarit, por edhe nga veprat memuaristike të autorëve të ndryshëm. Prerjet e episodeve kritike për jetën e personazheve brenda një kornize situative artistike, janë mbushur me "përjetime intensive", njësoj sikur të ishim ne në vend të tyre. Një pjesë e vogël e teksteve të rrëfimeve kanë referenca të drejtpërdrejta nga vepra të caktuara memuaristike, dhe përcillen në fund të librit me përmendjen e burimeve.

Sot apologjetët dhe simahorët e diktaturës janë shtuar shumë. Ata ndjejnë hapur mbështetje e nxitje politike të shpërthejnë në histeri, përderisa qën-drimi shtetëror ndaj krimeve të komunizmit është indiferenca e plotë dhe mungesa e çdo lloj ligji është në fakt, miratimi në heshtje, që autorët e këtyre krimeve, xhelatët e vrasësit t'i paraqesin si heronj, ndërsa bëmat e tyre makabre të konsiderohen të lavdishme. Kur shteti, kur organet ligjzbatuese, kur elitat politike dhe indiferenca shoqërore me topitjen e përgjithshme të vetëdijes sonë nuk qëndrojnë as në shkallaren minimale të ndërgjegjes dhe nuk kihet, së paku, keqardhje e mëshirë për mijëra të ekzekutuar të pagjetur ende, që të prehen në një varr e të ndizet një qiri, puna e dëshmisë me format e larmishme të saj, është rezistenca e vetme në këto kushte, për të mos u njëjtësuar të gjithë me krimin e pandëshkuar.

Shi për këtë situatë të turpshme e ka fjalën Shekspiri kur thotë: "O turp, o turp, ku e ke skuqjen!".

cyan magenta yelloë black

Tre dimensionet e tim xhaxhai dhe një kauzë e humbur për të tjerët

Nga **ALBAN TUFA**



Hekuri, thonë rrifet sa është i nxehtë, por të nxehtë, e rref veç ai që di se ku ta kapje, ku ta mbështesë, si t'i bjerë, sa t'i bjerë, si ta shtyjë, qysh ta kthejë, e së fundmi, kur ta shqimë në ujë, pra duhet një esnaf. Por meqë unë nuk jam edhe aq esnaf, thash të ftohet fillimisht hekuri e mandej, pasi i ranë të gjithë me ç'mundën, ta kap edhe unë kur të dua e t'i bie sa të dua, pavarësisht se forma është e vështirë për t'iu dhënë.

E shoh detyrë morale, familjare dhe qytetare t'i them edhe unë dy fjalë për ikjen e Agronit. E çka mandej nëse ia fus kot, aq më tepër kur nuk po ia ndjen askujt për çfarë flitet nalt e poshtë?! Meqë më pat thënë dikur "Për ty xhaxh, i djeg të gjithë", mendoj se ma fal ndonjë gabim nëse e bëj.

Agronin (tim xhaxha), mund ta ndaj në tre dimensione, në tre pika të mia vështrimi.

Le t'i shohim me rend:

Së pari, im xhaxha (njësoj si im atë) prej kur qe fëmijë përçmohej, përbuzej nëpër fshat e përtej sepse ishte bir gulaku, dhe sepse i dinte vjershat përmendësh, madje edhe nga ata fshatarë të cilët përmas viteve 90' nalt e poshtë u mburrën me faktin që ai (tashmë me një rol tjetër) ishte nga fshati i tyre. Në këtë frymë u rritëm edhe ne, nipërit, duke urryer me gjak sistemin komunist. Ky ligjërim na ndiqte përditë në vegjëli dhe në netët pa drita, të cilat ishin të mbushura me histori me oficerë, me kampe, burgje, mungesë buke, vdekje, zi, përbuzje, etj.

Isha i vogël kur im xhaxha kthehej nga Moska. Përherë na sillte nganjë dhuratë, nuk harronte kënd. Ndër to më të shumtat ishin librat, duke imponuar ndoshta me vetëdije letërsinë dhe leximin mbi ne.

Mbaj mend shumë mirë kur vinin njerëz nga i gjithë fshati për të takuar Agronin, tashmë prej kohësh edhe ata që e përbuzën dikurë. Siç mund ta kuptoj tashti, servilzmi qëndronte te ata njerëz siç kishte qëndruar atë kohën e Vjetër, por tashmë pa rregulla, pa kahje e pa përzgjedhje. Kur kthehej Agroni, ishte ngjarje jo vetëm në fshat, por edhe në qytetin e Peshkopisë, sigurisht ndër ata njerëz që kishin sadopak lidhje me kulturën.

Ndërkohë, pasi u rrita dhe iu afrova sadopak çështjeve të letërsisë, gjetkë nëpër ambjente takoja njerëz, në Dibër e Tiranë, dhe sapo tregoja mbiemrin, fill niste pyetja "Çfarë e ke Agronin?", pastaj si me breshëri fjalia e gjithëheshme "E kam shum mik të mirë". Sigurisht, që prej asaj kohë nuk i besoj më kësaj fjale.

Në një letër të hapur që ia nisa në prill tim Xhaxhai, fola për grazhdin dhe kokën e kolegëve të tij të cilët e kanë zhytu në grazhd dhe nuk mehen kurrë mbi tagjinë e tërshërtë, e kjo nuk i lë të shohin ç'po ndodh përrotull tyre.

Ata miq nëpër holle u terën, avulluan, ndryshuan grazhde, ndryshuan kahjet e tërheqjet, ndërkohë im xhaxha është i injëjti, bash siç e mbaj mend kur kthehej nga moska, veçse tash më i thinjur, më në peshë, dhe sigurisht pa mjekërr. E gjithë shkuara e tij, nisi të ndërtojë një ndër shkrimarët më të fortë të këtij shekulli në letërsinë shqipe.

Së dyti, letërisa e tij që në zanafillë ruan një koherencë që lidhet me krizën identitare të shqiptarëve ditë e sotme, kjo e ndikuar drejtpërdrejtë nga regjimi komunist në vendin tonë. Kështu ai u bë një ndër shkrimtarët më të vlerësuar në vendin tonë, i lexuar nga pjesë e madhe sepse dashuronin manierën e tij krijuese. Një pjesë tjetër e lexonin sepse urrenin që nuk kishin manierën e tij krijuese. Një tjetër pjesë për tu munduar të arrijën të shkruajnë sadopak ngjashëm me të. Ndërsa një pjesë krejtësisht tjetër pikërisht se nuk do mund të shkruanin kurrë si ai.

Kështu pas dështimit për ta mposhtur Agronin fëmijë (njeri), u pa mundësia e mposhtjes së shkrimtarit. Kështu pas dështimit me sukeses të madh të kësaj ëndërre, shpresuan për të mposhtur Agronin si idealist (antikomunist).

Para pak ditësh, në aeroportin e Athinës në ulëse të shumta kishin lidhur libra të poetëve grekë. Teksa po shfletoja një libër me poezi të Odisea Elitis mendova: more, si ka mundësi që të tjerët i lidhin poetët e tyre që të mos i'ua marrin, ndërsa ne i degdisimi me kërcënime nëpër botë.

Së treti, sigurisht që paralelisht me idealet e një qytetari thellësisht të angazhuar, rriten edhe realietet e qenieve që parazitojnë. Thoshte im gjysh shpesh, që "i papuni merret veç me punët e tjerëve", si edhe "i keqi ka llafe".

Diku lexova që Agroni, me ikjen nga Shqipëria është gjunjëzuar para idealeve të veta, pra kundra komunizmit.

Në Dibër është një shprehje "I ngopmi të untin (uriturin) nuk e njeh". Pra nëse dikush do të marrë përsipër të flasë për ideale, duher t'i ketë disa të tilla, në të kundërt leh në tym, ose së paku të jetë i vetëdijshëm që nuk ka asnjë të tillë në veten e vet.

Kështu ikja e Agronit ka dy këndvështrime të ndryshme që çojnë në një pikë: zhgënjim.

Nga këndvështrimi i atyre që e mbështetën: del në pah thërrmimi i çdo pretendimi demokracie dhe thërrmimi i çdo ideali antikomunist apo zëri opozitar. Tashmë nuk kanë me ç'ta ngushëllojnë veten, sepse statuset në facebook nuk bëjnë kurrëfar ndryshimi.

Ndërsa nga këndvështrimi i atyre që urryen (edhe në heshtje): do iu mungoje pasqyra ku herë pas here panë veten. Nga ana tjetër për ekzistuar duhet të njohësh joekzistencën, pra për të qenë duhet të mos kesh qenë dikur. Si e bardha që qëndron ballë të zezës, si e keqja që për tu vetëpërkufizuar ka nevojë për të mirën. Pa Agronin nuk do dinë më të përkufizojnë veten. Ata i irriton më së shumti mungesa e së kundërtës për të vënë në bold veten e tyre.

Gjithsesi ekziston edhe "Shumica e heshtur", ajo pjesë që rron veç për një copë bukë, dhe për të, është e gatshme të bëjë çmos.

OPINION

Shqipëria, vendi i vetëm ish-komunist që nuk e kemi ba ndamjen nga e shkuemja diktatoriale

Nga **ILIR SECI**

Para disa ditësh shkrimtari Agron Tufa kërkoi azil politik në Zvicër. Siç u mësue nga deklarimi i tij dhanë publikisht, ai e ndërmori këtë hap sepse i kërcënohej jeta jo vetëm atij në person por edhe pjesetareve të familjes, bashkeshortes dhe pesë fëmijëve që kanë. Zotni Agron Tufa deklaroi se kerkonte azil si person i kercenuem per shkak te detyres si Drejtori i Institutit të Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit (ISKPK). Kjo gja mendoj se asht nji çashtje serioze, sepse ka kerkue azil politik nji funksionar i administrates shteterore të Republikes së Shqiperise, vend qe jo me larg se në muejin Tetor 2019, kerkoi që ti hapeshin negociatat me Bashkimin Europian, me shpresën per anetaresim aty... Kerkesa e azilit nga ana e Drejtorit te ISKPK do mbetet nji sy i nximë, nji buhavitje në fytyrën e shtetit shqiptar per sa kohë qe institucionet e shtetit nuk reagojnë per me mbajtë qendrimin e duhun. Sepse nji vend në të cilin drejtuesit e institucioneve kërcënohen me jetë, jo vetem qe nuk ka pse shpreson per anetaresim ne BE, por e ka te humbun edhe davanë e demokracisë. Nji nga parimet baze te demokracise funksionale asht transparenca, në demokraci ka shtet te se drejtes që asht transparent ne tanë proçeset...Në nji demokraci të vërtetë kjo do thjeshtohej keshtu :

-"Nji palë jane gabim në këtë rast, ose Shteti Shqiptar ose zotni Agron Tufa."

Të mesme nuk ka ketu...

Lajmi i kerkeses per azil nga nji drejtues Institucioni deshmoi edhe njihere mangesite e shumta qe ka shoqnia shqiptare në perballje me realitetin si dhe ne qendrimin ndaj ngjarjeve. Sot falë rrjeteve sociale dhe medieve online, asht e lehtë të shihet reagimi masiv i shoqnise...Ne nji mase te madhe kjo kerkese per azil u paraqit si kerkesa e shkrimtarit Agron Tufa dhe jo si kerkesa e drejtorit të ISKPK!? Ka nji diference te madhe...kjo huti në rrjete sociale nuk shkaktohet pa qellim nga mediet, synimi asht te shmanget vemendja nga shkaku pse u kerkua azil ma së pari. Dhe shkaku asht qendrimi ndaj periudhes se diktatures enveriste. Siç kam mujte me pa ne artikujt e botuem vazhdimisht ne shtypin periodik, gjate ushtrimit te detyrës ne këtë Institut z.Tufa u perplas me segmente te caktueme te pushtetit aktual që mbrojnë publikisht periudhen kriminale te diktatures enveriste. Në detyren e drejtorit te Institutit Agron Tufa ishte vokal ne medie duke shqiptuar fakte qe deshmonin se Shqipnia e mbas vitit 1991, jo vetem qe nuk asht shkepute nga diktatura, por ne fakt mbahet peng prej saj, deklarime të bamê publikisht, siç ishte ky :

-"Janë rreth 3 mijë ish-shefa të Sigurimit në krye të institucioneve dhe të administrates sot.".

Siç kemi verejte nga shtypi mbas deklarimeve te tilla nisi nji ndermarrje ligjore që filloi para nji viti ne dhetorin e kaluem, ku bazue në nene te ligjit nr. 10242, te ISKK, kerkohej qe çdo institucion te shprehej nese kishte ne strukturat e veta punonjes qe kishin mbarue shkollen e Larte te Ministrise se Punëve te Brendshme, profili "Sigurim". Me perjashtim te dy institucioneve, te tjerat, jo vetem qe refuzuen kerkesen, por u bashkuen ne sulme dhe kercenime ndaj ISKK. Kjo perplasje asht produkti i nji gjendjeje te pergjithshme te krizës së shoqnisë shqiptare, krizë që nis nga Individi e deri te Institucionet. Kjo krizë që deri tash asht maskue e mshefë mbas termit demagogjik "periudha e tranzicionit", asht ne fakt kriza e mosballafaqimit me të verteten e hidhtë të diktatures. Shqipnia asht ne krizë sepse nuk asht nda nga e shkuemja diktatoriale, te inkriminuemit jane në pushtet, nuk asht vendosë drejtesia e per pasojë nuk jane qetesue ndergjegjiet.

Po te bajme nji krahasim me vendet e tjera te ish-Europes Lindore ne jemi vendi i vetem ish-komunist qe nuk e kemi ba ndamjen nga e shkuemja diktatoriale, nuk kemi denue krimet dhe nuk kemi realizue transparencen e dosjeve te Sigurimit diktatorial. Per pasoje jemi shnderrue ne nji vend qe rri e troket ma së koti në dyert e BE-së. Instituti i Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit u mundue me na kallzue se boja qe ia kane lye per siper ngrehines se diktatures asht thjesht nji varak "demokratik" siperfaqesor dhe se asgja nuk ka ndryshue ne realitet, as jane denue krimet e diktatures, as ka pase ndergjegjesim dhe distancim moral nga ajo e shkueme...Perkundrazi nga kerkesa per azil e drejtorit te ISKK, z.Agron Tufa u pa kjarte se spartak brahot dhe lakenjte e tjere glorifikues te diktatures, vetëm sa u inkurajuen ma shume ne revanshin e tyne per restaurim te neo-komunizmit maskue nen aureolë e "Lavdise se Luftes Antifashiste Nacionalçlirimtare"...Nji tjeter leksion deshtimi në proçesin e "dekomunistizimit" te shtetit ma stalinist ne Europe që vegjetoi deri me 1991. Nji tjeter deshtim per ata shqiptare qe aspirojne per demokraci në Shqipni mbas ndryshimeve te vitit 1991, deshtim sepse me perjashtime te rralla nuk u gjenden ne perkrahjen e z. Agron Tufa kur sulmohej publikisht dhe endej dyerve te gjykatave i detyruem me shkue aty per me mbrojte te drejtën e perbashket, per me mbrojte shtresen e perndjekun në kohen e diktatures...

Rruga e Arbërit nr. 163

REAGIME

Unë kam qenë dhe jam me Agron Tufën!

Nga prof.dr. **ADEM BUNGURI**

Unë kam qenë dhe jam me Agron Tufën! E kam njohur qysh kur ishte nxënës në gjimnazin e Kastriotit. Kur punonte gjithë ditën në fushë dhe shkollën e vazhdonte natën. Se hienat e komunizmit nuk e lejonin të vijonte mësimet ditën, si gjithë të tjerët! Megjithatë, me një vullnet të hekurt dhe etje të pashterrshme, ai studionte shumë dhe përpinte çdo libër që i binte në dorë. Sot Agron Tufa është më tepër se një institucion kulturor, është një erudit me dije të thella shkencore, është një aset i çmuar dhe diamant i kulturës dhe historisë sonë kombëtare, është një monument i saj. Për më tepër, flet vepra e tij e gjithanshme, flet trimëria dhe guximi i tij për të zbardhur krimet monstruoze të kmerëve të kuq!

Nuk po përmend në këto pak rrjeshta arritjet e shumta letrare dhe studimore që me kohë i kanë kaluar kufinjtë e ngushtë të Shqipërisë. Për të gjithë fosilet dhe rreptilët e komunizmit sllavo-ortodoks që ende frymon, po përmend vetëm një shkrim studimor të Agron Tufës mbi Kosovën të titulluar "Fallsifikimi i historise-shkas për spastrime etnike" botuar në shtypin rus në mars 1999 dhe ribotuar në "Rilindja Demokratike" në numrin e datës 4 korik 1999: shkrimi është botuar me titullin: "Agron Tufa-shqiptari qe shkaktoi termet ne shtypin rus". Pas botimit të këtij artikulli në revistën "Tatjanin denj", kryeredaktori i saj u shkarkua nga puna, per "simpati" ndaj shqiptareve, ndërsa autorin e saj, studentin Agron Tufa për këtë arsye, u munduan ta përjashtojnë nga Instituti "Gorki", masë që u zbut në "paralajmërim përjashtimi". Këtë studim përmbajtësor nuk e ka hartuar Akademia e Shkencave (që do të ishte dashur ta bënte (!), por një student letërsie i Institutit "Gorki"! I lindur dhe i rritur në një familje të thjeshtë patriotike dibrane! Në fshatin Sohodoll të Dibrës së Poshtme, një fshat me rrugë të shtruara me kalldrëm dhe avlli të lyera me gëlqere, që sipas Hahnit(1864), i ngjante një qyteti. Që bashkë me fshatrat e tjerë të krahut lindor të Drinit të Zi, ishte djegur 3 herë nga serbët në vitet 1913-1921! I mëkuar që në vogëli me dashuri të pamasë për vendin e tij dhe tokën e të parëve! Le ta lexojnë dhe rilexojnë atë të gjithë patriotët" e ppvve dhe trustit të lulelakrës dhe të shohin njëherë të vetme veten në pasqyrë, në se u ka mbetur ende ndonjë cep i pathyer! Edhe të gjithë meskinët, cinikët dhe gjithollogët, që duhet të skuqen kur përmendin emrin e Agron Tufës! Edhe ndonjë shkrimtar i vetëshpallur "disident", që në kohën e diktaturës mbante poste të larta në aparatin shtetëror! Të gjithë ata, që me bëmat e tyre lirisht do të përfshiheshin në kategorinë sociale të turpit, krijesë e ppsh,"homo albanicus"!

Për të gjithë ata, edhe një poezi një poezi të Agronit të vitit 1988:

I ndiej ca sy tinëzarë pas shpine...
I ndiej ca sy tinëzarë pas shpine
që më gjurmojnë në fshehtësi,
që i janë qepur rrugës sime
si Mefistofeli - qen' i zi.
Gjithë ç'kam bërë dhe bëj përditë,
ata e tjerrin fije-fije;
trillojnë, përsosin ligësitë
dhe m'i lidhin rrugët nyje.
Por ëndrrën që ngroh - frymë e shpirt,
askush s'do mundet të ma presë;
atë s'e ndryjnë dot sytë tinëzarë
në laboratorët e tyre të zes...

histori

Fallsifikimi i historisë

Nga **AGRON TUFA** *

Ka qene vere e vitit 1997, kur autorin e ketij shkrimi e solli rasti ne Ljubljane (Slloveni), dhe ne nje hotel-restorant jo larg aeroportit, takoi per here te pare ne jete, moshatarin e tij serb. Quhej ky serb, Zoran. Mbremja qe e qete, dhe salla e restorantit ku qeshe ulur, qelloi krejtesisht e zbrazet. Djaloshi qe sapo hyri iu drejtua si me medyshje tavolines sime, pershendeti serbisht, e pasi mori prej meje nje gjest ftues, u paraqit, nderkohe qe zinte vend karshi meje ne tavoline. Une i ofrova nje gote vere, dhe ai e pranoi ate me kenaqesi. Tha se kthente me pushime nga universiteti i Kelnit, por rusishten e fliste mire, pavaresisht theksit serb. Se pari, desha te flisja me te per poete e prozatore te njohur serbe - Branko Radicevic, Desanka Maksimovic, Danillo Kish, Millorad Pavic etj. Pot, ajme, kuvendimi yne s' qe i thene. Me te marre vesh nacionalitetin tim, Zorani s'mundi me ta fshehe irritimin e vet. Fytyra iu shtremberua nga zemerimi, sapo shqiptova emrin e qytetit tim - Peshkopia. Se pari s' arrita ta kuptoj dot arsyen e ndryshimit aq te menjehershem te gjendjes shpirterore te bashkbiseduesit tim, ngase biseda jone qe ende mjafte e shkurter, dhe asnje fjale lenduese nuk qe leshuar. Sidoqofte, gjithshka u be e qarte. "E dini si, -me thote Zorani, - im gjysh mbeti i vrare pikerisht ne qytetin tuaj, ne gusht te vitit 1920. Ekziston ne shtepine tone veçse fotografia, kurse varri ..." Per mua kjo qe krejt e papritur dhe ndjeja te me përfshinte ngadale nje lloj fyrje e erret. "Po, - iu pergjigja, - me vjen vertet keq ... Dhe im gjysh ne ate lufte la krahun e majte. Serbet atehere vepruan mizorisht: tre here e dogjen krahinen tone dhe masakruan çnjerezisht gjithe banoret". Me te thene keto, mu krijua nje ndjesi diskonforti, dhe heshta. Zorani gjithashtu nuk pergjigjej, veçse kerciste gishterinjte mbi tavoline,e se mbranmi, u ngrit nxitimthi dhe doli duke u pershendetur ftohte e duke lene ne tavoline goten e veres se papirë.

* * *

Kur konfrontimi ndereteknik ne Kosove vitin e kaluar mberriti pikun e vet me te tmershem, dhe rreziku i nje lufte te trete qe me se real, atehere Evropa u be e vetedijshme per krimin e 1913-es, kur gjysmen e territoreve shqiptare i ndau nga shteti ame duke ia dhene Jugosllavise. Evropa u vetedijesua me ne fund, vetem atehere, kur serbet po e shnderronin Kosoven ne nje kasaphane: Nuk do permend ketu perpjekjet e shumta per zgjidhjen e konfliktit ne rruge paqesore - nje nga perpjekjet e fundit, ajo e Rambujese, dha veçse nje rezultat logjik, te parashikuar prej kohesh, dhe kush i ka ndjekur zhvillimet e bisedimeve, ka kuptuar vetem se nje gje: marreveshja e shqiptareve me serbet, eshte po aq absurde, sa ç' qe dhe ajo mes serbeve dhe sllloveneve, kroateve dhe boshnjakeve, te cilet vecse me forcen e armeve arriten te shkeputeshin nga ajo

Jugosllavi, e shnderruar ne nje ferr serb per nacionalitetet e ndryshme.

Ne momentet e tashme Serbia eshte perfshire nga ethet e nacional-fashizmit kurse Miloshevici i eshtë vene misherimit te endrres se vjeter te careve serbe, per ta bere Kosoven toke serbe. Për permbushjen e ketij deliri shpenzohen te gjitha mjetet e mundshme te shovinizmit praktik gjer tek falsifikimet e abstraguara te nje historie qe kurre s'e kane pasur. Dhe prandaj pra, kur ne Rambuje vazhdonin bisedimet, une, sikurse dhe shqiptaret e tjere, nuk shpresoja me, ne asgje. Dhe para syve s' di pse me rrinte gota e papire e veres, qe la ne tavolinen time moshatari serb me emrin Zoran.

* * *

Nese do pyesesh sot cilindo qytetar rus, se ç'kerkojne te arrijne serbet ne Kosove, kur populllsia e ketij territori perbehet prej 95%' shqiptare etnike, - pergj igjen çdo rus e ka ne maje te gjuhes: "Po Kosova, dihet, eshte djepi i kombit serb". "Ne Kosove - serbet kane luftuar me turkun, aty gjenden tempujt e lashte te besimit serb ...".

E verteta eshte, se pikerisht per hir te ketyre "tezave", serbet e shnderruan Kosoven ne nje thertore te pergjakur.

E supozojme, se Kosova na paska qene djepi i kombit serb! - porse ne kete djep tashm'e gjendet foshnja shqiptare, dhe ia vlen valle te mbysesh foshnjen ne emer te shpetimit te nje fare djepi te mjere?

Nese, kjo nuk eshte asgje. tjeter,veçse ana etike e çështjes dhe secili eshte i lire te gjykoje në pershtatje me ndergjegjen dhe vlerat e moralit personal, - atehere serbet, ashiqare,e kane bere tashme konkluzionin e tyre: ata i jane perveshur mbytjes se kesaj foshnje. Ne pajtim me nje logjike te tille, pjesa dermuese e kontinentit Latino- Amerikan, SHBA, Kanada etj, duhet t'i braktisin territoret e tyre, perderisa ato dikur kane qene populluar nga indigjenet, dhe ke mund të quash djep te fiseve indigjene.

Ja dhe nje tjeter shembull: maqedonet nuk kane te drejte te jetojne aty ku jane, perderisa territori i tyre i sotem ka qene banuar dikur nga popujt greko-ilirefoles, nga ilirefoles, dhe aspak nga sllavet ...

Heret a vone te tilla falsiflkime japin frytet e veta duke hyre ne vetedijen e njerezve te thjeshte, dhe se fundi duke zgjuar nder ta mizori te tilla. Kjo te 'ndernend skicen e vjeter per njeriun, i cili ne te hyre te pazarit leshoi nje genjeshter dhe kur doli ne krye të pazarit, degjoi genjeshtren e vet te hiperbolizuar dhe e besoi. Keshtu ngjau dhe me ministrin serb te puneve te jashtme, Ilia Garashaninin kur me 1844 shkroi programin nacionalist" Nacertanie", qellimi i te cilit ka qene pastrimi etnik i tokave shqiptare te Kosoves. Ky njeri, me 1846 sajoi nje harte, ne te cilen per here te pare Kosova quhet "Serbia e vjeter". Ketu dhe ze fill miti qe helmoi me shovinizem gjithe popullin serb dhe fqinjet perreth. Me 1876-77, "Nacertanie" e Ilia Garashaninit punoi: ushtria e knjaz Obranovicit nje nate, papritur, ra mbi 620 fshatra shqiptare te Nishit duke djegur, vrare, gjymtuar e perzene nga shtepite familjet shqiptare, e me pas, duke pervetesuar tokat e shtepite e te debuarve dhe te te vrareve prej tyre. Nje analogji e tille, edhe me e eger po ndodh sot ne Kosove.

Pas ketij spastrimi etnik, me 1901 ne Serbi, krijohet organ izata terroriste "Crna Ruka" me synim zhdukjen e shqiptareve nga Kosova, kurse vetem nje vit pas fonnimit te "Keshilli i nalte i Çetnikeve" (1904), nis fushata e gjere e Çetnikeve kunder kosovareve, te cilet asokohe vuanin pushtimin turk. Ne vitin 1908 shfaqet nje tjeter organizate "Narodnaja Odbrana", detyra e se ciles ka qene formimi i bandave terroriste dhe hedhja e tyre per veprim ne Kosove. Nepo kete vit, del ne skene nje grupim jo me pak iterbuar "Serbet Otomane" veprimet e te cileve, gjithashtu, qene drejtuar kunder shqiptareve te Kosoves. Viti 1912 sjell librin e Vlladan Gjeorgjevicit, se pari ne anglisht e frengjisht, pastaj ne serbisht, ku ne nje menyre krejt te kualifikuar prej akademiku i deshmon botes, se çdo shqiptar ka bisht. Tema e bishtit te shqiptant, qe i qe nderkallur ne tru ketij serbi, qe kundruar asokohe nga shkencetaret evropiane si simbol psikoanalitik fallocentrizmi, dhe nje shqiptar, qe shprehur ne shtypin francez, se çeshtja eshte tejet serioze, ndaj i duhet ofruar urgjent psikanalist ketij te gjori. Tezat e Gjeorgjevicit u perpunuan dhe me radikalisht nga pasuesi i tij, Cubrillovic dhe u zbulua kesisoj, se Fallocentrizmi shqiptar qe ngulur thelle ne akademine e shkencave serbe.

Me 1913-14, vit i agresionit serb mbi Shqiperine Veriore dhe Veri-Lindore, Jovan Cvijic, Ylladan Gjeorgjevic dhe Nikolla Pashic, u shkruanin fuqive te medha te Antantes: "Serbia gjendet e izoluar nga te gjitha anet. Populli serb jeton si ne burg. Serbet jane te rrudhur brerida kontinentit dhe kerkojne, e vazhdojne te kerkojne me kembengulje t' i jepet Serbise, te pakten nje port shqiptar. Serbise i duhet patjeter nje dalje ne Adriatik - me hir apo pahir. Ju shpallim se, gjithshka qe quhet teritor. serb, eshte fituar me lufte". (I.Aralica. Reeard for Suffering, Yjesnik, Zagreb, 1993).

Ne kohen qe shkruheshin keto, çetat ushtarake serbe u nxirrnin lulaket nga barku grave shqiptare shtatzena, i digjnin, u rrjepnin lekuren vajzave, u shkulnin gershetat, qe te krenoheshin kur te ktheheshin ne Beograd.

Ata mbyllnin neper shtepi familje te tera, i sperkasnin me benzine dhe i digjnin, duke mos lene gjalle, as pleq, as femije. Roberit shqiptare i detyronin te germonin gropa te medha e pastaj i varrosnin aty, per se gjalli. Ky realitet ka ndodhur nder vitet 1912-1920, ky realitet po perseritet ne nje shkalle edhe me te eger sot.

Vjeshtes se vitit 1944, tre mije partizane kosovare, me urdher te shtabit te pergjithshem te ushtrise Jugosllave, qene thirrur te mblidheshin ne manastirin e qytetit te lashte shqiptar Tivar (asokohe e gjer me sot gjendet ne republiken e Malit te Zi). Brenda oborrit te manastirit ate i çarmatosin, dhe pastaj, sipas skenarit te nates se Shen Bartolemeut, masakrohen nga serbet, qe kishin zene pozicione speciale per kryerjen e kesaj masakre.Kete tmerr e vazhdoi pas luftes se dyte boterore Rankoviçi (Minister i puneve te brendshme te Jugosllavise), i cili nen pretekstin e çarmatimit te populllsise, torturoi e zhduku mbare Kosoves mijera e mijera shqiptare te pambrojtur,ç'ka i shpinte ate ne veprime absurde: ata qe nuk kishin arme,shterngoheshinm ta blinin per t' i shpetuar kesisoj dhunes shteterore. Por edhe pas kesaj, serbet i rrihnin e i burgosnin shqiptaret - per mbajtje arme pa leje.

Megjithate, kjo nuk e qetesoi Rankoviçin. Ai mblodhi rreth 500 mije kosovare, dhe sipas nje marreveshje te bere me qeverine turke, i deboi ata ne Turqi si turq, ku sot e kesaj dite jeton atje diasporam shqiptare. Kjo ka ngjare ne vitet pesedhjete; dhe me e eger po ngjet dhe sot.

* * *

"Serbia duhet te shtrihet gjer atje, ku jeton qofte edhe nji serb i vetëm"- kjo ka qene parrulla kryesore e Sllobodan Milosheviçit, gjate pjesemarrjes ne te ashtuquajturen "lëvizja unitariste" ne vitet 1987 -1988.

Duke ligjeruar ne mitingje te panumerta ne mbare Serbine e veçanerisht ne

Kosove, (qe ne fund te fundit e solli ne pushtet) ai i dha sinjal ne fakt nacinalizmit serb qe priste ne beft, duke i bere ftese te hapur per hegjemoni mbi nacionalitetet e tjera. Ne ligjerimet e tij te nginjura me pathos nacionalist, ndjehej instalimi i shpejte i rregjimit fashist ne Jugosllavi. Te paret qe u vetedijesuan per kete qene sllovenet, e fill pas tyre, kroatet e boshnjaket, ç'ka solli dhe renien e ish-Jugosllavise.

Duke ndjekur se si shtypeshin me tanke protestat e shqiptareve ne Kosove, ata iu kunder vune idese nacionaliste serbomadhe.

studim

(Ky shkrim eshte botuar me pak shkurtime ne shtypin rus, "Tatjanin denj" ("Dita e shen Tatjanes) reviste nacionaliste studentore dhe ortodokse. Pas botimit te ketij shkrimi, kryeredaktori i saj u shkarkua nga puna, per "simpati" ndaj shqiptareve. Gjithashtu, nje fragment nga ky shkrim eshte botuar ne revisten me popullore ruse, te perjavshmen "Novoje Vremja" (Koha e Re' ~ me psudonimin Elez Isufi. Tezat themelore te kiitij shkrimi jane shfrytezuar ne konferencen per Kosoven, mbajtur me nje fryme radikale antishqiptare nga Instituti i Marredhenieve Nderkombëtare me 15.04.1999. Publikimi i shkrimit ngjalli nje reaksion jashtezanisht histerik ne shtypin rus, me reagime te trasha, qe i tejkalojne normat etike).

- shkas për spastrime etnike

* * *

Anologji te tilla mund te sjellesh sa te duash, mirepo, persa i perket Kosoves, kemi te bejme me nje situate krejtesisht tjeter. Kush ka patur fatin te mos jete injorant, me nje vullnet minimal ka arritur te mesoje nje te vertete te siperfaqshme: Kosova nuk ka qene kurre atdheu i kombit serb, siy nuk ka qene kurre as qender kulturore e shpirterore serbe. Kjo eshte nje nga idete e jermise serbe, gjenealogjia e se ciles i ka rrenjet ende ne truall te ceket.

Konflikti etnik mes serbeve dhe shqiptareve ka rrenje mjaft te thella, kornizat kohore te se ciles nuk kufizohen aspak brenda suazes se shekullit XX, siç e paraqesin mjetet e informimit publik ne Rusi, fale shkrimeve te panumerta te te ashtuquajturve "specialiste" e qe per faqe te zeze, nxijne faqet e pafajshme te letres ne kete kohe krize. Zanafilla e konfliktit eshte shume e lashte dhe ka patur vazhdimisht shumanesine e tij te pandryshueshme gjer ne ditet tona. Ai ze fill nder shekujt VII-VIII pas Kr. me natyre nacionale, religjioze e gjuhesore. Konflikt ndermjet nje populli qe i kundervihet pushtimit dhe asimilimit, dhe nje tjetri, qe kerkon te zhduke ekzistencen e nje popullsisë autoktone. Pikerisht ne kufijte e ketyre shekujve (VII- VIII) ngjizet te shqiptaret e veriut dhe ne Kosove eposi nacional i shqiptareve, ne te cilin lejtmotivi qendror eshte ai i mbrojtjes se territoreve dhe bjeshkeve me kullota, nga dyndjet kaotike sllave, gjer tek invadimet e formacioneve luftarake te mbreterive mesjetare serbe.

Serbet jane vendosur ne Ballkan ndermjet shekujve VII-IX, siç deshmojne shumica e burimeve dhe autoriteteve historike. Keshtu, historiani bizantin Konstandin Perfirogjeni, burimi me i hershem qe flet per Serbinë si te tille, shkruan se Serbia kufizohet nga lumejte Lim, Drina, Piva, Tar dhe Morava Perendimore. Konform te dhenave me te vona, ketyre territoreve u bashkangjitet termi Rashka (Rascka).

Procesi shtetformue serb, i realizuar ne disa stade, gjate mbreterimit te Stefan Njemanjes ne gjysmen e dyte te shekullit XII, çoi ne krijimin e nje njesie te fuqishme politikb-ushtarake me qender Rashka dhe Dukla (Historia e popujve te Jugosllavise, Beograd,1953). Nje tjeter burim deshmon: "Nen mbrojtjen e mbretit hungarez, zhupani i madh Stefan Njemanja e shpalli veten te pavarur. Nga vasal i bazileusit Emanuel I, ai serishmi rrembeu armet pas vdekjes se te fundit dhe ne aleance me hungaret, pushtoi toka bizantino-shqiptare duke bashkuar kesisoj Rashen me Zeten (Dukla) e duke krijuar ne kete menyre shtetin e pare serb perreth qytetit Pec (Peje), qe hynte ne arqipeshkopaten e Ohrit." (G. Castellan,Historie de Ballkan, Paris 1991). Prandaj serbet per nje kohe te gjate i quanin "serbe nga Rasha". "Perderisa serbet u shfaqen ne Ballkan pas shekullit VII, nuk eshte çesnure, qe per popullsine autoktone te Kosoves ata s'qene veçse ardhacak - pushtues.

Dhe sundimi serb pati filluar shume me vone se Stefan Njemanja te behej Car, me 1189, shume me vone nga pushtimi i Pultit (krahine ne veri te Shqiperise) dhe Pejes (qytet ne veri-perendim te Kosoves), ne nje kohe kur "pjesa tjeter e Kosoves ishte jashte sundimit te tij" (A. Ducellier, Le monde, Paris, 1981).

Se kendejmi nxjerrim konkluzionin e pashmangshem: Kosova nuk ka qene as djep e as qender kulturore serbe, porse nje province bizantine, e okupuar perkohesisht nga mbreteria mesjetare serbe.

Mbetet i pamohueshem fakti historik, qe Stefan Dushani, okupuesi me i madh i tokave shqiptare pas Stefan Njemanjes, beri per nje kohe te caktuar kryeqytet te tij Prizrenin, dhe me pas Shkupin (Skopje)- nje tjeter qytet te madh shqiptar, qe gjendet sot ne territorin e Maqedonise. Nuk eshtee çuditshme, qe pushtuesit dhe tiranet, mund te vendosen aty ku duan. Prandaj le te mos kembengulin serbet, qe themelimi i nje qendre politike apo ekonomike, percakton, veçanerisht ne mesjete, perkatesine etnike te pushtuesit"(A. Ducellier, Le monde, Paris, 1981). Se sidoqofte, pushtuesi zhduket fill pas renies se perandorise. Procese te ngjashme po perjeton sot dhe "perandoria serbe", e cila, sipas kllapise se nacionalisteve vendas, duhet te shtrihet "gjithkund, ku jeton qofte dhe nje serb".

* * *

Nje nga parimet me te rendesishme, qe serbet e quajne Kosoven qender te tyre kulturore apo "Jerusalemi serb", ka te beje me ekzistencen e disa kishave e manastireve ne veri te kesaj krahine "autonome", ç'ka per mendimin e serbeve, e justifikon plotesisht gjenocidin ndaj shqiptareve, masakrat e padegjuara masive, e se fundi, larjen e hesapeve, per t'ifshirë ata nga faqja e dheut. Ketu pra ze fill apoteoza e kundervenies. "Ndikimi i kishes serbe, - deshmojne fallsifikatoret serbe - pasqyrohet dhe ne emertimin e provinces autonome - Metohia, ç ka do te thote "toke kishtare". Nga pikpamja historike, kjo nuk eshte aspak e vertetë.

Se pari, fjala "Metohia" që vertet do te thote "prone kishtare" rrjedh nga greqishtja e jo nga serbishtja. Kjo, tregon ne veçanti, se territoret e Kosoves ndodheshin nen zoterimin e kishes katoliko-romane, e se mbrami, nen ate ortodokso-bizantine.

Se dyti, ne periudhen e varesise nga Bizanti dhe pushtimi serb, keto territore qene te populluara kryesisht nga 'shqiptare (shih, Regjistrimi kadastrial turk i vitit 1481, per popullsine e Dukagjinit. S.Pulaha, Prishtine, 1974). Keto toka zoteroheshin nga shqiptaret, njeri prej te cileve - Duke Gjini, qe i dha emertimin toponimik Metohise: Dukagjin.

Se treti, megjithese fja1a "metohi" nuk perdoret nga shqiptaret, ata e pranuan krishterimin nga romaket dhe luajten nje rol te caktuar'ne perhapjen e tij. Kesisoj, shqiptaret, ne veçanti ata te veriut dhe Kosoves, qene krishteruar disa qindra vjet me pare se serbet te vinin ne Ballkan dhe te perqafonin ortodoksine nga fundi i shekullit IX. Me 734, sipas disa politikave kishtare, nje pjese e territoreve te populluara me shqiptare, kisha romake ia dha nen juridiksion kishes se Konstandinopojes.

Dega ortodokse ne keto vise gjeti truall te begate. Si rezultat, nisi te shfaqet e lulezoje pak nga pak rituali sllavo-ortodoks. Kjo tendencë u shfaq serish pas ndarjes perfundimtare te kishes kristiane ne lindore dhe perendimore me 1054. (Shih. Fjalori i Plote Enciklopedik i Teologjise Ortodokse, botim i reprintuar 1992, Moske), gjersa shqiptaret mbeteshin nen zoterimin e Bizantit.Kesisoj, kishat e Kosoves, te ndertuara per banoret shqiptare, kane qene ne krye të heres romano-shqiptare, dhe me vone u bene bizantino-shqiptare, ne pajtim me politikat kishtare te asaj kohe.

Me zanafillen e okupimit serb nga mesi i shekullit XIII kishat ne Kosove qene shtrënguar t'u rezistojne ndryshimeve te gjithanshme, te cilat i sillnin me vete serbet. Pa marre parasysh infiltrimin e popullsise sllave dhe presionin e ushtruar prej tyre, kishat ne Kosove mbeten edhe per nje kohe te gjate te pandryshuara. Keshtu, kisha e Pejes gjendej nen kontrollin e shqiptareve gjer ne vitin 1445 (Branislav Djurdjevic, Odnoz iz medju oohridsko arhipeskopije i serpske crkve od pad smedereva, Sarajevo, 1970).

Serbet, veçanerisht ne fillim te pushtimit turk, u perpoqen t'ia nenshtrojne kontrollit te tyre kishat e gjithe gadishullit ballkanik. Ne keto kushte, per t'i shpetuar serbizimit, shumica e shqiptarevc u kthyen' ne myslimane-nje analogji e tille ka ngjare ne te njejten kohe (shek. XVI-XVII) edhe me boshnjaket, per shkak te divergjencave qe paraqiste sekti ortodoks i fese karshi kishes serbe, si dhe nga presioni i vazhdueshem asimilues qe behej nga kisha serbe. Megjithate,' kishat shqiptare mbeten per nje kohe ende te gjate nen zoterimin e shqiptareve shizmatik, te cilet dalengadale u serbizuan.

Keshtu qe, nga ana historike nuk ka shume serbe qe te qajne per ate kisha, maksimumi, as gjysma e minoritetit serb te Kosoves. Studiuesi amerikano-shqiptar dr. M. Kerabreg nenvizon: "Ne kohen e "restaurimeve" te njepasnjeshme "dekorative" faktikisht kemi te bejme me shuarjen e mbishkrimeve dhe simboleve bizantino-shqiptare ne te gjitha kishat e Kosoves dhe vendosjen e atyre serbe". (The Century Historiographical Falsifications: Kosovo. NY, 1995 & The VOT, oct. 1995). Po tekembramja, keto kisha ne Kosove shqiptaret i kane ruajtur, duke i konsideruar ato deri sot si vende te shenjta (gje karakteristike e tolerances fetare shqiptare), se po te kishin dashur i kishin fshire nga faqja e dheut, dhe askush s'do mund t'i pengonte, po te kemi parasysh, qe partia komuniste ne pushtet, perkrahte politiken ateiste aso kohe. Keshtu do merrte fund dhe alibia e serbeve me kishat ne Kosove.

Se fundi, nje nder argumentet kryesore te serbeve eshte e ashtuquajtura "beteja e Fushë Kosoves (15.06. 1389). Si tezen me prestícioze, serbet quajne ate, qe "ne kohen e fushates turke ne Ballkan, serbet u bene atyre rezistence, ndersa shqiptaret, bashkepunuan me turqit".

Se pari, prijesi i madh serb Mirko Mmjanjevic, pjesetar I koalicionit kristian, ne betejen e Marices (1371) dha jeten duke luftuar ne anen e sulltanit turk kunder prijesit rumun Mirce (I. Aralica, Reward for suffering, Vjesnik, Zagreb 1993)

Se dyti, ne betejen e Kosoves(1389), ku gjithe popujt kristiane te Ballkanit u bashkuan, per t' i dhene goditje invazionit osman, serbi Marko Krajlevic, nje nga personazhet qendrore te eposit e folklorit serb, madje me kryesori, luftoi ne anen e turkut (Historia e Popujve te Jugosllavise. Beograd 1956}.

Se treti, Vuk Brankoviç, guvernatori i Kosoves se okupuar, tradhetoi lidhjen krisliane,m duke braktisur fushen e betejes. (Historia e Popujve Jugosllave. Beograd. 1956).

Se katerti, Stefan Uazarjeviç, i biri i udheheqesit te kaolicionit kristian, i te peshtyrit dhe te rrjepurit per se gjalli nga turqit, jo vetem qe luftoi me garden e vet personale ne anen e turqeve, por i dha sulltanit dhe motren e vet per harem (Historia e• Popujve Jugosllave, Beograd. 1956).

Se pesti, ne betejen e Nikopoljes, pothuajse ne prag te fitores se kristianeve, serbet hyne ne beteje ne fund fare, dhe per çudi, ne anen e turqeve, duke ua dhene faktikisht fitoren atyre (I.Aralica, Reeard, for Suffering,

Vjesnik, Zagreb, 1993.) Shkurt, qe t'i shmangemi numerimeve te merzitshme, nje pjese e "ajkes" serbe i ofroi bashkepunim pushtuesit turk, kurse shqiptaret, perkundrazi, ne menyre aktive iu kundervune turkut ne këte lufte, madje njeri prej tyre, Milesh Kopiliq, i preu koken sulltanit ne shatoren e tij.

Asnje shqiptar nuk luftoi ne anen e turkut ne kete lufte. Duke vazhduar traditen e "prijesave shqiptare" Gjergj Balsh Shkodrani III, komandoi formacionet luftarake te principatave shqiptare, qe luftuan bri per bri me serbet e te tjere kristiane te Ballkanit kunder fushates osmane. Pikerisht keto gjera studiuesit serbe, perpiqen te mos i kujtojne, duke i marre kesisoj mbi vete gjithe meritat e asaj lufte e duke e propaganduar si heroizem vetem te popullit serb. Psikopatologjia e nacionalisteve te sotem serbe ka arritur deri atje, sa ta shpalle jubileun betejes se Fushëkosoves si feste kombetare.Nese gjithe popujt e botes festojne fitoren, serbet, paraqiten i vetmi popull qe festojne nje humbje.

Nderkaq, ne Kosove, qe ndezur flaka e gjenocidit nacional sipas recetave te

vjetra: arrestimet, gjyqet e instaluara politike, burgimet. Nga viti 1997 gjer me 1998, rregjimi i Milosheviçit flaku nga puna 4000 mije shqiptare, te cilet qene te shternguar te emigrojne ne Evrope. Kjo ka hyre ne histori me term in "spastrimi i bardhe etnik". Nga ana tjeter, gjate po atyre viteve rezultojne mbi 7000 mije femije kosovare te helmuar neper shkolla dhe qindra raste sterilizimi te studenteve shqiptare neper universitete, nen masken e vaksinimit te detyrueshem. Viti 1989, sjell kulmin e aktit kriminal ndaj shqiptareve te Kosoves: privimi i autonomise, nxjerrja jashte ligji i universitetit te Prishtines, ndalimi i organeve te shtypit dhe botimi i librave ne gjuhen shqipe, gjer te nderrimi i emrave te rrugeve dhe shesheve shqiptare me emra luftetaresh serbe. Ne te tilla kushte intelektualet shqiptare krijuan qeverine e tyre me ne krye Ibrahim Rugoven (02.07.1989) - sipas plebishitit mbare kosovar.

Kete shtet ilegal te "jashteligjshem" serbet e quajten me termin; "shtet paralel".

Me ne fund, pas luhatjesh teper te gjata, edhe mjetet ruse te informimit publik, vendosen te pasqyrojne ngjarjet "objektive" ne Kosove. Vertet, me nje vetpermbajtje e kopraci qe del shpesh jashte kufijve te hijeshise dhe kontradiktë qesharake ne aspektin analitik te ngjarjeve, e megj ithate, gjithnje e me teper, vihet re pafuqia per ta "mbuluar diellin me shoshe". Madje, realitetin e perzieshem kriminal qe po krijojne "vellezerit sllave" ne Kosove, nuk mund ta fshehin me as shprehjet tejet cinike te kryeministrit Evgjeni Primakov, kinse "numri i te deportuarve nuk i kalon te 90 mije shqiptareve, prandaj per asnje lloj gjenocidi nuk mund te behet fjale-dhe kjo, ngjet mu ne ato momente, kur ne te gjitha telekanalet me te nderuara te bote, SNN, BBC dhe EURONEWS, komunikojne, se numri i te debuarve e ka kaluar shifren e 800.000 shqiptarëve, pa llogaritur mijera te vrare e te djegur nga serbet neper qytete e fshatra te Kosoves. Kurse, deklaratat e nginjura me vrer te Igor Ivanovit, kinse UÇK financohet nga tregtia e narkotikeve,-tashme kumbojne aq debile, e te pacipa, e sidomos, impotente per nga flashktesia e fantazise. Ne sfondin makaber te krimeve te Milosheviçit, cinizmat diletante te politikaneve rus, fyejne ndjenjat humane te dhimbjes njerezore ne pergjithesi, duke perfshire nder to edhe te kombit rus.

Une jam i sigurt, qe shqiptaret do te dine t'i qendrojne dhe kesaj here ciklonit te urrejtjes severber e shekullore te fqinjit te tyre, se s'mund te zhduket keshtu, nje nga popujt me te lashte te Ballkanit, nga gjiri i te eilit kane dale figura te dimensioneve boterore, Aleksandri i Madh dhe Skenderbeu, dhe te tille idole te shpirtmiresise dhe meshires, misionere me shpirt te pamposhtur, si Nene Tereza.

MOSKE, më 07.06.1999

"Kushëriri i ëngjëjve"

Nga **XHAFER MARTINI**

(vijon nga numri i kaluar)

Të gjitha të drejtat dhe mundësitë Zoti ia lanë vetëm vetes. Të tjerat qenie, edhe më e përsosura, siç është njeriu, kanë kufizimet e veta. Siç shikohet, këto janë ide filozofike. Proza e Kadaresë para së gjithash pëlqehet se është filozofike, por kjo filozofi nuk jepet nëpërmjet traktateve filozofike, as në formë tezash, nuk ka të bëjë aspak me filozofinë e katedrave dhe të universiteteve. Ajo është një filozofi e shtrydhur, nëse mund të shprehemi kështu, e "lëngëzuar", si gjaku i njeriut që rrjedh edhe nëpër kapilarët më të hollë, aq sa të krijohet iluzioni i mosekzistencës, megjithëse ai ja jep forcën dhe jetën njeriut. Por ky gjak ka rrugët e veta dhe nuk duhet të devijojë as edhe pak prej tyre, ndryshe bëhet burim i vdekjes së njeriut, si, për shembull, trombozat, hemarrogjitë celebrale etj. Gjithë ajo tramundanë që fryn në vepr*ën e Kadaresë do të shkaktonte një kaos sikur të mos kishte një pikë komandimi. Kadare e ka situatën në dorë, si balonën në fluturim*. Ekuilibrin e ka jeta. Kadareja, në analogji me këtë ekuilibër kaq delikat, ka ekulibrin artistik, atë harmoni dhe përsosmëri të domosdoshme për çdo vepër vërtet artistike. Gjithçka e mban në jetë ekulibri dhe harmonia.Të shkojmë edhe një herë tek filozofia e lëngëzuar. Natyrisht, ky nuk është as term dhe as koncept imi. Filozofia varet nga jeta. Në qoftë se jeta është "e lëngshme", edhe filozofia e tillë do të jetë. "Ideja e modernitetit ose e shoqërisë "së lëngshme", mban autorësinë e Zygmund Baumanit. Për këdo që dëshiron të kuptojë se ç'mbart ky koncept mund të jetë dobiprurës Gjendje krize, ku Baumani dhe Carlo Bordoni diskutojnë rreth këtij dhe problemeve të tjera.... Shoqëria e lëngshme nis të ravijëzohet me atë rrymë të ashtuquajtur postmoderne...Postmodernizmi shënon krizën e "rrëfimeve të mëdha" që mëtonin t'i mbivendosnin botës një model të rendit; iu kushtua një interpretimi të ri ludik dhe ironik të së shkuarës...është një lloj kpërcyelli nga moderniteti te një e tashme pa emër" (Umberto Eco: "Pape Satan Aleppe- kronika e një shoqërie të lëngshme- 2017:9) Shkurt, shoqëria e lëngshme është ajo që të rrëshqet nëpër duar, që nuk ka formë dhe është e ikshme, gjithçka tretet, humbet siguria, besimi, nuk ka më asnjë pike referimi: "gjithça tretet në një gjendje të lëngët". Tek vepra e Kadaresë interferojnë të gjitha rrymat krijuese paramoderniste, moderniste e postmoderniste, sistemet e ndryshme politike, rryma dhe rrymëzave filozofike. Por tek Kadare gjithçka është si tek rrjedhat nëtokësore. Jo se ai dëshiron të fsheh diçka, por se arti vetvetiu është i fshehtë. Flasim për artin që buron nga thellësitë.

Kadareja procedon me ide të rëndësishme, me mesazhe të fuqishme, por, nga që këto jepen me mjete artistike të holla dhe brilante, aspak në mënyrë bërtitëse dhe pëlcitëse, mezi diktohen. Kadare zotëron shumë teknika rrëfimtare që u përgjigjen kritereve të funksionalitetit, ai ka plot detaje, disa I lë mbasdore nëse I ka shfrytëzuar plotësisht, të tjera I rimerr në një mënyrë të re, kur të vijë rasti dhe vendi për to, përsërit kur është e nevojshme, por jo përsëritje që vine nga varfëria, por nga nevoja e shprehësisë artsitike. Kadare në një vend të kësaj eseje që po analizojmë, thotë që vallja korrigjon brutalitetin. Për analogji do të thoshim se proza e tij korrigjon brutalietin, vulgaritetin, naivitetin, konformizmin dhe të gjithë të këqijat që ka një shorëqi " lëngshme", që nuk ka asnjë "shtyllë" ku të mbahet. Prandaj vepra e Kadaresë është emancipuese, purifikuese. Puna është të kuptojmë se arti i madh pret hollë. Kadareja është artist i prerjeve të holla. Idenë e prerjes së hollë e jep edhe arti popullor:

"Në muajin e ramazanit që ra në verë, pikërisht në ato muaj kur dita ishte më e gjatë, burrat e një mëhalle iu lutën xhipit të katundit që t'i binte lodrës për të ngrënë iftarin nja pesë minuta ma para.

- Unë i bije, - tha lodërtari, - por më thonë njerëzit "na prishe ramazanin".

- Bjeri veç për ne, - ia kthyen kërkestarët.

- Po si t'i bije veç për ju? Po i rashë, e dëgjojnë të gjithë!

- Për ne bjeri me karthi (thupër e hollë), kur të vijë ora tamam, bjeri me topuz...".

Megjithë atë që thamë më lartë, njeriu nuk hoqi dorë nga dëshira për të fluturuar. Tani njeriu vuri vetes kufi se sa mund të fluturojë, ose, thënë pa figurë, sa mund të ngrihet mbi tokë. Ai filloi ta kuptojë madhështinë e vet edhe pse ishte qenie tokësore, midis tokës dhe qiellit. Lindi dëshira tjetër për të kërcyer, për të bërë me trupin e vet ato lëvizje, ato kapërcime, ato hedhje dhe kërcime që trupi normalisht nuk është i gatshëm t'i bëjë. Kadare jo vetëm në këtë ese por edhe në forma të tjera të krijimtarisë së tij është zotëruar nga filozofia e shkëputjes së trupit nga toka, edhe pse ai është krijesë që ecën mbi tokë duke mbështetur mirë këmbët në tabanin e saj. Kadareja "ka shkruar një vjershë me titull: "Vallja e shqiptarëve" që, veç ideve dhe mesazheve të tjera, përçon edhe idenë se njeriu është i lidhur fort me tokën, dhe për çdo shkëputje mbi të duhet t'i marrë leje asaj:

"Tri herë opinga rrahu dheun
Sikur kërkoi leje prej tij,
Pastaj shamia palët ndehu
Me qetësi dhe madhështi

Kështu midis qiellit dhe botës
Vallja u lind, vallja u shpall
Këmba sinjale i çoi tokës
Dhe dora qiellit i dha lajm".

Vallja nuk lindi kot, pa mision në jetën e njeriut. Vini re foljen tek vargu u shpall. Vallja shpalli veten. Me anë të saj njeriu ka diçka për të thënë, diçka për të shprehur ani pse gjuha është mjeti më i përshtashëm për të komunikuar. Kadare i referohet Jose Gil, i cili shkruan: "Kur gjuhët pushojnë së qeni vepruese, duhen kërkuar të çara të tjera. Njeriu, me sa duket, gjen vallen, trupin që flet". (Kadare: Vepra: 2009: 234) Nuk e kanë të gjithë gjuhën e valles. Natyra kompenson në mënyrë të çuditshme dhe arrin t'i kënaq të gjithë njerëzit me prirjet e ndryshme që u ka dhënë. Kam parë në mexheliset e Dibrës burra që nuk dinë të bëjnë muhabet, ose nuk janë në lartësinë e virtuozve të alegorisë dhe mënyrave të tjera të shprehjes. Këta vetëm dëgjojnë. Por kur ndodh që hidhet vallja, janë këta që ngrihen në valle, janë këta që fitojnë qoftë edhe përkohësisht (aq sa zgjat vallja), atë prestigj dhe rëndësi që do të dëshironin ta kishin gjithmonë. Po kështu ndodh edhe me atë çobanin e dhive që pothuaj nuk qaset në asnjë mexhelis, sepse di të ruaj vetëm dhitë. Ngaqë e ndien veten mjaft larg të tjerëve në zejen e odave, ai preferon të mos shkojë fare as për të dëgjuar. Ai fut fyellin në torbën e bukës dhe, kur është vetëm në mal, i bije atij aq bukur, aq përmallshëm sa e dëgjojnë edhe ata që janë poshtë në fshat. Ja, çfarë bën natyra, ka shpërndarë edhe talentet, ka shpërndarë edhe artin. Pelgam G. Wodehouse ka thënë "Duket sikur është ligj i pashmangshëm i natyrës njerëzore që askush nuk mund të shkëlqejë në të dy krahët. Nëse dikush është ballëlart dhe ka etje për dituri, fokstorti i tij (nëse vërtet vallëzon), do të jetë si lëkundjet e një të dehuri; ndërsa, pqese është valltar i mirë, nga veshët e lart do të jetë thuajse kokëbosh." (*Njeriu me dy këmbë të majta", Tiranë 2002, f. 234)*

Vallja flet shumë, thotë Kadare, madje më shumë e më mirë, më saktë se letërsia, piktura dhe artet e tjera. Vallja ka "epërsinë" e vet se zgjat pesë deri në dhjetë minuta. Ndryshe është një roman, fjala vjen, që zgjat me muaj për ta lexuar. Kjo e bën vallen një zhanër më demokratik sepse shijohet nga shumë njerëz njëkohësisht, është i kuptueshëm për të gjithë dhe shkakton ato emocione që asnjë art tjetër nuk mund ta bëjë në aq pak kohë. Edhe një pikturë, fjala vjen, do më shumë kohë dhe jo vetëm një herë për ta vështruar që "të nxjerrësh" diçka prej saj. Vallja edhe përgjithëson, thotë Kadare. "Era e lirisë, e pluralizmit, valëvitja e turmave, sulmi kundër idhujve e shtatoreve të tyre, sprapsja, sulmi i përsëritur, rrënimi i iudhjave, etj., etj., të gjitha këto ngjajnë me lëvizjen e gjithësisë". (Kadare: Vepra: 2009: 233)

Të shprehurit me anë të valles është një gjë shumë e vështirë, i thotë Angjelini shkrimtarit, se "Alfabeti i im janë vallëtarët. Janë ata me të cilët unë do të thur elipset e mia, figurat, idetë, ekstazën, tmerrin, gjithçka. Ti mund të shkosh kudo dhe atelien tënde, dhe veglat e tua, domethënë gjuhën, dhe shkronjat i ke me vete, kurse unë duhet të zhvendosem me gjithë këta njerëz të gjallë, që janë alfabeti im. A e mendon dot ti, që gjatë kohës së të shkruarit disa nga shkronjat ose vetëm një prej tyre, ta zëmë shkronja k, të mos jetë aty, të mos vijë, të mungojë?" (Kadare: Vepra 2009: 235) Kjo bisedë nuk e dimë në është bërë apo jo. Kjo nuk ka rëndësi. Ka rëndësi mënyra se si e thotë Kadare, kjo e bën konstatimin e baletmaestrit të veçantë. Ne befasohemi me mënyrën si e ka thënë shkrimtari dhe na ngelet në mendje. Këtu nuk ka vetëm art, ka edhe një farë ndarje midis arteve të ndryshme, depërtohet tek specifikat e secilit prej tyre . Secili, me atë mënyrën e vet, të jep kënaqësi. Arti ka harmoninë; gjithë artet, pa përjashtim, janë harmoni. Vallja, si shembull, nuk është kthehu e rrotullohu, kërce e hidhu kuturu, por të gjitha lëvizjet bëhen sipas një ritmi, sipas një melodie, shkurt, ato janë harmonike. Jeta fizike, jeta e vërtetë dhe arti, nuk kanë të ndarë. Janë të dyja për njeriun. Njeriu, siç ka nevojë për ushqimin fizik, që ai të jetë me larmi dhe llojshmëri, kështu ka nevojë edhe për artin, por jo vetëm për një lloj arti. Edhe këtu dalim tek një mësim tjetër filozofik dhe estetik: tek natyra e artit, tek funskioni i tij për ta bërë jetën e njeriut më të bukur. Pra, Kadare, ashtu si kalimthi, me një farzë, madje edhe me një fjalë, jep mësime të natyrave të ndryshme. Gjithë puna qëndron tek kuptimi që i japim fjalës.

"Në diktaturë jetonte në fshatin tim (Fushë Alie), një fshatar pa shkollë, por shumë i zgjuar, Can Kurti. Kuptohet që të gjithë të zgjuarit ishin kundër diktaturës. Cani ishte edhe shumë i varfër. Ai derdhte helm kundër sistemit, por jo drejtpërdrejt, por me anë të fjalëve me dy kuptime. Nëse ti, për arsye të ndryshme, - qoftë edhe për ta akuzuar Canin, - do të bëje një analizë të këtyre fjalëve, do ta filloje me kuptimin e drejtpërdrejtë të tyre, me atë që thuhej. Cani punonte në kooperative dhe, meqë e dinin se e kishte gojën hem, e caktonin shumë larg për të punuar. Kur ai nisej në mëngjes me shat ose lopatë në krah, ndodhte që dikush e pyeste:

- Ku punon, or Can?

- Ai përgjigjej:

- Këtu në Prat, në Prat.

Prej aty ku ishte Cani, Prati mbante gjashtë orë larg vajtje - ardhje, për të mos thënë më shumë. Pra, vetëm përdorimi i fjalës këtu, (ndajfolje për të treguar vendet afër), për një vend që ishte shumë larg, i jep krejt tekstit vlerë ironike dhe alegorike. Kadarjea pak a shumë kështu vepron, por në mënyrë tjetër. Por nuk ka rëndësi mënyra. Rëndësi ka nxjerrja e fjalës, frazës, nga "përgjumja" e zakonshme për ta ngritur atë në shkallën më të lartë të përdorimit për të na emocionuar më shumë. Ashtu si ka njeriu vallen për t'u bërë tjetër, ka edhe fjala vallen e saj për ta rritur shprehësinë dhe intensitetin e veprimit. Mjeshtrat e mëdhenj futin në valle jo vetëm fjalën, por edhe yjet. Kujtoni vjershën "Vallja e yjeve" të Lasgush Poradecit. Gjithçka vallëzon po dite ta futësh në valle.

Por mësimi në vetvete që na jep pothuaj në çdo pasazh Kadare nuk do të ishte gjë pa parë mënyrën se si e jep. Esetë e Kadaresë duhet të lexohen pikërisht për thellësinë e fjalës. Fjala është si toka, ka edhe ajo thellësinë e vetë. Por deri ku e ka thellësinë toka- flasim për një thellësi relative, duke mos synuar këtu zemrën e tokës. Thellësia e tokës është sipas vendit, në disa vende është më afër sipërfaqes, në disa më thellë saj. Kjo shtresë e tokës që është shumë e fortë, e papërshkueshme nga uji, e vështirë për t'u punuar me mjetet që puojmë tokën, quhet Celinë. Celina sikur i thotë njeriut: "Deri këtu ke punë, deri këtu mund të hyjsh në thellësitë e mia". Fshatarët më përpara kur ndërtonin shtëpinë, themelet i çonin deri në celinë. Atëherë ishin të sigurtë nga çdo lloj tërmeti. Për analogji, (kam frikë se kjo analogji do të jetë pak e kërkuar), edhe fjala ka celinën , me çka duhet të kuptojmë shprehësinë më të lartë. Kadare e çon fjalën deri në celinë.

***

Një pyetje që bëhet shpesh në këtë ese është edhe kjo: pse vallëzojmë, pse vallëzon njeriu, çfarë të mire ka prej kësaj veprimtarie? Siç shikohet, pyetja nuk është e thjeshtë. Natyra filozofike e kërkimeve të Kadaresë në botën dhe shpirtin e njeriut, ndryshon formë dhe bëhet e larmishme, por nuk mungon kurrë. Drejtpërdrejtshmëria dhe informacioni i thatë, atij nuk i duhet fare. Arti lind për të plotësuar një boshësi tek shpirti i njeriut dhe gjatë këtyre përpjekjeve, krijuesi nuk e ka të sigurtë suksesin. Po kështu nuk e ka as baletmaestri, madje as vallëtarët vetë. Sepse është jo vetëm e çuditshme, por e mundimshme, madje disi absurde "Të thërrasish në ndihmë trupin, këtë hamall, këtë varr, këtë burg të shpirtit (për të përmendur vetëm disa nga cilësitë e tij), pra, të thërrasësh në ndihmë pjesën tënde më prozaike, më të përbaltshme, më të vdekshme, për të shprehur hovëzimet qiellore të shpirtit, kjo është më se paradoksale " (Kadare: Vepra: 2009: 239). Se nuk do të sillesh dhe të rrotullohesh kot, por do shprehësh "hovëzimet qiellore të shpirtit".

Njeriu kur kërcen sikur e nxjerr zgjyrën nga shpirti, sikur pastrohesh nga helmet që përmban organizmi, sikur ia merr jetës atë gëzim që ajo e ka për çdo njeri. Kështu e kam kuptuar unë vlerën e të kërcyerit. Por Kadare i përgjigjet pyetjes : pse vallëzon njeriu? – ashtu si di ai të përgjigjet, në mënyrë befasuese dhe shumë mbresëlënëse: "Njeriu ngrihet në valle për t'u bërë tjetër. Ai bën një përpjekje për të kaluar nga një gjendje në një tjetër, ai ndërron lëvizjet e zakonshme me lëvizje më të ngadalta os emë të shpejta, prej vetes së vet ai nxjerr një shëmbëllim, një pasqyrim, një refleks të vetëvetes, një hije si ato të përrallave, një lloj ylberi, një lloj dyzimi ose fantazme, që edhe i ngjet , edhe nuk i ngjet vet atij". (Kadare: Vepra 2009: 239) Edhe pse shprehet me figura, me kaq elegancë dhe mjeshtëri, edhe pse jemi në nivelin më të epërm ku mund të ngritet gjuha njerëzore, ai, çuditërisht, është aq i saktë në atë që thotë sa të kishte shprehur përkufizimin e një teoreme. Le të më lejohet që këtë që totë Kadareja që valltari edhe i ngjet edhe nuk i gjet vetes kur ngrihet në valle, ta konkretizoj me një rast nga jeta. Në vitet gjashtëdhjetë në qytetin e Peshkopisë jetën kulturore dhe artistike e gjallëroi shkolla pedagogjike e qytetit. Kishte një ansambël këngësh dhe vallesh të mrekullueshëm. Midis valltarëve ishte edhe Miftar Alia, një shoku im i klasës. Në atë kohë ishte në modë dhe nuk kishte rast që nuk kërcehej e ashtuquajtura Vallja e Xhafer Kabës. Xhafer Kaba kishte kohë që kishte vdekur, por ruhej vallja e tij. Ai kishte qenë një kërcimtari i rrallë, por u sëmurë dhe nga reumatizmi e njera këmbë i mbeti drejt. Po atë e merrte malli për valle dhe ngrihej dhe kërcente me këmbën drejt duke u mbajtur në shkop. Kërcente vetëm. Vallja është për shumë njerëz, më e pakta është Vallja dyshe. Që këtu fillonte përveçësia e saj. Ishte një valle, pra, jo e natyrshme dhe njerëzit qeshnin. Në çdo repertor hyri si valle humoristike se pastaj kërcehej edhe nga ata që nuk kishin asnjë këmbë të sëmurë, por imitonin Xhafer Kabën. Vallja hyri, si të thuash, në shtratin e vet vetëm kur atë e kërceu Miftar Alia. Miftari kapi filozofinë e valles dhe e përçoi tek spektatorët ndryshe. Miftari dukej sikur këmbën e kishte pa jetë, por duke mos u pajtuar me atë fatkeqësi, për ta mundur atë, për të mbetur sërish në radhët e artit, shtrëngonte veten deri në dhimbje të fortë fizike që këmbën "ta vdiste me të vërtetë" për të qenë i vërtetë në kërcim. Por gjatë kësaj përpjekeje të mundimshme atij nuk i vinte të qeshte dhe të bënte grimasa humoristike si disa të tjerë. Ai nidente dhimbjte të madhe derisa këmba vërtet "i drunohej" dhe ai kujtonte që nuk e ka. Këmba I mbeteje mpirë edhe për disa kohë kur kishte dale nga vallja. Sëmundja kishte dashur ta linte Xhafer Kabën ulok, por ai nuk bindej. Miftar Alia ia hoqi valles karakterin humoristik dhe i dha asaj karakterin heroik burrëror, që konsistonte në mposhtjen e fatkeqësisë, të fitores së njeriut mbi sëmundjen dhe të artit mbi mangësitë trupore. Për çudi Miftari vërtet bëhej tjetër kur kërcente atë valle. Shtrëngohej dhe mundohej, sikur ishte Laokonti që e shtrëngonin gjarpërinjtë për ta mbytur. Partiakët dhe pushtetarët që erdhën për të parë ansamblin, e kritikuan Miftarin për mënyrën se si e kërceu vallen e Xhafer Kabës, për karakterin dramatik që i dha.

Ne jo vetëm nuk guxonim, por as nuk dinim, as nuk na shkonte ndërment përse partiakët dhe pushtetarët reaguan aq keq. Ata ishin njerëz të paditur dhe vetëm për këtë arsye ne e quajtëm reagimin e tyre thjesht një tek. Por nëse diktatura përbëhet nga njerëz të paditur, sigurisht prej atyre që i mban në krye të punëve, vetë ajo është e ditur dhe dinake, veçanërishte mprehtë dhe e stërholluar në aftësitë për të mbrojtur veten. Të keqen që po i afrohet, ajo e shikon kudo, edhe tek vallet. Diktatura përherë porosiste për të qenë vigjilentë. *(vijon)*

tregim



Tregim nga Ramiz GJINI

Nga cikli: Na ishte njëherë socializmi

Magazinieri i kooperativës, Nik Tuzi, ngase ndjente dhimbje koke, la në magazinë dy punëtorët e shërbimit dhe u nis për në shtëpi të pinte një tablet aspirinë, të hante edhe drekën dhe të kthehej sërish.

Teksa rrotullonte çelësin në bravë, i erdhi në vesh zëri i gruas, që nxorri një klithmë të mbytur e pështëriti nëpër dhëmbë diçka si "Uaaa, ç'na gjeti"! Ai hyri brenda ngadalë, krejt i qetë e pa ndonjë kuriozitet për të mësuar, çfarë qe ajo klithmë alarmante; athua se në shtëpinë e tij po shfaqej kushedi për të satën herë i njëjti film, për të cilin, nuk kishte pikë interesi ta shikonte.

Në korridor, teksa zgidhte me nge lidhëset e këpucëve, u kollit nja tre herë radhazi, pastaj piskati me zë të lartë:

- Frida!

- Fol! - i tha ajo, që nga dhoma e gjumit.

- A iku, moj?!

Ajo nuk u përgjigj.

Duke ecur pa ngut, mu si një burrë i matur, që u jep të gjitha gjërave kohën e vet, ai u avit në dhomën e gjumit, ku e gjeti gruan të zhvoshkur çipllak, teksa i fuste krahët një robdishani ngjyrë rozë. Qe mufatur nga gjinjtë dhe buzët; dhe krejt fytyra i kuqëlonte, athua se, sapo i qe larguar një zjarri bubulak.

- Me cilin po flisje, moj?! - pyeti ai, pa ndonjë interes të madh.

- Unë po flisja?! - bëri habi ajo. - A je në rregull, a si?!

- Në rregull jam, - tha ai. - A nuk më thua, përse je zhveshur lakuriq?

- Sepse dua t'i laj rrobat dhe të lahem edhe vetë, - tha ajo pa e vështruar, ndërsa gjithë hutim, çukërmonte kot së koti në syrtarin e hapur të një komoje të vjetër.

Nik Tuzi vuri re, që dritarja e dhomës ishte e hapur. Mbi komonë pranë krevatit, ndodhej një pjatancë, me frenjat e rrushit të ngrënë, por kish mbetur aty një bistak i paprekur. Ai u afrua, këputi me gishta një kokërr, e futi në gojë, dhe teksa e përtypte, hodhi vështrimin në kopësht.

Rrezet e diellit, i lanin gjethet e hardhive me një prajshmëri të dyfishtë, ndërsa dëgjohej zizima e grerëzave, që silleshin në fluturim gjithkah mbi frutat e dardhëve, që kishin rënë përtokë.

Pranë dritares së shtëpisë së tij njëkatëshe, kish kohë që pati nisur të përvijohej një si udhëz e hollë, e cila, pasi i binte mespërmes kopështit të tij, mbërrinte te gardhi ndarës i komshiut Lekë Cubi, ku ishte hapur një vrimë e madhe. Për të kaluar përmes asaj vrime, njeriut i duhej të vinte duart në tokë për të ecur këmbadoras; të fuste në fillim kokën, pastaj të përkulte kurrizin, - siç e përkulin rëndom qentë në raste të tilla.

Nik Tuzi, kishte mbërthyer për gardhi një copëz dërrase, në të cilën qe shkruar me shkronja kapitale: KODOSHË! KUJDES KOKËN!

Si kalonte gardhin, udhëza merrte nga e djathta, përgjatë një vije me ujë të pakët dhe dilte direkt në rrugë të madhe.

Në krye të herës, Nika, e pati pagëzuar këtë udhëz, që lidhte dritaren e shtëpisë së tij me rrugën e madhe, me emrin "Shtegu i Lekë Cubit", sepse kishte qenë Leka, ai që e kishte shkelur i pari; por, kur nisi të shkilej edhe nga të tjerë, Nika ia ndryshoi këtë emër. Nisi ta quante, "Shtegu i kodoshëve të gruas sime".

Një lastar i njomë hardhie, që e pati mbjellë pranë dritares, qe thyer; kurse pak më tej, ai shquajti një këpucë të vetme burrash!

Nik Tuzi, doli jashtë pa thënë asnjë fjalë; u fut në kopësht, mori këpucën, u kthye sërish, e teksa ia tundëte të shoqes mu para hundës, tha:

- Ja pra, edhe një tjetër provë, me të cilën, një ditë do të ballafaqohesh se s'bën para shokut Karaman Madhoshi.

- E-huuu...! - ia bëri gruaja. - As që më bëhet vonë fare! Nëse ta ka shkrepur t'i mbledhësh e t'i mbash në shtëpi ato rrangullina, kjo është puna jote.

- Po, puna ime është, sepse ato rrangullina, do flasin para shokut Karaman për punën tënde, - tha ai. Dhe u largua për në dhomën e ndenjes.

Shoku Karaman Madhoshi, qe sekretar partie. Ishte ai, që para pesë vjetësh, pak me kështillim e pak si me urdhër, kishte bërë, që Nik Tuzi, të martohej me Frida Kukolën, njëzetë e gjashtë vjeç, më e madhja nga katër vajzat, që kishte kryetari i kooperativës, Bato Kukola. Qe rritur me pekule e përkujdesje të mëdha, kjo Frida, pa i munguar asgjë. Ishte e gjatë, e kolme dhe shumë e bukur në pamje, por budallaçkë nga mendtë e kresë.

- Martohu me të, - i pati thënë shoku Karaman, - sepse ta rrahësh tokën me shkop, nuk gjendet në Biboll një e dytë si ajo. Është vajza e mikut tim, por unë e dua njësoj si të jetë e imja, prandaj po ta kërkoj këtë gjë.

Nik Tuzi u shtyp e u përtyp për nja tre javë rresht, por tek e mbramja, pranoi.

Pas martesës, shoku Karaman, i dha Nikës edhe një punë të mirë, të rehatshme. E bëri magazinier të kooperativës, ku përveç rrogës, kishte mundësi të merrte në magazinë e të çonte në shtëpi gjithshka ai donte. Veç kësaj, i ndihu të bënte edhe një shtëpi të re aty ku deshi vetë. Që nga dita e parë e martesës, tashmë, qenë bërë pesë vjet.

Ashtu siç etapat e vjetra, në të cilat ka kaluar njerëzimi, shpjegohen përmes objekteve arkeologjike të gjetura, edhe ky pesëvjeçar martese, - gjithë mardhënia e tij me të shoqen, shpjegohej me disa sende të thjeshta personale, të gjetura brenda shtëpisë së tij; sende, që kodoshët e gruas, i linin aty, për t'ia mbathur nga dritarja, sa herë dëgjonin kërcitjen e çelësit në bravë të derës.

Magazinieri, i merrte këto sende dhe i kyçte me inventar në një musandër, që gjendej në dhomën e ndenjes. Dhe nuk qenë pak; qe një koleksion i tërë sendesh, të cilat, ai mendonte se një ditë, do t'i duheshin si prova, për t'u ballafaquar me sekretarin e partisë, shokun Karaman, - zot i pushtetshëm në dymbëdhjetë katunde, me frymën e të cilit qe lidhur kjo martesë.

- Ata kodoshë, kujtojnë se më kanë ikur e ma kanë hedhur, po unë, në një farw mënyre, i kam kyçur të gjithë në musandër, - i tha Nik Tuzi gruas, duke folur me zë të lartë që nga dhoma e ndenjes.

- E-huuu...! - ia pat sërish ajo që nga dhoma e gjumit. - As që më bëhet vonë fare!

- E di që nuk të bëhet vonë. - ia ktheu ai. - Por dua që këto fjalë, t'i thuash edhe kur të ballafaqohemi me shokun Karaman!

Ajo nuk foli.

Nik Tuzi, hapi musandrën, futi aty brenda këpucën, dhe e kyçi apet me çelës. Pastaj, bëri ca hapa drejt korridorit, që t'i thoshte gruas edhe diçka tjetër, por krejt rastësisht, i vajtën sytë tek dera e hyrjes, ku qenë varur rroba në katër gozhdë.

Në njërën nga ato gozhdë, ai shquajti një xhaketë! Një xhaketë, që iu bë se nuk ishte e tij!

U afrua, e mori në duar dhe nisi ta kqyrte: xhaketë e re me kuadrate; e bukur, e hekurosur, prerë nga copë e shtrenjtë teritali dhe qepur për merak prej dorës së ndonjë mjeshtri të përngeshëm; dhe për më tepër, binte erë livanto!

- Hëm! - ia bëri ai, teksa e vështronte.

Futi dorën të kërkonte; një herë xhepat anësorë, pastaj atë të brendshmin, nga ku nxorri një dokument të vogël, - një tesere partie! E hapi dhe...! O zot! Si ta besonte këtë?! Në dorë po mbante teseren e partisë me foton dhe emrin e shokut Karaman Madhoshi. Iu prenë gjunjët dhe u shemb në dysheme, me kurrizin e pështetur për murit të korridorit.

- Frida! - thirri fort ai pasi e kishte marrë veten.

- Çfarë do? - pyeti vrazhdë ajo, që nga banja, ku ishte futur të lahej.

- Paska harruar xhaketën, moj! E ka harruar bashkë me teseren e partisë në xhep! Dil e gjeje dhe thuaj që të vijë ta marrë.

Ajo apet nuk u përgjigj.

Pas pak minutash, u dëgjua gërvima e derës së banjos që u hap, pastaj tre-katër hapa të shpejtë, dhe në fund, kërcitja e çelësit në bravën e derës së dhomës së gjumit që u mbyll.

Nik Tuzi, mbeti për pak kohë si një guak; i pafjalë dhe me nje shprehje habie në fytyrë, që iu stampua aty për gjithë jetën; madje, as vdekja nuk do ia fshinte. Xhaketa qe e lehtë, po atij i peshonte aq shumë, sa memzi po e mbante.

Si e mblodhi disi veten, u ngrit, vari xhaketën në vendin ku ishte më parë dhe vajti e u ul në divan; i heshtur, i kredhur në mendime, hem i habitur, hem i zhgënjyer me shokun Karaman.

Vetëm kur koka nisi t'i dhimbte fort, ai u kujtua pse kishte ardhur në shtëpi, ndaj u ngrit; hapi një syrtar të bufesë, nxorri prej aty një tablet aspirinë, ia hodhi gurmazit dhe shkoi e u ul sërish në vendin ku ndodhej më parë.

Provoi të mos mendonte asgjë, por nuk ishte e mundur. I thirri edhe njëherë gruas, por ajo nuk u përgjigj. Pastaj i tha mendja, se duhej të ngrihej; të dilte nga shtëpia e të shkonte te magazina, por ndjehej krejt i dërrmuar. I dërrmuar shpirt e korp. Atëherë, u shtri në divan dhe nisi të kotej me mendimin se i duhej të qetësohej e të pushonte. Të pushonte një grimë herë; sa ta merrte pak veten; dhe pastaj do të dilte. Po nuk qe e thënë, sepse dikush i thirri që nga oborri jashtë, dhe ai u ngrit e hapi derën.

Para tij u shfaq Petro Lushi, kushëriri i babait të tij, komunist dhe mik i pandarë me sekretarin e partisë, shokun Karaman.

- Më ra rruga këtej dhe mendova të të përshëndesja njëherë, o kushëri, - tha ai.

U pa ashiqare, që fjalët që tha, nuk e bënë të ndjehej rehat.

"Po ky, nga e dinte se gjendem në shtëpi, kur në këtë orë duhej të isha në punë"?! tha me vete Nik Tuzi. Deshi t'ia thoshte njëherë, por ndërroi mendje.

- Faleminderit, - i tha. Dhe e ftoi të hynte brenda.

- Nuk kam shumë kohë, - tha Petro. - Megjithatë, po futem për nja pesë minuta.

Dhe hyri.

I zoti i shtëpisë nuk e thirri gruan që ishte kyçur në dhomën e gjumit. I mbushi një gotë raki, hodhi edhe pak për vete dhe cakërruan gotat pa ndonjë qejf të madh.

Kushëririn Petro Lushi, dukej se nuk e mbante vendi. Edhe fjalët që thoshte, i nxirrte si me grep.

- Kështu, kështu more kushëri, - tha më në fund ai për t'i vënë kapak vizitës së tij të shkurtër e të papritur, pas një muhabeti gjithë ngërçe. - Tani të më falësh, sepse më duhet të dal.

Dhe u ngrit.

Tek dera, Petro Lushi, i ngjiti dorën xhaketës së varur në gozhdë që ta vishte, por Nik Tuzi e kishte nuhatur me kohë qëllimin e tij.

- Aaaa...! - ia bëri prishaqejfas ai duke e kapur për krahu. - Kushëri, kushëri! Xhaketën mos e prek! Erdhe pa xhaketë, pa xhaketë do të ikësh. Xhaketën të vijë e ta marrë i zoti. Kështu janë punët.

- Një minutë, të merremi vesh...! - i tërhoqi zvarrë fjalët tjetri.

- Ec, kushëri, ec! Nuk kemi për çfarë të merremi vesh. Në shtëpinë time jam zot vetë unë.

Dhe e shtyu ta nxirrte jashtë, pothuaj me pahir.

Në oborr u ndanë ftohtë, pa i dhënë, madje, as dorën njëri-tjetrit.

Me tu kthyer brenda, Nik Tuzi, e mori xhaketën dhe e kyçi në musandër, ku ruante edhe sendet e tjera. Pastaj, edhe pse dhimbja e kokës nuk i qe shugatur, ai doli nga shtëpia dhe u nis të shkonte te magazina.

Kur u kthye, nuk e gjeti të shoqen në shtëpi, po nuk i bëri fare përshtypje kjo. E dinte, që duhej të kishte shkuar te njerëzit e saj, sepse nuk qe hera e parë që e bënte.

Të nesërmen, ai nuk u duk fare te magazina. Kishte nevojë të rrinte vetëm. Po brenda, shtëpia kish nisur të mblidhej e trusej ngadalë. Afroheshin muret, tavani po bëhej gjithnjë e më i ulët, hapsirat e dhomave po ngushtoheshin, - gjithë shtëpia po i kthehej dalngadalë në një varr. Atëherë, ai doli në kopësht që të rrekej me ndonjë punë të vogël, sa për të mbajtur mendjen në rregull.

Andej nga ora dhjetë e paradites, i sollën korrierin, i cili i tha, se duhej të dorëzonte çelësat e magazinës.

Nika e kishte parashikuar këtë, po çelsat nuk i dha.

- Të vijë t'i marrë shoku Karaman, - i tha.

Pasdite, teptisi aty vetë sekretari i partisë, shoku Karaman Madhoshi. Erdhi i vetëm, por i armatosur me një armë zjarri në brez, të cilën e kishte me leje.

Nik Tuzi e priti si gjithmonë; athua se nuk kishte ndodhur asgjë. E futi brenda dhe e ftoi të ulej në divan, po ai nuk u ul.

- Ti nuk di asgjë, - i tha rreptë shoku Karaman, teksa qëndronte para tij drejt në këmbë. - Dhe as që duhet të dishë. Madje, ti egziston vetëm prej meje. Sepse të gjitha prej meje i ke: gruan, punën, shtëpi e katandi.

Nika nuk foli. Po vështrimin ia pati ngulur kokërr ndërsy dhe nuk po ia shqiste.

Qëndruan për pak kohë duke vështruar, njëri-tjetrin kështu, kacagjelas, derisa sekretari i partisë, pyeti me një zë gërgasës:

- Hë, çfarë ke që më shikon ashtu?

- Kam ca gjëra që ti nuk i di, - tha Nik Tuzi, qetësisht e pa e prishur fare terezinë.

- Çfarë nuk ditkam unë?! - pyeti tjetri gjithë qesëndi. - Fol! Çfarë nuk ditkam?!

- Unë t'i them e t'i tregoj të gjitha, po ju e keni arsyen në majë të shpatës, - ia pat qetësisht magazinieri. - Megjithatë, më lejoni t'ju tregoj mallin, që unë kam grumbulluar në këto pesë vjet martesë me Fridën. Mallin, që kam vënë nën hyqmin tuaj. Dhe e veçanta është, se këtë mallë, e kam shtënë në dorë pa dalë hiç nga shtëpia!

Dhe, si vajti e hapi musandrën, nxorri prej aty, si fillim, një kasketë, e teksa ia tregonte, tha:

- Kjo është kasketa e kryetarit të këshillit, Alem Qerimi! Kasketa që ia njohin të gjithë. Duhet ta ketë mbajtur në kokë, të paktën, nja njëzetë vjetë. Në pamje të parë, kur ia shikon rrethin gjithë zhul, të ngjall neveri. Po mund te lahet. Një koleksionist esnaf, kushedi sa do të jepte për këtë kasketë.

E hodhi kasketën në dysheme dhe e futi dorën sërish në musandër.

- Këto pantallonat prej doku, - tha ai, teksa i mbante me majë të gishtave si pincë, - janë të atij zabërhanit, Lekë Cubi, komshiut tim; të atij që ka hapur i pari shtegun e kodoshëve të gruas time. Janë pak të zhubravitura, por siç e shikoni edhe vetë, - sepse ju jeni një vëzhgues fort i hollë, - copa vazhdon të mbahet mirë. I ka lënë dhe ia ka mbathur nga dritarja, sapo ka dëgjuar kërcitjen e çelësit në bravë të derës.

- Mjaft! - bëlbëzoi i nervozuar shoku Karaman ngase nuk po e mbante vendi. Dhe bëri të dilte.

- Prit...! - e ndaloi tjetri. - E di që ke zahmet të madh. Dhe ashtu si unë, edhe ti, po e ndjen tani këtë shtëpi si një grusht që sa vjen e truset; dhe ke frikë se mos rroposet. Por mos u tremb! Duhet të mbarojmë njëherë punë bashkë.

Rrasi dorën sërish në musandër, nxorri prej aty një kuti duhani, dhe teksa e tregonte, jo pa qesendi, tha

- Kjo kuti duhani, është e Losh Ruçit, brigadierit të brigadës së plehut! Shikoje çfarë kutie, mor të paftë zoti, të paftë! Kuti e lashtë argjendi, fort e rrallë, shkërlitur bukur me onamente dhe figura heronjsh nga lashtësia!

Sekretari i partisë, tërhoqi njëherë hundët, pastaj bëri një lëvizje nervoze me kokë.

Nik Tuzi, nxorri nga musandra dhe i tregoi edhe një shall leshi të shitësit, Lame Qorri; një çantë meshini të teknikut të ndërzimit, Marin Dermeku; një palë syze optike me gjalm të rojes së stallave të lopëve, Hasan Hutës; një letër të zjarrtë dashurie që ia kishte pas shkruar Fridës, poeti Nuri Tarrota; si dhe një dyzinë të tërë sendesh të tjera, të njohura e të panjohura.

- Tani, mbaruam, shoku Karaman, - i dha fund ai duke shkundur duart, pasi qe bërë një grumbull i madh në dysheme. - Nuk ka më! ... Jo, prit! - kërceu sërish në beft. - Desh harrova kryesoren! Është edhe xhaketa juaj e re me kuadrate! E famshmja xhaketë e shtrenjtë, që ngado që ti shkon, të bën sqimëtar. Ju e patët varur në gozhdë, po unë e futa në musandër që ta ruaja me kujdes, të mos merrte pluhur; sepse kjo, i bie të jetë kryegjëja e të gjitha gjërave, që kam mundur të shti në dorë falë bujarisë suaj. Bre-bre! Sa të bukur e keni këtë xhaketë, o shoku sekretar! Sa shumë do më shkonte! Megjithatë, urdhëroni! Kini mirësinë ta merrni.

Shoku Karaman, zgjati dorën dhe e mori.

- Edhe teseren e partisë e keni në xhep të xhaketës. - vazhdoi Nik Tuzi me një nënqeshje përbuzëse, të hidhur pelin.

Dhe si heshti një grimë herë, i kredhur në hallin e vet, nxorri një gurgull fryme e foli apet:

- Çudi, ë?! Shpesh vras mendjen: vallë, si ndodh, që burrat bëhen kaq frikacakë në këso punësh?! Kushdo qofshin ata; që nga pushtetarët më të mëdhenj, e deri tek fshesarët, mjafton një zhurmë e vogël fare, një kërcitje çelësi në bravë të derës, dhe ia mbathin gollomesh me të katra nga dritarja! Dhe të mendosh, që unë jam njeri shumë paqësor; nuk kam zemër të vras, as edhe një mizë!

Dhe, phu, pështyu.

-Roman për një epokë-

Pus i thellë ky **“Bunari”** i Fatmir Terziut!

Nga **VIRON KONA**

“Lum ti, moj Shqipëri!” thashë,
Armët e tija kur i pashë,
Ndë Blevedere në Vjenë,
Sikur pashë Skënderbenë.”
Naim Frashëri

Fillimisht më erdhi në mendje pusi ynë i shtëpisë. Prindërit na porositnin të tregoheshim të kujdesshëm, të mos hidhnim atje mbeturina, sepse atë uji e përdornim për të pirë, për t`u larë e për të vaditur, ai ndihmonte jetën e familjes sonë por edhe të gjësë së gjallë apo bimësinë që rrisnim në kopshtin tonë të vogël. Ai pus lidhte sipërfaqen me tokën e nëndheshme, me përrenjtë që buronin nën tokë, që ushqenin rrënjët e bimëve, por dhe vetë jetën. Por ai ishte dhe frigoriferi i kohës, atje ne hidhnim shalqinj, pjepra dhe përgjithësisht zarzavate për t`i mbajtur të freskëta...


Janë me mijëra e miliarda përrenj nën tokë, me miliarda damarë të saj, ku rrjedh uji jetëdhënës, që ushqen fushat, pyjet, bimësinë e kodrave, faqet e maleve, luginat, gjithë jetën. Uji është gjithçka, rruzulli tokësor përmban 71 për qind uji dhe 29 për qind është tokë. Edhe trupi i njeriut është 70 për qind uji...Edhe kur kërkohet jeta në kozmos, synimi i parë është gjetja e ujit; edhe kur kërkohet vendi për të ngritur një fshat, një qendër banimi, pyetet: ujin, si do ta sigurojmë ujin, ku ka ujë? Edhe qytetërimet më të mëdha lindën buzë ujit, buzë lumenjve. Në ato vende njerëzit gjenin kushte më të mira dhe më të përshtatëshme për të zhvilluar jetën e tyre. Kështu kanë vepruar egjiptianët, të cilët ngritën qytetërimin e tyre në brigjet e Nilit; semitët dhe babilonasit, në brigjet e lumenjve Tigër dhe Eufrat; indianët, në luginat e lumenjve Ind dhe Gand; kinezët në luginat e lumenjve Uanche dhe Jance. Kështu në çdo kohë sepse uji është gjithçka, pa ujë jeta do të ishte e pamundur.

VESË E HOLLË NË TOKËN ARBËRORE

E takojmë vazhdimisht Fatmir Terziun në libra, në filma, në dokumentarë, në romane, tregime, vëllime poetike, në shkrime publicistike, artikuj, ese, studime, kritikë, në vlerësime dhe kushtime. E takojmë përditë edhe në Portalin “Fjala e lirë”, që ai drejton aq suksesshëm e ku kontribuojnë me dije, artikuj dhe krijime qindra njerëz të letrave. Krijimtaria e tij vetjake, tashmë është shndërruar në një bibliotekë,Terziu është njëherazi një “hidrocentral” shkrimor, i pandërprerë, që prodhon pareshtur dritë, kulturë, paqe, mirësi dhe dashuri, teksa përhap si erërat e pranverës, aromë dhe bukuri, ndjenja dhe fryëmëzim. Meriton të vlerësohet ky NJERI, cili, sikurse edhe të tjerë përfqësues të dijes, të mendjes dhe të penës, pa u thënë askush, na ofrojnë përditë frymën e tyre të pastër dhe të shëndetshme, mirësinë, dashurinë dhe ngrohtësinë, veçanërisht sot kur ne në Shqipëri kemi nevojë për më shumë vlera të munguara, nga ato që na bashkojnë dhe, jo nga ato që na ndajnë. Terziu e bënë këtë, e bënë me të gjithë fuqinë e shpirtit dhe të mendjes së tij krijuese e brilante, e bënë si një atdhetar i madh.

“Bunari” për të cilin po shkruaj, hedh dritë mbi një periudhë epokale të popullit shqiptar, të shoqëruar me rrëfime që kanë në qendër kështjellën e Sfetigradit, ujin dhe gjakun, dritën dhe erësirën, lirinë dhe skllavërinë, mbijetesën e një populli të tërë për t`i bërë ballë pushtimit të osmanëve, të cilët kërkonin edhe t`u “stamponin” dhunshëm shqiptarëve skllavërimin, por dhe mendjen dhe fytyrën e tyre. Gjithçka rrëfehet dhe analizohet artistikisht në dritën e dijeve dhe të kulturës së popullit, në atmosferën tunduese që krijon pasuria dhe larmia e legjendave dhe e krijimtarisë popullore në shekuj, ku spikat trimëria në sheshin e betejës, sakrifikimi i luftëtarëve, heronjve dhe dëshmorëve.

Përmasat dhe denduria e rrëfimeve vijnë e rriten, ashtu si përrenjtë e nëndheshëm të ujit, dalin në sipërfaqe në mënyrë të beftë dhe i bashkohen natyrshëm lumit të madh artistik që shtohet e vrullon pareshtur. Lexuesi përfshihet në “kurthin” artistik e mjeshtëror të shkrimtarit, tërhiqet pareshtur nga fjalët kyçe: Sfetigrad, përkrenarja e Skënderbeut me brirët e dhisë, kodra e diellit, kodra e gjakut, toponime të panumurta që rrëfejnë se në këtë tokë, edhe një grimcë rëre, edhe një pëllëmbë toke, edhe një burim që rrjedh pikë-pikë... fsheh përbrenda histori të jashtëzakonshme që shpesh nisin me një fjalë të urtë, me një varg, me një tingëllimë kambane, me një çudi, me një tingull lahute, me një pikë vese... kurse, në vazhdim, fare natyrshëm rrëfimi artistik shoqërohet nga tempo ritmi dhe sfondi muzikor i këngës: “*Oh, rosa rosit vo Arbanoshka zemlja...*” (Bie vesë e hollë në tokën Arbërore).



SFETIGRAD 1448

Beteja e Sfetigradit zgjati nga 14 maj deri më 31 korrik 1448. Kështjella kishte emrin Sfetigrad (qytet i shenjtë) sepse aty ndodheshin shumë vende kulti. Ishte kyci i Arbërisë nga ana e lindjes. Ushtria osmane kishte rreth 80 mijë ushtarë, të armatosur me armët më moderne të kohës. Drejtohej nga Sulltan Murati i Dytë së bashku me të birin Sulltan Mehmetin e Dytë, i cili pas vdekjes së të atit do të merrte drejtimin e Perandorisë si një ndër Sulltanët më të famshëm, i mbiquajturi *Fahtiu, “Pushtuesi”.. “Ai ishte më i egëri i sulltanëve. Ai ishte edhe më i armatosuri. Topat e tij të rrëndë bënin kërdinë. Topat dhe armët e zjarrit u përdorën prej tij për herën e parë në rrethimin e Sfetigradit. Pasi u ça një pjesë e mureve, Turqit bënë sulme të përgjithshme kundër fortesës, por u prapsën me humbje të mëdha...”* Luftimet për marrjen e kalasë ishin të përgjakshme. Kështjellën e mbronin rreth 2000 luftëtarë arbër, kryesisht dibranë, me kryekomandant mirditasin Pjetër Perlati. Me qindra të vrarë nga të dy krahët. Mbrojtësit s`kishin ndërmend të dorëzoheshin.

Skënderbeu sulmonte me stilin, me mjeshtërinë dhe taktikat e tij ushtrinë më të madhe dhe më të fuqishme të kohës, duke depërtuar shkatërrues dhe gjëmimtar deri edhe në qendër të saj. Pastaj tërhiqej po me aq shkathtësi. Se, tërheqja me organizim dhe pa humbje, ishte mjeshtëri dhe aftësi e gjeneralëve të mëdhenj. Edhe Bardhyli, një mbret tjetër ilir përpara tij, ishte nga ata mbretër luftëtar gjenial, që mbahet mend në artin luftarak për tërheqjen e ushtrisë nga beteja në mënyrë të organizuar dhe pa humbje. Ushtria që tërhiqet në panik shkërmoqet, shkatërrohet tërësisht, është e humbur. Ata që ishin të zotë në tërheqje, kanë pasur mundësitë taktike të ndryshonin befasisht fatin e betejës, duke sulmuar përsëri armikun kur ai ishte i përfshirë në eufori dhe festimet e fitores. Edhe trojanët, persianët, osmanët, edhe Napoleoni, edhe shumë të tjerë e kanë pësuar dhe e kanë shkatërruar ushtrinë me tërheqjen e tyre nga një betejë apo luftë. Kurse me Skënderbeun ndodhte ndryshe. Ai tërheqjen e konsideronte pjesë të betejës, ajo ishte në planet e tij taktike, ai e kishte stil të luftimeve sepse ndryshe nuk kishte sesi t`i përballonte dhe t`i shpartallonte njërën pas tjetrës ushtritë gjigande osmane. Në çdo betejë, raporti i tij me armikun ishte si te historia e famshme biblike, e ndeshjes së Davidit me Goliatin.

Kur Sfetigradi ishte i rrethuar dhe sulmet pushtuese të Sulltanit pësonin dështime pas dështimesh, gjithka u përqendrua në gjetjen e burimit të ujit që ushqente pusin e kështjellës. Uji u shdërrua në kryefjalën që artikulohej pareshtur që nga vet Sulltani e deri tek ushtari i fundit i asaj ushtrie gjigante. Si e merrnin ujin ata atje lart, si shuanin etjen në ata shkëmbinjë të thepisur mbi të cilët ngriheshin muret e asaj kështjelle, që e mbronin me aq zjarr si shqiponja folenë? Gjetja dhe zbulimi i atij burimi uji përfytyrohej dhe ëndërrohej non stop 24 orë nga të gjithë, shfaqeshin hipoteza të panumurta për fshehtësinë e tij, për vendin ku ai mund të rridhte dhe mbushte me ujë pusin e kështjellës, por edhe ofroheshin florinj për atë që do të tregonte sekretin, vendndodhjen e burimit të fshehtë. Ndonëse emri “Sfetigrad” ka kuptimin i *shenjtë*, më i shenjtë akoma ishte uji që e mbante në këmbë atë kështjellë trimëreshë, ashtu siç mban uji i nëntokës një lis shekullor që rritet e rritet trimërisht drejt qiellit dhe diellit, por, që, nëse nuk do të kishte atë rrjedhë uji atje nën rrënjë, ai do të binte në tokë i pafuqishëm.

Ndonëse u mbrojt trimërisht Sfetigradi ra. Pavarësisht emrit të shenjtë ai ra. Ra sepse osmanët më në fund e zbuluan burimin e ujit, rrjedhën që furnizonte BUNARIN. Kush e tradhtoi Gjergj Kastriotin? Sigurisht që tradhtarët, keqbërësit, janë pjesë, rekuizitë e betejave. Tringëllimat e monedhave të floririt ishin tunduese. Ca pëshpërima dhe, pas tyre erdhi gjëma.

Pas zbulimit të ujit, me marrëveshje garnizoni doli i lirë nga kalaja. konfiguracioni i zonës ndryshoi, gjithçka ndryshoi. Fshati Koxhaxhik aty pranë do të thotë: “Betejë e madhe”. Ajo betejë s`mund të harrohej ndaj dhe i mbeti ai emër. Kurse, po aty, “Kodra e diellit”, toponim i përhapur në trojet arbërore, por edhe në ditët e sotme, nga “Kodra e Diellit” u quajt “Kodra e Gjakut”!? *“Kodra e Diellit u bë shesh beteje. Aty dheu u skuq. E kuqja e saj të vriste më shumë. Të vriste. Dhe ashtu ajo mbeti “Kodra e Gjakut”. Aty pastaj ata vunë çadrat. Ndejtën gjatë. Aq gjatë sa u bë gjëma. Gjëma që na rivrau Bunarin, jetën, lumin, ujin, tokën, tërë këtë tokë që..., sot vuan atë mallkim shkatërrues, vuan tullacërrinë e moçme..”.*

DY BRIRËSHI

Një projektor drite lëviz në thellësi të erësirës që mbulon kohët e shkuara me qëllim që të zbulojë dhe të ndriçojë simbolikën:Brirët e dhisë, brirët e kaut, të demit, të dashit, të drerit... nuk janë vetëm thjesht shenja dalluese, ato janë edhe shenja të fuqisë, të forcës, luftuese e mbrojtëse. I ka pasur në përfytyrim shoqëria njerëzore përherë; ato gjithnjë kanë ngacmuar mendimin dhe përfytyrimin, i cili është ngritur edhe në hapësirën e thellë kozmike duke e pagëzuar deri edhe një yllësi me emrin e brirëve, *Yllësinë e Bricjapit*. Ishte i lumtur ai njeri, ditëlindja e të cilit, i përkiste asaj shenje zodiakore. Perandori i Romës August Oktaviani, në nderim të kësaj shenje preu një monedhë me figurën e dhisë së egër. Teksa, lexuesve u shkon mendja edhe te paralele të tjera të brirëve: brirët e perëndisë Pan, brirët e “përbindëshit” të Kretës, brirët në përkrenaret e vikingëve, brirët te versioni etimologjik i fjalës *tragjedi,* që do të thotë “kënga e cjapit”. Brirë në përkrenare ka mbajtur edhe Pirroja i Epirit, edhe Filipi i V i Maqedonisë...

Kemi ditur edhe më parë për brirët e përkrenares së Heroit tonë Kombëtar. Historia rrëfen në mijëra e mijëra faqe për to, por Fatmir Terziu, duke i vënë në dukje këta brirë simbolikë, i veçon dhe i ndriçon ata me projektorin e tij origjinal: Ai që e mbante përkrenaren me dy brirë atë kohë ishte Një dhe vetëm Një, ishte Ai, Gjergj Kastrioti, kryetrimi i mbiquajtur nga turqit Skënderbe (Aleksandër), gjenerali i pathyeshëm. Këtë fakt e kemi kaluar të gjithë ndërmend, por asnjëherë nuk e kemi ndriçuar si objekt dhe metaforë të veçantë. Mendja e shkrimtarit, po. Ai e ka bërë, ai e ka ngritur në piedestal dhe, duke hedhur më shumë dritë mbi të, na ka vënë në mendime të tjera, na ka krijuar vizione më të thella, më të qarta, na ka bërë të meditojmë më shumë për atë përkerenare dhe simbolikën metaforike të saj.

Brirët e dhisë apo të cjapit gjithnjë kanë treguar shkathtësi, forcë, guxim. Dhitë kalojnë lehtësisht në mjedise të pashkelura, në mjedise dhe shtigje të rrezikshme. Dhitë kërcejnë “shkëmb më shkëmb”, nuhasin shpejt rrezikun, dinë të shmangen nëpër “shtigje” e të mbrohen, nuk janë si delet që bëhen tufë dhe hidhen bashkë në humnerë, dhitë e kapërcejnë humnerën. Ato kanë aftësinë ta ngatërrojnë kundërshtarin, duke e futur atë në shtigje dhe mjedise ku ai ndihet keq, sepse atje ato kanë domenet e tyre, atje ato janë zot, janë gjithçka, atje jetojnë dhe mbijetojnë, nuk përkulen; prej atyre thepisjeve, skarpateve, gërxheve dhe lartësive ato shohin dhe vigjëlojnë krenare mjedisin, ato i prezantohen jetës plotë shkathtësi, lehtësi, elegancë, qëndrim plot madhështi, krenari dhe bukuri nga majat e piedestaleve të tyre, shkëmbinjve natyrorë, teksa në popull nderohet kulti i tyre si simbol i zanave shqiptare. Diku, edhe kulti i dhisë Amaltea, që ushqeu me qumështin e saj Zeusin kur ai ishte fëmijë. Kulte, pandehma, rrëfime fantazmagorike, shumë gjëra mund të themi edhe ne sot për bukurinë, funksionin, forcën dhe fuqinë e brirëve sulmues e mbrojtës, duke e lidhur këtë edhe me dëshirën apo parapëlqimin e Gjergj Kastriotit Skënderbeut për të mbajtur në përkrenare pikërisht atë simbol. *“Kastriotët, midis lindjes dhe perëndimit, mbanin stemën e shqipes me dy kokë por e veçanta është se Skënderbeu mbajti veç saj, si personale, përkrenaren e famshme të tij. Çfarë do të thotë ai me ato dy brirët e cjapit? Kujt i drejtohej ai me ato simbole surrealiste dhe përse fisnikë të tjerë shqiptarë pas tij ose njëkohësisht me të nuk e mbanin atë simbol? Mos ndoshta duheshin merita të caktuara për të mbajtur një përkrenare me të tilla simbole? Përse kjo përkrenare u transportua brez pas brezi dhe u ruajt në muzeun e Vienës?”*

“Bunari” nis e trazohet, autori shpjegon, hulumton, ai futet thellë në mite e legjenda, kërkon në arkivat e mendjeve të personazheve të tij, në përfytyrime, e mbi të gjithë na adreson qartë dhe saktë se çelësi i enigmave dhe mistereve mund të gjendet nëse kërkojmë në kulturën e popullit, në dijet, në bisedat dhe fjalët e tij të mençura, në rrëfenjat, sentencat dhe batutat, në këngët popullore, në ligjërimet, vajet dhe rritet e një populli kur ai shpreh dhembjen, hidhërimin, kur ai shpreh ndjenjat e gëzimit, kur feston, kur me britma e pasthirma jep lajmin e rrezikut apo të shporrjes së armikut, lajmin e fitores....Shkrimtari e kërkon kudo këtë shpjegim, edhe në kulturën e lashtë pagane, edhe në dallgët kulturore, filozofike, folklorike, studimore: *“Simbolizmi i dhisë lidhet me Perëndinë Pan, ndërsa brirët e dhisë datojnë në kujtimet e hershme primitive...Babilonasit kishin vetë një simbol dhe simbolikë të tillë në jetën e tyre që lidhej me Bricjapin dhe duke u mbështetur në këtë simbol shkencëtarët dhe ndërtuesit ndërtuan tempullin e parë. Brirët e dhisë kishin simbolizuar thelbin e Tempullit. Por, përveç kësaj që brirët e dhive simbolizojnë ndërtimin e Tempujve apo shtëpive të perëndive, vetë dhitë njihen si përfaqësuese aktive të seksulitetit mashkullor, madje edhe si simbole të lidhura tek vetë pjelloria e natyrës...”* Edhe në popull, edhe te populli shqiptar, brirët kanë qenë dhe janë simbole të parapëlqyera, të kërkuara. Shenja të tyre i sheh edhe sot, majë çative, mbi dyer në hyrje të shtëpive, majë grazhdeve, në mjedise mbjelljeje dhe korrjesh, ku nis dhe zhvillohet jeta...Ato konsiderohen shanse fati, shëndeti dhe begatie për jetën dhe të ardhmen.

DY BRIRËSHI I PËRKRENARES SË SKËNDERBEUT PËRFAQËSONTE PERËNDIMIN

Mendimet trazohen:*“Ai kishte fuqi Hyjnore, po, po duhet besuar. Kjo duhet besuar. Jo më kot ai ishte i përzgjedhur. Jo më kot ai mbajti dy brirët në kapelen e tij aty nis e fillon ftillimi i arsyes. Ai ishte i pari...”* Ndonëse ishte njeri real, nga bëmat Ai adhurohej dhe nderohej si njeri i rrallë, i veçantë, me një fuqi që i tejkalonte fuqitë e reales dhe të natyrshmes. Përgjithësisht në mesjetë njerëzit e nderonin një kalorës luftëtarë, e nderonin, e adhuronin apo dhe i frikësoheshin një mbreti apo udhëheqësi. Por Gjergj Kastrioti Skënderbeu ishte i një lloji tjetër, ai nuk ishte një “mbret” (Zot apo Princ) që qëndronte i ulur në poltron me skeptër në dorë e kurorë në kokë dhe prej andej drejtonte me urdhra popullin dhe ushtrinë. Jo, ai ishte një luftëtar i madh, që ndodhej çdo çast në krye të kalorësisë apo këmbësorisë së tij sulmuese dhe luftonte me shembullin e tij ashtu si dikur Akili, Hektori, Aleksandri, Cezari, Pirroja...

→

“Bunari” ka në qendër një personazh origjinal dhe interesant rreth të cilit autori vërtit e thur si rreth një boshti fabulën e romanit. Nuhi Karamuca, të cilit i kanë dalë dy brirë në ballë e që tashmë, pikërisht për ato brirë është bërë objekt studimi, eksplorimi nga shkencëtarë, mjekë të shumë vendeve të botës në spitalin Shën Gjergj të Britanisë.



Viron Kona dhe Fatmir Terziu

Bashkëkohësit e tij, e, veçanërisht Barleti na sjellin shembuj të panumurtë të ndeshjeve dhe dueleve që ai kishte bërë në Pallatin Perandorak të Osmanëve ashtu dhe pas kthimit në Arbëri, kur dy ushtritë armike ndodheshin përballë njëra - tjetrës dhe ai i përgjigjej trimërisht dhe pa iu trembur syri sfidave të gjeneralëve dhe pashallarëve osmanë, që kërkonin lavdinë në ndeshje direkte me kryetrimin shqiptar. Ata shpesh herë edhe njiheshin, ishin rritur duke mësuar bashkë artin mjeshtëror të luftimit me armët luftarake të kohës, kishin mësuar bashkë artet marciale të luftimeve trup me trup në shkollën e jeniçerëve, kishin bashkëpunuar dhe hishin hedhur në beteja të përbashkëta dhe në bedenat e kalave duke u ndeshur me kundërshtarët për jetë a vdekje, ia njihnin aftësitë dhe zakonet njëri-tjetrit, emri i Tij ishte në elitën e kryeluftëtarëve dhe të gjeneralëve të Sulltan Muratit të Dytë, ndaj dhe ai e pagëzoi me emrin Skënderbe (Aleksandër).

Skënderbeu, jo vetëm nuk u shmangej sfidave të dyluftimit, por ndodhte që edhe ai vet kur e shihte të nevojshme i sfidonte pashallarët turq në dyluftime, duke dalë përherë fitimtar. Bëmat e tij u përfshinë shpejt në gjirin e legjendave, morën përmasa mitike, ndaj emri i lakohej dhe përmendej që nga shtëpitë e thjeshta fshatare e qytetare të kohës e deri në sarajet e mbretërve më të famshëm të lindjes dhe të perëndimit. S`kishte luftëtarë atëherë, edhe të Arbërisë, edhe të Perandorisë Osmane që nuk e përmendte emrin e tij. Por, dhe shtetet dhe popujt nën sundimin e Perandorisë Osmane, edhe Europa që rrezikohej nga ato pushtime, i kishin kthyer sytë nga Skënderbeu. Ata e kërkonin atë luftëtar të madh që t`i udhëhiqte, që të mbronin Europën nga vërshimi osman.

Atëherë, simboli i dy brirëve ishte bashkëkohorë, ai përfaqësonte një metaforë të besueshme dhe të dëshirueshme. Madje, aso kohe, rrëfehej se në lashtësi, dashi me dy brirët e tij përfaqësonte Lindjen, Perandorinë e Persëve të vjetër, kurse Cjapi dy brirësh përfaqësonte Perëndimin, Aleksandrin e Madh të gjithëfuqishëm që shkatërroi Perandorinë Persiane. Besimi i europianëve te Skënderbeu, që identifikohej shpesh me fuqinë e Aleksandrit, rriste besimin tek Ai si një udhëheqës dhe gjeneral gjenial ushtarak. Koha tregoi se ai e kreu detyrën, ndonëse i vetëm me popullin shqiptar, ai e ndali vërshimin osman, u shndërrua në një mur të pathyeshëm dhe të pakapërcyeshëm duke e shpëtuar Europën, një kontribut real dhe monumental ky i Skënderbeut, i heroizmit dhe sakrificave sublime të popullit shqiptar. Duke u përballur me Perandorinë Osmane, Gjergj Kastrioti Skënderbeu tregoi me vepra se ishte fund e krye perëndimor. Miqtë e tij ishin perëndimorët, deri në fund të jetës. Qytetërimi i përkiste perëndimit dhe, Gjergj Kastrioti ishte elitë e atij qytetërimi. Historia e kryetrimit tonë dhe legjendat që krijoheshin natyrshëm rreth tij vazhduan edhe më pas, në dekada e shekuj e deri në ditët tona, teksa piedestali i tij lartësohet, emri bëhet më heroik dhe më i lavdishëm, ndërkohë që harmonizohet plotësisht edhe me “Shën Gjergjin” që konsiderohej atëherë perëndi mbrojtëse e Arbërisë. Ka kohë që ai është në legjendë dhe prej saj s`ka askush forcë që ta nxjerrë, sepse Ai dhe vepra e Tij janë vet legjenda.

ADHURIM

Pas 500 vjetëve, më në fund shqiptarët arritën të shihnin nga afër armët origjinale të kryeheroit shqiptar. Në 100 - vjetorin e Pavarësisë, ato i sollën nga Vjena (dy shpata, njëra prej të cilave ceremoniale), përkrenaren, një pikturë në vaj, gravura e përmasave të mëdha të kodeksit me të dhënat e jetës së Skënderbeut...Përkrenarja peshon 3000 gramë, ajo është në ngjyrë të bardhë me rrafshe të arta dhe ka sipër një kokë dhie të artë me dy brinjë. Njëra shpatë është me dorezë kadifeje në të cilën shënohet emri i Skënderbeut dhe peshon 1300 gramë. Shpata tjetër është me dorezë lëkure, e cila nga pesha e rëndë dhe prej shenjave të gjakut që duken është e madhërishme, pesha e saj është 3.2 kilogramë.

Nëse armët dhe përkrenarja origjinale do të vazhdonin të ekspozoheshin ende te Muzeu ynë Historik Kombëtar, atëherë qindra dhe mijëra shqiptarë të tjerë, por edhe nga bota do të vazhdonin të vërshonin drejt tyre si drejt një peligrinazhi të madh dhe të pandërprerë. Skënderbeu ishte për shqiptarët bashkëkohës sa real aq edhe hyjnor, por i tillë mbeti edhe për ata që erdhën më pas, dhe për ne që jemi sot, edhe për ata që do të vijnë. Jo se ne, si një popull i vogël, kemi nevojë dhe i “krijojmë” heronjët dhe shenjtorët, por sepse ne i kemi realisht ata. Ata janë shtylla të Historisë sonë Kombëtare.

Aleksandri i Madh është mbiquajtur Dybrirëshi, por Ai e konsideronte vetveten të shenjtë dhe, me këtë shenjtëri, por dhe me aftësitë e mëdha ushtarake, sigurisht, ai arriti fitore të atilla që s`i kishte arritur askush përpara tij. Me Skënderbeun ndryshonte puna. Ai as lindi dhe as u rrit me aureolën mbrojtëse të shenjtërisë, ai e fitoi atë në beteja luftarake të jashtëzakonshme, ai kreu vepra të mëdha, që detyrimisht harmonizoheshin edhe me shenja nderimi të kohës siç ishte dhe mbajtja e asaj përkrenare me dybrirë. Ishin veprat e tij në shërbim të atdheut dhe të Europës që e bënë atë një udhëheqës legjendar. Hyjnizimi dhe adhurimi i emrit të tij në popull, përfshirja në mite e legjenda ishte rrjedhojë e bëmave heroike që ai me populliin kreu në dobi të atdheut. Fitoi kaq shumë qytetari mbajtja e dy brirëve në përkrenaren e Skënderbeut, saqë edhe sot është vështirë që të mendojmë një imazh ndryshe për heroin tonë, gjithnjë ai përfytyrohet me përkrenaren e tij, madje piktorët dhe skulptorët e paraqesin me atë përkrenare edhe në beteja (ajo peshon tre kilogram dhe doemos që do ta pengonte Skënderbeun në luftime). Aq më tepër që ai preferonte të ishte i lehtë në luftim, që t`i lejohej cdo lëvizje dhe shkathtësi, që të demonstronte lirshëm aftësitë dhe zhdërvjelltësinë e tij.

Kuptohet, përkrenarja me kokën e dhisë ishte një simbolikë, një shenjë nderimi, e cila besojmë se përdorej nga heroi ynë në çaste zyrtare dhe ceremoniale. A e pati vet Skënderbeu idenë e vendosjes së kokës së dhisë në atë përkeranare apo ia dedikuan për nder të veprave të tij, kjo është një pyetje që ende s`ka një përgjigje shteruese, por ajo që është më se e sigurtë është se ai e meritonte plotësisht atë përkrenare, atë simbolikë që adhurohej. Sa për emërtimet: mbret, zot, princ, kur flitet për Gjergj Kastriotin Skëndebeun, ato janë dytësore, roli dhe vepra e Tij i përfshin ato. Ai ishte dhe është Gjergj Kastrioti Skënderbeu, Heroi Legjendar i Kombit Shqiptar. Edhe Cezari nuk u bë Perandor, por ai mbeti në histori si Jul Cezari, më shumë se çdo Perandor i Romës.

SIKUR BOTA TË DINTE MË SHUMË PËR HISTORINË DHE KULTURËN SHQIPTAR

“Bunari” ka në qendër një personazh origjinal dhe interesant rreth të cilit autori vërtit e thur si rreth një boshti fabulën e romanit. Nuhi Karamuca, të cilit i kanë dalë dy brirë në ballë e që tashmë, pikërisht për ato brirë është bërë objekt studimi, eksplorimi nga shkencëtarë, mjekë të shumë vendeve të botës në spitalin Shën Gjergj të Britanisë. Aty vijnë dhe diskutojnë, studiojnë, pyesin, kërkojnë informacion, bëjnë shpjegime dhe interpretime. Edhe personazhi ynë Stefani, që është në rolin e studiuesit, bashkëbisedon dhe debaton, por edhe informon dhe hap shtigje të rrjedhave nga do të shkojë linja kryesore e romanit. Marrim vesh që, diku në atë zonë përqark kalasë, lindi dhe një fëmijë me brirë, që u zhduk pas disa ditësh... Libri që të intrigon është jetëgjatë, ka shumë vlerë dhe ndër vlerat e tij themelore është se të vë në mendime, të bënë që të mos e lëshosh nga dora, të bënë t`i kthehesh dhe t`i rikthehesh kësaj apo asaj faqeje, të meditosh për çfarë shkruhet, për idetë e guximshme që shkrimtari ynë i trajton thjesht dhe me bukuri tronditëse.

Duke lexuar, zhytesh në arsyetime, sa filozofike, artistike dhe historike, aq edhe nxitesh nga mendimi tundues e pyetës se sa mundësi kemi në shqiptarët për të plotësuar atë “boshllëk” atë “tullacëri” faktesh historikë, gjeografikë, kulturorë, gjuhësorë, arkeologjikë, etnografikë etj. Fijet janë, madje të shumta, por ato duhen tërhequr me kujdes, të shpleksen ngatërrimet e qëllimshme, të qartësohen situatat, të kërkohet në arkiva, të përqendrohemi me më shumë besim te dijet e thella të popullit deri te paganizmi i tij. Edhe sot, shmilasit e çermenikasit bëjnë be` apo betohen: “Për atë diell!”, “Për atë qiell!”, “Për atë hënë!”, “Për atë Dhe` që do të më tresë!”. Ata thonë Kyedheu, siç ne sot themi kryetar komune, ne themi kryetar shteti, ne themi kryetar bashkie...Kurse arbreshët, ta zëmë ata të Italisë, e ruajnë edhe më të pastër *kohën e tyre*, sepse ata u larguan menjëherë pas pushtimit dhe nuk ranë nën ndikimin osman. Gjithsesi, vet trevat shqiptare janë jashtëzakonisht të pasura, ato fshehin brenda vetes pasur shpirtërore marramendëse, që shfaqet në histori dhe folklor, në mite dhe legjenda, në krijimtari gojore: rrëfime, vargje, tregime, nëpërmjet këngëve, valleve, nëpërmjet zbulimeve arkeologjike dhe etnografike, nëpërmjet veshjeve dhe kostumeve, nëpërmjet punimeve artizanale të drurit, të baltës dhe të gurit...

Duke zbatuar një urdhër të Senatit Romak, ushtria romake nën drejtimin e Konsullit romak Pal Emili, në vitin 168 p.e.s plaçkiti dhe shkatërroi krejt rreth 70 qytete të Epirit dhe të Ilirisë. Sulltan Mehemeti Fahtiu (“Pushtuesi”) pas vdekjes së babait të tij Sulltan Muratit, i cili nuk ia arriti ta pushtonte dot kalanë e Krujës, u betua se do ta zhdukte nga faqja e dheut Kombin Shqiptar, racën shqiptare, gjuhën shqipe. Hakmarrja ishte e madhe, e jashtëzakonshme. Nëse pas pushtimit të Kostandinopojës më 1453, Mehmeti i Dytë dha urdhër që tre ditë e tre netë ushtarët dhe ushtria e tij të hakmerreshin me Kostandinopojën, kur erdhi koha që, 10 vjet pas vdekjes së Skënderbeut, ai arriti ta pushtonte Arbërinë, urdhëri dhe betimi i tij ishte që Kombi Shqiptar të shfarrosej, të rrafshohej në gjithçka, në ekonomi e kulturë, në legjenda dhe gjuhë, asgjë të mos ekzistonte, që në këtë truall të mos lindnin më njerëz të racës shqiptare, të mos lindnin më Skënderbej... Por nuk ia arriti. Arbëria qëndroi dhe mbijetoi. Edhe populli, edhe kultura, edhe legjendat, edhe gjuha, edhe kështjellat.

Sot ato po rrezatojnë edhe për brezat e rinj, edhe për popujt e botës. Ndonëse të shkatërruara në shekuj luftërash, kështjellat shqiptare janë sot simbole, janë tërheqëse për këdo, edhe për brezin e sotëm të shqiptarëve, edhe për brezat e të huajve që mbeten të mahnitur përpara historisë dhe madhështisë së tyre të dikurshme... Shqiptarët po i ringjallin, po i rigjallërojnë, po u japin jetë... Ata shkojnë në Baba Tomor, si dikur grekët e lashtë në Olimp. Festat pagane janë gjallëruar si dikur: Dita e Verës, Dita e rrushit... Në qytetet e lashtë po luhen pjesë tatrale, zhvillohen koncerte artistike dhe muzikore, çelen eskpozita, zhvillohen parada veshjesh, konkurse bukurie... Pasuritë kulturore nuk gjenden vetëm në libra, ato gjenden te muret e kështjellave, te çdo gur i tyre, te skenat teatrale, tek mozaikët dhe pikturat murale, te gdhendjet në gurë e drurë dhe vizatimet në shpella... Kurse toponimet? Ato janë me mijëra. Dhe, pikërisht, me “Bunarin”, Fatmir Terziu na nxit, na vë në mendime dhe na ofron me këto vlera të jashtëzakonshme që historiografia jonë duhet t`i trajtojë, t`i pasqyrojë, por dhe t`i pasurojë më tej duke u dhënë fytyrën dhe pamjen e dikurshme, forcën dhe rrezatimin që kanë pasur dhe kanë pasqyruar. Për fat të keq kemi ende shumë boshllëk të pazbuluar, të pa kërkuar, të pa ndricuar. Kemi “boshllëk” që duhet ta plotësojmë. Dikur, Pisistrati (tiran i Athinës) vuri një brezë të tërë shkrimtarësh që sistemuan Iliadën dhe Odisenë. E lehtë s`ishte, por edhe e pamundur jo, përderisa ata me ato mjete të atyre kohëve e rikrijuan Iliadën dhe Odisenë. Ne duhet të nxjerrim nga rrënoja dhe të sistemojmë dhjetëra e qindra legjenda, fjalë të urta popullore, të kërkojmë dokumente të tjera të vjetra të shqipes së shkruar, të zbulojmë të tjerë vendbanime dhe qytete të lashtë, të pasurojmë më tej këta që janë zbuluar. “Grinden” mes tyre historianët grekë dhe shtatë qytete greke për origjinën dhe vendlindjen e Homerit; “Grindemi” mes vetes ne shqiptarët për vendlindjen e Skënderbeut, heroit tonë kombetar. Kjo grindje është e bukur, sepse të mirën dhe të mirin të gjithë e duam. Nuk është gjë e keqe pse grindemi, por në këtë grindje të arrijmë të hedhim më shumë dritë, të zbulojmë më shumë, edhe për Gjergjin tonë, edhe për shumë e shumë detyrime të tjera që i kemi historisë dhe kulturës sonë kombëtare. Për këtë, mendjet krijuese e projektuese si kjo e Fatmir Terziut na ndihmojnë, na nxitin, na e ndriçojnë fushë pamjen...

Nëse atë nam të keq politik të politikanëve tanë do të zëvendësonim dot me namin e mirë të historisë dhe të kulturës sonë kombëtare, atëherë Shqipëria do të ishte ndër vendet më të përzgjedhur të botës për t`u vizituar. Sepse gjithnjë ka qenë mes më të fuqishmëve dhe ka mbijetuar trimërisht, madje shpesh, më në lashtësi, ka qenë një prej tyre. Ka qenë dhe është midis grekëve, romakëve, maqedonëve, ka qenë rrugë kalimi për udhëtarë nga e gjithë bota, ka qenë vend ku janë kryqëzuar rrugët e historisë, të betejave dhe të luftërave. Nga Jugu në Veri dhe nga Lindja në Perëndim të trojeve shqiptare gjen gjurmë të historive dhe njerëzve të jashtëzakonshëm. Por, bota, ka ende pak njohuri për historinë shqiptare, për kalatë: Rozafën, Krujën, Kaninën, Amantien, Lisin, Petrelën, Prezën, kalanë e Ali Pashës, Beratit, Gjirokastrës, Elbasanit, Tepelenës... Për qytetet e lashtë: Apolon, Butrint, Orikum, Bylys, Dyrrah, Scodër, Gajtan, Antipatrea, Antigone.... Por dhe sa heronj, objekte, qytete të nëndheshme, sa pasuri kulturore, arkeologjike, etnografike, folklorike etj.,janë të mbuluara nga balta e harresës dhe e pushtimeve? Ato janë me dhjetëra, me qindra, me mijëra. Duke u marrë ashtu siç duhet me to, ne do të ishim ndër vendet më të pasura të dheut, do të ishim vend peligrinazhesh, do të vizitoheshim nga miliona turistë, ashtu siç ndodh në Greqinë fqinje, ashtu sic ndodh në Romën përballë, ashtu siç ndodh në Stambollin aziatik dhe evropian. Sa herë shkojmë e vizitojmë këto shtete, ne shohim edhe shembëlltyrën tonë!

JETA NUK KA FILLUAR KUR KEMI LINDUR NE

Libri “Bunari” është një kambanë, një thirrje për shkencat historike, arkeologjike, etnografike etj., që të zbulojnë atë që është mbuluar padrejtësisht nga hiri i kohës, që është mbuluar dhunshëm për të tjetërsuar historinë dhe identitetin e një populli të lashtë. Dhe çelësin e kemi në duar, mjafton ta vëmë në lëvizje, gjithçka e kërkuar gjendet te populli, te gjurmët e tij, gjendet te gojëdhënat, te toponimet, te këngët dhe folklori, te pasuria e madhe shpirtërore e popullit, burrat dhe gratë, e veçanërisht te gratë, sepse janë ato që u mësojnë fëmijëve që në djep gjuhën shqipe, me fjalë, me përkëdhelje, me këngët e djepit që në thelb janë pjesë legjendash, rrëfimesh historike të trashëguara ndër breza njerëzish. Gratë, përgjithësisht qëndronin në vend, burrat shkojnë në kurbet, shkonin atëherë, shkojnë dhe sot. Ata shkonin në luftime dhe s`ktheheshin, kurse gratë ishin aty, në atdhe, rrisnin fëmijët, mbanin vazhdimin e jetës ilire-arbërore-shqiptare në tokën mëmë. Me pak fjalë, me disa batuta, me disa shprehje e fjalë të urta, apo me fare pak vargje, ky popull rrëfen histori dhe kulturë disa qindra vjeçare. E tillë është kënga “Mbeçë more shokë”, një këngë nizamësh e kënduar nga këngëtari i shquar Demir Zyko nga fshati Gjerbës i Skraparit. Një këngë me vetëm 12 vargje, por me një përmbajtje të thellë unike, një këngë nga më të bukurat e këngëve të nizamëve. Teksti i saj përbëhet nga fjalët e një ushtari që po jep shpirt diku në rërat arabike, pranë Urës së Qabesë dhe që shpreh dëshirën për t`i çuar falë me shëndet nënës së tij që e pret atje larg, teksa i jep porosi që ta shesë kaun e zi, që të mbajë familjen, pasi ai nuk do të jetë më në gjendje t`i ndihmojë ekonomikisht: *Mbeç, more shokë, mbeçë*/Përtej Urës së Qabesë/Falë *me shëndet nënësë,*/*Kaun e zi le ta shesë*. Më tej poeti popullor shpreh dhembjen e thellë dhe fjalët e birit për nënën, e cila po e pret t`i gëzohet, ta martojë dhe të trashëgojë jetën, por, djali: Në pyestë nëna për mua/*I thoni që u martua*/*Në pyestë se ç`grua mori*/*Tre plumba te kraharori*. Në këngë flitet për vdekjen por vdekja nuk përmendet:*Në pyestë se ç`kalë hypi*/*Atje tek hypën meiti*/*Në pyestë se ç`krushq i vanë*/ *Sorrat e korbat e hanë*. Teksa shkrimtari ynë Ismail Kadare me të drejtë thotë: “Në qoftë se ndonjë ditë popujt që kanë vuajtur dikur nën sundimin otoman, do të binin në marrëveshje për të ngritur një monument të përbashkët në kujtim të miliona bijve të tyre të vdekur gjatë shërbimit ushtarak në ushtrinë shumëkombëshe osmane, vështirë se mund të gjendet një tekst më universal për t`u gdhendur mbi këtë monument se kënga shqiptare e Urës së Qabesë.”

Kurse populli i Labërisë së Vlorës, nëpërmjet këngëtarit kallaratas Zeqo Hoxha, përcjellë këngën: “Ç`u këput një këmbë mali”, e cila është njëherazi vajtim dhe mallkim kundër pushtuesve osmanë, që i kishin shkaktuar aq të zeza popullit: Ç`u këput një këmbë mali,/O Stamboll, të djegtë zjarri./Djemtë tanë, hajmedet,/djepi that` e vatra shkretë.”

(vijon në faqen 38)

Rruga e Arbërit nr. 163
gjenezë

Epopeja e fisit Murrja në Luzni të Dibrës ka filluar me lindjen e këtij fisi në shekullin e XVIII, si pasardhës të fisit Lika. Pinjollët e parë janë Halili dhe Osmani.

Dritëhijet e pinjollëve të parë të fisit **Murrja** - **Halili** dhe **Osmani**

Nga **ARIF MURRJA***

I -ASPEKTI METODIK

Punimi "Dritëhijet e pinjollëve të parë të fisit Murrja" është vazhdim i studimit "Kronologjia dhe gjeneza e fisit Murrja në Luzni të Dibrës". Për të evidentuar pinjollin/pinjollët e parë të fisit Murrja periudha nga sot e deri në origjinë është perceptuar si piramidë dhe është segmetuar në breza bilogjikë. Baza e piramidës është gjenerata e sotme (1991-2020) dhe gjatësia e brezit bilogjik është marrë në konsideratë si periudhë kohore 30 vjeçare. Pasi janë vendosur faktet e gjetura në literaturën historike në "piramidën" e mëposhtme jemi orjentuar në brezin e parë të fisit Murrja.

II –ANALIZA DHE DISKUTIME

Në kronologjinë e fisit Murrja, fakti historik më i hershëm, i shkruar dhe i pakontestuar është vrasja e Isufit nga ushtarët turq në vitin 1882 (Kolgjegja, 1991:38-41; Ndreu, 2003:163-164 & Frashëri, 2012). Viti 1882 përfshihet në segmentin kohor 1871-1900, që i përket gjeneratës së gjashtë, duke filluar nga origjina Lika, ndërsa si fis i mëvetësuar Murrja është gjenerata e tretë.

këve. Fisi Lala i ndihmuar nga banorët e tre fshatrave (vetëm një fshat nuk mori pjesë) u organizuan dhe vranë të gjitha antarët dhe ismiqarët e fisit Allamani. Nga ky konflikt i përgjakshëm shpëtoi vetëm një vajzë e vogël, e cila nuk ishte e fisit Allamani, por e ismiqarit të kësaj familje i ardhur nga Lura, ku disa thonë ishte nga fisi Vladi e disa të tjerë mbesa e këtij fisi. Vajzën e rritën Lalët, si bjën e tyre. Ajo u bë shumë e zonja, puntore e madhe, ku dhe sot kemi toponime të staneve që lidhen me famën e saj. Vajza u martua në Luzni dhe thirrej Murrja. Lindi dy djem, të cilët trashguan për mbiemër emrin e saj Murrja. (Burimi: Sami dhe Hekura Lala. Gojëdhënën e kanë dëgjuar nga pleqtë në mexhelise).

Kur fëmijët e Murres ishin të vegjël, Kreu i Malit të Luznisë (para vitit 1800) ishte "Grethi", kështu quhej fisi i Sefere në atë kohë. Grethi ishte plaku i parë, i fisit. Ai iu thotë djemve që të vritnin djemtë e Murres, sepse sipas tij, kur të rriten nuk do të drejtoni ju, por ato. Por djemtë e Grethit nuk pranun. Ato i thënë babait se nëse do të bënin një gjë të tillë, do të turpëroheshin dhe do të humbisnin emrin e mirë që kishte krijuar fisi i Sefere (Burimi: Ibrahim Murrja dhe Ilmi Murrja).

-Dritëhijet e Halilit si pinjoll i parë i fisit Murrja në Hotesh, Luzni

Në lidhje me historikun e Halilit ka dy burime gojdhënore. Burimi i parë, flet për lidhjen e Halilit me perandorinë Osmane. Për shak të kësaj lidhjeje Ai u fuqizua ekonomikisht dhe u zhvendos në fshatin Hotesh (Burimi: Musa Murrja dhe Ilmi Murrja). Burimi i dytë, flet për largimin e Halilit për shkak të grindjeve/zënkave me të ëmën e tij (Burimi: Ibrahim Murrja). Sipas këtij burimi thuhet se Halili u bë shumë arrogant dhe i dhunshëm ose beterr siç i thonë në gjuhën lokale. E ëma e këshilloi disa herë të birin e saj, që të kthehej në rrugë të mbarë, por Ai vazhdonte me sjelljet e tij jo normale/të këndshme. Meqë i biri nuk iu bind, ajo vendosi që ta vriste atë. Halili nga frika detyrohet të largohet nga fshati. E ëma e ndoqi/gjurmoi duke e detyruar Halilin, të kërkonte ndihmë tek Karahsani në Brezhdan. Fisi i Karahsanit në Brezhdan njihet si një nga katër qendrat kryesore të administrimit të Dibrës në perandoria Osmane. Karahsani, Agolli, Xhilaga në Dibër të Vogël/Poshtme dhe Hoxholli në Dibër të Madhe/Epërme ishin "oxhaqe". Titulli "oxhak" ishte ofiq i perandorisë Osmane për të administruar Dibrën.

Tregtari turk ose tuxhari, siç njihej në atë kohë reagon ashpër/egërsisht, duke goditura barbarisht me gërbaç fëmijën. Halil Murrja ishte prezent në këtë ngjarje. Për shkak të detyrës ishte i armatosur me hutë (armë artizanale e kohës që kishte vetëm një shkrepje baruti). Ai duke mos duruar rrahjen barbare të fëmijës, qëllon për vdekje tregtarin. Vrasja e tregtarit tronditi marrëdhëniet e Karahsanit me adminsitratën turke. Karahsani i detyruar nga ultimatumi i administratës lokale turke, nxorri urdhrin për të vrarë Halilin.

Menjëherë vjen reagimi i nënës së tij nga Luznia. Ajo i dërgon «plakun» (personi që sipas traditës së Maleve të Dibrës ishte gjyqtar për sqarimin e çështjes në fjalë) dhe i bën të ditur Karahsanit se: -Nëse, djalit të saj i prekej qoftë edhe qimja e flokut do të merrete hak (hakmerrej). Ajo i kujtoi Karahsanit se i kishte dal borxhit që të mos mbante djalin e saj. Karahsani i detyrur nga fjala e dhënë anullon urdhërin e vrasjes, por me kusht që Halil Murrja të largohej nga njësia administrative e tij (Brezhdani).

Kështu, Ai përfundimisht vendoset në fshatin Hotesh, në vendin, ku dhe sot quhet kodra e Halilit. Gjithsesi shërbimi te Karahasani në Brezhdan i krijoj mundësinë Halilit që të lidhej me administratën e perandorisë Osmane dhe "Mihajri" ose thënë ndryshe vula e kreut të Luznisë iu dorëzua Murres nga Gredhi i Sefere. Murrja bëhet Kreu i Luznisë.

Halili me disa nga vllezërit nga ana e babait (Skuka) "zabtuan" territorin më të mirë të fshatit Hotesh. Fshati ndahet në dy pjesë nga rruga kryesore që kalon për mes tij. Në të majtë ose poshtë dhe rrezë brigjeve të lumit Drini i Zi janë vendosur Murret dhe Skuket. Halili u martua dhe u shtua me pesë djem Elezin, Hasanin, Hysenin, Tafën dhe Limanin. Trungu i Halilit u shtua shumë dhe më pas u zgjerua në fshatin Selane, Trenë e Trepçë në Topallti (quhej atëherë Dibra e Vogël/Poshtme matan Drinit të Zi).

III -PËRFUNDIME

Epopeja e fisit Murrja në Luzni të Dibrës ka filluar me lindjen e këtij fisi në shekullin e XVIII, si pasardhës të fisit Lika. Pinjollët e parë janë Halili dhe Osmani.

Osmani qëndroj në fshatin e lindjes Lishan i Epërm dhe u shtua me tre djemë. Hijedrita e tij dhe fëmijëve është vesi i kakçëkllëkut, ndërsa dritëhija e tyre është "dora e mbarë" në plaçkitje, ku të dëmtuarve nga vjedhja iu shtohej edhe më shumë pasuria. E pambeshtetur shkencërisht, por kjo është arsyja që trungu i Osmanit nuk është shtuar shumë.

Halili u zhvendos në fshatin Hotesh dhe u shtua me pesë djemë. Hijedrita e tij është sjellja arrogante kur ishte në rini, ndërsa dritëhija është bashkëpunimi me administratën e perandorisë Osmane, ku dhe mori "mihajirin" ose vulën e Kreut të Luznisë nga Grethi i Sefere. Trungu i Halilit u shtua shumë dhe u zgjerua më vonë në fshatrat Selane, Trenë dhe Trepçë përballë Hoteshit në anën tjetër të lumit Drini i Zi. Pasardhësit e Halilit u shquan shumë brez pas brezi, ku spikasin Elez Murrja, Isuf Murrja, Ahmet Murrja, Zenel Murrja, Halil II, Myftar Murrja, Elez II, Xhetan Murrja, Vesel Murrja, Sadik Murrja etj.




Figura 2.1 *–Segmentimi i periudhës së studimit në breza biologjik (Burimi: Autori)*




Figura 2.2 *–Dy pinjollët e parë të fisit Murrja (Burimi: Autori)*

Studiuesi i historisë së Dibrës, Hazis Ndreu, në librin e tij "Dibra në Udhën e Historisë" shkruan: "-Isuf Murrja, biri i atdhetarit Elez Murrja, që pat udhëhequr Luznisë kundra Hajerdin Pashës". Babai i Elezit është Halili, i cili bashkë me të vëllanë e tij Osmanin janë pinjollët e parë të fisit Murrja. Halili dhe Osmani janë pasardhësit e Skuk Likës, i cili u martua dy gra. Katër djemtë e lindur me gruan e parë Mani, Ademi, Rizani dhe Baftjari trashëguan mbiemrin Skuka; ndërsa dy djemtë e lindur me gruan e dytë nuk mbajtën si mbiemër emrin e të atit, por morën si mbiemër emrin e fshatit të lindjes së nënës së tyre nga Qaf-Murra e Katër-Grykëve.

Legjenda e bukurisë dhe e madhështisë së gruas që u trashëgoi emrin e fshatit të vajzërisë për mbiemër dy djemve të saj ka lënë gjurmë edhe në fshatin Qaf-Murrë. Gojëdhëna vendase e banorëve të Qaf-Murrës thotë: -Fisi Lala në Qaf-Murrë kishte hyrë në konflikt territoresh me fisin Allamani të Matit. Allamani ishte i fuqishëm ekonomikisht. Më pas konflikti me fisin Allamani u zgjerua jo vetëm me fisin Lala, por edhe me banorët e tjerë të fshatrave të Katër-Gry-

Pasi u rriten, dy vëllezërit Murrja, Halili dhe Osmani u ndanë. Osmani qëndroj në Lishan të poshtëm, ndërsa Halili u zhvendos në Hotesh. Historia induviduale e tyre iu ngjan dy anëve të monedhës, ku njëra anë është mossukesesi (e keqja) dhe ana tjetër është suksesi (e mira).

-Dritëhijet e Osmanit si pinjolli i parë i fisit Murrja në Lishan të Epërm, Luzni

Sipas gojëdhës Osmani dhe fëmijët e tij Tahiri, Sinani dhe Rrahmani morën "kaçakllëkun". Kështu quheshin ato që dilnin për plaçkitje (Burimi: Ilmi Murrja). Telepatia na bën të mendojmë se kjo ka qenë arsyeja që trungu i Osmanit në Lishan të Poshtëm sot e mot nuk i ka kaluar 15 shtëpi apo familje. Kjo është e keqja, ndërsa e mira shpjegohet me legjendën e mëposhtme vendase.

Plaçkitja e tyre ishte në numër të kufizuar. Ato merrnin disa krerë bagëti dhe jo të gjithë tufën, disa okë (njësi e vjetër peshe) bereqet dhe jo të gjithë prodhimin. Thuhet se ku plaçkisnin ato, të dëmtuarve nga vjedhja u shtohej edhe më shumë tufa e bagëtive, bereqeti në arë etj. (Burimi: Ibrahim Murrja).

E ëma e Halilit i kërkon Karahsanit, t'i dorëzonte vocin (djalin) sepse kishte vendosur ta vriste si pasojë e sjelljeve arrogante. Me gjithë kërkesën e Murres, Karahsani nuk e dorëzoi Halilin, duke i thënë se është në besën tij. Atëherë, e ëma e Halilit i përgjigjet: -Dëgjo këtu Karahsan! Unë e njohë djalin tim dhe më mirë është ta vras me dorën time; sepse, nëse nesër më gjen gjë vocin do të biem në hasmëri dhe nuk e lë gjakun pa marrë. Por Karahsani e bindi Murren, se Halili do të ishte nën kujdesin e tij dhe se nuk do t'i ndodhte asgje e keqe. Kështu u ra dakord dhe Halili ndejti tek Karahsani.

Karahsani e angazhoi Halilin në sistemin ushtarak të tij, për të mbajtur qetësinë publike në njësinë e tij administrative. Brezhdani ishte qendër kryesore ku bëhej tregtia e gjithë Dibrës së Poshtme. Karvanet e kuajve me karroca, të ngarkuar me mallra vinin nga Shehri i Dibrës (Dibra e Madhe sot apo Dibra e Epërme më parë). Një ditë prej ditësh, po kalonte një karvan kuajsh me mallra ushqimore në mes të fshatit. Një fëmijë i vogël zgjat dorën dhe merr një kokërr sheqeri (karamele e rrumbullakët e kohës).

** Profesor i lëndës "Menaxhimi i Riskut të Biznesit" në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit në Universitetin Bujqësor të Tiranës. Është "Doktor i Shkencave Ekonomike" dhe ka titullin akademik "Profesor i Asociuar". Ka botuar dhjetra artikuj shkencor në fushën e ekonomisë dhe biznesit në revista me impakt faktor dhe konferenca shkencore ndërkombëtare. Është autor dhe bashkautor në katër teksteve universitare, si: Baza Finance, Financat Lokale dhe Qeverisja, Drejtim i Fermave dhe Menaxhim Risku.*

cyan magenta yelloë black

Libri i ri "Lufta e fshehtë në Shqipëri" i Roderick Bailey, profesor në universitetin e Oksfordit, kushtuar misioneve britanike, u vlerësua nga juria ndërkombëtare e konkursit si "vepra shkencore më cilësore kushtuar antifashizmit të popullit shqiptar" në kuadër të 75-vjetorit të Çlirimit.

Misionet angleze *dhe përshtypja e tyre për* **krerët dibranë** *gjatë Luftës*

Nga **RODERICK BAILEY**
Historian, Universiteti i Oksfordit, Britani e Madhe


Në nëntor, siç do të kujtonte Ridëlli, veprimet e gjermanëve përreth Dibrës i kishin bindur shumë vendas se nuk ia vlente të bënin qëndresë. Prej veprimtarisë së gjermanëve misioni kishte mbetur pa lidhje telegrafike me Kajron dhe ishte detyruar që të fshihej dhe të mbështetej tek vendasit për strehim dhe mbrojtje. "Ishte tashmë një çështje mbijetese më tepër se sa çdo gjë tjetër, prandaj Toni Simkoks dhe Majkëll Lis dhe unë u tërhoqëm në shtëpinë e një pjesëtari të familjes Lita, i cili jetonte lart mbi shpatet e malit të Korabit dhe mjeti kryesor i jetesës ishin inkursionet në Kosovë për të grabitur dele. "Kaluan javë dhe nuk kishin shumë për të bërë. Ridëlli dhe Lis bënin garë se kush t'i rriste më tepër mustaqet. Në mbrëmje ata luajtën me letra dhe vunë bast me stërlina dhe mushka, por asnjë shumë nuk ia kërkuan ndonjëherë njëri-tjetrit". Erdhën Krishtlindjet; "ziemë një dhi" dhe "si i ftuar nderi, m'u desh të haja një nga sytë e saj" dhe "zbukuruam një pemë me fishekë." "Të gjithë pranuam se, pas luftës, çdo Krishtlindje do të vinim një fishek ose krehër fishekësh mbi pemën e Krishtlindjeve. Unë e bëra këtë për vite me radhë."

Në janar, duke kërkuar për të mbijetuar nga misioni i Dejvisit në pjesën perëndimore, Ridëlli takoi Xhon Dejvisin dhe Gregson-Ollkotin, të cilët kishin qëndruar në arrati që nga periudha e Krishtlindjeve. Pastaj, kur Hiberti erdhi nga Dega me një aparat ndërlidhje, misionit iu rikthye lidhja telegrafike. Ishte kërkuar një lëshim me parashutë që nga nëntori, që do të ishte lëshimi i parë për Ridëllin, por, kur ai u krye, vendasit i vodhën gjysmën e rezervave, por gjithsesi u shtuan shpresat se ata do të ishin aktivë. Në shkurt, Ridëlli dhe oficerët e tij po i zgjeronin përsëri kontaktet me familjet, krerët dhe fiset vendase. Ridëll ishte kryesisht në kontakt me familjen Kaloshi, Majkëll Lis me familjen Lita, ndërsa Hibert dhe Simkoks kryesisht me Muharrem Bajraktarin. Pasi u larguan Hends dhe Haiberdin, një forcë e përbashkët e përbërë nga xhandarë dhe gjermanë u dukën në luginë, dogjën shtëpitë dhe pyetën se ku gjendeshin britanikët. Pastaj, i erdhi radha për t'u larguar grupit të Ridëllit. Gjermanët u tërhoqën nga mesi i prillit, kështu Ridëlli dhe njerëzit e tij iu rikthyen punës.

Zhgënjimi i misionit u rrit, sepse përpjekjet e tij nuk sollën shumë rezultat. Lidhur me familjet dibrane, si, për shembull, familjen Kaloshi, Hibert shkroi më vonë:

Në zonën e Dibrës anarkia për shkak të drejtimit nga ana e krerëve shkon në ekstrem. Pothuajse nja dhjetë prej këtyre krerëve kontrollojnë zonën dhe secili ka zonën e vet të ndikimit e përpiqet gjithmonë që ta shtrijë drejt asaj të fqinjit. Mburrja për pasurinë dhe ndikimin personal qëndron në bazë të politikës së tyre. Ata flasin shumë për patriotizëm, por është e vështirë në realitet të gjesh edhe gjurmën e tij më të vogël në parime apo në praktikë ...

Çdo dibran të deklarohet i gatshëm për të luftuar gjermanët; flet me fjalë të zjarrta për patriotizmin e tij dhe nëse është e mundur për aktivitetin që ka pasur familja e tij në të kaluarën. Këto rrëfime janë të



Harta e vendeve, bazave, në Veri, ku vepruan misionet angleze gjatë luftës.

Majori anglez jep një vlerësim për numrin e ndjekësve të tij dhe përmend të gjithë fqinjët që janë nën ndikimin e tij dhe tepër të gatshëm për ta ndjekur. Përmend shifra prej 2000 vetash, por faktet më vonë dëshmuan se nuk kishte në dispozicion më shumë se 50 vetë. Ai shpreson në këtë mënyrë që të sigurojë furnizime nga britanikët dhe kështu të grumbullojë të tjerë...
Ata i kanë krijuar vetes një reputacion të jashtëzakonshëm për mikpritjen, saqë thonë se kur je n ë konakun e tyre, të gjitha gjërat e tua janë të sigurta dhe do të të plotësohen të gjitha dëshirat...

tepruara dhe kalojnë çdo cak. Ai jep një vlerësim për numrin e ndjekësve të tij dhe përmend të gjithë fqinjët që janë nën ndikimin e tij dhe tepër të gatshëm për ta ndjekur. Përmend shifra prej 2000 vetash, por faktet më vonë dëshmuan se nuk kishte në dispozicion më shumë se 50 vetë. Ai shpreson në këtë mënyrë që të sigurojë furnizime nga britanikët dhe kështu të grumbullojë të tjerë...

Ata i kanë krijuar vetes një reputacion të jashtëzakonshëm për mikpritjen, saqë thonë se kur je n ë konakun e tyre, të gjitha gjërat e tua janë të sigurta dhe do të të plotësohen të gjitha dëshirat. Majori Ridëll mund të përmendë shumë raste vjedhjesh të gjërave të tij në një shtëpi dibrane, por, nëse do ta bënte këtë, nuk do t'i mjaftonin faqet e raportit. Nëse ekziston mikpritja, është vetëm për interes të ndonjërit prej krerëve që është me ju dhe kujdeset për ju me shpresën se kjo do t'i shërbejë qëllimeve të tij. Kur keni nevojë për strehim dhe jeni në arrati, po të mos keni ndikimin e një kreu për t'iu ndihmuar, një fshatar do t'ua mbyllte derën dhe nëse do ishte e nevojshme do t'u shtinte për t'iu bërë që të largoheni...

SOE kishte shpresuar për një kohë të gjatë që të arrinte diçka me anë të Muharrem Bajraktarit. I mërguar në vitin 1930, për pjesëmarrje në intriga kundër Zogut, ai ishte kthyer pas pushtimit italian, kishte ngritur një çetë dhe përpara se të arrinte Mëklini, ishte një nga pak guerilasit, emri i të cilit kishte arritur deri tek britanikët. Megjithatë, që me ardhjen e gjermanëve, ai kishte bërë shumë pak dhe kur misioni po bashkëpunonte me të, në mënyrë që ai të ishte aktiv, ai kërkoi subvencione të çuditshme në ar përpara se të vepronte, dhe të mjaftueshme për të garantuar që çdo forcë e krijuar prej tij, t'i rezistonte reprezaljeve të gjermanëve. "Muharremi nuk është budalla... Ai e dinte se kur gjermanët ta thyenin rezistencën dhe të shkatërronin ndonjë zonë të veriut në shenjë reprezalje, njerëzit e zhgënjyer do t'i braktisnin krerët e tyre." Në të vërtetë, ai mund të bënte rezistencë si "shembulli më i shkëlqyer dhe më i plotë i krerëve shqiptarë të veriut." Ai ishte, gjithashtu, "shëmbëlltyra më e afërt me një xhentëllmen, që ky mision kishte gjetur në Shqipëri." Ai ndihmoi çdo mision aleat që kalonte nëpërmjet Lumës edhe gjatë dimrit, duke bërë të pamundurën, dhe kurrë nuk e konsideroi misionin sikur të kishte ndonjë detyrim ndaj tij." Por, ai nuk luftoi kurrë dhe, meqenëse furnizimet mund t'i jepeshin vetëm shqiptarëve që angazhoheshin në luftime, e gjitha ajo që britanikët i dhanë atij ishin "50 stërlina të arta, një armë e lehtë automatike *Bren* dhe një *Marlin SMG*".

...Në një raport që Iden (ministër i Jashtëm i Britanisë së Madhe) i dërgonte Çërçillit (kryeministër) atë verë jepet një shembull tipik i pikëpamjeve të *Foreign Office*-t. Çërçilli kishte marrë një telegram nga Brod, që nënvizonte "kërcënimin e vërtetë nga ana e gjermanëve" me të cilin po përballeshin partizanët në Dibër dhe se situata "e luftës civile nuk përbënte tashmë një problem serioz". Çërçilli i dërgoi një promemorie Idënit si më poshtë: "Më dërgoni një shënim lidhur me këtë, ku të tregohet se me cilën anë jemi." Në përgjigjen e Idenit, që ishte përgatitur tre javë pas kalimit të partizanëve në veri dhe sulmit kundër Kupit, evidentohej qartë se FNÇL ishte një lëvizje "e majtë," "me një element të fortë komunist" dhe "e vetmja organizatë në Shqipëri që po luftonte në mënyrë aktive kundër gjermanëve." Aty shtohej, megjithëse nuk ishte aq e saktë, se ndikimi i FNÇL "kufizohej vetëm në jug" dhe ekzistonte mundësia e pajtimit me Abas Kupin. Dhe kur Brod raportonte nga fillimi i gushtit se situata mund ta kërkonte tërheqjen e Mëklinit, *Foreign Office* mbajti të njëjtin qëndrim si në të kaluarën: "Në këtë fazë të luftës nuk duam të angazhohemi tepër me njërën anë ose me tjetrën dhe unë jam kundër tërheqjes së oficerëve të ndërlidhjes nga Kupi," shënonte në protokollin e mbledhjes *Armine Dew*. "Zëvendës nënsekretari, Sër Orm Sargjënt, ishte dakord." Më në fund, vetëm në shtator, Ideni pranoi se *Foreign Office* nuk kishte asnjë përfitim nga misioni që ishte pranë Kupit. "Është e sigurt se të lësh oficerët tanë pranë tij, do të thotë të kërkosh telashe. Është më mirë që t'i largojmë ata."

(Marrë nga libri "Lufta e fshehtë në Shqipëri", i Roderick Bailey, botimet "Naimi",Tiranë 2019)



Roderick Bailey
LUFTA E FSHEHTË NË SHQIPËRI
Një histori e misioneve britanike 1940-1945

Botimet "Naimi"
ISBN 978-9928-234-40-7
Faqe: 456
Çmimi: 1500 lekë

Rruga e Arbërit nr. 163

**Bajram XHAFA: Në lidhje me kujtesën historike,
dibranët vuajnë tmerrësisht nga amnezia dhe shpërfillja.**

histori

Ramadan Çaushi (Halili) i Grezhdanit në Rrethimin e Shkodrës (1912-1913)

Nga **BAJRAM XHAFA**

Luftoi si burrat Ramadan Çaushi (Halili) me shkjaun, Karadakun e serbin, me taborin dibran në Luftën për mbrojtjen e Shkodrës për tetë muaj rresht pa dalë prej istikamit, natë e ditë me pushkë për faqe, me bukë e pa bukë, me ujë e pa ujë dhe u kthye fitimtar.

Një ditë të bukur tetori (datë 22) të 2017-ës, nga Peshkopia u nisa për Grezhdan për të parë motrën, Rrufijen. Kishte qenë sëmurë. Mora dhe Nuzin që banon në Peshkopi, nipin tim. Kur mbërritëm, shpejt erdhi edhe Njaziu, nipi tjetër. Pas pyetjeve të zakonshme filloi një muhabet i këndshëm. Kishte do kohë që s'ishim parë dhe shpejt malli dhe hallet bënë punën e vet. Halle të jetës, çoroditjet e kohës, politike e shoqërore, probleme të fesë, ndonjë anekdotë dhe bejte gazmore nga të vendit.

U hodhëm edhe tek historia, ku shqiptarët notojnë jermas në konfuzion e në xhahilizëm. Duke menduar se tek unë do të zinte vend ajo që do të thoshin, si i zanatit dhe si "prej Shkodre", më thanë me një farë krenarie se në Luftën e Shkodrës nga Grezhdani ka marrë pjesë Ramadan Çaushi, një stërgjysh i tyre, për të cilin nuk kisha dëgjuar ndonjëherë. Unë ngrita atenat dhe shënova emrin, gjë që u ngjiti fjala dhe atyre. Shqiptarët janë harraq të mëdhenj, mendova atë që është thënë e stërthënë si ndër të metat e mëdha të shqiptarëve. Pse? U kanë hedhur mbi kurriz njëmijë halle dhe s'kanë kohë ta çojnë mendjen e të kujtojnë edhe tek të kallurit nën dhe.

Ramadani ka qenë vëllau i Zyberit, babës së vjehrrit tim, të cilin ti Bajram duhet ta kujtosh ndopak kur pate ardhur të rrije për pushime, u gjallërua motra që rrinte në shtrat. Ishe fëmij, por i vogli mban mend shumë. Në Luftën e Shkodrës, nga Grezhdani ka qenë edhe një tjetër, Nazif Aga, por ai u kthye shpejt prej andej, shtoi nipi. Por punën e luftës së Ramadanit me Karadakun në Shkodër, ma mirë e din Faizi, sqaroi Nuzi. Më thanë edhe diçka më tepër por, duhej kërkuar.

Fjala është për Rrethimin shtatë mujor të Shkodrës (tetor 1912 – 25 prill 1913) nga ushtria malazezo - serbe, e njohur në Shkodër edhe si "Muhaserja" (rrethimi) në Luftën I Ballkanike 1912 – 1913 ku roli luftarak i dibranëve ka qenë në kufijtë e legjendës, siç ka qenë e tillë vetë ajo MBROJTJE, ndoshta e pa shembullt në historinë e luftërave në rrethim.

* * *

NJË DIGRESION ME EKSKURSE HISTORIKE

Por le të ndjekim fillin e "lidhjeve" sipas parimit didaktik: nga e njohura, tek e panjohura duke hapur një parantezë.

Nga portreti i gjyshit të madh, Zyber Qorri, vëllait të Ramadanit, se me këtë llagap njihesh-in në fillimet e të pesëdhjetave kur shtëpitë tona u lidhën me miqësi, në kujtesë më kishin mbetur vetullat e trasha që spikasnin fort në fytyrën gjatoshe tharë nga pleqëria e thellë, shekullore, vetullat kaleshe, që mua më kujtonte një varg të një kënge sevdaje që këndohej atëherë në fshat. Nëpër mjegull kujtoj kur mixha Zyber rrinte në krye të vendit në odën e madhe, rreth e rreth me burra ulur kamëkryq, (kamëturqisht i thonë në Shkodër). Duhet të ketë qenë viti 1951 a 1952. Edhe pse fare i vogël, në atë valle burrash rrija si i gozhduar në vendin tim dinjitoz, në respekt të protokollit. Nuk qendroja tek dera, i lirë me 'hyn e dil', siç bëja në shtëpinë time kur vinin miq. Isha pjesë e "delegacionit" të krushqve, një karvan bukur i gjatë, që shkonte në përviçe (gostë) tek Zyber Qorri (Halili) në Grezhdan, burrë me emër në gjithë "Fushë-n" e më përtej. Vajza e mixhës, Rrufija, u martua me nipin e tij, Esatin, djalin e madh të Halilit.

Ishin derë e madhe. Familje dykurorëshe, vëllezërit Aqif dhe Halil Halili (Qorri) jetonin bashkërisht. Ishin të kamur. Kishin mbi 70 dynym tokë. Për Dibrën kjo ishte shifër e lartë. Shtëpia dykatëshe ishte një konak i vërtetë. Muret prej guri me qoshe me gur të gdhendur. Katër dhoma të mëdha gjithë dritë; dy lartë e dy poshtë, secila me banjë dhe hamam për larje; lartë me çardak dhe hajatin e gjërë poshtë në katin e parë. E gjitha e mbuluar me çati me tjegulla marseljeze, importi, jo me rrasa guri si në Malësi, as me tjegulla vendi, njëmijë mbarë e njëmijë mbrapë (gjë a gjëzë), por me xheremide (tjegulla) frengu. I pashë vetë se si qendronin në çati kur një ditë gjatë "vakancave" të mia dyjavore ndërmora edhe një ekspeditë hulumtimi në tavanet e shtëpisë për zgjerim horizonti. Dyshemeja, dyert, dritaret dhe shkallët ishin të gjitha "dagramë", bërë me dërrasë "deti" të zdrukthtuar mirë e që shndritshin nga pastërtia dhe lëmutësia. Oda e shtruar allaturka me mutaf Prizreni, sipër tyre qilima e velenxa me ornamente plot ngjyra dhe shilte e jastëkë me këllëfë të qëndisur mbështetur për muri. Çdo gjë ishte si në Sheher.

Përjashta, lart në murin e fasadës ishte murosur një gur i latuar në të cilin ishte gdhendur viti i ndërtimit, "**1943**". Oborri para shtëpisë, shtruar me kalldrëm, ishte i rrethuar me avlli dhe portën e madhe në mes. Gjithçka në simetri. Në anë të avllisë (kjo e prishte pak simetrinë) ishte mutfaku (kuzhina) ku bëheshin gatimet, rrinin grania dhe vërdalliseshin fëmijët. Dukej sikur endé jetonin me të "vjetrën", me traditën, kohë kur vetëm tufa e dhenvë më 1942 numëronte 1000 kokë dele, të cilat i veronin tek bjeshkët e Korabit, përmbi Radomirë. Kurse tani kishte filluar një epokë e "re", që shkonte "de kreshendo", në ulje, por drejt "progresit". Emri kishte mbetur, por ndryshimi kishte filluar e në rrugën e duhur. Tufa e dhenve ishte tkurrur në 150 krerë që tashmë e veronin më afër, në bjeshkët e Hinoskës, përmbi Shkrep të Erebarës dhe ruhej nga barinjtë (hyzmeqarët), ndërsa në mjeljen dhe përpunimin e bulmetit merrnin pjesë edhe burrat e shtëpisë.

Ne të Përtejdrinit zonës së Maqellarës i thoshim "Fusha" dhe ky ishte emri toponimik i zonës. Ajo vërtet ishte një fushë e madhe që shkonte nga Sheheri i Dibrës me rrethinë, deri poshtë Peshkopisë. Gjithë krahu i djathtë i bregut lindor të Drinit të Zi, dikur e njohur si Topalltia, përbën një tarracë natyrore që nga lindja shkon rrëzë vargut malor Korab – Deshat – Mali i Kërçinit e nga perëndimi bie butë mbi rrjedhën e Drinit, butësi që thyhet nga ndonjë kanion si i Gradecit që zgjatet nga Ura e Topojanit në Katund të Ri.

Lidhjet martesore me Fushën Malësia (krahu i majtë i Drinit) nuk ishin dhe aq të shumta. Edhe këta, më tepër ishin kur Malësia jepte vajza dhe më pak qëllonte të merrte. Ishin mikrokrahina me nivele të ndryshme në shumë drejtime, nga mënyra e jetesës, e folura, veshjet, zakonet etj. Pozita shoqërore dhe familjare e gruas në Fushë ndryshonte shumë nga ajo që kishte në Malësi. Punët e saj atje ishin të përqendruara në derë të shtëpisë e brenda. Gruaja atje nuk dilte të punojë në arë, të prashisë, aq më tepër në të shkojë në mal, të bëjë e të mbajë kran(d)e e krece të thata, punë të cilat ishin krejt të natyrshme për gruan në Malësi. Këtu ajo merrej me larje, pastrime, punët me gjilpërë, shtiza dhe grep, mirëmbante rregullin e shtëpisë, rritjen e fëmijëve, kujdesi për burrin etj. Gruaja në Fushë ishte zonjë në kuptimin e vërtetë të fjalës. Fytyra u rrinte bardh si bora dhe dielli nuk i shihte shumë. Cucat e Fushës ishin të dlira sa edhe uji u shihej teksa u kalonte nëpër gurmaz të fytit. Këtë metaforë e kam dëgjuar për herë të parë në fshat aty nga 1963 nga një 40 vjeçar. U habita me metaforën, aq më tepër kur po e thoshte një person si ai, ndërsa po fliste për një mundësi fejese. Vërtet ishte pak si sevdalli por kur mendoja se ishte analfabet, thashë me vete se poezia flen aty ku s'ta merr mendja. Për herë të dytë këtë figurë letrare e kam parë në një poezi vetëm kohët e fundit.

Për mënyrën e jetesës dhe trajtimin e gruas Fusha kishte marrë shumëçka nga zakonet e Shéherit, qyteti i Dibrës së Madhe. Pozitës së gruas në Shehër të Dibrës nuk i qasej as ajo e grave të aristokracisë së vendeve me nobilitet historik. Në Malësi thoshin: lum kush e marton cucën në Fushë se e ka të vendueme. Motra jonë qe me fat. Siç duket Zoti e "shpërbleu" kur Ai i mori nënën dhe e la jetime kur ajo ishte ende fëmijë. Por, punët e Tij shkofshin!

Kooperativa bujqësore endé nuk kishte ardhur për të bërë "shartimet" dhe skartimet "socialiste" të tradicionalizmit. Gruan e Fushës të "mbyllur" brenda katër mureve të shtëpisë, kooperativa do ta "çlironte" e do ta nxirrte jashtë tyre në "lirinë" dhe emancipimin shoqëror. Ajo do t'ia piqte lëkurën e fytyrës dhe do t'ia regjte shpirtin me punët e bujqësisë, në mbjellje e në korrje, në prashitje e në ujitje, në shirje e në mjelje, në duhan e në stallë. Punët e shtëpisë do t'i mbeteshin për turnin e natës. Atëherë do ta shihnin mirë zojllëkun e, ndonjëherë edhe tanderllëkun gratë e Fushës, por kjo do të vinte nga fundi i të '50 – ve.

Përveçse punëtorë të mirë e njerëz të rregullt në komunitet e kudo, fusharakët e fusharaket, burra e gra, ishin model edhe si besimtarë të mirë, myslimanë që shkonin në xhami, falnin pesë vaktet dhe mbanin ramazan (agjëronin). Rakia konsiderohej gjynah i madh. Edhe të krishterët ortodoksë, (kaurrit), një minoritet i vogël, kishin kishën dhe ruanin besimin e tyre të pacenuar. "*Kudo rrâni turr Shqiptari, / Mirë ai lidhë me besë e fe*", thotë Fishta. Edhe në këtë drejtim, fusharakët ishin të centruar bukur mirë, shembull qytetarie.

Ne të Malësisë (të Përtej Drinit) ishim, ku e ku me ata të Fushës. Në shumë drejtime. Edhe ne ishim familje e "madhe", dykurorëshe; jetonim bashkë 12-13 vetë, zakon që respektohej, me tokë që i kapte a s'i kapte 15-20 dynymë, shumica në të thatë. Ara të ndara në rriska e parcela, me meja e me mure, me gardhe e sinure, tamam "ara në mal" siç shkruan Petro Marko; me bagëti të imta deri në 30-40 krerë, dhen e dhi përzjerë, dy lopë mali me rendiment të ulët dhe një mushkë si hajvan barre. Bilanci vjetor i prodhimit shkonte deri tek sigurimi vjetor i bukës (së misrit). Mbase 3-5 kv misër si tepricë që shkonte për treg, ndonjë kuintal gjizë dhe ½ kv. tlynë që i zoti i shtëpisë edhe ato do t'i shiste në Tiranë për të mbuluar ndonjë harxh e për të parë ndonje hall. Megjithatë, në katundin tonë ishim birinxhi, mbasi shumica nuk arrinin të siguronin bukën as për gjysmën e vitit. Kush siguronte bukën dhe groshën e vitit, quhej "agá". Malësia kishte bërë më "përpara" në përdorimin e rakisë. Në shtëpinë tonë nxirrej raki (para buke) kur vinte ndonjë mysafir i veçantë, ndonjë i deleguar, sidomos nga Jugu. Ne kishim edhe kazan rakie për prodhimin e saj.

Për burime ujrash fshati ynë ishte më i pasuri. Në Kovashicë i Madhi Zot ka dhënë tre gurra që gulfojnë e gurgullojnë nga uji i bollshëm dhe i ftohtë që të plas kapakun e ballit, por niveli i ujit për ujitje kapte më pak se gjysmën e tokave të fshatit. Disnivelet i mbulonim me delegacionin e përviçes. Atë e kishim dinjitoz. Të tillë më shumë e bënte njëri, mixha Gani, Gani Meta. Atë e kishin vënë në krye edhe si moshë, edhe si "shoq" mëhallalí edhe si kushëri i nuses. Atëbotë ai ishte tek të 50-tat; burrë i ditur dhe fort i luajtur. Kishte një jetë të ngjeshur me përvojë të madhe dhe të larmishme. Tallazet e jetës e kishin rrahur mirë, si në dërstilë. I kishte provuar të dy ekstremet, nga pozita e ngrohtë me 7 napolona flori në muaj dhe pastaj si mik i agait me influencë në qeveri, tek dënimi me 20 vjet burgim, që u përfundoi, bafti i Zotit, me lirimin e befasishëm. Në rininë e tij kishte ndejt shumë kohë si 'djalë mbas vedit' në familjen e Dervish e Zenepe Hima (Çoku). I kish qëlluar të rrijë me burra të rëndësishëm, politikanë e veprimtarë kombëtare me emër nga të cilët kishte ditur të mësojë e të përfitojë shumë. Më pas kish punuar në armën e xhandarmërisë mbretërore. Ç'dinte, dhe dinte jo pak, i transmetonte nëpër mexhlise plot hijeshi. Kishte një narracion të këndshëm. Ishte vrojtues i hollë dhe mendje absorbuese.

Në atë kokën e tij fodulle me qylafen mënjanë hedhur mbi sy, ishte zbrazur dhe ngjeshur gjithë dramaciteti dhe epika e Shqipërisë sonë të gjysmës së parë te shekullit të 20-të, të cilën ai e tregonte me art nëpër në vallet e burrave në dasma e vakijate. Kjo i kthente odat në kuvende e shkolla të mendimit. Bisedohej e komentohej për luftëra e për fate kombesh e shtetesh, për ngjarje e historira plot dhimbje të Shqipërisë sonë, për heroizma dhe emra burrash të shquar. Edhe tradhtish që i janë bërë kombit tonë. Me atë zërin e trashë e kumbues, bisedave u jepte karakterin e polemikave duke i shoqëruar me riprodhime dialogjesh. Shkurt, krijonte atmosferë për kuvend burrash. Në këtë drejtim Ganiu ishte një thesar, që kur fliste ndiqej me vëmendje e kërshëri. Dinte t'i jepte peshë fjalës. Por le të kthehemi atje ku e nisëm, tek Ramadan Çaushi në Luftën e Shkodrës.

RAMADAN ÇAUSHI NË "*SHKODRA E RRETHUEME*" (1912 – 1913)

Kur mora vesh se heroi "im" i historisë, Ramadani kishte qenë vëllau i madh i mixhës Zyber, pata ndjesinë se edhe unë jam i kohës së "Rilindjes". Vdekur më 1956 – ën mbi 100 vjeç, më shumë se gjysmën e viteve të jetës Zyberi i kishte kaluar në periudhën e Rilindjes. Ndërsa unë 6 apo 7 vjeçar, kisha ndenjur në konak burrash "me të". Tashmë unë vërtet po i qasem treçerek shekullit, por jo aq sa për ta menduar veten "rilindas". Mos më ngatërroni me "rilindjen" e Edi Ramës që po na *rivdes*, por për ata që bënë "zgjimin kombëtar" dhe Luftën epike të Shkodrës, Luftë të cilën këtyre të fundit dhe gjithë historiografisë shqiptare nuk duan t'ua zësh me gojë, se ajo "zgjon urrejtje nacionale" dhe "nxit katastrofën!". Gjithësesi, sëpaku ndjeva se jam një "nyje lidhëse" e një "shahit" (dëshmues) në vazhdimësinë e epokave.

Kanë qenë tre vllazën, tregon Faiz Aqif Halili, farmacisti i Peshkopisë, miku dhe versniku im. Si fëmijë, atëherë nuk po kuptoja pse paskan dy mbiemra a llagape, "Qorri" dhe "Halili". Tani na del edhe një i tretë, "Çaushi". Në thelb mbiemri i tyre ishte dhe mbetet "Halili". Pasurimin e familjes me shumë patronime e kishte bërë "historia" e Ramadanit. Ai kishte bërë emër të mirë në organet e xhandarmërisë si çaush ndaj u mbiquajt Ramadan Çaushi. Gjatë kryerjes së detyrës ishte plagosur rëndë duke humbur njërin sy, nga dhe erdhi nofka tjetër, Ramadan Qorri, me të cilën u thirrën edhe dy vëllezërit e tjerë që vinin pas tij, Zyberi dhe Qazimi. Dy llagapet e fundit ishin futur si nofka. Për mua kishte edhe një tjetër nonsens: djali i dytë i Zyberit e kishte emrin Halil. Edhe emri edhe mbiemri njëlloj, Halil Halili.

Në fillim të shek. XX Evropa i ishte vënë në shpinë Perandorisë Osmane. I "sëmuri i Bosforit" ishte në shthurje e dekadencë. Shthurja përfshiu sidomos forcat e armatosura dhe ato të rendit. Revolucioni i Turqve të Rinj (xhonturqve) më 1908-ë, që solli "Hyrrjetin" (Liria) u prit si shpëtimtar i Perandorisë që do të çlironte energjitë e ndrydhura. Por ky vetëm sa përshpejtoi katastrofën. Në këtë mjegull "revolucionare" vërtiteshin edhe viset shqiptare. Për të zezën e tyre, shqiptarët kanë luajtur rol të rëndësishëm në atë revolucion, siç qenë të tilla të zeza për ata të gjitha luftërat, kryengritjrevet dhe revolucionet e tjera që i zunë poshtë më pas. Dikur shtylla e Perandorisë në pjesën perëndimore të saj, shqiptarët u kthyen në elementë të rrezikshëm dhe destabilizues të Devletit Osman. Dezeritmet e shqiptarëve nga radhët e ushtrisë e të xhandarmërisë ishin të shumta. Njëri nga ata që dezertoi nga radhët e xhandarmërisë ishte edhe Nazif Aga. Vendin e tij si çaush[1] e zuri bashkëfshatari i tij, Ramadan Halili.

* * *

1912

Gjatë vitit 1912, me urgjencë e sforcë të madhe Rusia bashkoi të pabashkueshmit në Aleancën e krishterë Ballkanike të boshtit ortodoks: Serbi – Greqi – Bullgari – Mali i Zi. Qëllimi i tyre ishte

fshirja e Shqipërisë dhe e shqiptarëve nga harta e Ballkanit si popull e si komb dhe e myslimanizmit si fe. Sapo kishte kaluar mesi i gushtit dhe Shqipërisë iu njoh njëlloj autonomie nga Porta e Lartë. Kur panë se Shqipëria po "bëhej", shtetet e Ballkanit dhanë alarmin – plasën luftën kundër Perandorisë Osmane.

Mali i Zi, një mikroshtet i krijuar nga Fuqitë e Mëdha evropiane në Kongresin e Berlinit (13 qershor – 13 korrik) 1878 kërkonte t'i bashkonte mbretërisë së vogël prej 3. 500 km katrorë (sot ka afro 14 000 km katror), edhe Shkodrën, Pejën, Gjakovën dhe Prizrenin dhe ta shtrijë shtetin e Krajl Nikollës deri në Shëngjin, e në rastin më të mirë, deri në derdhjen në det të lumit Mat. Më 8 tetor 1912 ai e shkrepi i pari luftën kundër Perandorisë Osmane. Pas tij Serbia, Bullgaria dhe Greqia, njëherësh. Kështu filloi Lufta Ballkanike (1912-1913) midis Aleancës Ballkanike dhe Perandorisë Osmane.

Shqiptarët e panë veten si shpakat në mjergull në kohë stuhie. Të çorientuar, të përçarë e të çoroditur, krejtësisht të vetmuar e të izoluar. Tani e panë vetën se ç'farë i kishin bërë vetes me atë nxitjen që u bënin fqinjët "për t'i ra turkut" aziatik se vetëm kështu do t'u vinte liria. Të lodhur e të rraskapitur nga kryengritjet e vitit 1910 - 1912 kundër Devletit Osman, aleatit të natyrshëm e të vetëm të tyre, Shqipëria dhe shqiptarët u vunë para rrezikut të zhdukjes. Kapën armët, por ishte vonjo të gjithë. Shënjestra e parë e Malit të Zi ishte *Shkodra*. Rreth saj sillej historia dhe legjenda, krenaria dhe magjia e shqiptarëve. *Me Kështjellën Rozafa si mishërim i simbolizmit historik e kulturor, Shkodra ishte shpirti dhe shpresa e kombit shqiptar***.**

Valiu i Shkodrës Hasan Riza Pasha, që ishte edhe kryekomandant i Ushtrisë për mbrojtjen e qytetit, ngarkoi Esat Pashë Toptanin, komandant i xhandarmërisë së vilajetit të mblidhte forca rezerviste dhe vullnetare.dhe me to të krijonte një divizion që do t'i shtohej divizionit osman të ushtrisë së rregullt (të nizamëve). Natyrisht, nizamët përbënin fuqinë kryesore të specializuar dhe bazë për mbrojtjen e Shkodrës.

Për të mbledhë forca Esat Pasha çoi fjalë edhe në Dibër e cila ishte një burim i pashtershëm forcash luftarake. Shkodra për Dibrën ishte "zamadhe"; si për gjithë Shqipërinë, "*Që prej Tivarit deri në Prevezë*" (Pashko Vasa).

Dibranët qenë më të gatshmit dhe më të organizuarit. Hovmëdhenj e të turrshëm, trima e plot plot maturí. Mbi 3 000 forca rezerviste (redifë) dhe vullnetare (sipas autorit italian Gino Berri – 4 000) të Dibrës së Poshtme u nisën për Shkodër. Rrugës duke kaluar nëpër Mat morën lajmin e marshimit të ushtrisë serbe drejt Prizrenit, Lumës e Dibrës. Elez Isufi me 600 forca të Reçit, Dardhës e Uj' e n'Ujë u kthye nga rruga për t'i dalë përpara ushtrisë serbe në Kolesian të Lumës. Atje do të bashkoheshin me forcat e Lumës e të Hasit të drejtuara nga Ramadan Zaskoci e Islam Spahiu.

Forcat e tjera dibrane, të prirë nga krerë dhe paritë e tyre si *Isuf Bej Hysenagolli, Selman Alia, (As)Llan Kaloshi (alias haxhi Llani), Shaban Lusha, Nel Hoxha, Dine Hoxha* etj., të Dibrës së Poshtme në rrugën për Shkodër u detyruan të kalonin nga Kruja mbasi Mirdita nuk u dha rrugë kalimi (ndërsa divizionit "Shumadia" të soldateskës serbe Kapidani i Mirditës ia liroi rrugën pa pengesa).

Forcat e Dibrës së Epërme, rezervistë e vullnetarë u shpërndanë për mbrojtjen e trojeve të atdheut nga Dibra deri në Manastir e Follorinë. Një pjesë e fuqive dibrane nga qyteti i Dibrës dhe Reka që kishin si prijësa përveç krerëve të Dibrës me *Hajredin Pustinën* dhe disa oficerë shqiptarë të karrierës, shkoi në *Manastir* dhe më pas në *Follorinë* për t'u përballur me ofensivën e ushtrisë greke drejt tokave shqiptare. Më vonë kësaj fuqie i erdhi në ndihmë një tjetër fuqi dibrane prej 1000 vullnetarësh të prira nga *Mersim Dema* i Grykës së Vogël (nga Homeshi) sëbashku me krerë të tjerë si Zenel Hoxha i Gjurasit, Jakup Cani nga Gryka e Madhe, *Dan (Ramadan) Cami* i Sepetovës etj. të cilët u prinin çetave të tyre. Atje takojnë grupin e parë të forcave dibrane me *Selim Demën, Eqrem Camin, Izet Çaushin* që kishin shkuar për të njëjtin qëllim. Ndeshjen me forcat greke prej 40 000 vetësh ky grup e zhvilloi në *Banicë* ku luftuan heroikisht dhe i prapsën sulmet greke por edhe vetë lanë mjaft të vrarë. Pas tërheqjes së detyruar drejt Manastirit, dy fuqitë dibrane luftojnë në *Ovak* e *Preblicë* me forcat serbe të cilat kishin zënë malet Babunë me pozita shumë strategjike për Manastirin, duke u përleshur deri thikë me thikë[2].

Mobilizimi i forcave bëhej sipas organizimit shoqëror tradicional me sistemin e parive (bajraktarëve). Nuk dimë se si kanë shkuar në Shkodër Ramadan Çaushi dhe Nazif Aga dhe me cilat forca janë shoqëruar. Mendojmë se ata mund të kenë pasur ndonjë njohje e mëparshme me Esat Toptanin ose me Isuf Hysenagollin, qoftë edhe nga afërsia krahinore. Ky i fundit ishte byrazer me Esat Pashën dhe, si "oxhak" ishte në krye të "Taborrit dibran" që shkoi në Shkodër dhe mori pjesë në Luftën për mbrojtjen e saj. Ndoshta ka ndikuar ndonjë rekomandim i Zogut, i cili kishte shumë miq në Dibër, midis tyre, Hysenagollët e Dohoshishtit që i kishte miq dere. Zogu kishte të martuar motrën e tij (Adile) për Emin Dohoshishtin.

Ndërkaq vetë Zogu 17 vjeçar drejtonte një fuqi prej 2000 vetësh, matjanë e dibranë për t'i shkuar në ndihmë Shkodrës. Sipas kujtimeve të Mbretit Zog të shkruara nga kol. Hysen Selmani, adjutant i Mbretit, fuqia e drejtuar nga Zogu në pritën që i bëri ushtrisë malazeze ishte prej 8 000 vetësh, matjanë e dibranë[3]. Pas një beteje të ashpër me ushtrinë malazeze (12 nëntor 1912) në Kakarriq të Lezhës, Zogu u detyrua të kthehet në Mat me forcat e veta. Mbërritja nëpërmjet Mirditës e Zadrimës e divizionit "Drina" të ushtrisë serbe rrezikoi të bjerë në rrethim dhe atëherë me një manovër të shpejtë u tërhoq me forcat e tij drejt Matit, i cili rrezikohej të pushtohej nga forcat e tjera serbe që erdhën nga lindja dhe kishin pushtuar Dibrën.

Si mbërritën në Shkodër, forcat dibrane u pritën me gëzim të madh. Nazif Aga nuk qendroi shumë dhe u kthye në Dibër, për arsye të panjohura. Si komandant i divizionit të redifëve dhe vullnetarëve, Esat Pashë Toptani e caktoi Ramadan Çaushin komandant të një njësie luftarake rezervistësh ku qendroi deri në mbarim të Luftës, më 25 prill 1913. Shkodra e rrethuar mbrohej nga katër pikëmbështetje që u bënë katër frontet kryesore: *fronti i Taraboshit*, që ishte fronti kryesor dhe pozicioni kyç i mbrojtjes, *fronti i Bërdicës*, *fronti i Bardhanjorit* dhe ai i *Shtojit*. Redifët (rezervistët), shkruan korespondenti italian i luftës Xhino Berri në ditarin e tij me 7 janar 1913, janë më tepër se asnjëherë të padurueshëm për t'u kthyer në shtëpitë e tyre. Këtë ua thonë të gjithëve. Patjetër që nisja e tyre do të tregonte fundin e rrethimit. Ata mund të ishin 15 000 veta që do të braktisnin qytetin. Por deri tani kjo nisje është vetëm në mendjen e redifëve. Ata të Dibrës mbi 4 000 veta janë më turbulluesit, ndaj për të thyer kompaktësinë e tyre i kanë shpërndarë nga pak në të gjitha pozicionet[4]. Nuk dimë se në cilin front ka luftuar Ramadani me dibranët që komandonte.

Luftoi si burrat Ramadan Çaushi (Halili) me shkjaun, Karadakun e serbin, me taborin dibran në Luftën për mbrojtjen e Shkodrës për tetë muaj rresht pa dalë prej istikamit, natë e ditë me pushkë për faqe, me bukë e pa bukë, me ujë e pa ujë dhe u kthye fitimtar. Fusharakët kujtojnë endé fragmente të nji kange për Luftën e Shkodrës që e paska kënduar Bit Dema (1898-1979), kangë e kënduar në rini të tij. Kjo kangë tregon edhe kushtet në të cilat është zhvilluar lufta e Shkodrës, kur pas muajit dhjetor, vetëm nga uria filluan të vdesin çdo ditë nga 50 vetë. "Nji taborr qi e kam dibranë, / Ata brejnë çelik me dha(b)më. / Kual therni e breshka hani, / Se mu m'thonë Esat Pashë Toptani".

Pas kthimit nga Shkodra, për jetën e Ramadanit nuk dimë më tej. Nisur nga fakti që njëri nga vëllezërit e tij, Zyberi, paska pasur 70 dynym tokë, po aq duhet të ketë pasur secili prej vëllezërve të tjerë, pra edhe Ramadani. Nga pasardhësit nuk mundëm të marrim asnjë llojë informacioni, as për vitin se kur ka vdekur dhe në çfarë rrethanash. Në lidhje me kujtesën historike dibranët vuajnë tmerrësisht nga amnezia dhe shpërfillja.

Shkodër, 2019

1 Çaush –nënoficer me gradë midis marshallit dhe rreshterit në ushtri, në xhandarmëri, në kalori etj.; kapter. Një këngë e kohës: " O vjen çaushi me 'izet zapti...".; Tahir Dizdari, Fjalor i Orientalizmave në gjuhën

2 Në luftë kundër pushtuesve grekë ranë më shumë se 30 dibranë nga Dibra e Madhe, Malësia dhe Topalltia, ndër to: Fuat bej Kulla, Xheladin Kuka, Hasan Stërmilli, Izet Haziz Dema, etj. Në Manastir gjithashtu pati shumë dibranë të rënë në luftë. Disa prej të rënëve në Follorinë e Manastir janë njohur si dëshmorë të atdheut si Ramë Duka (Shtushaj), Rrahman Xheleshi (Mazhicë), Hasan Hidri (Pocest), Qerim Sula (Allajbegi), Rrahman Çupi (Vojnikë), Rrahman Tollja, Ali Kostenja Sadik Demiri, Xhabir Sejdini (Striçan), Jashar Disha, Hasan Lila, Ismail Qorri, Sadik Balliu, Selim Loka, Ymer Margjoka, Dalip Demiri (Sopot), etj. Në fushën e Orizares në Manastir ranë dhe dy imamët e qytetit të Dibrës së Madhe: Jusuf efendi Skikuli, Osman efendi Langu dhe kapiten Aqif Rusi. Në Preblicë u vra i riu Habedin Dema nga Homeshi. (Marrë nga Haki Stërmilli, "Dibra në prag të historisë", Tiranë, 1940, (dorëshkrim) f. 71; Kadri Dema, "Fisi Dema nëpër breza", Shkup, 2003, f. 90.

3Hysen Selmani, "Nga notomet e Zogut I "Mbretit të Shqiptarëve", Tiranë, shtator 2008, f. 33.

4 Gino Berri, "Rrethimi i Shkodrës", Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë, 1998, f. 128.

Rrëfen për "Rrugën e Arbërit", Isa Kola, 92 vjeç, nga Sopoti i Zerqanit, mbi bazën e kujtimeve të familjes së tij, mbi këtë ngjarje, në të cilën ka marrë pjesë edhe gjyshi i tij, Qerim Kola: Ja si u masakruan të therur me bajoneta nga patrulla serbe, 5 burra nga fshati Sopot i Zerqanit, 3 prej të cilëve vëllezër të së njëjtës familje.

Masakra serbe në Sopot të Zerqanit

Nga **HYSEN LIKDISHA**

Me tërheqjen e Perandorisë Osmane, nga Rumelia, pra edhe nga Dibra, në fillim vitin 1912, shtetet ballkanike, shfaqën orekset e tyre, për zaptimin e trojeve shqiptare. Të gjithë këta shtete, nisën bisedime të fshehta e drejtpërdrejta, për ndarjen e Shqipërisë në copa për vete. Pikërisht, në këtë kuadër, Dibra ra pre e sulmeve të ushtrive serbe, të cilat vijuan për 9 vite rresht, nga 1913 deri në 1921.

"Armë, nuk kemi, - ka thënë Muharrem Zeneli."

"Si nuk keni armë, - ka thënë komandanti serb. Nëna jote tha që shtatë pushkë ju rafshin", - vijoi komandanti dhe urdhëroi ta rrahin me shkopinj. Për të ndërprerë masakrimin që serbët po i banin bashkëfshatarit të tyre, ngrihen 3 vëllezërit e fisit Kamberi: Selim, Ali dhe Hajredin Kamberi dhe deklarojnë se nuk kanë armë.

" Ne vetëm të bëjmë pushkë druri për t'i dorëzuar, se të tjera nuk kemi", - thotë



Isa Kola, 92 vjeç, nga Sopoti i Zerqanit,

Masakrat, barbarizmat, djegia e fshatrave, plaçkitja, vrasjet ditën me diell, të burrave dhe grave, në sy të fëmijëve, duke i therur me bajoneta, jashtë çdo caku njerëzor, shkuan deri në vrasje të 3 vëllezërve të së njëjtës familje, duke çuar kështu në zhdukjen e saj. Ka plot dokumente të kohës që dëshmojnë për këto masakra të serbëve mbi popullsinë e fshatrave të Dibrës,. Në plotësim të shpalosjes së këtyre masakrave, një dëshmi e gjallë mbetet ajo që dha për "Rrugën e Arbërit", 92 vjeçari Isa Kola, njohës i mirë i historisë së Grykës së Madhe (Zerqanit), por edhe më gjerë Dibrës,.

Ja çfarë rrëfen ai për një masakër të serbëve, në fshatin Sopot të Zerqanit:

"Ka qenë një mëngjes janari i vitit 1920, kur në rrugët e fshatit Sopot, ja beh patrulla serbe, e cila si zakonisht bënte krehjen e zonës, për armë e plaçkitje, për t'i hapur rrugën ushtrisë serbe, në sulmet e saj për pushtimin e Dibrës. Patrulla duke kaluar në lagjen Mustafanje, të këtij fshati, është parë nga nëna e Muharrem Zenelit, e ndodhur në oborrin e shtëpisë. Teksa ka dëgjuar të artikulohet fjala pushka, nga patrulla, ajo ka mallkuar duke thënë; "shtatë pushkë ju rafshin". Porsa marrin vesh për mallkimin e plakës, patrulla bastis shtëpinë e saj, në kërkim të gjetjes së armëve. Pasi nuk mundi të gjej armë, kanë marrë me vete të zotin e shtëpisë, Muharremin. Ndërkohë patrulla urdhëron që të gjithë burrat e fshatit të grumbullohen tek lisi i kuvendit ke varrezat. Komandanti i patrullës serbe, u ka bërë thirrje fshatarëve të dorëzojnë armët.

Sal Kamberi.

Siç dhe u duk, komandanti serb, i mirinformuar për armëmbajtje të fshatarëve, jep urdhërin për kontroll në shtëpinë e Kamberëve. Gjatë kontrollit, në hajatin (ahurin) e lopëve, patrulla serbe gjen 3 pushke austriake. Kaq mjaftoi që patrulla serbe të niste masakrimin e banorëve të këtij fshati.

Pas rrahjes në grup të fshatarëve, komandanti urdhëron veçimin nga turma, të 6 prej tyre, për t'i vrarë: Selim Kamberi, Ali Kamberi, Hajredin Kamberi, vëllezër, Sal Kamberi, Muharrem Zeneli dhe Tahir Hoxha. Në fjalën e tij të fundit para ekzekutimit, Muharrem Zeneli, i thotë kryeplakut të fshatit, Xhabir Zeneli: "- Mos mi ler në shpirt 4 napolonat, që ja kam borxh Ahmet Lokës".

Pasi e dëgjoi këtë serbi, lëshoi si nëpër dhëmbë: "-Lirojeni qenin të punojë e copëtohet vetë për të larë borxhin, duke i falur kështu jetën. Ndërkohë 5 të tjerët, Selim, Ali dhe Hajredin Kamberi, vëllezër, Sal Kamberi dhe Tahir Hoxha, i vrau duke i therur me bajoneta në oborrin e shtëpisë në sy të fëmijëve".

"Masakra të tilla, si kjo e Sopotit, - tregon 92-vjeçari Isa Kola, - kanë vijuar edhe në fshatra të tjerë të Grykës së Madhe, si Zerqan, Valikardhë, Peladhi, si dhe Dushaj, Dragu, e Vajkal në Bulqizë, ku serbët kanë msakruar në mënyrë makabër luftëtarët e këtyre fshatrave, në mbrojtje të trojeve të tyre, duke i therur me bajoneta, në sy të fëmijëve, duke mos kursyer as vrasjen e grave, siç dhe ka ndodhur në Dragu të Bulqizës."

**Analizë kritike e jetës
dhe veprës së Skenderbeut**

Epoka e Gjergj Kastriotit,
bazament i vetëdijes kombëtare shqiptare



Dr ENVER HALILI
Melburn, Australi

PËRMBAJTJA

Ky studim ka për qëllim që të kontribuojë në ndriçimin e veprës së Gjergj Kastriotit, e cila është epoka më e lavdishme e historisë jo vetëm të popullit shqiptar, por edhe atij ballkanik dhe europian. Epoka e Kastriotit u bë hallka kryesore e ndërlidhjes së kohës së re me periudhat e mëhershme historike, e cila mundësoi krijimin e bazës mbi të cilën do të ngrihej dhe ndërtohej etnia shqiptare. Ky studim i qaset Epokës së Gjergj Kastriotit nga një këndvështrim tjetër në krahasimi me hulumtimet pararendëse.

Kjo analizë parashtron tri hipoteza, të cilat janë fokusuar në tri aspekte: ***Së pari***, do të analizohet historia paraprake e mesjetës, si një hallkë ndërlidhëse në mes të periudhave të hershme iliro-pellazge me historinë e re të popullit tonë. Veçanërisht do të vështrohet Periudha e Mesjetës gjatë të cilës u krijuan Principatat (Mbretëria) e Arbërve, të cilat vunë bazën e kulturës shtetndërtuese të kombit shqiptar**.** ***Së dyti,*** do të analizohet periudha e Gjergj Kastriotit me vështrim të posaçëm në rolin e Kastriotit në bashkimin e princave arbërorë në një një front të përbashkët për të çliruar vendin dhe krijuan Mbretërinë Arbërore/Epirote. ***Së treti***, do të analizohet nga aspekti multidimensional vepra e Kastriotit dhe roli i saj në krijimin e bazamentit mbi të cilën do ngrihet vetëdija kombëtare dhe shtetërore individuale dhe kolektive e popullit shqiptar. Veçanërisht do të shtjellohet roli i Kastriotit në motivimin dhe udhëzimin e prijësve, luftëtarëve dhe krijuesve shqiptarë në krijimin, ndërtimin dhe avancimin e vetëdijes kombëtare shqiptare gjatë gjithë periudhave të mëvonshme historike deri në ditët e sotme.

1. RRËNJËT ILIRO-PELLAZGE TË GJEGJ KASTRIOTIT

1.1 Origjina iliro-pellazge e popullit shqiptar

Pellazgët ishin populli i parë që banuan Evropën e viset të tjera dhe ata vunë bazat e qytetërimit dhe kulturës njerëzore (Homeri I; Homeri II; Herodoti, 425 pK). Pellazgët krijuan shkrimin, numrat, llogaritarinë, artin, filozofinë dhe shkencën (Hesiod, 700 pK; Kocaqi, 2008; Mati, 2007). Pellazgët zhvilluan kulturën bimore, shtazore në tokë dhe ujë (det) siç janë bimët, shtazët, shpezët, peshqit dhe produktet e tjera ujore. Ata kultivuan pemët, perimet, drithërat, vreshtat, gdhendën dhe përpunuan drurin e gurin, zbuluan dhe përpunuan mineralet dhe metalet e ndryshme. Pellazgët krijuan bazën materiale mbi të cilën do të ngrihet, ndërtohet dhe më tutje zhvillohet ekonomia, arti, filozofía, shkenca dhe kultura njerëzore.

Pellazgët zhvilluan bujqësinë, krijuan zejtarinë, industrinë, ekonominë, organizuan tregun, ndërmorën transaksionet e para të biznesit si ato tregtare dhe këmbimet financiare. Pellazgët (Hititët dhe Lidianët) krijuan paranë (monedhën electrum trite) si një mjet tregtar dhe monetar (Pano e Angjeli, 2019). Paraja (monedha) është shpikja më e rëndësishme dhe instrumenti më kompleks, të cilën e ka bërë mendja e njeriut në historinë e vet. Zbulimi dhe përdorimi i parasë i dha një shtytje të jashtezakonshme zhvillimit të ekonomisë brenda bashkësive etnike si dhe mundësoi (lehtësoi) zhvillimin e këmbimeve tregtare ndërmjet etnive të ndryshme.

Populli pellazg, përmes degëve të veta si, ilirët, dardanët, maqedonët, thrakasit, etrustët, dakët e fiset tjera, i dhuruan njerëzimit ***dijetarët*** më të mëdhenj antikë si Homeri, Herodoti, Hesiod, Sokrati, Platoni, Aristoteli, Hipokrati, Pitagora, e të tjerë (Kocaqi, 2008; Kola, 1983 & 1989; Mati, 2008). Të gjithë autorët klasikë dëshmojnë se pellazgët u shquan edhe si popull shtetndërtues dhe luftartak, të cilët dhanë komandantët dhe ***gjeneralët*** më të shquar të historisë së lashtë**.**

Shqiptarët janë pasardhës të drejtpërdrejtë të pellazgëve, të cilët u krijuan si produkt të përzierjeve natyrale të fiseve pellazge si të ilirëve, thrakaseve, maqedonëve, epirotëve, dardanëve, dakëve, etruskëve e fiseve të tjera (Frashëri, 1899; Kola, 1983, 1989; Kocaqi, 2007; Mati, 2008; Vlora-Falaski, 1984). Shqiptarët emrin e morën nga 'zogu i bekuar- shqiponja' (S. Frashëri, 1899; Kola, 1983). Gjatë historisë populli shqiptar është njohur edhe me emërtimet e tjera si alban, albanoi (shek. 2-të, Ptolemeu), arbën/r, arban, arbëresh, arvanitë, arnautë, maqedon dhe epirotë (Frashëri, 1899; Kola, 1983; Kocaqi, 2007; Mati, 2008).

Populli ynë i njohur me emra të ndryshëm la gjurmë të forta që nga historia e lashtë, duke i dhënë Europës dhe gjithë njerëzimit figura të shquara. Ilirët, maqedonët, dardanët, epirotët i dhanë njerëzimit Aleksandrin e Madh dhe Pirron e Madh në Antikitet, po ashtu dhanë dy perandorët më të mëdhenj të krishtenizmit Konstantin e Madh nga Nishi dhe Justinianin e Madh nga Shkupi. Toka e lashtë iliro-pellazge po ashtu do t'i dhurojë njerëzimit mendje të ndritura dhe gjeneralë të shquar në Mesjetë dhe deri në ditët tona, siç janë Gjergj Kastrioti, Nëna Terezë, F. Murati, I. Kadare, etj.

1.2 Principatat Arbërore, pararendëse e shtetit të Kastriotit

Populli ynë, si pasardhës i drejtpërdrejtë i pellazgëve ishte faktor kryesor shtet-ndërtues në Europën Juglindore e më gjerë në të gjitha etapat historike, sidomos në periudhën e Mesjetës. Në Mesjetë Krahina e Arbanonit me qendër në Krujë u bë epiqendra e të gjitha lëvizjeve dhe proceseve të rëndësishme historike në Gadishullin Ilirik. Kjo krahinë ishte vatra e veprimtarisë patriotike të popullit tonë, e cila rezultoi me krijimin e Principatës së Arbërisë me 1190, e cila veproi me sukses deri në vitin 1216. Vlera e veçantë historike e kësaj principate qëndron në atë sepse ajo arriti të avancohet në nivel të Mbretërisë së Arbërisë me 1272 (Regnum Albaniae).

Gjatë kësaj kohe dhe sidomos në fund të shekullit 13-të dhe fillim të shekullit 14-të populli i arbërit arriti të zhvillohet dhe organizohet politikisht dhe administrativisht që rezultoi me krijimin e disa principatave të cilat kontrollonin një pjesë të gjerë të territorit arbëror që nga jugu (Preveza) deri në veri (Sarajevë e Sjenicë) dhe në anën lindore kontrollonte territorin përgjatë lumit Vardar dhe Morava. Principatat më të njohura të asaj periudhe ishin: Principata e Artës (1304-1400), Principata e Zenebishëve (1304-1418), Principata e Muzakajve (1335-1372), Principata e Balshajve (1362-1421), Principata e Topiajve (1368-1392), Principata e Dukagjinit (1387-1444), Pricipata e Kastriotëve (1389-1444) dhe Principata (shteti) e Arianitëve. Është shumë me rëndësi të potencohet se Principata e Arianiteve zë fill qysh herët në shekullin e XI (1001-1018), kur David Arianiti përmendet si figurë kyçe e dy qendrave më të njohura të kohës. David Arianiti arriti të bëhet strategu i Selanikut dhe më pas edhe strategu i Shkupit.

Principatat dhe sidomos Mbretëria e Arbërisë ishte produkt i ndërgjegjësimit kombëtar arbëror, i cili u krijua jo vetëm si domosdoshmëri e mbijetesës gjatë historisë, por ishte edhe rezultat i ngritjes dhe zhvillimit të traditës shtetformuese të popullit tonë. Principatat arbërore përfaqësuan familjet fisnike të vendit, të cilat ishin bartëse të krenarisë kombëtare dhe u paraqitën si urë lidhëse e traditave të lashta shtetërore iliro-pellazge dhe asaj të Mesjetës së vonë. Rëndësia e Principatave dhe Mbretërisë Arbërore qëndron në atë se:

- Organizuan rezistencë kundër pushtuesve të ndryshëm në vitet e zhvillimeve të vrullshme të Mesjetes.
- Shpalosën aspiratën shtetformuese të popullit arbëror (Frashëri, 2018),



Portret i rrallë i Gjergj Kastriotit-Skënderbeut nga fillimet e shek. XIX. (Foto ilustruese)

- Krijuan bazën mbi të cilen do të ndërtohet shteti kombëtar i Gjergj Kastriotit, dhe
- Definitivisht sanksionuan popullin arbëror si faktor kryesor në hapsirat e lashta të Gadishullit Ilirik (Ballkan).

Pricipatat e arbërve kontribuan jashtëzakonisht shumë në organizimin dhe mëvetësimin e popullit tonë në shekujt e trazirave të shpeshta e dramatike të cilat rrodhën si rezultat i venitjeve të mbrendshme të perandorisë së Romës dhe Bizantit. Rëndësia e veçantë e organizimit të principatave arbërore qëndron në atë se ato paraqesin formacionet dhe organizimet e para shtetërore të popullit tonë në periudhën e Mesjetës (Frasheri, 2018). Por rëndësia kryesore e Principatave (dhe Mbretërisë) së Arbërit qëndron në atë se ato kultivuan, zhvilluan më tutje vetëdijen për krijimin e një shteti si forma kryesore e identitetit dhe mbrojtjes së kombit shqiptar.

Pa dyshim, Principata e Kastriotëve është ajo e cila do të lë gjurmë të pashlyeshme jo vetëm në historinë e re, e cila arriti të unifikojë shumicën e principatave arbërore në një ombrellë të përbashkët. Bashkimi i principatave arbërore dhe pajtueshmëria ne mes liderëve të shumtë të asaj kohe rezultuan në krijimin e shtetin të parë të kombit shqiptar. Një rëndësi e veçantë e Principatës së Kastriotëve qëndron në atë se ajo u bë prioritare e formimin të një ushtrie paneuropiane, e cila në shekullin e 15-të u bë një digë e pakalueshme drejt Europës për forcat pushtuese osmane.

1.3 Lufta e Kosovës kundër pushtuesve osmanë

Në fund të shek 13, në Azinë e Vogël, në trollin e lashtë të trojaneve e hititeve pellazge u vendosën ca familje feudale nga Mongolia, të cilat u forcuan shpejt dhe arritën të krijojnë një perandori shumë të fortë. Pas pushtimit të disa viseve të Arabisë, në vitin 1385 osmanët dolën këndej Anadolit duke zaptuar Sofjen dhe paraqitën aspitata pushtuese drejt Gadishullit Ilirik. Popujt e Ilirikut, duke e parë rrezikun që i kërcënohej nga pushtuesi lindor krijuan një koalicion me qëllim që ta ndalin hovin e armikut. Në kryqëzatën e ballkanasave morën pjesë: Princat arbërorë: Gj. Balsha dhe T. Muzaka, mbreti Bosnjës, Kroacisë, Hungarisë dhe Rashkës (Ermenji, 1973). Komandant i ushtrisë së koalicionit u zgjodh prijësi i Rashkës (serbi), Lazari.

Lufta e Parë e Kosovës kundër osmanëve u zhvillua me 28 qershor të vitit 1389, në Fushë Kosovë (afër Prishtinës), e cila përfundoi me humbjen e ballkanasve. Por një djalosh dardan nga fshati Kopiliq i Drenicës, Milloshi, një ushtar sypatrembur, arriti pa frikë deri te kampi dhe shtriu të vdekur Sulltan Muratin e I. Disfata e koalicionit në luftën e Kosovës u hapi rrugë osmanëve të depërtojnë drejt viseve të Gadishullit Ilirik dhe Europës. Humbja e kësaj lufte do të jetë fatale për popujt e këtyre trevave, sidomos për popullin shqiptar.

Rrjedha dhe përfundimi i Luftës së Parë të Kosovës, shtron dy pyetje shumë të rëndësishme, të cilat kërkojnë përgjigje: "Pse princi serb Lazari u zgjodh udhëheqës i koalicionit ballkanik? A mos vallë ballkanasit kishin mosbesim në seriozitetin e elementit serb? Kjo dilemë vërtetohet që në fillim të betejës, kur një princ tjetër serb V. Brankoviçi tradhëtoi koalicionin ballkanik. Brankoviçi pa fije turpi, i nxitur prej interesave të ngushta personale, i largoi trupat e veta duke e dobësuar në mënyrë drastike forcën e koalicionit ballkanik në raport me një forcë shumë herë më të madhe. Largimi i forcave të princit serb nga fushëbeteja mundësoi që ushtria osmane që në sulmet e para të marrë epërsinë ndaj koalicionit dhe lufta përfundoi në favorin e saj.

Ky dyshim, gjithashtu, vërtetohet edhe me veprën tejet të ulët të gruas së princit serb (Milica), e cila pa fije turpi pas përfundimit të luftës ajo do t'ia dhurojë të bijën e saj, Oliveren e bukur, si shërbëtore në harem të sulltan Bajazitit. Për shkak të shërbimit të saj të mirë që nga ato vite në haremet e sulltanatit çdo herë do shërbejnë bukuroshet serbe. Po ashtu, që nga Lufta e Parë e Kosovës, serbët do të bëhen sklave të dëgjueshme dhe shërbëtore të vyeshme të osmanëve. Ndërsa epirotët kurrë nuk do t'u nënshtrohen osmanëve dhe çdoherë do të organizojnë rezistencë të fortë kundër tyre, serbët nuk bënë ndonjë rezistencë për të shënuar deri në mes të shekullit të 19-të, atëherë, kur ata do të shtyhen dhe përkrahen nga Rusia.

1.4 Rezistenca e popullit shqiptar kundër osmanëve

Në fillimi të shekullit 15 fuqia e Gjon Kastriotit rritej vazhdimisht. Principata e tij u forcua shumë, sidomos pasi Gjon Kastrioti arriti me sukse ta zgjerojë territorin dhe të sigurojë jo vetëm dalje në det, por mori në kontroll trevat e pasura bujqësore e minerare të Kosovës (si Peja, Prizreni e Prishtina) dhe Maqedonisë, në rajonin e Pollogut, Dibrës dhe Ohrit (Drançolli, 2018). Si rezultat i këtyre sukseseve, shteti i Gjon Kastrirotit arriti të shtojë jo vetëm pozitën gjeostrategjike në këtë pjesë të Gadishullit Ilirik, por gjithashtu do ta rrisë forcën ekonomike dhe politike në rajon. Fitoret e Gjon Kastrioti rritën besimin dhe vendosmërinë e epirotëve për të mbrojtur lirinë dhe patën jehonë të fuqishme në Ballkan, Evropë e më gjerë.

Represioni osman në viset e pushtuara ishte brutal dhe për arbërit ishte i papranueshëm nënshtrimi dhe poshtërimi nga forcat e huaja. Në vitin 1415 forcat e arbërit nën udhëheqjen e Gjon Kastriotit, u hodhën në një kryengritje kundër sulltanit me synim për ta çliruar Krujën. Fatkeqësisht ai nuk mundi t'u rezistojë sulmeve të osmanllinjve. Kjo përpjekje e pasuksesshme e shtyri Gjon Kastriotin të bëjë një marrëveshte shumë të dhimbshme me osmanët. Sulltani i pashpirt, për të siguruar moskundërshtimin e Gjon Kastriotit dhe për ta siguruar vetvehten, i mori peng katër djem. Ndër ta mori peng edhe Gjergjin, që ishte fëmijë fare i vogël dhe kishte vetëm nëntë vjet.

2. EPOKA E GJERGJ KASTRIOTIT

2.1 Vitet e hershme të jetës së Gjergj Kastriotit

Gjergj Kastrioti u lind me 6 maj të vitit 1405 në Krujë, në një familje princore të njohur epirote. Nëna e tij Vojsava kishte parandjenjë se do të lindë një djalë i cili do të shpëtonte Arbërinë nga robëria. Barleti (1508, fq.2), i kushton një theks të veçantë këtij fakti dhe sqaron se: *"Kur e ëma mbeti shtatzënë, pa një ëndërr se lindi një dragua aq të madh, saqë mbulonte tërë Epirin"*. Vërtetë Gjergj Kastrioti u lind i bekuar nga Zoti dhe kishte një shenjë në krahun e djathtë. Zoti i kishte falë Gjergjit dhunti të veçanta, ishte shtatgjatë, shpatullgjerë, ishte shumë i fuqishëm, ishte i shpejtë si vetëtima, mbi të gjitha ai ishte shumë inteligjent dhe i shoqërueshem. Gjergji *ishte ne gjendje të përballonte kushtet ekstreme të luftës, duronte urinë, etjen, të ftohtin, vapën dhe pagjumësinë (*Barleti, 1508*).*

(vijon në numrin e ardhshëm)

**Meditime në 76 vjetorin e rënies
së Heroit të Popullit Gjokë Doçi...**

A do të shkojnë lurasit të vendosin një kurorë në Symizë të Mallakastrës?

**** Në vendin ku ka një lapidar në kujtim të heroit të popullit Gjokë Doçi?***

**** Në shkollën 9 vjeçare të Damësit në Mallakastër që mban emrin e Djalit të Lurës që u bë Djalë i Mallakastrës?***

Për të parë si e nderojnë Gjokën e Lurës, Gjokën e tyre: ***"Mallakastra i nderon dhe i kujton me nostalgji bijtë e saj që janë heronj të popullit si Gjok Doçi. Ai është nga Lura, por nga momenti i Rënies dhe brez pas brezi është djali i Mallakastrës, sepse ai ra si trim dhe iku në moshën e rinisë 21 vjeç."***

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

Do të desha që këto radhë ti lexonin Lurasit, të mëdhenj e të vegjël. Do të desha që një autobus me djem e vajza të shkollës 9 vjeçare të Lurës të bëhen mysafirëtë djemve dhe vajzave të shkollës 9 vjeçare të Damësit, të lidhin me ta miqësi, vajtje e ardhje siç i thonë në Lurë, të venin së bashku një kurorë me degë bredhi e lule vjeshte të Lurës në lapidarin e Djalit e Heroit Gjokë Doçi...



Në Symizë, në qoftë se nuk gaboj adresë, djali e ndalon makinën duke ma bërë me dorë drejt një lapidari. E kishte mbajtur mend herën e kaluar kur u mërzita pse nuk i bëra një fotografi. Zbrita dhe bëra disa shkrepje mbi atë vend ku ra biri i Lurës Gjokë Doçi, në atë vend ku banorët e fshatit e kishin lënë barin të paprekur që nga koha e rënies. Pllaka e lapidarit ishte me të gjitha shenjat e shkronjat e ditës kur dekada më parë ishte vënë. Ishte një nder që populli i bënte një heroi të Luftës Antifashiste, një vlerë e kulturës së popullit të thjeshtë.

Asaj rruge nuk kaloj më, kokën majtas apo djathtas dhe ngritjen paksa në këmbë nga ndenjësja e autobusit në nderim të Heroit, nuk do ta përjetoj më. Koha e la në harresë rrugën drejt Gjirokastrës nëpërmjet Ballshit, kodrave të Mallakastrës...

Rrugë të reja hapen, zgjerohen e asfaltohen çdo ditë...

Veç rruga për në Lurë, nga Peshkopia apo Rrësheni, po ajo është...

Në Lurë mbase më bie përsëri rruga.

E dua dhe e ndjej si pjesë e shpirtit tim.

Bustin që i qëndron Fushë-Lurës si degë ari, mbase e fotografoj përsëri. Jo bardhë e zi siç e kam fotografuar dekada më parë, por me ngjyra...

Ajo që më ka ngelë brengë e mbase nuk e gjej ta fotografoj, është një rrënojë, mure që të ftohtit e Lurës i ngrin dimrit për ti shkrirë e thërrmuar verës. Tash gurët e asaj ndërtese në odën përdhese të së cilës tundi themelet zëri i Gjokë Doçit, janë bërë muranë, si muranat pa emër e pa zë, veshur nga myshku i heshtjes...

Ato mure nuk u ngritën në këmbë, ato kthina nuk u mbushën me reliktet e Gjokë Doçit dhe të familjes së tij, mbase në një muze që do ti bënte nder jo vetëm Lurës.

Nuk i bëri ajo kohë...

Nuk do ti bëjë kurrë as kjo kohë...

Ata që bashkë me gjermanët i derdhën plumb në gjoks Gjokë Doçit, tash kryeministri ynë bir e nip komunisti, partizani, i ka ulur në krye të vendit me nderimet më të mëdha...

Gjokë Doçi përsëri mbeti jetim jo vetëm pa babë e pa nanë, por pa Atdhe...

* * *

Kisha meditur një vit më parë, në 20 nëntorin e shtatëdhjetë e pestë të rënies së Heroit...

E kisha përcjellë në facebook në një bisedë me një Luras, Nin Rajtën- autor i shkrimit "Në ballë të sulmit" botuar vite më parë në gazetën lokale të Dibrës "Ushtima e maleve", kushtuar Gjokë Doçit.

Më tërhoqi vëmendjen një shënim, shoqëruar me një fotografi...

"Mallakastra i nderon dhe i kujton me nostalgji bijtë e saj që janë heronj të popullit si Gjok Doçi. Ai është nga Lura, por nga momenti i Rënies dhe brez pas brezi është djali i Mallakastrës, sepse ai ra si trim dhe iku në moshën e rinisë 21 vjeç. Ja si përkujtohen heronjtë e popullit. Kjo fotografi i dedikohet këtij djali, këtij heroi. - Ylli Filaj - 23 Nëntor 2018"

Fotografia (po e bashkëngjis) flet më shumë se faqe të tëra shkrimi...

Dy fëmijë, një vajzë dhe një djalë, nxënës të shkollës 9-vjeçare të Damësit në Mallakastër, me kurora lulesh të freskëta poshtë bustit, nderojnë Djalin e Lurës, Djalin e Mallakastrës...

* * *

Do të desha që këto radhë ti lexonin Lurasit, të mëdhenj e të vegjël. Do të desha që një autobus me djem e vajza të shkollës 9 vjeçare të Lurës të bëhen mysafirëtë djemve dhe vajzave të shkollës 9 vjeçare të Damësit, të lidhin me ta miqësi, vajtje e ardhje siç i thonë në Lurë, të venin së bashku një kurorë me degë bredhi e lule vjeshte të Lurës në lapidarin e Djalit e Heroit Gjokë Doçi...

Damësi, bashkëkohësit e Gjokë Doçit, e kanë ruajtur dhe e ruajnë si gjë të shtrenjtë kujtimin e Djalit të Lurës...

Brezi i ri, më i riu që ngjitet vit pas viti shkallëve e vështron me admirim Djalin e Damësit, Djalin e Lurës e ka në shpirt dhe e ruan në kujtesë si një Hero të Luftës së Madhe Antifashiste Nacionalçlirimtare, më të madhes betejë që bëri vend e hodhi themele në historinë e popullit shqiptar...

A do të shkojnë Lurasit, të moshuar e nxënës shkolle, të pinë një kafe më 20 nëntor në Damës, tek busti i Djalit të tyre, në shkollën e Djalit të Mallakastrës, Gjokë Doçi?

I bëjnë nder vetes...

I bëjnë nder birit të tyre...

Është koha më e përshtatshme për qoka, koha e 75 vjetorit të Çlirimit të Atmëmëdheut nga pushtuesit fashisto-nazistë...

Athinë, 13 nëntor 2019

Keni ndonje shqetesim per te ndare me komunitetin?

SHKRUANI NË GAZETË! BASHKËPUNO EDHE TI!

< rrugaearberit@gmail.com >

**Për librin: "Zenel Hoxha i Gjurasit"
të autorit Beqir Mata**

Luftëtari e burri mentar Zenel Hoxha

Nga **MEVLUD BUCI**

Figurat e ndritura të kombit vijnë përmes dritës së qëndresës dhe përmes provave atdhedashëse ,sepse ata kaluan rrebeshe të historisë duke lënë testament për brezat vetëmohimin për atdhe e për flamur.

Ky mendim m`u përftua ndërsa mbarova së lexuari librin për Zenel Hoxhën të autorit luznak Beqir Mata,një libër që shtjellon qëndresën,mençurinë,guximin dhe bujarinë e një figure të paepur ndër beteja,i cili ishte i lidhur si mishi me kockën me popullin;dhe, me këtë libër ,autori,por edhe redaktori Xhafer Martini,sjellin nderimin dhe mirënjohjen që duhet të kemi për figura të tilla.

Autori sjell një lëndë të pasur me shënime argumentuese të sakta,ai ka gjurmuar me pasion e përkushtim, veprimtarinë atdhetare të Zenel Hoxhës,duke nxjerrë në pah këtë figurë historike të mbuluar nga pluhuri i harresës,për t`i shërbyer jo vetëm njohjes së tij,por edhe edukimit të brezave të rinj me frymën atdhetare,sepse Zenel HOxha ishte një lapidar qëndrese.

Autori e ndan librin në disa kapituj të rëndësishëm:"Grykа e Vogël","Gjurasi","Gurra e Mazhicës","Familja Hoxha","Koha","Jeta","Në LIdhjen e Prizrenit","Takimi me Abdyl Frashërin","Thirrja e Zenel Hoxhës","Në ngjarjet e vitit 1910"etj., etj. Është një libër me 99 faqe,por fort i çmuar përsa u përket mesazheve të atdhetarisë,sepse pasqyron luftën dhe përpjekjet e kryengritjes së armatosur kundër të huajit,tubime dhe kuvende popullore të asaj kohe me Zenel Hoxhën në krye,i cili ishte komandant trim ,por edhe ushtar njëherit,që luftonte në ballë të çetave vullnetare kundër armikut..


Zenel Hoxha ka qenë gjithashtu edhe plak Kanuni,duke pajtuar gjaqe dhe konflikte,i cili u udhëhoq nga ideja se vetëm një popull i pajtuar mund t`i bënte ballë armikut,që ishte, në atë kohë, pushtuesi turk,dhe më vonë ai serb, duke u nisur nga kjo,ai u përpoq të shuante çdo ngatërresë dhe hasmëri në vizionin e një atdhetari të spikatur.

Ai karakterizohej nga mendja e mprehtë,nga një qëndrim fjalëpaktë,por fjala e tij ishte e qëlluar,por edhe nga karakteri i fortë e ndershmëria,për të mos ia ndryshuar rrugën së drejtës,sado kosto të kishte ajo. Ishte si shumica e malësorëve të këtij vendi,kryelartë dhe me dinjitet të pacënuar.

Nuk preferonte të ishte i pari,por populli e thërriste Zenel-a,duke e ngritur në rangun që e meritonte.

Zeneli kishte pak shkollë dhe ishte mendjehollë,burrë i odës dibrane. Kujtimet për të janë një gjerdan i ndritur kujtese,dhe këtë e kam provuar edhe vetë ,kur para katër vitesh ndenja në kullën e tij te nipi Bedri Cani me gati 15 burra të tjerë dhe aty mësova shumë gjëra mbi të ,të cilat i gjej të pasqyruar edhe në librin e Beqir Matës.

Nga libri në fjalë, mund të shkë-



XHAFER MARTINI: Njerëzit që e kanë njohur nga afër Zenel Hoxhën kanë vlerësuar disa cilësi që rrallë burra i kanë pasur si: guximin, trimërinë, besën, sinqeritetin, drejtësinë dhe dëshirën e madhe për të ndihmuar të tjerët me çfarë kishin mundësi.

pusim dhe citojmë:"Populli nga gjiri i tij nxjerr ata që duhen. Burrat e atëhershëm,të ndershëm dhe të thjeshtë,i kanë qëndruar besnik popullit se nuk kanë dashur të majmen dhe të pasurohen në kurriz të tij. Një nga ta ishte Zenel Hoxha. Në këto ngjarje të stuhishme ai u formua si atdhetar."(fq.20). Ndarjet:"Në lidhjen e Prizrenit",Thirrja e Zenel Hoxhës(Zenel Hoxha ka çue fjalë/me i dalë turkut përballë)"Një ngjarje e vitit 1910","Malësorët rebelohen""Këngë për Ali Limanin", "Kundër copëtimit të Shqipërisë", Zenel Hoxha dhe flamuri" etj.,pasqyrojnë këtë qëndresë heroike të këtyre malësorëve trima ,të cilët me pushkë në dorë lufton për të mbrojtur trojet amëtare.

"Me Zenelin në krye,-thotë autori-grupi i luftëtarëve çau me pushkë rrugën për të hyrë në thellësi të vendit ku ishte zhvilluar beteja. Mbas tri orëve marshim,Ibrahim Gjokën e gjetën gjallë me flamur në dorë. U kthyen bashkë me të. Një nga ushtarët serbë, kur pa aktin e Zenel Hoxhës ,thuri një këngë për të. Mbahen mend vetëm dy vargje ,që ,në gjuhën shqipe ,kanë këtë përmbajtje:"Hajde hajde o Zenel Hoxha i Gurit/sa besnik I qëndrove flamurit"(fq 56).

Ky model qëndrese do të përcillej në kujtesën popullore dhe do të gdhendej aty përjetësisht.

Në këtë moment nuk mund të rrihet pa përcjellë fakti se Arif Hyqymeti,nënprefekt i Peshkopisë,si mik i serbëve,ishte i predispozuar t`ia mblidhte armët popullit liridashës. Por kjo nuk mund të arrihej,sepse Zenel Hoxha,kryetar komune,prijës dhe luftëtar i zoti e kishte mobilizuar popullin dhe tashmë qëllimi ishte i qartë;Luftë pa kompromis e deri në sakrificë sublime kundër armikut që kërkonte të gllabëronte trojet shqiptare.

Si burrë i besës,i lidhjes së saj me afsh dhe ndjenjë patriotike ai arriti të çojë përpara këtë besë dhe ta forcojë në popull.

Në ndarjet e librit:"Loja e Arif Hyqymeti",'Në kërkim të armëve","Kryetar komune","Mikpritja e Zenel Hoxhës","Zenel Hoxha fliste në heshtje","Përgjigje lakonike","Zenel Hoxha shpëton Gjurasin","Plak Kaniuni""Te Murrët","Përballë Hoxhollit","Në ndihmë të Hazis Xhekës", etj,pasqyrohet më së miri simbolika e atdhetarisë dhe qëndresës në ato mote të vështira kur fati i Shqipërisë vihej në rrezik dhe në kërcënim serioz nga lakmitë shoviniste fqinje dhe,për këtë vetëdija kombëtare ishte e zgjuar e ndezur.

Po kështu,në kapitujt: "Burrë kuvendesh", Ndërmjetësia e Zenel Hoxhës", "Për dekorimin e Zenel Hoxhës", pasqyrohet jeta e një kreshniku i cli u bë prijës i lëvizjes popullore duke i shumëfishuar në këto çaste vlerat e njohura të trashëguara nga të parët si: qëndresa, urtësia, strategjia e luftimit, bashkimi e përcjellja me zë të lartë e mesazheve të lirisë.

Zenel Hoxha i Gjurasitv është model më vete dhe i ndritshëm i këtyre vlerave kombëtare..

"Zenel Hoxha, - shkruan Xhafer Martini, - sipas kujtimeve që kanë lënë njerëzit për të, del si një personalitet i veçantë,që kishte mbi vete një hir hyjnor. Njerëzit që e kanë njohur nga afër kanë vlerësuar disa cilësi që rrallë burra i kanë pasur si:guximin, trimërinë, besën, sinqeritetin, drejtësinë dhe dëshirën e madhe për të ndihmuar të tjerët me çfarë kishin mundësi. Nuk ishte fodull e mendjemadh, por i thjeshtë sa s`ka më, pa rruza dhe pa tufa, me tirq të arnuar, por që ndrinte nga pastërtia e jashtme dhe nga pastërtia e shpirtit".

Edhe muza popullore, përmes epikës, nuk ka ngurruar të derdhet me vargje plot nderim:

Zenel Hoxha një plak me shkop,
I shkoi pashës deri në top,
Deri në top e në xhephane,
A s`i ke njoft pashë këto Natë Male
Hajde hajde o Zenel Krosi
Tu ne Luznia e desh e sosi...

Provat e urtësisë dhe mençurisë së tij jepen në kuvendet e ndërmjetësimit, po kështu fotot e Gurrës së Mazhicës,Gropat e Ujkut, Kulla e Zenel Hoxhës, e shtojnë dhe e rrisin pasqyrimin për këtë figurë; gjithashtu thëniet filozofike dhe alegorike.

Libri i Beqir Matës është shkruar me realizëm,pa harruar frymën e nderimit për figura të tilla,frymë që përcillet natyrshëm,si një monografi model;të vërtetat historike jepen qartësisht dhe të argumentuara në rrjedhën e tyre kohore.

Shkurtësia dhe lakonizmi i thënies nuk mund të përcillen veçse në qëllimin e qartë dhe të kuptueshëm për të pasqyruar me vërtetësi një periudhë historike mjaft tronditëse, ku nuk munguan burrat e shquar,dhe një ndër ta ishte edhe luftëtari e burri mentar Zenel Hoxha...

Pus i thellë ky "Bunari" i Fatmir Terziut!

(vijon nga faqja 31)

Fatmiri studion dhe kërkon, në arkivat britanike, dhe, atje, ai është një fill i artë e i rëndësishëm i Ariadnës, sepse edhe atje mund të gjenden gjurmë të kulturës dhe të historisë sonë. Ishte arkeologu i madh, anglezi Evans, që erdhi e kërkoi në veri të Shqipërisë dhe kreu zbulime arkeologjike dhe më pas ai zbuloi Kretën. Ishte Eduart Liri, që fiksoi bukuritë dhe lashtësitë e kështjellave, portretet dhe veshjet kombëtare shqiptare me penelin tij; ishte Bajroni që u frymëzua aq shumë sa tek "Çajlld Haroldi" vargjet më të bukur, me siguri janë ato për shqiptarët dhe Shqipërinë, por besoj edhe kostumi më i bukur populllor që ai ka veshur, është ai shqiptar; ishte Edit Durham, që eksploroi pasuritë shpirtërore dhe etnografike të popullit shqiptar, që zbuloi aq shumë bukuri veshje, etnografike, aq shumë cilësi dhe virtyte shqiptare, ishte ajo që vuri në dukje se *"Kudo në Rumeli njerëzit përgjigjen: jam ortodoks apo katolik, ndërsa në Shqipëri edhe bariu më i thjesht me krenari thotë: unë jam shqiptar..."* Shqiptar, më shumë se një fe, më shumë se një besim, një komb i shkëlqyer.

"BUNARI" NJË KANISTËR ME BUKURI VLERASH ARTISTIKE

Gjithnjë kam menduar se është i suksesshëm ai shkrimtar që njeh me themel objektin dhe subjektin për të cilët shkruan e, si rrjedhojë bëhet bindës dhe tërheqës për lexuesin, e bënë atë të ndjejë kënaqësinë e rrëfimit, e emocionon dhe e mban fort të lidhur pas faqeve të librit, ndërkohë që i sjellë si pa kuptuar dije dhe informacione të dobishme që e bëjnë të krahasojë përvojat e veta, teksa entuziazmohet kur ndjen forcës e krijuesit origjinal që di të bëjë art të vërtetë, ashtu siç, Fatmir Terziu, penën e hollë e rrëshqet butësisht dhe lirshëm, herë e lakon si një balerinë reshtave dhe paragrafeve, herë ngre me të buçimën dhe jehonën e zhurmave të luftës, trokun e kuajve, vringëllimat e shpatave, gjëmimin e topave, krisjen e mureve, thirrmat dhe sokollimat e luftëtarëve që përleshen për jetë a vdekje.... Te "Bunari" ndjen deri dhe erërat dhe fladet që fryjnë, vërshimin dhe përleshjen e reve në qiell, shkrepëtimat e rrufeve, ngrohtësinë e rezeve të diellit, rrjedhjen e lumit dhe të përrenjve, zërat e njerëzve, të moshuar dhe të rinj; ndjen gurët e mullirit të blojes, këngët e vajzave, të qeshurat, të qarat, lodrat e fëmijëve, blegërimat dhe këmborët e bagëtive. Janë tërheqëse dhe realiste përshkrimet që autori i bënë dy Dibrave, duke veçuar karaktersitikat e tyre, përshkrimi i relievit, i luginave, maleve, kodrave, përshkrimet e skenave plot kolor të jetës me të gjitha shfaqjet që nga lindja e deri në vdekje. Ai e tërheq mjeshtërisht lexuesin drejt përmbajtjeve të rrëfenjave, legjendave, episodeve dhe ndodhive të çuditshme; portretizon tipa dhe karaktere origjinalë, përshkruan me delikatesë dhe ndjeshmëri bukurinë femërore, siç është përshembull përshkrimi plotë hijeshi dhe delikatesë i vajzës 15 vjeçare Ançës me *"fustan basmaje të qepur andej nga matanë majave të larta. Nuk dihej se ku, por ishte i qendisur bukur. Lule i tëri në kraharor. Ançes pesëmbëdhjetëvjeçare i shkonte shumë. Aq shumë sa edhe më laiku i ngulte sytë tek ajo vajzë. Gjoksdalë. E bukur nga tërë konstrukti. Këmbëgjatë, belhollë, flokëmjaltë, syqiell, bojaneshë e tëra. Eh, si ishte ajo."* Lexuesi entuziazmohet dhe emocionohet nga bukuria dhe përshkrimet realiste e idilike aty te "Bunari" dhe vargjet zjarr të djaloshit të dashuruar: *"Dil moj cucë te bunari,/ se për ty m'ka marr malli,/ malli yt o nuk po më hiqet,/ zemra ime flak po m'digjet./ Hajde cucë hajde bre,/ faqet kuq si molla i ke,/ faqe kuqe sytë e zi,/ mos më le moj në vetmi./* faqe kuqe sytë e zi,/ *mos më le moj në vetmi...*

I jep vlerë origjinale librit përdorimi me vend i toponimeve dhe i emrave të mjediseve të zonës, emra që krijojnë efekt te lexuesi, bëjnë përshtypje dhe e bëjnë atë të përqendrojë më shumë vëmendjen: "Lugina e Prerë me Shpatë", "Karrigja e Skënderbeut", "Arra Budallaqe", "Shtegu i dhive", "Shkëmbi i Xhemos", "Tre Lisat e Damllosur"..., ndërkohë që lexuesit i lind kureshtja për të ditur më shumë rreth tyre, teksa autori me bukuri dhe elegancë ia plotëson shpejt këtë dëshirë duke shpjeguar përmbajtjet e tyre.

Frymëzimi dhe logjika artistike e ka çuar shkrimtarin edhe tek traditat popullore, te respektimi i tyre në doket dhe zakonet e jetës familjare dhe shoqërore, respekti dhe nderimi i mikut, folklori dhe veshja, mënyrat e ushqyerjes dhe e gatimit e deri dhe te përdorimi i bimëve medicinale me efekte pozitive mjekësore, i hithrave, qershive, rrushit... me aq shumë vlerë për popullësinë e zonës, por dhe për të rritur rezistencën e ushtrisë së Skënderbeut. I tillë ishte dhe përdorimi i bulgurit dhe receta e gatimit, e cila u mor dhe u përdor gjerësisht edhe nga vet Sulltani si një ushqim bazë për ushtrinë e tij shumëkombëshe. Teksa respektojmë këto vlera dhe prurje, sa artistike aq edhe shkencore, që shkrimtari përcjellë te lexuesi, sjellim ndërmend faktin mbase unikal ku një bimë mjekësore shqiptare ka emër mbreti: është bima me fuqi çudibërëse, që mban emrin botanik *"Gentiana lutea"*, bima e mbretit ilir Genti me aromë nga Malësia e Shqipërisë? Ilirët ishin të parët që e përdorën këtë bimë për të ulur temperaturën dhe për të shëruar sëmundje të zemrës, ajo është e lakmuar dhe kërkohet edhe sot me emrin *Gentiana* në tregjet botërore. Sa më shumë e lexon librin, aq më shumë nxitesh të njohësh lashtësinë dhe historinë e popullit tonë, por po aq herë të shkon mendja te shumë e shumë gjëra që përqasen, që harmonizohen dhe të ngacmojnë mendimin të shprehesh, të thuash edhe ti diçka si lexues.

SOT E GJITHË BOTA ËSHTË NJË LIBËR I HAPUR

Sot e gjithë bota është shndërruar në një libër të hapur, ku mësohet çdo gjë "sa hap e mbyllë sytë" e deri në detaje. E kemi këtë mundësi më shumë se në dekadat dhe shekujt e mëparshëm, për t`ia prezantuar tërë botës Kombin dhe Qytetërimin tonë të lashtë. Mendoj se, jo vetëm libri në fjalë, por edhe vet personaliteti i Fatmir Terziut, vet vepra e tij e gjerë dhe e shumanshme, e bënë mrekullisht këtë. Ta bëjmë edhe ne, të gjithë. Jeta, nuk ka filluar kur kemi lindur ne, por breza të tërë para nesh kanë punuar e kanë luftuar, janë përpjekur e kanë sakrifikuar për ta ndritur këtë vend dhe këtë Dhe`, për të shtruar rrugët për brezat e ardhshëm.

Të parët tanë kanë bërë për ne, atë që ne të gjithë bëjmë kur punojmë, sakrifikojmë dhe luftojmë aq shumë për fëmijët tanë, për të ardhmen e mbesave dhe të nipërve tanë, që ata të ndihen sa më mirë dhe krenarë me atdheun e tyre, të ecin të sigurtë në jetë.

Faleminderit Fatmir Terziu për këtë vlerë artistike që na ke ofruar, për shërbimin e madh që i bënë historisë dhe kulturës sonë kombëtare edhe me këtë "Bunar'" që rrjedh uji të freskët e jetëdhënës.

nekrologji

Sherif Dervishi, biri i Dardhës



Nga **ILMI DERVISHI**

Sherif Dervishi, këngëtar dhe rapsod, u nda nga jeta më 21 nëntor 2019. Dervishi ndërroi jetë në spitalin "Nënë Tereza" në kryeqytet, pas një hemoragjie cereblare, e cila rezultoi fatale.

Ai ishte biri i Dardhës që e deshi dhe ju përkushtuar lindi në Lugjej në vitin 1961, në nje familje patriotike të Dali Dervishit. Në këtë familje ishte traditë dhe kënga por Sherifi qe në fëmijëri u ngjit në skenë e ra në sy për zërin e tij të veçantë.

Kënga e tij e parë "Shqipëri kala vigane" e kënduar më 1978, kur ishte vetëm 17 vjeç, por që u prit shumë mirë dhe si një zë premtues. Për arsye biografie nuk vazhdoi të shkollohej dhe u sistemua në punë në minierën e bakrit në rrethin e Mirditës, ku u aktivizua me grupin folklorik të minieres por edhe me Ansamblin e rrethit Mirditë.

Pas viteve 1995 u aktivizua si solist në Estradën Profesioniste të Peshkopisë ku interpretoi disa këngë, këndoj në disa skena brenda e jashtë Shqipërisë. Ka marrë pjesë në disa takime folklorike si në Turqi, në Festivalin "Sharri këndon" në Tetovë, nnë takimet folklorike të Danubit u vlerësua me çmim të dytë si instrumentist dhe si solist. Në Festivalin Folklorik në Gjirokastër këndoj këngën "Ç'po i folka burri-burrit", dhe në vitin 1993 mori pjesë në Festivalin e Beratit me këngën "Prej Dibre në Tiranë", ku pati jo vetëm duartrokitje por dhe vlerësime.

Krahas shumë këngëve Sherifi ka dhe disa vidioklipe të këngëve të tij si "A dëgjon një zë bilbili", "Nusja jonë vetull kurorë", "Ishe e mbete shqipe Lure", "Në sytë e tu marr dritë e shpirt", "Të falet kombi ty Mirditë", "300 djem - 300 duvak". Në gusht të këtij viti publikoj videoklipin "Këngë për Sali Dervishin", një duet me djalin e tij, Fatjonin.

Pak ditë më parë, me 15 nëntor 2019, në festimet për ansamblin "Kuvendi" të Zall Dardhës, Sherif Dervishit iu dha urdhëri "Naim Frashëri" i Klasit të Parë nga Presidenti i Republikës. Në këtë përvjetor ai u nderua edhe me certifikatë mirënjohje nga Ansambli "Kuvendi". Kënget e tij i dhanë tonin kësaj veprimtarie, duke mos menduar askush se kjo do të ishte kënga e tij e fundit në skenë.

Sherif Dervishi, admirues i shumë dashamirësve të muzikës, është "Qytetar Nderi" i Dardhës dhe së fundi, me unanim të plotë, Këshilli Bashkiak i Dibrës i akordoi titullin "Qytetar Nderi".

Dritë e këngës në flamur

Kushtuar këngëtarit virtuoz Sherif Dervishi

Nga **MEVLUD BUCI**

Hej, paska vdek Sherif Dervishi
Jo s`ka vdek por rron i gjallë,
Burrë vigan porsi lisi
Dardha e Lura e kanë djalë...

Hej, Dardha e Lura e kanë djalë
Sherif- kënga, bir Drini,
Lum si ti moj Zall-Dardhë,
Sherif Dervishi o xhevahiri...

Sherif Dervishi, xhevahiri
Shpirtin kish si ujët e Zetës,
Nëpër këngë, çel lule bliri
Nuk harrohet këngëtar i bjeshkës.

Nuk harrohet këngëtar i bjeshkës
Dibra e lashtë, mal i këngës,
O Sherif, bilbili i shkrepit
Dritë Arbnie, zjarr i zemrës.

Drit Arbnie, zjarr i zemrës
O Sherif, të nderon Lura,
Nëpër kohëra kurorë e pemës,
Të nderon në mejdan për burra.

Të nderon në mejdan për burra
Këngët e tua lule mbi gur,
Të nderon kombi, Dibra e Lura
Dritë e këngës në flamur...

ELEGJI PËR NJË MIK, NJË SHOK, NJË VËLLA, NJË NJERI QË SE TRET DHEU.

Eh, more **Nexh Tomçini** ç'na bëre...



Ai iku...
Nexh Tomçini sot nuk merr më frymë...
Nuk flet...
Nuk qesh...
Nuk përgjigjet në telefon...
Shoku im...
Miku im...
Vëllai im...
Njeriu që për mirësinë që përcolli...
S'e tret dheu...
Nuk e di ku do të prehet...
Në Pollozhan pranë Hasanit të Tomçineve...
Në Tiranë pranë Merzes...
Të mirës Merze...
"Nënë Terezës" Merze...
Pranë Sefedinit që iku duke fluturuar...
Nuk e di...
E pse ta di tash kur nuk do të më vijë më zëri...
Gushteve të nxehta kur bisedonim gjatë në telefon...
Unë nga Mali i Robit...
Ai nga Tirana...
Çdo vit...
Edhe këtë vit...
Këtë gusht që iku për të mos u kthyer më në biseda...
Zëra plot mall...
Eh mor Nexh ç'më bëre...
Eh mor Sulë ç'më hidhërove...
Pelin për mua germat që shkrove...
Pelin...
Pelin...
Pelin...
Nexhë !
Po të dërgoj dy fotografi...
Një bashkë...
Tek Ura e Drashovicës në atë udhëtim të bukur kohës kur ishim në një zyrë...
Dhe një portret nga takimi i fundit bashkë...
Tek kolonat e Pallatit të Kulturës...
Të qeshte zemra në atë takim...
Të ngazëllehej shpirti...
Ty...
Dhe mua...
Dua të përcjell një ngushëllim...
Për të pangushëlluarit...
Sulejmanin, vëllain e madh...
Ylli yt polar...
Për Përparimin...
Melodi e shpirtit tënd
Me lutjen...
Një këngë për Nexhën...
Mbi tela çiftelie...
Mbi tastiera pianoje...
Mbi gjëmime daulleje...
Për djemtë...
Nipërit...
Mbesat...
Eh sa do të doja sot...
Fytyrën të ta ledhatoja...
Plot mall...
Plot dashuri...
Ashtu siç ishte miqësia jonë...
E madhe...
Njerëzore...

Abdurahim Ashiku, *Athinë, 19 tetor 2019*